

**PERFORMANCA FINANCIARE E INSTITUCIONEVE
MIKROFINANCIARE NË KOSOVË**

Qefsere Kupina

Dorëzuar
Universitetit Evropian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca
Ekonomike me profil Financë, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Drini Salko

Numri i fjalëve: 50,757

Tiranë, Janar 2018

DEKLARATA E AUTORESISË

Me përgjegjësi të plotë deklaroj se punimi “Performanca Financiare e Institucioneve Mikrofinanciare në Kosovë”, është punë origjinale e autorit dhe për herë të parë dorëzohet pranë komisionit për vlerësim dhe përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës pranë Universitetit Evropian të Tiranës.

ABSTRAKTI

Efektet në zbutje të varfërisë, ekonomi familjare, fermerë etj, përmes qasjes në shërbime financiare, si kredi të vogla të ofruara nga institucionet mikrofinanciare, kanë bërë që aktivitetet mikrofinanciare të marrin vëmendje të konsiderueshme gjatë dekadave të fundit. Që ky ndikim të jetë afatgjatë institucionet mikrofinanciare preferohen të operojnë me performancë të vetëqëndrueshme.

Në Kosovën e pas vitit 1999 themelimi i institucioneve mikrofinanciare mori vëmendje të madhe, duke u vlerësuar në vazhdimësi si nevojë për mbështetje sociale dhe zhvillim ekonomik, përkundër debateve kundërshtuese për mënyrën e operimit të IMF-ve gjatë viteve të fundit.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të hulumtojë mbi ecurinë e institucioneve mikrofinanciare(IMF-ve) dhe përcaktimin e faktorëve që ndikojnë në performancën financiare të tyre në Kosovë.

Përcaktimi i faktorëve që ndikojnë në performancën financiare të IMF-ve, rezulton temë e shumë studiuar nga autorë ndërkombëtarë si nga aspekti teorik dhe empirik, gjetjet e të cilëve ndryshojnë varësisht nga vendi, koha dhe faktorët që janë marrë për studim.

Në këtë punim, vetëqëndrueshmëria operative bazohet në aftësinë e IMF-së që përmes të ardhurave të gjeneruara të mbuloj shpenzimet operative dhe të kenë kthime nga aktivet si faktorë i rëndësishëm i fitueshmërisë së tyre duke matur kështu efikasitetin e menaxhmentit të institucionit dhe si rrjedhojë performancën financiare të tyre në Kosovë.

Analiza e trendit të faktorëve të performancës përfshin periudhën e viteve 2012-2016, të cilat tregojnë një rritje të faktorëve kryesor të performancës, sipas raporteve të shfrytëzuara nga BQK-së dhe AMIK.

Në anën tjetër të dhënat dytësore, sipas platformës MIX e mirënjohur ndërkombëtarisht, e cila përmban informacione të faktorëve social dhe financiar të IMF-ve nga e gjithë bota, janë përdorur për të matur performancën financiare të IMF-ve që operojnë në Kosovë.

Modeli i regresionit linear dhe regresionit logjistik binar janë përdorur për të përcaktuar faktorët që ndikojnë në performancën financiare të IMF-ve në Kosovë. Në kemi gjetur mangësi në periudha për raportim të faktorëve të performancës nga ana e IMF-ve. Kemi identifikuar se me operimin gjatë viteve IMF-të nuk do të arrijnë vetëqëndrueshmëri operative dhe përfitueshmëri. Kjo është pasojë e rritjes së shpenzimeve operative mbi aktivet, që është faktori kryesor i mos arritjes së performancës financiare të pritshme dhe si rrjedhojë kemi rekomanduar se IMF-të në Kosovë duhet të menaxhojnë në mënyrë më efektive aktivet e tyre me qëllim të arritjes së performancës financiare pozitive për të operuar në drejtim të misionit për të cilin janë themeluar.

ABSTRACT

Effects on the poverty reduction, households, farmers, etc., achieved through access to financial services, mainly small loans, offered by microfinance institutions, made that microfinance activities take a considerable attention during the last decades. In order that these impacts to be long term, microfinance institutions should take in consideration to show operate self-sufficiency performance

In Kosovo after the 1999, establishment of microfinance institutions received great attention. Being evaluated continuously as the need to support social and economic development, despite the controversial debates about the IMF's operations in recent years.

In the absence of other previous domestic studies, the main aim of this paper is to research the progress of microfinance institutions (MFI) and determinate of indicators that impact financial performance of microfinance institutions that operate in Kosovo.

Determination of the indicators that affect the financial performance of the MFI, results as a highly studied topic from international authors, both in theoretically and empirically aspects, whose findings vary depending on the country, time and indicators that have been taken for the study.

In this paper, operational self-sustainability is based on the ability of the MFI that through generated revenues to cover operating costs and to have returns from assets as an important indicator of their profitability, thus measuring the efficiency of the institution's management and, consequently, financial performance of them in Kosovo.

The analysis of the trend of the performance indicator include the period 2012-2016, showed an increase in the values of key performance indicators, according to the reports used by CBK and AMIK.

Secondary data, based on MIX well known international platform that contains social and financial indicator information for MFI from all around the world, are used to measure financial performance of MFI-s that operate in Kosovo.

The linear regression model and binary logistic regression were used to determine the indicators that affect the financial performance of MFIs in Kosovo. We have found deficiencies in reporting performance indicators by MFIs. We have identified that over time MFIs may not be self-sustainability and profitable. We have determined that the indikator such as operating expense on assets is the main indicator of not achieving expected financial performance and therefore we recommended that MFIs in Kosovo should manage their assets more effectively in order to achieve positive financial performance for operated in the direction of the mission for which they were established.

DEDIKIMI

Për më të dashurit,

Për bashkëshortin , AGRONIN dhe fëmijët, GRAMOZIN & DORUNTINËN

FALENDERIME

I jam mirënjohëse dhe falënderoj shumë, Profesor Drini Salko i cili bashkëpunoi gjatë këtij rrugëtimi, në mënyrë shumë profesionale dhe korrekte. Motivimi për të mos ndaluar për ta studiuar një temë të ndjeshme për vendin është padyshim shume e rëndësishme.

Ditët doktorale të organizuara nga Universiteti Evropian i Tiranës(UET) dhanë kontribut të madh në këtë punim. Përvoja të ndryshme, bashkëpunimi, debatet e zhvilluara me kolegë dhe pedagogë nuk kanë munguar. Ishte privilegj të isha në mesin e tyre.

I falënderoj miqtë, kolegët, shoqërinë, për respektin dhe vëmendjen e shtuar, gjatë kësaj periudhe të studimit .

Ajo pa të cilën nuk do të isha këtu, është familja ime të cilën e falënderoj dhe e përgëzoj për mirëkuptim gjatë gjithë kohës së studimit, Më mbështeti, më beri të ndihem e lumtur dhe e suksesshme duke e realizuar këtë projekt të rëndësishëm të jetës time. Nuk do ta arrija ndryshe. ME GJITHË ZEMER JU FALEMINDERIT.

Faleminderit, Familje e dashur, Profesor dhe Miq të nderuar ☺

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E AUTORËSISË	ii
ABSTRAKTI	iii
ABSTRACT	iv
DEDIKIMI	v
FALENDERIME	vi
PËRMBAJTJA	vii
LISTA E TABELAVE	ix
LISTA E FIGURAVE	xi
KAPITULLI I: HYRJE NË TEMË	1
1.1. Parashtrimi i problemit	3
1.2. Qëllimi dhe objektivat	5
1.3. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza	6
1.4. Metodologjia dhe metodat e punimit	7
1.5. Rëndësia e punimit	8
1.6. Struktura e punimit	9
KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS - HYRJE NË MIKROFINANCË	12
2.1. Themelimi i mikrofinancës	12
2.1.1. Përkufizimi dhe zgjerimi i konceptit mbi mikrofinancën	16
2.1.2. Dallimi i mikrofinancës me mikrokreditin	19
2.1.3. Evoluimi i mikrofinancës	21
2.1.4. Roli i mikrofinancës në luftën kundër varfërisë	22
2.1.5. Ndërtimi i Institucioneve Mikrofinanciare (IMF)	26
2.1.6. Modeli i shërbimeve të mikrofinancës	31
2.1.7. Roli i mbështetjes në zhvillimin e mikrofinancës	36
2.1.8. Transformimi i mikrofinancës	38
2.2. Mikrofinanca në Evropë	41
2.2.1. Promovimi i mikrokredisë në vendet e Unionit Evropian	43
2.2.2. Misioni i institucioneve mikrofinanciare	45
2.2.3. Madhësia dhe kërkesa për mikrokredi në vendet e Bashkimit Evropian	47

2.3. Teoritë mbi qëllimin e mikrofinancës dhe vlerësimi i performancës	49
2.3.1. Mbështetja e aktiviteteve të mikrofinancës	52
2.3.2. Qëndrueshmëria e institucioneve mikrofinanciare	54
2.3.3. Performanca dhe faktorët e performancës financiare	57
2.3.4. Faktorët të përdorur për vlerësim të performancës të IMF-ve	61
2.3.5. Studime empirike mbi vlerësimin e performancës të IMF-ve.....	71
2.4. Përmbledhje e kapitullit	76
KAPITULLI III: SITUATA EKONOMIKE DHE SOCIALE NË KOSOVË - NEVOJË PËR THEMELIMIN E MIKROFINANCËS.....	78
3.1. Zhvillimet kryesore të ekonomisë në Kosovë.....	79
3.2. Ecuria e sistemit financiar në Kosovë.....	83
3.2.1. Dinamika e zhvillimit të sistemit financiar	86
3.3. Roli i mikrofinancës në vendet e pas konfliktit	89
3.4. Vështirësi të përgjithshme themelimi i mikrofinancës në Kosovë.....	93
3.5. Reflektimet e mikrofinancës për zhvillim ekonomik dhe social.....	97
3.5.1. Kreditimi i mikrondërmarrjeve në Kosovë.....	98
3.5.2. Raporti i të varfërve me mikrofinancën	100
3.5.3. Bujqësia dhe financimi i fermerëve.....	103
3.5.4. Remitencat dhe mikrofinanca	105
3.5.5. Roli i mikrofinancës në fuqizimin e femrave	109
3.6. Përmbledhje e kapitullit	112
KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E PUNIMIT	114
4.1. Profili i shkurtër i sektorit të mikrofinancës në Kosovë.....	117
4.1.1. Aktivitetet dhe performanca e faktorëve kryesore të IMF-ve në Kosovë	124
4.2. Rëndësia e përdorimit të MIX.....	137
4.3. Metodologjia dhe të dhënat.....	138
4.3.1. Mbledhja e të dhënave	140
4.4. Specifikimi i modelit.....	143
4.5. Përmbledhje e kapitullit	145
KAPITULLI V: TË DHËNAT, ANALIZAT EMPRIKE, REZULTATET DHE DISKUTIMI	146
5.1. Përshkrimi dhe rezultatet e të dhënave të mbledhura përmes pyetësorit	147
5.1.1. Përshkrimi i rezultateve të nxjerra nga anketimi i zyrtarëve të IMF-ve	148

5.1.2. Përmbledhje nga perceptimi mbi faktorët e veçuar të performancës financiare	151
5.1.3. Mesataret nga perceptimi mbi faktorët e veçuar të performancës financiare	154
5.2. Statistikat përshkruese të variablave dhe analiza e korrelacionit.....	156
5.2.1. Variablat e varura, përfaqësuese të performancës financiare.....	157
5.2.2. Variablat e pavarura (shpjeguese)	160
5.3. Analiza e korrelacionit	167
5.4. Rezultati ekonometrik.....	169
5.4.1. Formimi i modeleve ekonometrike	173
5.4.2. Metoda dhe rezultati i regresionit linear për vetëqëndrueshmërinë operative.....	174
5.4.3. Metoda dhe rezultati i regresionit linear për kthimin nga aktivet	178
5.4.4. Metoda dhe rezultatet e regresionit logjistik binar.....	183
5.5. Përmbledhje e rezultatit të regresionit	186
5.6. Përmbledhje e kapitullit	188
KAPITULLI VI. PËRMBLEDHJE, KONKLUSIONE, REKOMANDIME DHE KUFIZIMET E PUNIMIT.....	190
6.1. KONKLUSIONE.....	191
6.2. REKOMANDIME	198
6.3. KUFIZIMET	199
6.3.1. E rëndësishme për studime në të ardhmen.....	201
LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA.....	202
SHTOJCA.....	212

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Mesatare e madhësisë së kredisë dhe organizatat mikrofinanciare në Evropë	48
Tabela 2. Trendi i numrit të institucioneve financiare në Kosovë	87
Tabela 3. Pjesëmarrja e femrave huamarrës në baza vjetore sipas IMF-ve	111
Tabela 4. Pjesëmarrja e femrave në baza vjetore- Bosnje dhe Hercegovine (BH).....	112
Tabela 5. Pasqyra e disa faktorëve të performancës sipas IMF-ve	121
Tabela 6. Krahasimi i aktiviteteve midis IMF-ve në Kosovë dhe vendet fqinje	123
Tabela 7. Trendi i aktiveve gjatë periudhës 2004-2011.....	125
Tabela 8. Trendi i aktiveve gjatë periudhës 2012-2016 (BQK).....	127
Tabela 9. Trendi i kredive gjatë periudhës 2004-2011	128

Tabela 10. Trendi i kredive gjatë periudhës 2012-2016 (BQK)	129
Tabela 11. Struktura e kredive në përqindje për ekonomi familjare dhe ndërmarrje	130
Tabela 12. Përqindja në mesatare e vetqëndrueshmërisë operative.....	134
Tabela 13. Trendi i të ardhurave dhe shpenzimeve të sektorit mikrofinanciar	135
Tabela 14. Numri i të anketuarve dhe pozita e punës në institucion	147
Tabela 15: Gjinia e të anketuarve	147
Tabela 16. Mesatare nga perceptimi i të anketuarve.....	155
Tabela 17. Ndarja e IMF-ve sipas statusit OSS	158
Tabela 18. Ndarja e IMF-ve sipas nivelit të ROA	160
Tabela 19. Fazat e operimit dhe rezultati i OSS	161
Tabela 20. Fazat e operimit dhe rezultati i ROA	162
Tabela 21. Përshkrimi i variablave të varura të përdorura në model	170
Tabela 22. Përmbledhje e modelit	174
Tabela 23. ANOVA modeli	174
Tabela 24. Koeficientet e variablave.....	175
Tabela 25. Përmbledhje e modelit	175
Tabela 26. ANOVA modeli	176
Tabela 27. Koeficientet e variablave.....	176
Tabela 28. Koeficientet e variablave për ekuacion	177
Tabela 29. Përmbledhje e modelit	178
Tabela 30. ANOVA modeli	179
Tabela 31. Koeficientet e variablave.....	179
Tabela 32. Përmbledhje e modelit	180
Tabela 33. ANOVA modeli	180
Tabela 34. Koeficientet e variablave.....	181
Tabela 35. Koeficientet e variablave për ekuacion	181
Tabela 36. Koeficientet e variablave për ekuacion	184
Tabela 37. Testet e vlefshmërisë të koeficienteve të modelit	185
Tabela 38: Përqindja e përgjithshme e vërtetimeve.....	185
Tabela 39. Variablat në ekuacion.....	185
Tabela 40. Tabela e statistikave	212
Tabela 41: Përshkrimi i variablave	212
Tabela 42. Tabelat e kryqëzuara për statusin e IMF-ve (2tabelat).....	213
Tabela 43. Tabela e kryqëzuar sipas fazave të operimit	213
Tabela 44. Testi i normalitetit – faktorët e përfshirë në modelin e regresionit.....	214
Tabela 45. Statistikat përshkruese- krahasimi i mesatareve IMF-ve sipas statusit.....	1
Tabela 46. Tabela e korrelacionit midis variablave të varura me ato të pavarura	1

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Periudhat e zhvillimit të aktiviteteve të institucioneve mikrofinanciare	41
Figura 2. Klasifikimi i definicioneve të mikrokredisë sipas llojit të kreditimit.....	47
Figura 3. Trekëndëshi kritik i Mikrofinancës	59
Figura 4. Rritja reale e Produktit të Brendshëm Bruto nëpër vite.....	80
Figura 5. Norma e rritjes së PBB në vendet e Evropës Juglindore	81
Figura 6. Struktura e sistemit financiar në Kosovë.....	85
Figura 7. Trendi i numrit të institucioneve financiare në Kosovë	87
Figura 8. Struktura e aktiveve të sistemit financiar sipas sektorëve	89
Figura 9. Shkalla e varfërisë në përqindje sipas zonave të banimit 2009-2011.....	101
Figura 10. Bruto Produkti Vendor (BPV) dhe remitencat në vitin 2012	107
Figura 11. Trendi i pjesëmarrjes së femrave në huamarrje (Kosovë).....	111
Figura 12. Trendi i pjesëmarrjes së femrave në huamarrje (BH).....	112
Figura 13. Shpërndarje gjeografike e degëve të IMF-ve sipas regjioneve.....	124
Figura 14. Trendi i aktiveve gjatë periudhës 2004-2011	126
Figura 15. Trendi i aktiveve gjatë periudhës 2012-2016	127
Figura 16. Trendi i kredive gjatë periudhës 2004-2011.....	128
Figura 17. Trendi i kredive gjatë periudhës 2012-2016 (BQK).....	130
Figura 18. Struktura e kredive të IMF-ve nëpër vite në mënyrë grafike	131
Figura 19. Norma e interesit nëpër vite sipas sektorëve kryesorë të shërbyer nga IMF-të	132
Figura 20. Të ardhurat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar 2012-2016.....	135
Figura 21. Faktorët e Përfitueshmërisë të sektorit mikrofinanciar.....	136

KAPITULLI I: HYRJE NË TEMË

Kërkesa për shërbime financiare për biznese të vogla, mikronjësi, fermerë, individë duke përfshirë edhe kërkesat nga njerëzit me të ardhura të ulëta dhe ata më të varfër, kërkon një studim jo vetëm teorik të ndërmjetësve financiar por edhe analizë dhe vlerësim të performancës së tyre. Në këtë drejtim është bërë e ditur që bankat tregtare hezitojnë dhe nuk janë të interesuara tu shërbejnë klientëve të mësipërm me shërbime financiare. Këtë rol e kanë mundësuar institucionet mikrofinanciare (IMF), të cilat sipas, Barr (2005) kanë demonstruar se është e mundur tu shërbejnë këtyre klientëve, që edhe ata të veprojnë në drejtim për të arritur në nivelin e duhur ekonomik.

Rritja e konsiderueshme e mikrofinancës që nga viti 1980, ka ndikuar që donatorët aktivisht të mbështesin dhe të inkurajojnë aktivitetet mikrofinanciare, duke u fokusuar në institucione mikrofinanciare që janë të angazhuara për të arritur shtrirje dhe qëndrueshmëri financiare (Ledgerwood, 2000:2). Qëndrueshmëria e institucioneve mikrofinanciare, është konsideruar e rëndësishme për mikrofinancën, në të kundërtën ato bëhen një mjet kalimtar i arritjes së të varfërve dhe humbasin fuqinë e tyre si një komponent për strategji të gjerë të zhvillimit në çdo mjedis (Hollis dhe Sweetman, 1998; Otero 1999).

Mikrofinanca përfshin programe të larmishme, të cilat fokusohen në ofrimin e shërbimeve financiare për familjet e varfra, të cilat e kanë bërë qëndrueshmërinë financiare qëllimin kryesor, ose të tjerat janë fokusuar në ndikimet e ndryshme ekonomike dhe sociale (Morduch, 2000:626). Sipas Mark Schreiner (2000), qëndrueshmëria është “aftësia për të përsëritur performancën nëpër kohë” dhe performanca është “përmbytje e misionit të

mikrofinancës”, që për mision kanë të ndihmojnë të varfrit dhe të pa shërbyerit, për të lehtësuar qasjen e tyre në shërbime financiare.

Institucionet mikrofinanciare duhet të arrijnë qëndrueshmërinë financiare me qëllim që të ofrojnë shërbime të qëndrueshme mikrofinanciare dhe të kontribuojnë në luftim të varfërisë, (Nyamsogoro,2010;LOGOTRI.2006; Shcreiner,2000;Hollis and Sweetman,1989;Christel et al,1995;Krahnne dhe Schmidt,1994; Adam et al,1984).

Duke e vënë theksin në shumë punime ndërkombëtare, të cilat theksojnë se ekziston një numër i madh i IMF-te në botë të cilat ende nuk arrijnë qëndrueshmëri financiare, është e rëndësishme për të identifikuar se cilët janë faktorët që ndikojnë në performancën financiare.Prandaj, vlerësimi dhe përcaktimi i faktorëve që e ndikojnë performancën financiare konsiderohet i një rëndësie të madhe, si për zhvillimin social dhe atë ekonomik të një vendi, ashtu edhe për vetë institucionin që operon.

Në shumë punime shkencore janë përdorur faktorë të rëndësishëm për matjen e performancës së IMF-ve. Ata grupohen si në faktorët e shtrirjes (gjerësia dhe thellësia e institucioneve),faktorët e qëndrueshmërisë së përgjithshme financiare (vetëqëndrueshmëria operative dhe vetëqëndrueshmëria financiare, përfitueshmëria), efikasiteti dhe produktiviteti, cilësia e portofolit të kredisë, menaxhimi dhe faktorë të tjerë për të cilët duhet të sigurohet një program afatgjatë që lidhet me aktivitetin dhe ofrimin e shërbimeve financiare në përputhshmëri të plotë me objektivin, qëllimin dhe misionin e një IMF-je. Ekzistojnë evidenca të shumta të cilët i japin përparësi matjes së performancës financiare ose asaj sociale. Kjo ndodh pasi ekzistojnë ndarje të mendimeve ekonomike mbi qëllimin

kryesor të mikrofiancës. Një grup studiuesish sugjeron se primare është forcimi financiar i institucionit, për të krijuar një institucion të qëndrueshëm për të shërbyer të varfrit. Studiues të tjerë sugjerojnë përdorimin e shërbimeve financiare, si një mjet për të lehtësuar varfërinë e thellë e shprehur midis pjesëmarrësve të shërbimeve, të cilët ndonjëherë kërkojnë subvencione. Të dyja këto do të trajtojnë kërkesat e të varfërve dhe atyre me të ardhura të ulëta.

1.1. Parashtrimi i problemit

Konsolidimi i sistemit financiar në Kosovën e pas vitit 1999 ka sjellë ndryshime të rëndësishme, rezultat i të cilave janë operimi efektiv i ndërmjetësve financiar, pjesë e të cilit bëhen edhe institucionet mikrofinanciare. Në këto rrethana të reja, krijimi i kushteve për themelimin të institucioneve mikrofinanciare (IMF) në Kosovë u mundësua nga aktiviteti i programeve të zhvillimit ekonomik të organizatave humanitare ndërkombëtare. Këto ishin të rregulluara si OJQ nga Misioni i Kombeve të Bashkuara (UNMIK), për t'u regjistruar më vonë në Ministrinë e Shërbimeve Publike, fitimi i të cilave ishte i përjashtuar nga taksat. Institucionet mikrofinanciare në Kosovë u themeluan në përputhje me misionin e tyre për të përmirësuar standardin e jetesës dhe zhvillimin ekonomik në baza të qëndrueshme dhe afatgjate, duke ofruar shërbime financiare (kredi të vogla) për njerëz të varfër, biznese të vogla, ekonomi familjare, bujq etj., të kufizuar në shërbime financiare që ofrojnë bankat tregtare. Pa dyshim, në kushtet e pasluftës ashtu edhe kushtet sociale dhe ekonomike në të cilat u gjend Kosova, ekzistenca e institucioneve mikrofinanciare zë një vend të rëndësishëm.

Kur i referohemi AMIK¹ dhe BQK², aktiviteti i Institucioneve Mikrofinanciare në Kosovë është i shtrirë më shumë në zona urbane dhe më pak në ato rurale duke mundësuar shërbime financiare (kredi të vogla) për klientë, të cilët kryesisht janë individë me të ardhura të ulëta, ekonomi familjare ose mikro ndërmarrje të cilët kanë mundësi të pakta për këto shërbime nga bankat tregtare. Kontributi i dhënë nga IMF-të në Kosovë, sipas AMIK (2016) tregon tendencë të rritjes së aktiviteteve të këtyre institucioneve. Shuma mesatare të kredisë të akorduar për klient gjatë vitit 2015 arriti në 1900 euro. Aktivitetet e IMF-ve janë të shtrira përmes 98 degëve, të cilat mbulojnë tërë territorin e Kosovës. Këto degë ofrojnë shërbime për afër 53 mijë klientë aktiv me një staf prej 711 punonjës. Si rrjedhojë e këtyre aktiviteteve performanca e IMF-ve gjatë viteve të fundit sipas raporteve të BQK-së ka treguar përshejtim të kredi dhënies duke i bërë ato kontribuuese edhe në sistemin financiar të vendit gjithashtu.

Në kërkim të dhënave sasiore është identifikuar një bazë e të dhënave e përdorur nga shumë studiues ndërkombëtarë që për qëllim kanë marrë të studiojnë performancën financiare të IMF-ve duke përdorur numër të ndryshëm të faktorëve të të cilët ndikojnë në rritje të performancës financiare të IMF-ve. Në platformën e MIX, vihet re raportim i numri të madh i faktorëve të performancës (afër 90) të cilat pasqyrojnë llojin dhe vëllimin e aktiviteteve sociale dhe financiare, të cilat zhvillohen nga sektorë të mikrofinancës nga e gjithë bota të ndara sipas rajoneve³. Në këtë platformë vërehet ndarja sipas statutit siç e raportojnë IMF-të si; unionet e kreditit, banka, IFJB, OJQ dhe tjera. Në rajonin e Evropës

¹ AMIK- Agjensioni i Institucioneve Mikrofinanciare në Kosovë

² BQK- Banka Qendrore e Kosovës

³ Rajonet të ndara : Afrika, Azia, Evropa Lindore dhe Azia Qendrore (ECA), Amerika Latine, Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut (MENA)

Lindore dhe Azisë Qendrore(ECA) (siç është e klasifikuar në MIX) pjesë e së cilës janë IMF-të që operojnë në Kosovë .

Institucionet mikrofinanciare që operojnë në Kosovë, siç është vënë në pah, ende gjenden në mes të një mentaliteti të OJQ-së dhe institucionit profesional që është sfidë më vete për shkak të statusit të pa qartë të IMF-ve. Nëse i referohemi raporteve të BQK-së dhe ligji për IMF-të i cili nuk është aprovuar ende në kuvend, konsiderohet jo vetëm si i rëndësishme por edhe i domosdoshëm. Si rezultat, i gjendjes aktuale të operimit dhe vlerësimit mbi dobitë që sektori mikrofinanciar i ofron popullatës së Kosovës, matja e performancës dhe përcaktimi i faktorëve që ndikojnë në performancën financiare, paraqet një rëndësi të madhe e cila mund të përdoret si faktorë për të shqyrtuar pritjet për të ardhmen nga IMF-të në Kosovë, e pa studiuar plotësisht në ndonjë punim të mëhershëm në vend.

1.2. Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të hulumtojë mbi ecurinë e operimit të institucioneve mikrofinanciare, të analizoj trendin e performancës dhe të përcaktojë faktorët që ndikojnë në performancën financiare të IMF-ve që operojnë në Kosovë.

Ky punim synon të arrijë objektivat si më poshtë:

1. Të hulumtojë faktorë që ndikojnë në performancën financiare të institucioneve mikrofinanciare bazuar në literaturën bashkëkohore.
2. Të analizojë ecurinë në kohë të faktorëve kryesorë të performancës financiare të IMF-ve në Kosovë.
3. Të përcaktojë dhe analizojë faktorët që ndikojnë në performancën financiare të IMF-ve në Kosovë.

4. Të evidentojë problemet lidhur me performancën e IMF-të gjatë operimit në Kosovë dhe te japë rekomandime për rritjen e saj.

1.3. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza

Ekziston një numër i madh i faktorëve që përdoren për të matur ndikimin në performancën financiare. Megjithatë, jo të gjithë faktorët janë njësoj të rëndësishëm për performancën financiare të IMF-ve dhe jo të gjithë ofrojnë rezultate të njëjta. Prandaj, në këtë punim parashtrojmë dy pyetje kërkimore në dy drejtime të performancës financiare.

1. Cili është ndikimi i moshës (përvojës), madhësisë (vlera e aktive), faktorët e shtrirjes (portofolit të kredisë, numri i huamarrësve aktiv, shumës mesatare të kredisë, huamarrëset femra) dhe faktorët e efikasitetit (shpenzimet operative mbi aktivet, shpenzimet operative mbi portofolin e kredisë, shpenzimet e personelit mbi portofolin e kredisë dhe kostoja për huamarrës) lidhur **me vetqëndrueshmërinë operative të IMF-ve në Kosovë?**
2. Cili është ndikimi i moshës (përvojës), madhësisë (vlera e aktive), faktorët e shtrirjes (portofolin e kredisë, numri i huamarrësve aktiv, shumës mesatare të kredisë, huamarrëset femra) dhe faktorët e efikasitetit (shpenzimet operative mbi aktivet, shpenzimet operative mbi portofolin e kredisë, shpenzimet e personelit mbi portofolin e kredisë dhe kostoja për huamarrës) lidhur **me kthimin nga aktivet të IMF-ve në Kosovë?**

Mbi bazën e këtyre synimeve dhe pyetjeve kërkimore është ngritur hipoteza e cila paraqitet në vijim:

Hipoteza1. *Mosha e institucionit, madhësia, faktorët e shtrirjes dhe faktorët e efikasitetit janë të rëndësishëm për performancën financiare e përfaqësuar përmes;*

1.1. vetëqëndrueshmërisë operative (OSS); dhe

1.2. kthimit mbi aktivitet (ROA)

1.4. Metodologjia dhe metodat e punimit

Këtë pjesë të punimit do ta shtjellojmë më shumë në kapitullin e katërt dhe gjithashtu në kapitullin e pestë të këtij punimi. Megjithatë, këtu paraqesin disa nga pikat më kryesore përmes së cilave është zhvilluar ky punim.

Duke filluar me shqyrtim e literaturës së gjerë bashkëkohore e cila ka qenë pikë referuese për të marrë më shumë informacione mbi historikun e përgjithshëm të mikrofinancës si dhe rritjen dhe rëndësinë që ajo ka treguar dekadave të fundit. Studimet empirike që kanë trajtuar faktorët përcaktues të performancës financiare për institucionet mikrofinanciare në vende të ndryshme, janë përdorur si orientim për përzgjedhjen e faktorëve të vlerësuar më të rëndësishëm për të matur ndikimin në performancën financiare të IMF-ve, ashtu si janë shfrytëzuar në vende të ndryshme të ngjashme me Kosovën.

Raportet vjetore të publikuara si ato në faqe zyrtare nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe Agjensioni i Institucioneve Mikrofinanciare në Kosovë (AMIK), lidhur me faktorë të performancës për IMF-të që operojnë në Kosovë, janë përdorur për të analizuar ecurinë, zhvillimin dhe trendin e performancës gjatë viteve të fundit.

Të dhënat cilësore i kemi përmbledhur bazuar në realizimin e intervistave dhe të bashkëbisedimeve përmes pyetësorit të ndërtuar me përfaqësues të IMF-ve të cilat kanë

pranuar të jenë pjesë e këtij kërkimi. Ky proces ka pasur për qëllim të marrë perceptimin mbi faktorët e përzgjedhur dhe ndikimin e tyre në performancën financiare të IMF-ve që operojnë në Kosovë.

Qasja me metodën sasimore, na mbështet në përdorimin e të dhënave dytësore, pjesë e rëndësishme e këtij punimi. Të dhënat janë siguruar duke u qasur në platformën e mirënjohur ndërkombtarisht të MIX, në të cilën raportohen një numër i madh i faktorëve të performancës sociale dhe financiare nga shumë IMF-të nga e gjithë bota, pjesë e të cilës platformë janë të dhënat e raportuara nga 11 IMF-të nga 13 që operojnë në Kosovë.

Metoda e regresionit linear dhe regresionit logjistik binar janë përdorur për të përcaktuar faktorët që e ndikojnë performancën financiare të cilës në këtë punim është e përfaqësuar nga vetëqëndrueshmëria operative (OSS) dhe kthimi nga aktivet (ROA).

Vetëqëndrueshmëria operative (OSS) është masa e cila paraqet aftësinë e IMF-së për të mbuluar shpenzimet operative nga të ardhurat operative të gjeneruara. Kthimi mbi aktivet (ROA) është matës i përgjithshëm i fitueshmërisë i cili reflekton marzhën e fitimit dhe efikasitetin e institucionit.

1.5. Rëndësia e punimit

Kontributi i institucioneve mikrofinanciare është vlerësuar si shtytës i rritjes ekonomike menjëherë pas luftës në Kosovë, në kohën kur sektori financiar po thuaj se nuk ka ekzistuar. Rritja e besimit tek IMF-të, nga ana e klientëve të IMF-ve ndikohet edhe nga mos angazhimi i bankave tregtare vendore në ofrimin e këtyre shërbimeve financiare për këtë grup klientësh. Nga ana tjetër rritja e numrit të këtij grupi klientësh të IMF që marrin

kredi ulë mundësitë që ata ti drejtohen tregut informal të huave i cili ka risk shumë të lartë me pasoja të rënda ekonomike për ta.

Sektori i mikrofinancës është i përbërë nga institucione mikrofinanciare të cilët dallohen si për nga statusi por edhe për nga pronësia, e të cilat gjatë viteve të fundit kanë përsheptuar aktivitetin e tyre të kredi dhënies, e cila ishte rezultat i arritjes të numrit të klientëve (aktualisht 53 mijë) të cilët janë të kufizuar në shërbimet financiare të ofruara nga bankat komerciale duke u bërë pjesë e rëndësishme e sistemi financiar në vend.

Dhe në fund ajo që konsiderohet jo pak e rëndësishme, është plotësimi i një boshllëku me një punim me të plotë që studion faktorët që ndikojnë në performancën financiare të institucioneve mikrofinanciare në Kosovë. Padyshim ky punim do të pasuron literaturën vendore dhe gjithashtu mundë të përdoret nga praktikues të mikrofinancës, mbikëqyrësve dhe politik bërësve vendor në anën tjetër.

1.6. Struktura e punimit

Punimi është i strukturuar në gjashtë kapituj kryesor. Me shqyrtimin e literaturës marrim informacione mbi themelimin dhe ecurinë e vazhdueshme të institucioneve mikrofinanciare. Gjithashtu analizojmë metodat e përdorura për identifikimin e faktorëve që e ndikojnë performancën financiare, të cilat gjejnë aplikim për rastin e studimit në Kosovë. Si rrjedhojë edhe e situatës aktuale dhe zhvillimeve të IMF-ve në Kosovë është analizuar në funksion të qëllimit, objektivave, pyetjeve kërkimore dhe është ngritur hipoteza mbi çështjen e këtij punimi të cilat u pasqyruan përgjatë **kapitulli të parë** të këtij punimi.

Teoritë mbi mikrofinancën zënë vend të rëndësishëm në këtë punim, pasi ato ofrojnë një qasje për të kuptuar më mirë qëllimin e operimit të mikrofinancës. Për të hyrë më në thellësi, mbi themelimin, zhvillimin dhe teoritë mbi mikrofinancën, si dhe rëndësinë e përcaktimit të faktorëve të performancës financiare të IMF-ve, në **kapitullin e dytë** është shqyrtuar literaturë e gjerë, shumica ndërkombëtare.

E pa evitueshme është analiza e ndryshimeve në Kosovën e pas vitit 1999, përkrahja dhënë themelimit të sektorit të mikrofinancës, e cila në kohët e fundit debatohet në këndvështrime të ndryshme, sidomos kur është fjala për ndikimin në drejtim të zhvillimit social dhe atij ekonomik. Prandaj pasqyrimi i zhvillimeve dhe arritjeve të mikrofinancës në Kosovë, janë trajtuar në **kapitullin e tretë** të këtij punimi.

Metodologjia e punimit është pjesë e **kapitullit të katërt**, në të cilin është përshkruar mënyra e përzgjedhjes të faktorëve të performancës për studim, instrumentet e hulumtimit dhe përcaktimin e modelit ekonometrik. Për efekte të këtij punimi, do të shfrytëzohen të dhënat mbi faktorë të veçuar, të raportuar në platformën e MIX (www.mix.org), të cilat janë vlerësuar që kanë ndikim në performancën financiare të institucioneve mikrofinanciare, me theks për rastin e IMF-ve që operojnë në Kosovë.

Kapitulli i pestë në pjesën e parë trajton rezultatet e intervistave dhe bashkëbisedimeve mbi perceptimet e të anketuarve përmes pyetësorit të ndërtuar për këtë punim. Pjesa e dytë tregon rezultatet e dala nga statistikat përshkruese sipas të dhënave të MIX për periudhën 2000-2015 sipas raportimeve në vite, nga IMF-të që operojnë në Kosovë. Në vazhdim të këtij kapitulli, analizohet korrelacioni (lidhja) midis variablave të varura me ato të pavarura

(shpjeguese) nga të cilat është pritur të jenë të rëndësishme dhe me ndikim në performancën financiare. Pjesa e fundit e kapitullit të pestë, diskuton mbi rezultatet ekonometrike të nxjerra sipas modelit të regresionit linear dhe regresionit logjistik binar. Të dy këto metoda janë marrë në konsideratë për të vlerësuar ndikimin e faktorëve në performancën financiare të IMF-ve që operojnë në Kosovë.

Në **kapitullin e gjashtë** reflektojmë me një përmbledhje të përgjithshme kryesisht bazuar në literaturën e shqyrtuar, konkluzionet e nxjerra nga analiza e materialit të mbledhur, rekomandimet e dhëna të konsideruara të nevojshme si për institucionet mikrofinanciare dhe akterët tjerë relevantë për këtë sektor si dhe në fund paraqiten kufizimet me të cilat u ballafaquam gjatë këtij punimi doktoral.

Fjalët kyçe: *institucionet mikrofinanciare, vlerësimi i performancës, faktorët e performancës financiare, vetë qëndrueshmëria operative, kthimi nga aktivet, etj.*

KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS - HYRJE NË MIKROFINANCË

Mundësia për përzgjedhjen e duhur të literaturës shkencore është rritur. Pasqyrimi i drejtë është lehtësim për të zhvilluar idenë dhe për të arritur pritjet mbi çështjen e studiuar. Literatura informon në mënyrë konstruktive lexuesin për atë që është thënë më herët (Webster dhe Watson, 2002) dhe shqyrtimi i saj është vlerësim mbi atë që është publikuar lidhur me një temë, nga studiues dhe hulumtues të caktuar (Tayler dhe Procter, 2008). Sipas Fisher dhe Bugles (2010), literatura nënkupton mbledhjen e librave dhe dokumenteve që kanë të bëjnë për të njëjtën çështje dhe i përgjigjen njëra-tjetrës në zhvillimin e debateve lidhur me një temë. Në këtë drejtim, literatura e gjerë në dispozicion mbi themelimin, rritjen, teoritë, rëndësinë e mikrofinancës dhe identifikimin e faktorëve që ndikojnë në performancën financiare, paraqet përparësi për të marrë informacione të rëndësishme për fushën e këtij studimi.

2.1. Themelimi i mikrofinancës

Kufizimi i të varfërve në shërbime financiare ishte një ngecje e madhe që edhe kjo kategori të bëhej pjesë e shoqërisë ku jeton, e cila ka ngritur nevojën për studimin mbi rëndësinë e qasjes së të varfërve në shërbime financiare. Prandaj, para se të kalojmë në themelimin dhe ecurinë e mikrofinancës, është e rëndësishme të vihet në pah rëndësia e qasjes së të varfërve në shërbime financiare.

Qasja në shërbime financiare ulë cenueshmërinë dhe ndihmon njerëzit e varfër për të rritur të ardhurat e tyre, (Farhodova et al 2008) e cila është karakterizuar si një e mirë publike, pasi mundëson që njerëzit të jenë pjesë e përfitimeve nga ekonomia e tregut duke e krahasuar me qasjen në ujë, shërbime esenciale për shëndetin dhe edukim, nënvizojnë

(Hulme dhe Arun, 2009:1). Shmangia nga shërbimet financiare për ekonomitë familjare dhe për ndërmarrjet është pengesë për rritjen dhe mirëqenien e tyre. Kontributi që qasja në shërbime financiare ofron, është mbështetur nga Zeller dhe Meyer (2002), sipas së cilëve qasja ishte motiv për krijimin e rrjeteve të suksesshme të sistemit bankar në fshat si “Indonesian Bank Rakyat Indonesia (BRI)”, duke u zgjeruar në numër të Organizatave Joqeveritare (OJQ) me programe dedikuar kreditimit për të varfrit.

Njohjen mbi “qasjen në shërbime financiare” e nënvizon Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara,⁴ duke kujtuar rezolutat e saj 52/193 dhe 52/194 të 18 dhjetorit 1997, 53/197 të 15 dhjetorit 1998, 58/221 të 23 dhjetorit 2003, 59/246 të datës 22 dhjetor 2004 dhe 61/214 të datës 20 dhjetor 2006, në mënyrë të veçantë për të varfrit, duke përfshirë qasjen në mikrofinanca dhe në mikrokredi. Sipas dokumentit, mikrofinanca përmes programeve të mikrokredive ka treguar sukses në gjenerim të vetëpunësimit dhe në zbutjen e varfërisë, duke zvogëluar cenueshmërinë e të varfërve dhe me theks rritjen e pjesëmarrjes dhe fuqizimin e grave në aktivitetet socio-ekonomike.

Rritja e kërkesave nga të varfrit për shërbime financiare lidhet me themelimin e industrisë së mikrofinancës (Sinha, 2014), e cila mori hov që nga viti 1976. Është theksuar se mikrofinanca ka krijuar një histori të gjatë, por shumë studimeve u mungon thellësia historike. Evidencat tregojnë se lindja e mikrofinancave në Evropë daton në rritjen e jashtëzakonshme të varfërisë që nga shekulli i 16-të dhe i 17-të. Në Irlandë dhe Gjermani si dy vende me histori të ndryshme, mikrofinanca filloi të merrte rëndësinë e saj nëpërmjet zhvillimit të fondeve të kredive dhe të kursimeve në forma të ndryshme (Seibel 2005). Në

⁴ <http://www.un.org/esa/socdev/social/publications/resolutions/docs/microfinance.pdf>

Irlandë, fondet e kredive ishin zhvilluar që nga viti 1720 deri në 1950, që karakterizohen me: **a)** rritjen graduale të institucioneve informale, **b)** krijimin e institucioneve formale, ligjërisht të rregulluara, **c)** rënien, për shkak të represionit financiar. Përderisa, në Gjermani mikrofinanca fillon të zhvillohet gjatë viteve 1778 dhe vazhdon, duke u përqendruar në fonde të kursimeve, që ishin të bazuara në kursime të komunitetit, pastaj kishte vazhduar me lëvizje dhe me përhapjen e kursimeve dhe me tërheqje të kredive të bizneseve, duke përfshirë edhe kredi të kooperativave në mjedise rurale dhe urbane.

Zhvillimi i institucioneve mikrofinanciare përshpejtohet që nga periudha e dekolonizimit, kur u krijuan shtetet e reja dhe që atëherë bankat e mëdha në vende të zhvilluara kishin krijuar kushte që këto institucione të rriteshin dhe të ofronin shërbime me kushte të përshtatshme për të varfrit, e nënvizojnë, Srnec dhe Svobodova (2009). Ndërkohë, me programe të ngjashme, IMF-të operonin edhe gjatë viteve 1950 deri 1970, por të cilat nuk ishin treguar shumë premtuese, sepse ato ishin shoqëruar me standarde të larta të kredisë dhe me një pamundësi të përgjithshme për të arritur deri te familjet e varfra rurale (Robinson, 2001). Qeveritë dhe donatorët u përqendruan në ofrimin e kredive bujqësore të subvencionuara për fermerët e vegjël, me shpresën e rritjes së produktivitetit dhe të ardhurave (Robinson, 2001). Nga mesi i viteve 1980, subvencionimi (inspiruar nga modeli Raiffeisen i ngritur në Gjermani në vitin 1864, kur donatorët me qëllim për të subvencionuar me kredi bujqësore, kishin krijuar unione të kreditimit) ishte objekt kritik, sepse shumica e programeve kishin akumuluar humbje të mëdha të kredisë dhe shpesh kërkohej rikapitalizim për të vazhduar me tej, nënvizon (Robinson, 2001).

Gjatë viteve 1970 në vendet e zhvilluara qasja në mikrokredi ofrohet përmes programeve të ashtuquajtura “programe mikrofinanciare” (Hermes dhe Lensink, 2007). Sipas Hulme dhe Arun (2009), zhvillimi i programeve të mikrokredisë është rezultat i Bankës Grameen në Bangladesh, e cila ka bërë që sot në shumë vende të botës të ketë “modele” dhe sektorë të qëndrueshëm mikrofinanciar. Banka do t’ju ofrojë hua të varfërve, duke u zgjeruar për një periudhë të shpejtë në më shumë se 43,000 fshatra në afërsi të Bangladeshit.⁵ Kredia do t’ju ofrohet rreth 2.8 milionë huamarrësve, prej të cilëve 96 për qind janë të gjinisë femërore. Iniciativa ishte ndërmarrë nga Profesor Muhamed Yunus,⁶ e mbështetur nga studentë të tij, të cilët hartuan një listë me kërkesa të njerëzve që kanë nevojë për shuma të vogla të parave. Ishte kjo një pasqyrë e rëndë mbi atë se çfarë kërkonin të varfrit për të mbijetuar. Lista e formuar me 42 njerëz ishte kërkesë për një shumë minimale prej 27 dollarësh. Pasi që përpjekja e Profesorit për të siguruar një kredi nga banka e Universitetit ishte refuzuar, ai do t’i drejtohej bankës lokale për të marrë një kredi personale, të cilën e shpërndan tek fshatarët e të cilët më pas, pa asnjë problem e kthyen kredinë. Ishte një hap dhe dimension i ri për financim të mikrokredive. Për t’i mbështetur të varfrit që të marrin kredi të vogla, Profesor Yunus themelon një bankë dedikuar njerëzve të varfër, për të cilën më në fund kishte gjetur mbështetjen nga qeveria e vendit. I gjithë ky rezultat do të tregojë arritjen e vlerësimit të mikrofinancës me Çmimin Nobel të Paqes në vitin 2006 për Profesorin Yunus, që ishte pikërisht për kontributin e tij nga Bangladeshi dhe institucionin mikrofinanciar

⁵ Bangladeshi , është vend në Azinë jugore, dhe njihet si vend ku është themeluar mikrofinanca.

⁶ Profesor Muhamed Yunus ishte profesor ekonomie, i diplomuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vitin 1974. Ishte angazhuar në luftën kundër varfërisë, kohë kur kriza e ushqimit kishte përfshirë vendin e tij, Bangladeshin, i cili ishte një ndër vendet më të varfra në botë. Në vitin 1976 fillon Projektin Grameen, të cilit ia përkushton kohën me dekada pas këtij viti.

GRAMMEN bankë e cila që në vitin 1976 fillon të praktikojë programet e para të mikrokredive.

Rritja e mikrofinancës gjatë vitit 1980 është përgjigje ndaj dyshimeve dhe hulumtimeve mbi shpërndarjen e kredive nga shteti për të subvencionuar fermerët, thekson Ledgerood(1998). Kjo situatë sipas Robinson (2001), paraqet kthesë dhe zhvillim historik të mikrofinancës. Si rrjedhojë në vitin 1990 mikrofinanca do të shndërrohet në industri, duke përshpejtuar rritjen e numrit të institucioneve mikrofinanciare dhe rritje të shumës së huadhënies.

Mikrofinanca është duke u konsideruar si një pjesë e rëndësishme dhe kontribuuese e sistemit financiar në vendin ku ajo zhvillohet. Megjithatë ky sektor nuk mundë të jetë i plotësuar pa shqyrtimin e historikut, përkufizimin, mënyrën e operimit si dhe analizën e faktorëve që e ndikojnë performancës financiare të institucioneve mikrofinanciare që janë pjesë e këtij sektori.

2.1.1. Përkufizimi dhe zgjerimi i konceptit mbi mikrofinancën

Mikrofinanca sipas Otero (1999) nënkupton “ofrimin e shërbimeve financiare për njerëzit e varfër me të ardhura të ulëta, njerëzit shumë të varfër të vetëpunësuar”, e cila është zhvilluar duke praktikuar konceptet e zhvillimit social dhe ekonomik, si dhe parimet që janë themel i tregjeve financiare dhe komerciale. Mikrofinanca adreson drejtpërdrejt dimensionin e të ardhurave për të varfrit dhe në mënyrë indirekte, shëndetin dhe edukimin (Beatriz ,2009).

Dieckmann et.al (2007), mikrofinancën e konsiderojnë si “ombrellë” nën të cilën janë themeluar institucionet mikrofinanciare (IMF), për të ofruar shërbime financiare për pjesën e varfër të popullsisë, e cila nuk është shërbyer nga ofruesit kryesor të shërbimeve financiare.

Në terma më të gjerë, sipas Robinson(2001:9), mikrofinanca referohet sigurimit të shërbimeve financiare në nivel më të ulët, kredi dhe kursime, të cilat ofrohen për njerëz që merren me aktivitete si në bujqësi, sipërmarrje, mikrondërmarrje, të cilët kryesisht operojnë në rajone rurale por edhe urbane, të vendeve në zhvillim, ku shumica e këtyre familjeve kanë llojllojshmëri të ardhurash. Kësaj kategorie, sipas (Roy, 2003:11) zakonisht u mungon qasja në institucione formale financiare. Brau dhe Woller (2004), shtojnë se mikrofinanca i ofron fushës së financës një rrugë të mundshme për të bërë ndryshime të rëndësishme në jetën e miliona njerëzve të varfër.

Shumica mendojnë se mikrofinanca është e fokusuar tek gratë sipërmarrëse, ato janë korrekte në shlyerje të kredive dhe në shpërndarje të të ardhurave nga ndërmarrja tek familjet e tyre edhe pse një gjë e tillë nuk arrihet të dokumentohet (Karlan dhe Goldberg, 2007). Sipas, Alimukhamedova(2013), qasja në mikrofinanca ka ndikuar në rritjen e shpejtë të pjesëmarrjes së grave në shoqëri, sidomos në ato vende më pak të zhvilluara ku familja dhe përgjegjësia për rritjen e fëmijëve është e grave. Ajo që del në pah është se mikrofinanca ka evoluar si një qasje për zhvillim ekonomik, duke mos përjashtuar synimet që të përfitojnë gratë dhe burrat me të ardhura të ulëta. Nga ana tjetër, termi mikrofinancë ndonjëherë kufizohet në specifika si programe për kreditim, metodologji kreditimi në grup etj, megjithatë në përgjithësi i referohet të gjitha llojeve të shërbimeve financiare të ofruara

për njerëzit me të ardhura të ulëta dhe sipërmarrjet e vogla (Robinson, 2001:42). Për më tepër (Beatriz dhe Morduch, 2005:181), mikrofinanca është krejtësisht biznes tjetër, që ka të bëjë me biznese të vogla, të cilat shpeshherë përfshijnë të vetë punësuarit në sektorin joformal, ku gratë janë pjesa më e madhe në rritje e bizneseve në sektorin joformal. Karakteristikat tradicionale, të cilat e bëjnë të dallohet mikrofinanca, i gjejmë të përmbledhura tek Karlan dhe Goldberg (2007).

Një program të jetë i konsideruar si “mikrofinancë“, duhet të përmbajë një karakteristikat:

1. Kredi të vogla,
2. Kredi pa kolateral,
3. Kredi për aktivitet të sipërmarrjeve,
4. Kredi në grup,
5. Fokusi tek klientët e varfër,
6. Fokusi në shërbim të klientëve të gjinisë femërore,
7. Procedura të thjeshta aplikimi,
8. Ofrimi i shërbimeve për komunitetet e pashërbyera,
9. Norma e interesit – në nivel të tregut.

Përmbledhja e karakteristikave në nëntë grupet e paraqitura, sipas Karlan dhe Goldberg (2007), ofron një strukturë të mirë për pyetje të hapura mbi karakteristikat e produktit të mikrofinancës.

Industria e mikrofinancës kërkon të dhëna të sakta, me qëllim për të bindur donatorët, qeveritë dhe aksionarët e tjerë që mikrofinanca punon, zhvillon produktet dhe proceset e tyre me qëllim që të përshpejtojë ndikimin e tyre për të varfrit. Kështu që vlerësimi në perspektivë mund të ndihmojë IMF-të dhe politikë bërësit që të dizajnojnë më mirë institucionet. Një vlerësim i mirë ofron mundësi që donatorët të dinë më shumë mbi përfitimet nga investimi i tyre, gjithashtu vlerësimi i mirë u ofron institucioneve financiare një perceptim më të mirë se si të operojnë me biznesin e tyre dhe si mund të rrisin ndikimin

ekonomik e social. Nga sa u diskutua më lartë, shumica e përcaktimeve i referohet objektivit cili korrespondon me qëllimin e themelimit të mikrofinancës, çështje që do të trajtohet përgjatë gjithë punimit.

2.1.2. Dallimi i mikrofinancës me mikrokreditin

Qëllimi për të cilin është themeluar mikrofinanca ka sjellë në vëmendje shumë studime për të hedhur në dritë përmbajtjen dhe rolin e saj të saktë. Ekzistojnë përcaktime të ndryshme të klasifikuara si mendime ekonomike, shkolla ekonomike, kampe apo grupe të cilat bëjnë përpjekje të shpjegojnë qëllimin e mikrofinancës. Dallimi mbi kuptimin e termit “mikrofinancë “ dhe “mikrokredi” bëri që në debate teorike të paraqiten shpjegime të ekspertëve të fushës lidhur me atë se “çfarë trajton mikrofinanca”?

Grameen Bank, e njohur për ofrim të kredive të vogla për njerëzit e varfër dhe ata me të ardhura të ulëta, gjatë vitit 1990 bëhet model i mikrokredisë dhe termi mikrofinanciar kuptohet si ndërmjetësues financiar. Mikrokredia rezulton si produkt i institucioneve, siç është rasti i Bankës Grameen, me fluksin e dhënies së kredive shtresave shumë të varfra, e që sipas Hollis dhe Sweetman (1998) është bërë i njohur si në vende të varfra ashtu edhe në zonat rurale të vendeve të pasura. Nga mesi i vitit 1990, Grupi Konsultativ i Donatorëve për Ndihmën e të Varfërve (CGAP),⁷ arrin që revolucionin e mikrokredisë ta kthejë në revolucion mikrofinanciar, duke e profesionalizuar mikrofinancën (Seibel, 2005).

⁷ CGAP (Grupi Konsultativ për Ndihmë Ndaj të Varfërve) partneritet global i udhëhequr nga 34 organizata, përqipen për të përparuar përfshirjen financiare; zhvillon zgjidhje të reja nëpërmjet kërkimit dhe angazhimit praktik me ofruesit e shërbimeve financiare, hartuesit e politikave dhe financuesit, për të mundësuar qasje në nivel. E vendosur në Bankën Botërore, CGAP kombinon një qasje pragmatike ndaj zhvillimit përgjegjës të tregut me një platformë të evokimit, të bazuara në dëshmi për rritjen e qasjes në shërbimet financiare për nevojat e të varfërve për të përmirësuar jetën e tyre.

Elahi dhe Rahman (2006) shohim dy dallime midis mikrokrede dhe mikrofinancës. Të parin në aspektin e funksionit, pasi që ndryshimet sipas tyre janë më "kuptimore sesa përmbajtjesore" dhe të dytin në aspektin konceptual, dallimi është më shumë "themelor". Për Beatriz dhe Morduch (2005:14), konceptet janë të ndryshme kur flitet për gjendjen e financave rurale dhe natyrën e varfërisë.

Sipas punimit të Grupit nga Federata Bankare Evropiane,⁸ mikrofinanca në industrinë bankare të BE-së i referohet kredive të vogla, "mikrokreditimit" ose "mikrokredive" dhe konsumatorëve të vegjël tregtar, "mikrosubjektet. Mikrokedria në vlerë më të ulët se 25,000 euro u ofrohet kategorive të caktuara, të cilat, sipas Kraemer–Eis dhe Conforti (2009:13), janë: mikrondërmarrjet, ndërmarrjet e ekonomisë sociale,⁹ për ata që duan të bëhen të vetëpunësuar, njerëzit që punojnë në ekonominë informale, për të papunët dhe të tjerët që jetojnë në varfëri e të cilët nuk konsiderohen të mundshëm për bankën, për të cilën arsye u mungon qasja në burime tradicionale të kapitalit.

Mikrokedria, sipas Duvdack et al (2011), është zhvilluar në shumë mënyra dhe shihet si një komponentë e mikrofinancës e cila nga ana tjetër përfshin kursimet, sigurimet dhe shërbimet e pagesave për të varfrit. Ngjashëm, sipas CAGP,¹⁰ mikrofinanca i referohet një grupi të gjerë të shërbimeve financiare të përshtatura për nevoja të individëve të varfër.

⁸ Raporti i Federatës Bankare Evropiane – grupi punues i ekspertëve në financimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), shih në <http://www.ebf-fbe.eu/uploads/D1093k%20Microfinance%20EU%20banking%20industry.pdf>

⁹ Ndërmarrjet e ekonomive sociale kanë për qëllim shërbimin e anëtarëve ose komunitetit e jo thjesht për përfitime: ato mund të zhvillohen në të gjitha sektorët që plotësojnë nevojat e komunitetit.

¹⁰ <http://cgap.org/site-search/What%20Is%20Microfinance%3F>

2.1.3. Evoluimi i mikrofinancës

Për më shumë se tri dekada të themelimit, tregu i mikrofinancës nuk ka ndaluar evolucionin e saj, i cili i referohet ofrimit të shërbimeve financiare, kryesisht për të varfrit.

Me rritjen e mikrofinancës, që nga mesi i vitit 1980, bëhet e ditur se në ditët e sotme ekzistojnë mijëra institucione mikrofinanciare (IMF), të cilat ofrojnë shërbime financiare për më shumë se 100-200 milionë njerëz të varfër në mbarë botën. Sipas presidentit të Bankës Botërore, James W (Morduch 1999), “duke shërbyer mbi 100 milionë amvisëri të varfra, deri në vitin 2005, përmes programeve të mikrofinancës do të përfitonin 500-600 milionë të varfër”. Prandaj, modeli i mikrofinancës jo edhe pa kufizimet e saj, sipas Roy (2003), është një nga drejtimet e rëndësishme dhe potencialisht të suksesshme të zhvillimit në vendet në zhvillim.

Otero (1999) numëron tri dimensione të mikrofinancës, të cilat bëjnë një lidhje të mikrofinancës me zhvillimin. **Marrëdhënia me të varfrit**, e cila u mundëson të vetë punësuarve të krijojnë produkte, të ruajnë dhe të rrisin kapitalin që ata kanë, të merren me rrezikun dhe të shmangin humbjen e kapitalit. **Ndërtimi i institucioneve**, përmes të cilëve tenton të krijojë institucione private, të cilat ofrojnë shërbime financiare për të varfrit si një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen qeveritë. **Përfshirja në sistemin financiar** të vendit, ku institucionet mikrofinanciare zgjerojnë veprimtarinë e tyre sidomos në ato vende ku popullsia është e kufizuar nga shërbimet bankare apo institucionet e tjera financiare. Kur mikrofinanca arrin të përfshijë këto tri pika, atëherë ajo ka aftësinë për të krijuar ndryshime strukturore. Megjithatë, jo të gjitha institucionet arrijnë të përmbushin këto tri dimensione.

Me transformimin nga mikrokredia në mikrofinancë, familjet me të ardhura të ulëta do të përfitojnë me shumë sesa një kredi dhe atë përmes qasjes në një grup më të gjerë të shërbimeve financiare dhe shërbimeve sociale (Beatriz dhe Morduch, 2005:147). Kur institucionet mikrofinanciare angazhohen në marrjen e depozitave për të mobilizuar kursimet e ekonomive familjare, ato bëhen ndërmjetës financiar (Vetrivel & Kumarmangalam, 2010).

Me rritjen e numrit të programeve të mikrofinancës në vendet në tranzicion, që nga viti 1994, siç janë p.sh. rasti në Kinë, në Shqipëri dhe në Rusi, është dëshmuar se mikrofinanca përmbush premtimet për të kredituar sipërmarrësit e vegjël, shumica e të cilëve kanë vështirësi të kreditimit nga sistemi formal (Beatriz & Morduch, 2000:17). Kjo pasi edhe vendet në tranzicion përballen me sfidën për të gjetur mënyrat për të rritur të ardhurat e ekonomive familjare me të ardhura të ulëta dhe për të zgjeruar tregjet financiare.

2.1.4. Roli i mikrofinancës në luftën kundër varfërisë

Varfëria ekziston kur njerëzve u mungojnë mjetet për të plotësuar nevojat e tyre themelore, e cila është jo lehtë për t'u përcaktuar, pasi ekzistojnë shkallë të ndryshme të varfërisë. Si shembull, Banka Botërore vlerëson se varfëria ka të bëjë me nivelin e të ardhurave dhe shkalla e varfërisë bazohet në përqindjen e njerëzve që jetojnë nën një shumë të caktuar, siç është 1 USD (dollarë) në ditë (Banka Botërore, 2003). Para së gjithash, është i rëndësishëm identifikimi i njerëzve të varfër dhe nevojat e tyre themelore. Sipas të literaturës në një hulumtimet e Bankës Gjermane¹¹, mbi 1.1 miliard njerëz në botë jetojnë në varfëri ekstreme, e kjo nënkupton me më pak se 1 USD në ditë, dhe afërsisht 2.7 miliardë njerëz –

¹¹ Microfinance: An emerging investment opportunity, fq.3 (referuar të dhënave nga Banka Botërore)

apo rreth 40 për qind të popullsisë botërore, jetojnë me më pak se 2 USD në ditë. Këto faktorë i japin një dimension të ri rolit dhe rëndësisë për ta zhvilluar mikrofinancën.

Nevojat e të varfërve klasifikohen në kuptim të ngushtë, në "mjetet e domosdoshme për mbijetesë" dhe në kuptim më të gjerë në "mjetet që pasqyrojnë standardin mbizotërues në jetën në komunitet".¹² Sipas Leikem (2012), "fokusi për reduktimin e varfërisë që nga viti 1950-1980 ishte që të bëhej integrimi i të varfërve në ekonomi përmes performancës më të mirë makroekonomike". Kjo çështje, sipas autorit, ishte institucionalizuar në vitin 1944 me themelimin e Bankës Botërore,¹³ në kohën e krijimit të sistemit të Bretton Woods.¹⁴ Banka Botërore përqendrohet rreth organizatave të mëdha globale dhe në bashkëpunim me qeveritë e vendeve dhe institucionet e tjera formale, shpërndan kredi në vendet në zhvillim, nëse ato i përmbahen politikave të përcaktuara nga Banka Botërore.

Modeli i mikrofinancës, i themeluar nga Banka Grameen në Bangladesh në mes të vitit 1970, i cili ofron kredi të vogla për sipërmarrësit dhe bizneset e vogla, ishte vlerësuar si ndihmë për të varfrit dhe mundësi që ata të ndjekin fatin për zhvillimin e tyre. Synimi për të përfshirë në skemën e mikrokredise 100 milionë familje të varfra ishte vendosur në vitin 1997, në Samitin e Mikrokredisë. Profesor Yunus kishte bërë llogaritjet që deri në fund të vitit 2002 të jenë arritur të kreditoheshin së paku 35 milionë familje të varfra me mikrokredi. Llogaritjet do ta tejkalojnë shifrën, pasi ky numër u arrit që në vitin 2001. Përfitues nga mikrokredia ishin më shumë se 54 milionë familje të varfra në mbarë botën.

¹² <http://dictionary.reference.com/browse/poverty>

¹³ Qëllimi i saj është që të nxisë zhvillimin ekonomik të vendeve anëtare, duke dhënë kredi për projekte prodhuese dhe këshillim teknik. (https://sq.wikipedia.org/wiki/Banka_Bot%C3%ABrore)

¹⁴ Qëllimi i marrëveshjes së Bretton Woods ishte për të siguruar stabilitetin e kursit të këmbimit dhe për të parandaluar zhvlerësimin e monedhave në periudhën e pasluftës. FMN-ja ishte përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri. <https://www.fxslider.com/al/education/forexhistory/>

Dhe nga ky numër 26.8 milionë ishin në mesin e më të varfërve apo ata që jetonin me vetëm 1US dollarë në ditë (Yunus, 2003).

Për rolin e mikrofinancës, Atlay, (2007) bën lidhjen me luftën kundër varfërisë, e cila është dëshmuar duke siguruar sipërmarrësit me kapital të nevojshëm, që ata të fillojnë dhe të zgjerojnë aktivitetet e tyre ekonomike me ndikim edhe social. Në përputhje me këtë, duket se mikrofinanca u jep pushtet të varfërve, në vend se t'i bëjë ata të varur nga lëmosha. Kjo i mundëson përfituesit për të marrë përgjegjësinë për jetën e tyre, duke punësuar veten e tyre, duke kursyer për të ardhmen e tyre dhe duke investuar në bazë të prioriteteve të tyre.¹⁵ Yunus (2003) tregon se Bangladeshi është vendi ku shtrija e mikrokredisë ka përfshirë mbi 75 për qind të familjeve të varfra, përderisa në shumicën e vendeve ky faktorë nuk ka arritur 10 për qind të familjeve të varfra. Përfshirja në skemën e mikrokreditit të 100 milionë të varfërve, ishte qëllimi i Fushatës së Mikrokredisë të vitit 2005, si i vetmi rrjet global që lidh të gjithë akterët e sektorit të mikrofinancës dhe që përcakton dhe rregullisht mat progresin drejt qëllimeve për të përdorur mikrofinancën e për t'i dhënë fund varfërisë. Megjithatë, studime të tjera (Beatriz dhe Morduch, 2005:19) besojnë se mikrofinanca mund të bëjë ndryshime të vërteta në jetën e atyre që janë shërbyer, por nuk mund të jetë “ilaç” dhe as diçka magjike, prandaj nuk duhet pritur që të jetë kudo ose për të gjithë me të njëjtin ndikim.

Në zhvillimet e para, mikrofinanca është nënkuptuar si ofrues i kredive shumë të vogla (mikrokredi), që paraqet ”procesin e dhënies së kredive të shumave të vogla, që shpesh nuk tejkalojnë 100 dollarë, për të varfrit ose huamarrësit e tjerë, të cilat janë të injoruar nga

¹⁵ <http://www.planetfinance.or.jp/English/microfinance/index.php>

bankat tregtare” (Sengupta dhe Aubuchon, 2008). Po ashtu, kishte mendime se mikrofinanca ka dalë si zgjedhje për të mbuluar dështimet qeveritare për skemat e kredisë rurale, të cilat kanë pasur për qëllim për të përfshirë fermerët e vegjël në sektorin bankar formal, për të ofruar shërbime për ekonomi familjare¹⁶ me të ardhura të ulëta (Hulme dhe Arun:1). Fillimi dhe rritja e sektorit, duke zhvilluar programe të shpejta të mikrokredive për të varfrit, ishte bazuar pikërisht në kuadër teorik dhe vetëbesim të madh, se diçka duhet bërë rreth gjendjes së vështirë të varfërve.

Bankat tregtare nuk kishin interes për ofrim të shërbimeve financiare si kredi të vogla dhe depozita për klientët me të ardhura të ulëta, duke i parë si rrezik dhe të padobishme për biznesin e tyre. Mikrofinanca si disiplinë e re ka krijuar produkte dhe shërbime financiare, të cilat së bashku, u kanë mundësuar njerëzve me të ardhura të ulëta të bëhen klientë të këtij sektori. Sipas Murray dhe Boros (2002:10,11) mikrofinanca karakterizohet me:

- Shuma të vogla të kredive dhe kursimeve;
- Kredi afatshkurta (zakonisht deri në një vit);
- Format e pagesës me anë të kësteve të shpeshta (apo depozitave të shpeshta);
- Këstet e përbërë nga principi dhe interesi, që amortizohet në kohë;
- Normat e interesit për kredi më të larta se normat e bankave tregtare, por më të ulëta se sa “loan–shark rates”, të cilat pasqyrojnë punën intensive lidhur me marrjen e kredive të vogla dhe duke ju mundësuar qëndrueshmëri ndërmjetësve mikrofinanciar me kalimin e kohës;
- Qasja e lehtë me ndërmjetës mikrofinanciar kursen kohën dhe paratë e klientëve dhe u mundëson ndërmjetësve të kenë ide më të mira lidhur me statusin financiar dhe social të klientëve;
- Procedurat e aplikimit janë të thjeshta;
- Periudhë e shkurtër e procedimit (në mes të kompletimit, aplikimit dhe shpërndarjes së kredisë);

¹⁶ Ekonomitë familjare janë definuar si njësi, anëtarët e të cilëve ndajnë burimet ose/dhe kontribuojnë në krijimin e të ardhurave (sipas punimit të Michal Mutal dhe Caroline Tsilikounas).

- Klientët që paguajnë me kohë fitojnë të drejtën për kredi të përsëritur dhe me shuma më të mëdha;
- Përdorimi i normave të interesit në rënie (rënia e normave të interesit gjatë disa cikleve të kredisë), si një nxitje për të shlyer me kohë. Kreditë e mëdha janë më pak të kushtueshme për IMF-të, kështu që disa nga huadhënësit ofrojnë kredi të mëdha me norma relativisht të ulëta;
- Nuk kërkohet kolateral, që është e ndryshme nga praktikat e bankave tregtare. Në vend të kolateralit, ndërmjetësuesit mikrofinanciar përdorin metoda alternative, si vlerësimin e potencialit të klientit për shlyerje duke analizuar fluksin monetar, që është e bazuar në rrjedhën e flukseve monetare të gjeneruara nga aktivitetet për të cilat janë marrë kreditë, etj.

Është e rëndësishme se të kuptuarit e shkallës së varfërisë të një vendi ndihmon IMF-të ose donatorët në vlerësimin e nevojave të tregut për shërbimet mikrofinanciare dhe gjithashtu, mund të ndihmojë për të qartësuar objektivat e tyre (Ledgerwood, 1998).

2.1.5. Ndërtimi i Institucioneve Mikrofinanciare (IMF)

Sistemi financiar është zhvilluar duke ju përgjigjur kërkesave për financim në shumicën e ekonomive të zhvilluara. Megjithatë, ky sistem nuk plotëson një pjesë të kërkesës për shërbime financiare për të varfrit, për arsye të rregullimit të tregut (Adeyemi, 2008:29). Programet e institucioneve mikrofinanciare janë bërë komponentë e rëndësishme e strategjive për uljen e varfërisë apo nxitjen e promovimit të ndërmarrjeve mikro dhe atyre të vogla, Hulme (2000:2).

Sipas Otero(1999), qëllimi i mikrofinancës është lufta kundër varfërisë në nivel individual, e cila gjithashtu ka një rol të rëndësishëm në nivel institucional. Mikrofinanca tenton të krijojë institucione private, të cilat ofrojnë shërbime financiare për të varfrit dhe të cilat bëhen pjesë të infrastrukturës së vendit. Krijimi i këtyre institucioneve shihet si një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen qeveritë. Institucionet mikrofinanciare (IMF) janë

institucione speciale financiare dhe për nga natyra janë sociale dhe fitimprurëse (Nieto at.al, 2007).

Kjo tregon se forcimi i këtyre institucioneve kërkon trajtim të veçantë, për shkak të rëndësisë që ka për zhvillim të programeve për të varfrit dhe për “qëndrueshmëri financiare”.¹⁷ Qëndrueshmëria e institucioneve mikrofinanciare është shumë e rëndësishme për mikrofinancën, në të kundërtën ato bëhen një mjet kalimtar i arritjes së të varfërve dhe humbasin fuqinë e tyre si një komponentë për një strategji të gjerë të zhvillimit në çdo mjedis (Otero,1999:11). Edhe pas 30 viteve të fundit, rrjeti i institucioneve mikrofinanciare në botë është rritur në mënyrë shumë të shpejtë. Institucionet mikrofinanciare shihen si konkurrencte në ofrimin e huadhënies të parave, duke ofruar shërbime me kushte të favorshme për numër të konsiderueshëm të ekonomive familjare. Në anën tjetër, këto institucione po tentojnë që duke shfrytëzuar potencialin e tyre, të tërheqin më shumë burime financiare, në mënyrë që të rrisin numrin e klientëve dhe të promovojnë shërbime cilësore financiare.

Rasti më i mirë i suksesit të mikrofinancës është i Bankës Grameen, e cila rezulton me zgjerimin e saj në mbi 1084 degë, të shpërndara në mbi gjysmën e fshatrave të Bangladeshit (Roy, 2003). Gjithashtu, ishte e para nga IMF e cila kishte përfshirë kursimet e detyrueshme në strukturën e kreditimit. Nga klientët ishte kërkuar të vendosnin 5 për qind të vlerës së kredisë së marrë, e cila ishte e vënë në fondet në grup me rregulla të sakta të

¹⁷ Qëndrueshmëria financiare arrihet kur një biznes është në gjendje për të ofruar produkte dhe shërbime në treg me një çmim që mbulon shpenzimet e tyre dhe gjeneron një fitim <http://toolkit.smallbiz.nsw.gov.au/part/17/83/358>

mbitërheqjes, ku si rregull paratë nuk kishin të drejtë të tërhiqeshin para tri viteve (Sengupta dhe Aubuchon, 2008).

Ofruesit e mikrofinancës operojnë në dy sektorët, si në atë privat edhe në atë publik. Për të identifikuar hapësirat në tregjet kur ofrojnë shërbime financiare për mikrondërmarrjet, është me rëndësi të dihet cilët janë ofruesit ekzistues dhe si është zhvilluar tregu (Ledgerwood, 2013). Në rastin “kur tregjet dështojnë, sipërmarrësit nuk mund të tërheqin të gjithë kapitalin e nevojshëm për të drejtuar biznesin e tyre”. Si rezultat ata mund të përfundojnë në punëtorë krahu ose të merren me ndonjë biznes i cili nuk është më fitimprurës. Sipas një hulumtimi të bërë me mbi 2,880 ekonomi familjare në zonat rurale dhe gjysmë urbane në Tajlandë, i realizuar nga Pulson dhe Townsend (2001:2), nënvizuar nga Beatriz and Morduch, (2005:26), del në pah interesimi i të bërit sipërmarrës. Në të njëjtin hulumtim, të intervistuarit kishin shprehur interesimin për të vazhduar me biznes, mirëpo kufizimet financiare ishin pengesa për të vazhduar, qoftë me zgjerim të biznesit ose për të filluar një biznes të ri. Në studimet e bëra lidhur me kufizimet financiare, rëndësi i është dhënë lëvizjes së mikrofinancës (Beatriz and Morduch, 2005:26). Janë donatorët ata të cilët mund të përcaktojnë kush është aktiv në mikrofinancë dhe kush ka nevojë për mbështetje me fonde. Atje ku nuk zhvillohen aktivitete të mikrofinancës, praktikantët mund të përcaktojnë kush janë konkurrenca dhe ndikimin që ata kanë në atë treg, thekson Ledgerwood (2013). Gjithashtu, theksohet se IMF duhet të ofrojnë shërbime financiare që plotësojnë hapësirat dhe që të integrohen si një organizatë zhvilluese që të ofrojë shërbime financiare tregut me qëllim që të arrijë objektivat zhvillimore të tilla si: a) Uljen e varfërisë; b) Mbështetjen e grave ose grupeve të popullatës të pa favorizuara; c) Të krijojë punësim;

d) Të ndihmojë në zgjerimin e bizneseve ekzistuese dhe e) Të inkurajojë zhvillimin e bizneseve të reja.

Modeli i sistemit financiar u zhvillua në vitin 1990, duke kontribuar me sukses në zhvillimin e industrisë së IMF (Mayer, 2013). Termi "sistem financiar" është përdorur për të përfshirë të gjitha institucionet financiare, tregjet financiare dhe instrumentet, mjedisin ligjor dhe rregullativ, si dhe normat dhe sjelljet financiare (Mayer, 2013, Ledgerwood,1999). Sipas Ledgerwood,1999, sistemi financiar ndahet në:

A) Formal, që është i rregulluar nga autoritete monetare dhe bankare (Bankat Qendrore) ku përfshihen bankat publike dhe private, kompanitë e sigurimit dhe kompanitë financiare. Në rast se ndonjë nga këto institucione shërben bizneset e vogla të fermerëve, është një mundësi që këto të përfshihen në sektorin mikrofinanciar. Institucionet private në përgjithësi përqendrohen në zonat rurale, ndërsa ato publike janë të shtrira në zonat urbane dhe ato rurale.

B) Gjysmëformal, i cili nuk është i rregulluar nga autoritetet bankare por zakonisht është i licencuar dhe i mbikëqyrur nga agjenci të tjera të qeverisë. Si shembull janë unionet e kredisë dhe bankat kooperative, të cilat mbikëqyren nga një zyrë në krye të bankave kooperative. Edhe OJQ ndonjëherë janë konsideruar pjesë e sektorit gjysmëformal, sepse ato shpeshherë janë ligjërisht të mbikëqyrura dhe ka kërkesa për raporte. Institucionet gjysmëformale ofrojnë produkte dhe shërbime, të cilat janë midis atyre që ofrohen nga sektori formal dhe produktet e kursimeve shpesh marrin karakteristikat e të dy sektorëve.

Në shumë vende institucionet gjysmëformale shpeshherë marrin donacione ose mbështetje nga qeveria, përmes asistencës teknike ose subvencione për operacionet e tyre.

C) Informal, që vepron jashtë strukturës së rregullimit dhe mbikëqyrjes qeveritare. Përfshin huadhënësit lokalë, agjentët (fajdexhinjtë), grupet për vetë ndihmë dhe OJQ-të, si dhe kursimet e grupeve familjare, të cilat kontribuojnë në ndërmarrje të vogla. Këto institucione koncentrohen në sektorin informal të kredive dhe të depozitave për firma të vogla dhe ekonomi familjare. Shpeshherë kreditë jepen pa kolateral formal, mbi bazën e njohjes së huamarrësit.

IMF në periudhën fillestare kryesisht janë financuar nga donatorë me status të OJQ-ve, për të kaluar një proces drejt formalizimit dhe komercializimit, të cilat përpiqen të bëhen të pavarura duke synuar qëndrueshmërinë financiare (Vanroose & Bert D’Espallier, 2009). Zhvillimi i IMF duke ofruar shërbime të qëndrueshme mikrofinanciare zgjedh probleme në kreditimin bujqësor, në disa zona të varfra rurale (Meyer, 2013). Qeveria dhe donatorët ndërkombëtarë supozojnë se të varfrit kërkonin kredi të lira, duke menduar se ishte mënyra më e mirë për nxitjen e prodhimit bujqësor. Në vazhdim, donatorët formuan unione krediti, të inspiruara nga modeli Raiffeisen, i cili ishte i zhvilluar në Gjermani që në vitin 1864, fokusi i të cilave ishte në mjediset rurale, “t’i mësojë fermerët si të kursejnë”. Modeli i subvencionimit të kredive që fillimisht ishte i mbështetur nga shumë donatorë, hasi në kritika të vazhdueshme gjatë vitit 1980, sepse shumica e programeve kishin akumuluar humbje të mëdha të kredive dhe kërkonte rikapitalizime të shpeshta për operim të vazhdueshëm. Kjo solli deri te një qasje e re, e cila e konsideroi mikrofinancën pjesë përbërëse të sistemit financiar.

2.1.6. Modeli i shërbimeve të mikrofinancës

Mikrofinanca si disiplinë më e re ka krijuar produkte dhe shërbime financiare, të cilat së bashku u kanë mundësuar njerëzve me të ardhura të ulëta të bëhen klientë të tyre (Murray&Boros, 2002:10). Klientët janë të ndryshëm. Ata janë të vetëpunësuar, sipërmarrës me të ardhura të ulëta në zonat urbane dhe rurale, tregtarë, shitës në rrugë, fermerë të vegjël, ofrues të shërbimeve, profesioniste (flokhtarë, shoferë), zejtarë dhe prodhues të vegjël, të cilët nuk konsiderohen “më të varfrit ndër të varfër”, nënvizon Ledgerwood(1999:2).

Mikrofinanca ka për objektiv krijimin dhe zgjerimin e aktiviteteve, të cilat gjenerojnë të ardhura, duke u fokusuar në klientë potencialë, që zakonisht janë të interesuar për produkte të mikrokredive (Krameer-Eis dhe Confort, 2009). Institucionet Mikrofinanciare (IMF) nuk kufizohen vetëm në ofrim të kredive të vogla dhe kursimeve, por këtu mund të ofrohen edhe shërbime të sigurimit dhe shërbime të tjera pagesash, thekson Ledgerwood(2000:1).

Si rezultat, ”modeli mikrofinanciar, ndërsa jo pa kufizimet e tij, është një nga nxitësit më të rëndësishëm dhe potencialisht të suksesshëm të zhvillimit në botë” (Roy, 2003).Këto modele, sipas autorit, ndikojnë në “fuqizimin e të varfërve”, duke u dhënë atyre burime financiare që të gjenerojnë të ardhura shtesë, për t’i motivuar në krijim të vlerave, që ato t’i kthejnë me zhvillim. Ekziston një numër i metodave, të cilat institucionet mikrofinanciare i përdorin për të ofruar shërbime financiare (Murray dhe Boros 2002, Ledgerwood,1999);

- Kreditimi ne grup;
- Kreditimi individual;
- Unionet e kredisë;
- Kreditimi rural

- Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok.

i) Kreditimi ne grup

Sipas Murray and Borros (2002), shumica e institucioneve mikrofinanciare ofrojnë kredi përmes modelit së “kreditimit grupor”, pa kolateral. Ky model është konsideruar si një mënyrë ku kreditë janë akorduar në shuma të vogla për një numër të madh të klientëve, të cilët nuk mund të ofrojnë kolateral. Gjatë vitit 1980, kur mikrofinanca filloi të zgjerohet, kreditonte të varfrit në mjedise rurale, me qëllim që të gjenerojnë të ardhura, kryesisht përmes kreditimit ne grup me shuma të vogla, Lützenkirche (2012). Modeli më i suksesshëm i dhënies së kredive dhe kursimeve theksohet të jetë ai Bankës Grameen.

Banka Grameen, e themeluar në Bengali, ishte ndryshe nga bankat tradicionale dhe numri më i madh i huamarrësve ishin shtresa e të varfërve, nga të cilët nuk kërkohej kolateral. Përmes shfrytëzimit të shërbimeve të dedikuara për të varfrit,¹⁸ Prof. Muhamed Yunus beson se në çdo vit, 5 për qind¹⁹ të klientëve arrijnë të dalin nga varfëria, rrjedhojë e ofrimit të kredive pa ndonjë garanci financiare. Këtu ekziston dallimi midis kontratave me klientë të Grameen Bank me ato kontrata të bizneseve të vogla në bankat standarde (Morduch 1999. 12). Në një marrëdhënie standarde, huamarrësi jep kolateralin si garanci bankare, merr kredi nga banka, investon kapitalin për të gjeneruar një kthim dhe në fund paguan kredi me interes. Kur huamarrësi nuk arrin ta paguajë kredinë, kolaterali i tij konfiskohet nga banka. Shumica e klientëve që kërkojnë mikrokredi janë të varfër dhe nuk janë në gjendje për të ofruar kolateral. Kështu që Grameen Bank, i ofron përparësi klientit brenda

¹⁸ “Varfëria nuk ekziston në shoqërinë e civilizuar. Vendi i saj është në muze”, thekson Yunus. http://www.economists.com/media/globalexecutive/banker_to_the_poor_yunus_e.pdf.

¹⁹ Ka ende studime që janë të dyshimta mbi këtë shkallë të ndikimit të mikrofinancës dhe ato nuk mund të jenë të papritura ; thekson Anis Chowdbury (Dhjetor, 2009)

komunitetit të tyre. Kontratat e kredisë përfshijnë një grup të klientëve dhe jo një individ të veprorë i vetëm, në të cilat raste grupi vullnetarisht do të mbështesë ndonjërin nga individët nëse do të ketë vështirësi në kthim të kredisë. Në punimin nga Sengupta dhe Aubuchon (2008), procedura për kredi në grup përshkruhet për rastin e Bankës Grameen. Kërkesa për kredi në bankë bëhet nga grupi i huamarrësve (pesë anëtarë). Pas rënies dakord me bankën, kredia u ofrohet dy prej anëtarëve, të cilët duhet ta shlyejnë kredinë në kohën e caktuar. Më tutje kredia zgjerohet te dy anëtarët e tjerë të grupit, duke vazhduar deri tek i fundit, gjithnjë duke pasur parasysh shlyerjen me kohë të kredisë. Kjo është një procedurë kur kredia mund të zgjerohet në të ardhmen, në të kundërtën, nëse shlyerja e kredisë dështon nga ndonjëri anëtar i grupit, gjithë grupit i mohohet e drejta për qasje në kredi në të ardhmen.²⁰ Kjo procedurë bën që grupi të ushtrojë ndikim tek huamarrësit dhe kjo përgjegjësi u shërben si kolateral për kredinë.

Ndërkohë që formacioni i grupit të çon për të ulur kostot e transaksioneve për IMF, ka kosto sociale që lidhen me këtë proces. Këto kosto ndryshojnë në mes të shoqërive dhe madhësia e tyre varet nga marrëdhëniet themelore sociale (të cilat ndikojnë në lehtësimin/vështirësinë e formacionit të grupit) si dhe nga distanca që njerëzit duhet të kalojnë në udhëtim për të marrë pjesë në aktivitetet e grupit. Murray dhe Borros (2002: 11) theksojnë se në zonat rurale këto kosto janë më të larta.

Modeli i Bankës Grameen u shfrytëzua nga të varfrit dhe ata shumë të varfër, në më shumë se 58 vende të botës dhe nga më shumë se 8 milionë njerëz, duke u përdorur gjithashtu nga më shumë organizata dhe duke u përhapur edhe në Shtetet e Bashkuara. Në fund të viteve

²⁰ The Microfinance Revolution: An Overview; 2008

1990, për shkak të vështirësive në cilësi të portofolis së saj dhe rënies të kredisë, Grameen Bank u rimodelua në të ashtuquajturën Grameen Bank II. E projektuar të jetë më fleksibile, orari i shlyerjeve do të jetë i përshtatshëm me rrjedhën e të ardhurave familjare, përmbushja e kërkesave për produkte të sigurta dhe të besueshme dhe njohja e nevojave të ndryshme të klientëve. Këto ndryshime sollën që Banka Grameen të kalojë nga një huadhënës për mikrosipërmarrës në një bankë me pakicë për familje të varfra. Grameen II pasqyron ndikime të mikrofinancës në një klimë me qasje në shkallë më të gjerë, konkurrencë dhe risi.²¹ Banka Grameen ka normë të lartë të shlyerjes së kredive, gjë e cila tregon se mikrofinanca nuk është një bamirësi por ajo ndihmon për të bërë biznes.

ii) Kreditimi individual

Kjo formë e kreditimit mund të jetë e suksesshme tek fermerët e vegjël në zona rurale (Lengerood, 2000:83). Është një numër i vogël i institucioneve tradicionale, siç janë bankat, që ofrojnë kredi individuale për njerëzit me të ardhura të ulëta (Murray dhe Boros, 2002), kjo për arsye se klientët e varfër konsiderohen me rrezik më të lartë për shkak të mungesës së kolateralit. Banka Rakyat në Indonezi (BRI) dhe ADEMI në Republikën Dominikane janë shembull për suksesin që kanë treguar në ofrim të kredive individuale për klientë të varfër të mikrofinancës, theksojnë (Murray dhe Boros, 2002). Madhësia e kredive ndryshon nga 100 dollarë deri në 3000 dollarë, me kohëzgjatje në mes të gjashtë muajsh dhe pesë vitesh, të cilat zakonisht shpërndahen në zyre të degës (Ledgerwood, 2000:83).

²¹ <http://www.microfinancegateway.org/sites/default/files/mfg-en-paper-grameen-ii-and-portofolis-of-the-poor-jun-2010.pdf>

iii) Unionet e kredisë

Unionet e kredisë kanë një histori operimi më të hershme. Konsiderohet që ideja e krijimit të tyre të ketë lindur në Angli. Ky model kishte një filozofi e thjeshtë: “Njerëzit ndihmojnë njerëzit”. Janë të njohura edhe si kooperative financiare, të cilat ndryshojnë nga bankat e fshatit (Roy, 2003:13). Unionet e kredisë janë institucione të organizuara dhe të përbëra nga një grup të cilët bien dakord të kursejnë paratë e tyre së bashku dhe të ofrojnë kredi afatshkurtër sipas nevojave të anëtarëve të grupit (Murray dhe Boros, 2002:12). Këto përfshijnë kreditë për mikrondërmarrje, kredi personale dhe kredi për zbutje të të ardhurave, blerje të ushqimeve për ekonomi familjare etj. Madhësia e kredive ndryshon dhe është e lidhur në mënyrë tipike me nivelin e huamarrësit të kursimeve në institucion. Në Afrikën Perëndimore, mesatarja e kredive nga Unioni i kredisë është 190 dollarë, dukshëm më e lartë dhe më e vetëmjaftueshme se kredia nga banka e fshatit (Roy, 2003:13).

iv) Banka e fshatit

Banka e fshatit është model i shërbimeve financiare, që i mundëson komunitetit të varfër për të themeluar shoqata kursim krediti ose siç njihen me emrin banka fshati (Murray and Boros, 2002). Modeli u themelua në mes të viteve 1980 nga Fondacioni për Ndihmë Ndërkombëtare të Komunitetit (FINCA),²² që përbëhet nga 30-50 anëtarë, nga të cilët zakonisht shumica janë gra (Ledgerwood, 2000:85). Kredia është e lidhur me kursime dhe në shumicën e rasteve madhësia e kredisë është e lidhur me shumën që çdo huamarrës ka ruajtur dhe kur standardet tregtare janë aplikuar (Murray dhe Boros, 2002:12). Kapitali

²² FINCA në anglishte: Foundation for International Community Assistance, e përhapur në shumë vende të botës e cila në Kosovë operon nga viti 2000.

filleshtar i huas mund të sigurohet nga një burim i jashtëm. Anëtarët e vetë bankës e drejtojnë atë duke zgjedhur zyrtarët e tyre. Ata vendosin për shpërndarjen e huave tek individët, mbledhin pagesat dhe kursimet. Bankat e fshatit kanë një shkallë të lartë të demokracisë dhe pavarësisë së kontrollit (Ledgerwood, 2000:85). Në rastin e huas, premtimi i grupit qëndron si formë e garancisë apo kolateralit dhe jo ndonjë pasuri e paluajtshme ose mallra.

v) *Grupet për vetë ndihmë / Shoqëritë e kursim-kredisë*

Shoqëritë e kursim-kredisë funksionojnë nëpërmjet dy llojeve të fondeve, ato me rotacion dhe ato pa rotacion (Bouman, 1995). Shoqëritë janë të vogla dhe anëtarët e njohin mjaft mirë njëri-tjetrin. Janë organizata të dominuara nga femrat që kursejnë shuma të vogla dhe mund të huazojnë nga grupe të përbashkëta në baza të rotacionit. Shoqata e kursim-kredisë (ROSCAs) ekziston në shumë vende të botës dhe është e njohur me emra të ndryshëm, si psh., Tontines dhe Susus. ROSCA dhe shoqatat e tjera ndonjëherë përdoren nga IMF për kreditim të grupit (Murray dhe Boros, 2002). Ky është një institucion financiar, i cili vepron për përfitimin e anëtarëve të tij. Formohet në baza vullnetare, duke kontribuar në një fond të përbashkët, që pastaj u jepet anëtareve të grupit në baza të çdo cikli prodhimi (Wrenn, E. 2005).

2.1.7. Roli i mbështetjes në zhvillimin e mikrofinancës

Programet e mikrofinancës të drejtuara nga qeveritë, megjithëse mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, ndonjëherë mund të dështojnë në veprimtarinë mikrofinanciare. Kjo ndodh atëherë kur qeveritë nuk kanë përvojë të mjaftueshme në implementimin e

programeve mikrofinanciare dhe nuk arrijnë t'i stimulojnë ato për të ruajtur qëndrueshmërinë afatgjatë. Sipas Simmons (1998:87), organizatat joqeveritare (OJQ) kanë treguar se bëjnë të pamundurën të mundur, duke bërë atë që qeveritë nuk mundën ose nuk duan ta bëjnë mire. Për ta përcaktuar OJQ-në, Simmons (1998:83) shfrytëzon një dokument të vitit 1994 të Kombeve të Bashkuara, duke e përshkruar OJQ-në si:

“Entitet fitimprurës, anëtarët e të cilit janë qytetarët ose shoqatat e qytetarëve të një ose më shumë vendeve dhe aktivitetet e të cilave janë të përcaktuara nga vullneti i vetë anëtarëve, në përgjigje të nevojave të anëtarëve të një apo më shumë komuniteteve me të cilat OJQ-ja bashkëpunon” (Simmons, 1998:83).

Sipas autorit, ky formulim përfshin çdo lloj grupi, duke përjashtuar bizneset private, grupet revolucionare apo terroriste dhe partitë politike. OJQ-të ndikojnë në qeveritë kombëtare, institucionet multilaterale dhe korporatat kombëtare dhe shumëkombëshe në katër mënyra: Me vendosje të agjendave, negocim të rezultateve, dhënie të legjitimitetit dhe zbatim të zgjidhjeve (Simmons, 1998). Megjithatë, disa programe qeveritare rriten shumë shpejt, duke mos u mbështetur nga baza institucionale dhe nuk arrijnë të koordinojnë përpjekjet me OJQ-të lokale ose grupet të cilat vetë ndihmohen (Ledgerwood, 1999).

Diskutimet mbi përfshirjen e qeverisë në ofrim të mikrofinancës janë të vazhdueshme. Disa argumentojnë se roli i qeverisë është që të krijojë një mjedis të përshtatshëm për suksesin e mikrondërmarrjeve dhe sektorit privat të mikrofinancës. Të tjerët argumentojnë se qeveria duhet të ofrojë shërbime financiare për mikrondërmarrjet, por këtë duhet bërë në baza tregtare, që të promovojë më tutje qasje të vazhdueshme në mikrofinancë dhe për të shmangur çrregullimin e tregjeve financiare (Ledgerwood 2000:15).

Nga ana tjetër, donatorët duhet që mënyrë efikase, të identifikojnë dhe të lidhen me ofrues mikrofinanciar, të cilët janë me përvojë pune në zonat e prekura nga konfliktet, në mënyrë që ata të mund të kanalizojnë fondet në mënyrë të efektshme (Nagarajan, 2004). Interesimi i donatorëve për mikrofinancën është rritur gjatë viteve të fundit. “Meqenëse donatorët janë financuesit kryesorë të aktiviteteve mikrofinanciare, qasjen që kanë drejt mikrofinancës dhe kërkesat që ata paraqesin për krijimin e institucioneve mikrofinanciare, me qëllim të qasjes në fonde, mund të jenë shumë efektive në zhvillimin e fushës së mikrofinancës“, Ledgerwood(2000:16). Aktivitetet e mikrofinancës mbështeten nga donatorë vendorë dypalësh, ose qeveri shumëpalëshe, apo OJQ vendore dhe ndërkombëtare (Ledgerwood, 2013.16), siç janë:

- 1 Grante për ndërtimin e kapaciteteve institucionale;
- 2 Grante për të mbuluar mungesat operacionale;
- 3 Grante për kredi kapitali;
- 4 Linjat e kredive;
- 5 Garancinë për fonde tregtare;
- 6 Asistencë teknike.

2.1.8. Transformimi i mikrofinancës

Mikrofinanca vlerësohet si një nga mekanizmat kryesorë lëvizës për të përmbushur objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit, veçanërisht objektivin gjithëpërfshirës për uljen e varfërisë ekstreme dhe të urisë deri në vitin 2015.²³ Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) deklaroi se viti 2005 do të jetë “Viti Ndërkombëtar i Mikrokredisë”, në të cilën ngjarje theksohet rëndësia e madhe e mikrofinancës. Pikërisht për rëndësinë e mikrofinancës dhe kontributin e madh të saj, në vitin 2006 Dr.Yunus dhe Banka Grameen u

²³ Shih në: <http://www.erasepoverty.org/how-it-works/what-microfinance>

shpërblyen me Çmimin Nobel.²⁴ Kjo bankë është themeluar për të sigurimin e kredive të vogla për shtresat e varfra, meqë bankat shtetërore nuk ishin treguar të suksesshme në këtë drejtim. Këto zhvillime bëjnë që mikrofinanca të konsiderohet si “një nga ato ide të vogla që rezultojnë të kenë ndikime të mëdha” (Beatriz and Morduch, 2005). Suksesi i arritur i modelit të mikrofinancës pasqyrohet me rritjen e numrit të institucioneve mikrofinanciare, duke arritur në 3133 në vitin 2005, nga 618 që ishin në vitin 1997, që dëshmon për rolin që kanë treguar që nga themelimi. Komiteti i Norvegjez i Nobelit kishte deklaruar se mikrofinanca mund t’i ndihmojë njerëzit për të dalë nga varfëria në njërën anë dhe në anën tjetër të shihet si parakusht i rëndësishëm për të vendosur paqe afatgjatë dhe të qëndrueshme (Hermes dhe Lensing, 2007). Duke parë që kërkesa për shërbime financiare është rritur mjaft, Viti Ndërkombëtar i Mikrokredisë evidentoi dhe nxori në pah rrugët për të arritur shërbime financiare mbi baza të qëndrueshme. Si rezultat i kësaj dinamike të zhvillimit, në Samitin e Mikrokredisë në vitin 2007, raportohet mbi gjendjen e numrit të institucioneve mikrofinanciare, duke arritur në 3,316, me numër prej 133,030,913 klientëve të përfshirë në marrjen e shërbimeve financiare. Nga tërë ky numër i klientëve, 92,922,574 prej tyre ishin shumë të varfër kur për herë të parë morën kredinë e tyre dhe 85.2 për qind ose 79,130,581 të klientëve ishin gra. Nga këto shifra supozohet që në 92.9 milionë klientë të varfër të arritur deri në fund të vitit 2006, janë të prekur 464,612,870 anëtarë të familjes ose një nga pesë anëtarët e familjes së tyre.²⁵ Industria e mikrofinancës është rritur në mënyrë të vazhdueshme në 3500 institucione mikrofinanciare në vitin 2010, duke shërbyer kryesisht në zonat rurale si një platformë e gjerë e zhvillimit (Nga raporti i Sekretarit të

²⁴ http://www.nobelprize.org/nobel_prizes/peace/laureates/2006/

²⁵ State of the Microcredit Summit Campaign Report 2007.

Përgjithshëm, 2010). Ky raport nxjerr në pah një varg çështjet të cilat ndërlidhen me përfitimin dhe kufizimet e mikrokredisë dhe mikrofinancës, si një strategji për çrrënjosjen e varfërisë, duke shqyrtuar ndikimin e krizës financiare dhe ekonomike si dhe adreson masa që qeveritë duhet ndërmarrë për të përmirësuar shërbimet e ofruara të mikrofinancës dhe për të ndërtuar një sistem financiar gjithëpërfshirës.


Ajo që shohim gjatë periudhës në vazhdim, IMF-të fillojnë të transformohen në institucione formale financiare ose të rregulluara si (niche)²⁶ para banka apo banka . Ato fillimisht u themeluan si ndërmarrje jofitimprurëse me fokus për të ndihmuar të varfrit, ku edhe financoheshin përmes donatorëve ose subvencioneve, granteve të ofruara nga agjencitë dhe donatorë privat. Transformimi në institucione formale ndihmon në arritjen e qëndrueshmërisë financiare, pasi ajo lehtëson qasjen në huamarrje tregtare dhe tërheqje të depozitave. Kështu, në shumë vende sot IMF janë të rregulluar dhe të mbikëqyrura nga autoriteti monetar (Banka Qendrore) lidhur me depozitat që tërheqin dhe kreditë që akordojnë (Dieckmann et al., 2007).

Zhvillimi i aktiviteteve të mikrofinancës në vendet më pak të zhvilluara, sipas Srnec dhe Svobodova (2009), varet nga disa faktorë si: sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm ekonomik, ekzistenca e një programi të përhershëm liberal për të mbështetur sektorin privat, bashkëpunimi me vendet e zhvilluara në botë, kurs këmbimi i qëndrueshëm (p.sh. tregti të hapur ndërkombëtare, fakte dhe njohuri, mirëkuptim të ndërsjellë, tolerancë etj.).

²⁶ Bankë e cila kujdeset për t'u shërbyer nevojave të popullsisë sipas segmentimit demografik.
http://www.investopedia.com/terms/n/niche_banks.asp

Ky zhvillim, për të cilin meritë kanë një numër i madh i personaliteteve,²⁷ sipas Srenec dhe Svobodova (2009), ndahet në katër faza, të cilat mund të mbulojnë njëra-tjetrën (figura 1) me karakteristikat e tyre.

Figura 1. Periudhat e zhvillimit të aktiviteteve të institucioneve mikrofinanciare



Burimi: Srnc et al. (2009), adaptuar në shqip nga autori

2.2. Mikrofinanca në Evropë

Në Evropë, mikrofinanca i referohet aktiviteteve të mikrokredive kryesisht për biznese ose për qëllime produktive (Bendig et al., 2012:36), e cila trajtohet si një mjet i politikës sociale, me qëllim që të promovojë vetëpunësimin, mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla, luftën kundër “përgjashtimit social” dhe “përgjashtimit financiar”.²⁸ Zhvillimi i mikrofinancës në Evropë fillon me intensitet në vitet e 90-ta (Jayo et al., 2010).²⁹ Sektori i mikrofinancës është ngritur me shpejtësi të madhe përmes organizatave të specializuara në shumë ekonomi të zhvilluara të Evropës. Ky zgjerim reflekton direkt në jetën e njerëzve, të cilët

²⁷ Autori i referohet mbi të gjitha Muhamed Yunus (Grammen Bank, John Keith Hatch (sistemi FINCA), Akhtar Hameed Khan (Tameer Bank), Ela Blatt (SEWA- Self Employed Shoqata e Grave), Michaela Walsh (Women World Banking - WWB) dhe të tjerët.

²⁸ Overview of the Microcredit Sector in the European Union 2008-2009

²⁹ Critical issues: From Exclusion to inclusion through microfinance

janë në gjendje për të punuar, por kufizimi në shërbime bankare tradicionale ua pamundëson. Siç tregohet nga Molenaar (2009), mikrokredia dhe mikrofinanca nuk do të ishin zhvilluar me shpejtësi të madhe, nëse nuk do të ishin të përkrahura thellësisht nga sipërmarrësit e vegjël dhe nga sektori i mikro ndërmarrjeve të bazuara në teoritë që u zhvilluan në fund të viteve të tetëdhjeta.

Ekzistojnë dallime në zhvillim të mikrofinancës midis vendeve të Evropës Perëndimore dhe Evropës Qendrore/Lindore. Politikë bërësit në Evropën Perëndimore e shohin mikrofinancën si instrument të rëndësishëm, përcjellë nga Agjenda e Lisbonës, e cila është e projektuar për të nxitur rritjen, punësimin dhe përfshirjen sociale. Për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, qëllimi kryesor i mikrokreditimit është për të rritur më shumë individët të cilët kufizohen në sigurimin e financimit të jashtëm si rrjedhojë e aksesit të pakët pranë bankave tregtare ose për shkak të kolapsit të sistemit financiar në përgjithësi (Molenaar, 2009).

Përfshirja financiare / financial inclusion

Sipas Komisionit Evropian (2008), “përfshirja financiare” është përdorur për herë të parë në vitin 1993, kur gjeografët shprehin shqetësimin e tyre ndaj qasjes së kufizuar fizike në shërbimet bankare, si rezultat i mbylljes së degëve të bankës. Vëmendja për “përfshirjen financiare” është rritur gjatë dekadës së fundit, si nga qeveritë evropiane ashtu edhe nga ana e Bashkimit Evropian, i cili është një dimension që duhet të merret parasysh në luftën kundër varfërisë dhe përfshirimit social (Microfinance Centre). Në këtë kontekst, në projektin

“Ofrimi i shërbimeve financiare dhe parandalimi i përjashtimit financiar”³⁰ të Komisionit Evropian (2008), përjashtimi financiar i referohet procesit ku:

“njerëzit ndeshen me vështirësi në qasje dhe/ose përdorim të shërbimeve financiare dhe produkteve në tregun kryesor, që janë të përshtatshme për nevojat e tyre dhe për t’u mundësuar atyre që të bëjnë një jetë normale sociale në shoqërinë që i përkasin”, fq.9/136.

Dhe sipas Komisionit Evropian (2008), produktet financiare do të konsiderohen të përshtatshme për t’u përdorur, atëherë kur ofrimi, sigurimi, struktura dhe kostoja nuk krijojnë vështirësi dhe probleme për qasje dhe përdorim.

Përjashtimi social / social exclusion

Përjashtimi social është fenomen shumë kompleks. Një përcaktim politik për përjashtimin social theksohet në raportin e EU (2008: 48/136) ku thuhet se “kufizimi në pjesëmarrje në shoqëri përfshin probleme për nga natyra shumë dimensionale, shumë shtresore dhe dinamike”. Raporti nënvizon se ekziston lidhja midis përjashtimit financiar dhe përjashtimit social, si dy fenomene të veçanta, të cilat janë analizuar nga pesë vende: Austria, Gjermania, Franca, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar (EU, 2008:48). Vendet si Belgjika, Holanda dhe Italia nuk kanë ndonjë raport të veçantë për këtë lidhje, por ato pajtohen se të dy këto koncepte janë të ndërlidhura. Përderisa, sipas raportit në Bullgari, Lituani, Norvegji, Poloni, Sllovaki dhe Spanjë nuk është bërë ndonjë progres lidhur me këtë lidhje.

2.2.1. Promovimi i mikrokredisë në vendet e Unionit Evropian

Është theksuar se mikrofinanca në Evropë është bërë mjet i rëndësishëm për politika sociale, për të promovuar vetëpunësim, si mbështetje të mikrondërmarrjeve dhe për të

³⁰ Ne anglishte “ Financial services provision and prevention of financial exclusion”

luftuar përjashtimin social dhe atë financiar. Edhe pse kriza e vitit 2008 ndikoi tek mikrofinanca, ajo nuk u pengua për të ri dizajnuar mikro kredinë personale. Kjo mikrokredi ishte dedikuar për të ndihmuar përballjet e familjeve me nevoja më specifike dhe jo për të financuar biznese të reja. Bashkimi Evropian (BE) vazhdon të mbështesë aktivitetet e mikrofinancës dhe si rezultat, mikrofinanca konsiderohet si mjet që gjithnjë është i arritshëm për pjesëmarrësit dhe ata që janë të përjashtuar financiarisht nga shoqëria. Mikrofinanca është efektive për të krijuar vende pune dhe për përfshirje sociale, thekson Erikson et al. (2011). Kjo pikëpamje mbështetet nga Baldi et al. (2014), duke artikuluar se mikrofinanca ofron shërbime të mikrokredive për bizneset e kufizuara në shërbime bankare dhe ka për qëllim të promovojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në raportin³¹ dedikuar mikrokredisë për biznese të vogla dhe ato të reja, theksohet rëndësia e mikrofinancës në drejtim të përtëritjes dhe rritjes së popullimit të biznesit, që forcon ndërmarrësin në vendet anëtare (MS)³² dhe vendet kandidate (CCs)³³ të Unionit Evropian.

Kufizimi i qasjes në financa është pengesa që ndërmarrjet e vogla kanë për tu zhvilluar. Kjo ndodh pasi bankat tregtare shohin rrezik të lartë për kthimin e mikrokredisë. Kthimi i kredisë mund të dështojë për shkak të normës dhe kostos së lartë të trajtimit për kredinë nën 25,000 euro. Ky dështim i tregut ndodh për shkak të informacionit asimetrik.³⁴ Në kontekstin e rëndësisë dhe të promovimit për ndërmarrësin, më 20 dhe 21 mars të vitit 2003, Këshilli Evropian nënvizoi për herë të parë rëndësinë e “mikrokredisë”. Kjo ngjarje ishte me rëndësi të madhe për vendet kandidate, marrë parasysh që sigurimi i kredive për

³¹ Microcredit for small businesses and business creation; fq 3

³² MS- Member State

³³ CC- Candidate Countries (CCs)

³⁴ Po aty, fq.36

familje ishte një çështje shqetësuese e që gjithashtu kishte rritur interesimin e ndërmarrjeve të vogla në mikrofinancë (Komisioni Evropian, 2003).³⁵ Përkufizimi i “mikrokredisë” për Komisionin Evropian (EC) është i dyfishtë “double-line” nga fakti se ka ndikim dhe kontribuon në performancën financiare dhe atë sociale të pjesëmarrësve.

Shkalla e mbijetesës së mirë tregon se mbi 60 për qind e bizneseve operojnë falë mikrokredive edhe pas dy viteve të fillimit të aktivitetit. Në terma ekonomik, mbështetja e mikrokredisë është e vlefshme edhe në qoftë se sipërmarrja ka edhe vetëm një vit eksperiencë (Komisioni Evropian, 2008). Ofrimi i mikrokredive zë një vend të rëndësishëm edhe nga ana politike. Për vendet e Unionit Evropian konsiderohet të jetë instrument efikas dhe efektiv i politikave për përfshirje sociale, punësim dhe zhvillim ekonomik.³⁶ Komisioni i Komuniteteve Evropiane synon të përmirësojë mundësinë e mikrokredive për bizneset e vogla dhe për njerëz të përjashtuar social që duan të vetëpunësohen. Shërbimet e mikrofinancës në vendet e Evropës nuk do të konsiderohen vetëm mjet për të luftuar varfërinë, ato do të konsiderohen si mundësi për të zhvilluar aktivitetet e biznesit dhe krijimin e vendeve të punës përmes përforsimit të mikro ndërmarrjeve. Mikro ndërmarrjet në vendet anëtare të BE zakonisht zhvillojnë aktivitete si: ndërtimtari, pasuri të patundshme, hotelieri, shitje me shumicë dhe atë me pakicë etj.

2.2.2. Misioni i institucioneve mikrofinanciare

Zhvillimi i mikrofinancës në Evropë konsiderohet mjet i rëndësishëm për politika sociale e ekonomike, për të promovuar vetëpunësim, për mbështetje të mikrondërmarrjeve dhe për të luftuar përjashtimin social dhe financiar. Kriza e vitit 2008 ndikoi që modeli i

³⁵ Po aty, fq. 7

³⁶ Faqe 13: survey 2010-2011 (EMN)

mikrofinancës të ridizajnohet, duke bërë mikrokreditin personale të jetë e integruar me intensitet të dukshëm. Kjo kredi nuk ishte e projektuar për të mundësuar qasje në financimin e bizneseve të reja, por ishte e dedikuar për të ndihmuar përballjet e familjeve me nevoja më specifike. Bashkimi Evropian është mbështetës i aktiviteteve të mikrofinancës në drejtim e caktuar. Mikrofinanca është gjithnjë më shumë e arritshme për pjesëmarrësit dhe ata që janë të përjashtuar nga financat (Jayo, 2010).³⁷

Misioni i IMF-ve është i fokusuar për “promovim të mikrondërmarrjeve” dhe për “krijim të vendeve të punës” (Botti dhe Corsi 2011; Bending et al, 2012). Në punimin “Rrjeti Evropian i Mikrofinancës”,³⁸ Benard (2014) bën përmbledhjen e hulumtimeve për periudhat 2008-2009 dhe 2010 -2011, duke arritur në konkluzion mbi akterët e zhvillimit të mikrofinancës në Evropë. Sipas studimit (Bending et al, 2012:43),³⁹ 72 për qind e IMF-ve qëllim kryesor kanë krijimin e vendeve të punës, 69 për qind mbështesin promovimin e mikrondërmarrjeve, përfshirja financiare arrin në 49 për qind, përfshirja sociale në 42 për qind dhe mbesin në shkallë më të ulët fuqizimi i grave 39 për qind dhe i pakicave 33 për qind. Për të specifikuar trendin e sektorit të IMF-ve, është bërë ndarja e mikrokredive për biznese dhe për nevoja të konsumit (e përfshirë në pyetësin e Bending et al, 2012).

- Mikrokredia për biznesin (e përcaktuar nga UE⁴⁰) është kredi nën 25,000 euro, për të mbështetur dhe zhvilluar vetëpunësimin dhe mikro ndërmarrjet;

³⁷ Overview of Microcredit Sector in the European Union (2008-2009))

³⁸ European Microfinance Network


³⁹ Analiza e Bending et al, 2012 është e bazuar në të gjeturat pas hulumtimit të 154 IMF (të cilat i janë përgjigjur pyetësorit). “Survey Monkey, të shpërndara në 34 vende, të cilat nuk përfshijnë të gjitha vendet e EU, por vetëm 18 prej tyre janë pjesë e hulumtimit. Në hulumtim bëjnë pjesë, si psh. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Moldavia dhe Serbia, të cilat nuk ishin pjesë e hulumtimit paraprak 2008-2009. Hulumtimi ka qenë i fokusuar në institucionet të cilat ofrojnë mikrokredi më të larta se 25,000 euro.

⁴⁰ Unioni Evropian

- Mikrokredia personale është kredi nën 25,000 euro, për të mbuluar nevojat personale ose të domosdoshme të klientit, si rasti i qirasë, nevojave emergjente, edukimin dhe nevojat për konsum personal (si p.sh. gjëra shtëpiake).

Në këtë kuptim, Bending et al (2012) bën klasifikimin e përkufizimeve të mikrokredisë lidhur me llojet e modelit të kreditimit (figura 2).

Figura 2. Klasifikimi i definicioneve të mikrokredisë sipas llojit të kreditimit



Burimi: Bendig et al, 2012:16, përshtatur në shqip nga autori (2015)

2.2.3. Madhësia dhe kërkesa për mikrokredi në vendet e Bashkimit Evropian

Madhësia e kredive ndryshon nga lloji i institucionit në Evropë. Siç tregohet nga Moleran(2009), bankat tregtare dhe institucionet jo bankare dhe organet qeveritare kanë tendencë për të ofruar kredi më të mëdha sesa unionet e kredive, OJQ, fondacionet e kursimeve (tabela 1).

Tabela 1. Mesatare e madhësisë së kredisë dhe organizatat mikrofinanciare në Evropë

Llojet e ndërmjetësve financiare	Mesatare e përafërt madhësia se kredisë (€)	Organizata mikrofinanciare te angazhuara ne (%)
Unionet e Kredive	4500	2
OJQ Fondacionet	8200	54
Bankat e kursimit	9700	6
Organet publiko/private (Statusi I projekteve)	11000-13000	23
Bankat/Institucionet financiare jo bankare	14500-13000	14

Burimi: Moleran (2009:10), përshtatur nga autori (2015)

Me rritjen e numrit të IMF-ve në vendet e Bashkimit Evropian, numri i kërkesave për shërbime mikrofinanciare është rritur gjatë dekadës së fundit. Sipas raportit të BE,⁴¹ madhësia mesatare e mikrokredive është 10,000-15,000 euro në shtetet e vjetra anëtare të BE-së ("EU-15"), dhe më e ulët në shtetet më të reja anëtare ("EU 12"). Komisioni Evropian e konsideron mikrokreditimin në BE të jetë kredi nën 25,000 euro për iniciativa biznesi dhe ka vërejtur që në mënyrë tipike, mesatarja është 10,000 euro për BE-15 dhe 3800 euro për BE-12. Ky komision ofron detaje mbi kërkesën dhe ofrimin e mikrokredive në vendet e Unionin Evropian,⁴² të cilat janë të ndara sipas vendeve të BE-së.

- Për 15 vendet anëtare të BE: 557 000 * 10 000 euro = 5 570 milionë euro
- Për 12 vendet anëtare të BE: 155 900 * 3 800 euro = 575 milionë euro
- Gjithsej për 27 vendet anëtare të BE, kërkesat për mikrokredi llogariten të jetë përafërsisht 712 900 kredi - 6 145 milionë euro.

⁴¹Microfinance within the EU banking industry (2010) fq 4; referenca e marrë nga:http://ec.europa.eu/regional_policy/funds/2007/jjj/micro_en.htm

⁴² Metodologjia e përdorur ishte llogaritur për vendet anëtare më të vjetra EU (15) dhe vendet anëtare më të reja EU (12), fq. 18 (po aty)

Shumica e institucioneve janë të reja ose 70 për qind e tyre janë krijuar pas vitit 2000⁴³ dhe 17 për qind pas vitit 2005. IMF-të më të mëdha, të cilat dominojnë tregun e mikrofinancës të krijuar para vitit 1996 (ADIE – France, Finnvera – Finland dhe Funduz Mikro - Poloni), llogaritet të kenë shpërndarë 70 për qind nga totali i 27,000 kredive në vitin 2005. Sipas raportit, 65 për qind e IMF-ve shpërndajnë kredi jo më shumë se 100 në vit, vlera e të cilave është mesatarisht 7700 euro, me variacion të gjerë (10 240 euro në BE-15 dhe 3 800 euro në vendet e reja anëtare). Norma mesatare e shlyerjes është 92 për qind dhe gjysma e IMF-ve paralelisht ofrojnë trajnime dhe shërbime këshilluese.

2.3. Teoritë mbi qëllimin e mikrofinancës dhe vlerësimi i performancës

*“Gjithsecili i përfshirë në mikrofinancë ndan një qëllim themelor: për të ofruar shërbime, kredi dhe kursime për mijëra e miliona njerëzve të varfër, në një mënyrë të qëndrueshme”.*⁴⁴

Qëllimi kryesor i mikrofinancës për një numër të praktikuesve është “të përmirësojë mirëqenien e të varfërve”, thekson Schreiner (2002), duke nënvizuar se jo të gjithë pajtohen mbi mënyrën për të arritur këtë qëllim. Prandaj, zgjedhja e metodës më të mirë për të ofruar qasje në shërbime financiare për të varfrit ka zgjeruar debatin në shumë vende të botës, mbi qëllimin e mikrofinancës.

Robinson (2001) kësaj ndarjeje i referohet si “qasja në sistemin financiar” dhe “qasja në kreditim të të varfërve”. Të dyja kanë për qëllim zbutjen e varfërisë, vetëm se metoda për të ndihmuar të varfrit në qasje të shërbimeve financiare ndryshon.

“Qasja në sisteme financiare nënvizon shkallën e lartë të qasjes tek të varfrit ekonomikisht aktiv dhe tek huamarrësit të cilët mund të shlyejnë kreditë e vogla dhe të kursejnë nga qarkullimi i të ardhurave të krijuara nga ekonomitë familjare dhe

⁴³ European microfinance and social performance; where do we stand? (Marie Anna Benard, October 2014), fq.3

⁴⁴ Elisabeth Rhyne, 1998, fq.6

ndërmarrjet. Qasja e sistemeve financiare përqendrohet në mjaftueshmërinë vetinstitucionale, ngaqë duke pasur parasysh shkallën e kërkesës për mikrofinanca në mbarë botën, kjo është e vetmja mënyrë për të përmbushur kërkesën e përhapur të klientëve për shërbime të përshtatshme dhe të duhura financiare” (Robinson, 2001:22).

“Qasja e kreditimit për të varfrit është e përqendruar në uljen e varfërisë nëpërmjet kredisë, shpesh të ofruar së bashku me plotësimin e shërbimeve plotësuese, të tilla si trajnimi i aftësive dhe mësimave të shkrim - leximit dhe numërimit, shëndetit, të ushqyerit, planifikimit familjar dhe të tjera. Përmes kësaj qasjeje, fondet e donatorëve dhe të qeverisë ofrojnë kredi për huamarrësit e varfër. Qëllimi është të qasja e të varfërve, sidomos atyre shumë të varfër - më të varfrit, për të ndihmuar me kredi për të tejkaluar varfërinë dhe që ata të fuqizohen” (Robinson, 2001:22).

Pikëpamjet mbi diversifikimin “schism”⁴⁵ e programeve të mikrofinancës e karakterizon debatin midis “institucionalistëve” dhe “mirëqenëve”, e që në thelb të dyja kanë të njëjtin qëllim, me atë që mikrofinanca ka në drejtim të luftimit të varfërisë.

Sipas, Eöller et al, 1999, “ Institucionalistët ”, fokusohen në krijimin e institucioneve mikrofinanciare për të shërbyer klientët që nuk shërbehen nga sistemi financiar formal. Ata argumentojnë se objektivi primar i mikrofinancave është forcimi financiar, duke krijuar një sistem financiar ndërmjetësues të “qëndrueshëm” për të varfrit. Përderisa, mirëqenësit “Eëlfarists” fokusohen në përmirësim të menjëhershëm të pjesëmarrësve në mikrofinancë dhe në vetvete më pak janë të interesuar në fushën e bankave. Preferojnë përdorim të shërbimeve financiare, si një mjet për të lehtësuar varfërinë e thellë në mes të pjesëmarrësve dhe komunitetit edhe nëse disa nga shërbimet kërkojnë subvencionim. Objektivi kanë vetëpunësimin e personave që ekonomikisht janë të varfër. Edhe për këta, sikurse për institucionalistët, kanë ndikim dhe vëmendje më shumë sesa që kanë dokumentuar (Woller et al, 1999).

⁴⁵ Schism – nënkupton ndarjen e mendimeve rreth një çështjeje

Sipas Leikem (2012), **shkolla e parë** beson se mikrofinanca duhet të shënjestrojë “të varfrit”, ata më afër kufirit të varfërisë, pasi ata kanë më shumë mundësi të zhvillojnë aktivitete të cilat krijojnë të ardhura. Nga ana tjetër, **shkolla e dytë** preferon që institucionet mikrofinanciare drejtpërdrejt të shënjestrojnë të varfrit, pa marrë parasysh cila është kostoja. Rritja e produktivitetit do të rrisë të ardhurat, përmes të cilave do të paguhet interesi i kredisë, por gjithashtu edhe mundëson kursimin. Sipas Diop et al. (2007), e theksuar nga Leikem (2012), argumentohet se këto metoda janë të pamjaftueshme, sepse të varfrit mund të identifikohen vetëm përmes njohjes në thellësi lokale. Kur IMF-të duan të shënjestrojnë të varfrit, ata duhet të punësojnë punonjës me njohuri të mira për komunitetin lokal.

Ledgerwood(1998), nënvizon se duke mos marrë parasysh se cili treg synohet, IMF-të financiarisht mund ta pësojnë, pasi kostot e operimit do të jënë të larta. Gjithashtu, IMF-të duhet të përcaktojnë mungesën e plotësimit të kërkesave për shërbime mikrofinanciare dhe grupet e synuara prej tyre. Si shembull, nëse objektivi i një IMF-je është të arrijë tek njerëzit shumë të varfër me shërbime financiare dhe shërbime të tjera, tregu i tyre do të ndryshojë nga IMF- të cilat dëshirojnë të shërbejnë vetëm me shërbime financiare njerëzit e varfër, të cilët janë ekonomikisht aktiv, nënvizon Ledgerwood(1998).

Faktet se përderisa ekzistojnë mendime dhe ndarje në kuptimin e rolit të mikrofinancës, sipas Duvedack et al. (2011), krijohet ndarja e dy teorive mbi mikrofinancën. **E para** krijoi literaturën e cila adreson problemet e njerëzve të varfër, të cilët nuk kanë mundësi për qasje në shërbime financiare me kosto të përballueshme, si rezultat i mungesës së kolateralit. **E dyta** eksploron rrugët dhe ndikimin e mikrofinancës në ndërmarrje, ekonomi familjare dhe individë.

Me gjithë këto që u përmendën më sipër, del se edhe pse mendimet janë të ndara në grupe, shkolla, kampe ose drejtime, ato kanë qëllimin për të ndihmuar njerëzit ekonomikisht të varfër, sepse, siç thekson Rhyne (1998:6),

”Në mikrofinancë duhet të dimë sa jemi afër kufirit. Nëse jemi pranë, atëherë ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë për të arritur të varfrit dhe qëndrueshmërinë. Nëse jo, duhet të rrisim shtrirjen dhe qëndrueshmërinë”.

Në drejtim të këtij debati të zhvilluar, Hermes & Lensiks (2011:13) theksojnë atë që donatorët, politikëbërësit dhe financierë të tjerë bëjnë në drejtim të zhvendosjes nga subvencionimi i institucioneve drejt një fokusi në qëndrueshmërinë financiare dhe efikasitetin e këtyre institucioneve.

2.3.1. Mbështetja e aktiviteteve të mikrofinancës

Qëllimi i mikrofinancës ka bërë që donatorët të vazhdojnë të mbështesin dhe i inkurajojnë aktivitetet mikrofinanciare, dhe pasi që ato janë të angazhuara për të arritur shtrirjen dhe qëndrueshmërinë financiare. Me mbështetjen nga qeveria dhe donatorët, industria e mikrofinancës po zhvillon teknologjinë e cila do të ndikojë në rritje të konkurrencës me bankat tregtare dhe institucionet e tjera financiare duke përzgjedhur klientët si në zonat rurale ashtu edhe ato urbane (Zeller&Mayer, 2002). Të gjitha burimet nga donatorët subvencionohen, thekson Schreiner (2000). Donatorët janë aktiv në dhënien e fondeve, matjen e progresit dhe përhapjen e praktikave të mira përmes asistencës teknike. Ato krahasohen si ushqim dhe si asistencë, pasi e ndihmojnë institucionin mikrofinanciar për të marrë kualifikimin e duhur dhe për të arritur rezultat pozitiv në të ardhmen (Schreiner, 2000:1).

Nga ana tjetër, sipas Armendariz et al (2013), ‘mikrofinanca dhe subvencionet janë të ndërlikuara’, pasi subvencionet mund të krijojnë pasiguri, e cila nxit institucionin të krijojë fonde mbrojtëse, duke ndikuar kështu në objektivin për të zbutur varfërinë. Pra, politikat e donatorëve duhet të jenë të parashikueshme, nëse ata dëshirojnë ta maksimizojnë ndikimin social dhe të ofrojnë subvencione të besueshme. Kjo bëhet duke specifikuar volumin, periudhën dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve ndaj klientëve nga ana e IMF-ve, si dhe transparencën.

Ende ekzistojnë arsye që institucionet mikrofinanciare të kenë nevojë për subvencione, theksojnë Hermes & Lensink (2011), duke gjetur se 1 deri 2 për qind e të gjitha IMF në botë ose rreth 150 institucione janë të qëndrueshme financiarisht, afër 8 për qind i ofrohen qëndrueshmërisë dhe 20 për qind ende nuk janë financiarisht të qëndrueshme por që kanë tendencë për ta arritur qëndrueshmërinë financiare. Si rezultat, sipas autorëve, 70 për qind, që përbëjnë numrin e IMF që sipas madhësisë karakterizohen si të vogla ose të cilat po sa e kanë filluar biznesin, janë ende larg operimit si financiarisht të qëndrueshëm. Kështu që këto IMF ende kanë nevojë për subvencione (Hermes & Lensink, 2011:14). Burimet e subvencionuara janë ato që donatorët besojnë për organizatat mikrofinanciare me çmime nën koston e tyre oportune. Subvencioni është kostoja oportune e burimeve të subvencionuara, minus atë që një organizatë mikrofinanciare paguan (Schreiner, 2000).

Subvencionet e donatorëve nuk konkurrojnë me kapital në sektorin privat, nënvizon Grupi Konsultativ për Ndihmë të Varfërve (CAGP, 2004) në njërin nga 11 parimet themelore të funksionimit të IMF-ve. Për të qenë efektiv, financimi i donatorëve, duhet të kërkojë të përfshijë shërbimet financiare për të varfrit në tregjet financiare vendore, pastaj të ofrojë

ekspertizë të specializuar për hartimin dhe zbatimin e projekteve dhe të kërkojë nga IMF-të dhe partnerë të tjerë të përmbushin standardet minimale të performancës, si kusht për mbështetjen e vazhdueshme dhe planifikimin nga fillimi (CAGP, 2004).

Sipas Hermes & Lensink (2011), një numër i madh i programeve mikrofinanciare janë të varura nga subvencionet e donatorëve për të mbuluar shpenzimet e larta, duke nënvizuar se këto institucione ende nuk janë financiarisht të qëndrueshme. Matja e qëndrueshmërisë përdoret si “instrument për të ndihmuar donatorët të krijojnë qëndrueshmëri për të paktën pesë vite”, thekson Schreiner (2000).

2.3.2. Qëndrueshmëria e institucioneve mikrofinanciare

Grupi Konsultativ për Ndihmë të Varfërve (CAGP, 2004) lidhur me krijimin e mundësive të reja për qasje në financa dhe mikro njësi për të varfrit, angazhohet në gjetjen e më shumë zgjidhjeve, duke bashkëpunuar me ofrues të shërbimeve financiare, hartues të politikave dhe financues të tjerë. Ky grup bazohet në 11 parime mbi gjetjen e mënyrave për qasje në financa për të varfrit. Një nga parimet e rëndësishme paraqitet qëndrueshmëria financiare e institucionit. Sipas këtij parimi, ndërtimi i institucioneve financiarisht të qëndrueshëm do të nënkuptojë ulje të kostos së transaksionit duke ofruar shërbime më të mira, të cilat plotësojnë nevojat e klientëve dhe gjetjen e mënyrave të reja për të arritur të financojnë të varfrit.

Qëndrueshmëria e IMF-ve, sipas Mark Scheriner (2000), përkufizohet si “aftësia për të përsëritur punën në kohë” dhe performancën e definojnë si “përmbushje të misionit të

mikrofinancës”. Sipas Sinha et al, (2014), qëndrueshmëria e mikrofinancës tregon qëndrueshmëri të vetë programit.

Në anën tjetër, Hermes dhe Lensing (2011), në punimin “Mikrofinanca; ndikimi i saj, shtrirja dhe qëndrueshmëria”,⁴⁶ fokusohen për të gjetur përgjigje në pyetjet më së shumti të ngritura nga evidencat e sjella mbi ndikimin e mikrofinancës në ulje të varfërisë. Tri pyetjet e parashtruara ishin: E para, “nëse mikrofinanca ndikon në gjendjen sociale dhe ekonomike tek të varfrit në vendet e zhvilluara”; E dyta, “a janë institucionet mikrofinanciare të qëndrueshme në periudhë të gjatë”, dhe e treta, “nëse ekziston një lidhje midis qëndrueshmërisë dhe shtrirjes apo zgjerimit të IMF-ve”. Për më tepër, autorët ofrojnë përgjigje në pyetjet e ngritura, duke nënvizuar evidencat e reja për dy çështje të ndara. E para, për rolin e mikrofinancës ndaj ngritjes së mirëqenies së të varfërve dhe e dyta, për raportin midis shtrirjes dhe qëndrueshmërisë të IMF-ve në të njëjtën kohë. Siç tregohet në këtë punim, theksi bie mbi tri mësimet për çështjen e ndikimit të mikrofinancës. *E para*, nxjerr në pah faktin që teknologjia e kreditimit dhe lloji i kontratës që IMF-të përdorin mund të ketë pasoja për mënyrën se si huamarrësit e përdorin kredinë. *E dyta*, shpreh rolin e mikrofinancës në rimëkëmbjen ekonomike pas fatkeqësive natyrore apo dështimeve në biznes si dhe ndikimin në fuqizimin e sipërmarrjeve të drejtuara nga gratë. *E treta*, paraqet përdorimin e metodologjive kërkimore më efektive për të analizuar ndikimin e mikrofinancës, e cila sugjeron krijim të një “grupimi të dhënash në retrospektive”⁴⁷ mbi një sondazh të vetëm, duke përdorur bazën e klientëve të IMF-ve të përfshira në analizë.

⁴⁶ Në anglisht “Microfinance: Its impact, outreach and sustainability”

⁴⁷ Retrospective Panel Data – Të dhënat panel në retrospektiv

Kur është fjala te aplikimi i metodologjisë mbi “grupimin e të dhënave në retrospektivë”, McInstosh et al (2011) kishte ndihmuar në shqyrtimin e programeve mikrofinanciare në një numër të konsiderueshëm të familjeve të shpërndara në Guatemalë, Indi dhe Ganë duke gjetur se mikrofinanca, nga përdorimi i kredisë për nevoja të banimit, ka treguar edhe një rritje modeste në përdorim të kredive për konsum familjar.

Sikurse vihet re në punimin e Hermes dhe Lensing (2011), lidhja midis shtrirjes dhe qëndrueshmërisë së IMF-ve është e trefishtë. Duke e synuar qëndrueshmërinë, ekziston përpjekja për të arritur objektivat sociale dhe ekonomike të IMF-ve dhe ngjashëm me transformimin e IMF-ve në një institucion formal bankar, prej të cilit nuk do përfitojnë vetëm të varfrit. Kjo do të tregojë nëse politikëbërësit e vlerësojnë nëse duhet subvencionuar ose jo një IMF, e cila bën gjithashtu praktikuesit që të mendojnë të përmirësojnë vazhdimisht efikasitetin e aktiviteteve të tyre. Kjo është e rëndësishme për investitorë financiar tregtar, sidomos për ata që synojnë për investime me përgjegjësi sociale. Në anën tjetër, theksojnë Hermes dhe Lensink(2011:14), kostoja e lartë e transaksionit dhe informacionit të ofruesve të mikrofinancës bëjnë që ky sektor të jetë i paqëndrueshëm financiarisht, duke u mbështetur nga subvencionime të donatorëve, arsye kjo që u diskutua në debatin e vitit 1990 ku pati mendime që mikrofinanca është e orientuar me qasje ndaj sistemit financiar ose qasje për kreditimin e të varfërve.

Prej çfarë u tha më lart, vërehet se qëndrueshmëria e IMF-ve është shumë e rëndësishme për mikrofinancën, në të kundërtën, siç thekson Otero (1999:11), ato bëhen një mjet kalimtar i mbështetjes së të varfërve dhe humbasin fuqinë e tyre si një komponent për një strategji të gjerë të zhvillimit në çdo mjedis.

2.3.3. Performanca dhe faktorët e performancës financiare

Matja e performancës konsiderohet një parim themelor i menaxhimit të organizatës, meqenëse identifikon mangësitë aktuale të veprimtarisë ekonomike e krahasuar me atë të planifikuar apo të dëshiruar. Përzgjedhja me kujdes e faktorëve kryesor të performancës (TKP)⁴⁸ identifikon saktësisht se ku duhet marrë masa për të përmirësuar këtë performancë (Weber dhe Thomas 2005:3). Numri i faktorëve kryesorë të performancës (TKP) nuk kufizohet në dy ose tre faktorë për organizatë, përkundrazi ato mund të jenë më shumë se kaq të cilët së bashku mbështesin qëllimin e përgjithshëm të organizatës (O'Neill, 2006).

Ekzistojnë argumente të shumta mbi vlerësimin e performancës së institucioneve mikrofinanciare. Në studimin e tyre, Luzzi dhe Weber (2006) theksojnë se matja e performancës së institucioneve mikrofinanciare nuk është detyrë e parëndësishme, pasi duke matur qëndrueshmërinë financiare të një institucioni, do të ofrohet një karakteristikë e saj. Është vënë re se në rastin e matjes së performancës së institucioneve mikrofinanciare, rezultatet janë të ndryshme, pasi ato kanë stadi zhvillimi të ndryshme në vende të ndryshme të botës.

Në udhëzuesin mbi “faktorët e performancës të institucioneve mikrofinanciare”, publikuar nga Damini et al (2003),⁴⁹ prezantohen faktorët të cilët i takojnë grupit të cilësisë së portofolit, efikasitetit dhe produktivitetit, menaxhimit financiar dhe fitueshmërisë, të cilët i konsiderojnë më të rëndësishëm. Kjo rrjedhë e paraqitjes të një pamje të përgjithshme mbi performancën, rrezikun dhe pozitën financiare të institucioneve mikrofinanciare. Ledgerwood (1999:2005) përcakton gjashtë faktorë kryesor të performancës, të cilët i

⁴⁸ Faktorët Kryesorë të Performancës (TKP) nga anglishtja – Key Performance Indicator (KPI)

⁴⁹ Performance indicators for Microfinance Institutions, technical guide (2003)


konsideron si minimumi i faktorëve të rëndësishëm në menaxhimin e IMF-ve, që janë: cilësia e portofolit të kredisë, qëndrueshmëria financiare, përfitueshmëria, leva financiare, mjaftueshmëria e kapitalit dhe shkalla apo thellësia e shtrirjes gjeografike të IMF-ve. Ndryshe, në dokumentin e Rosenberg (2009:1), duke mos i numëruar të gjithë faktorët që mund të përdoren, paraqiten ata më të rëndësishmit për të matur performancën, siç janë faktorët:

- a.** Gjerësia e shtrirjes, tregon se sa klientë janë shërbyer;
- b.** Thellësia e shtrirjes paraqet nivelin e përfshirjes së klientëve të varfër;
- c.** Shlyerja e kredisë (cilësia e portofolit) paraqet raportin e kredisë se shlyer ndaj kredisë totale të akorduar;
- d.** Qëndrueshmëria financiare tregon nëse IMF-ja është mjaftueshëm fitimprurëse për të ruajtur dhe për të zgjeruar shërbimet e saj, duke mos vazhduar me “injektive” të subvencioneve dhe;
- e.** Efikasiteti, që pasqyron se sa mirë IMF-të menaxhojnë dhe kontrollojnë kostot e tyre operative.

Për mënyrën e menaxhimit të problemave të cilat lidhen me qasjen ndaj të varfërve, Zeller dhe Mayer (2002), përmes teorisë së ashtuquajtur “Trekëndëshi Kritik i Mikrofinancës“, paraqesin rëndësinë e një IMF-je që ajo të jetë e suksesshme. Kështu, skematikisht përmes tre brinjëve të trekëndëshit, paraqitet shtrirja tek të varfrit (outrech), qëndrueshmëria financiare dhe ndikimi i mikrofinancës, e cila në mënyrë figurative është paraqitur më poshtë në figurën 3, të përshtatur për punimin, marrë nga Zeller dhe Mayer (2002). Lidhja e

fortë e këtyre faktorëve kërkon menaxhim të mirë, me qëllim që një institucion mikrofinanciar të jetë i suksesshëm.

Figura 3. Trekëndëshi kritik i Mikrofinancës



Sipas Cheng (2007), Kina ofron një rast të mirë për të analizuar ndikimin e mikrofinancës, pasi në Kinë IMF-të gjeografikisht veprojnë në zonat e thella malore, duke shënjestruar familjet shumë të varfra. Duke përdorur të dhënat e 600 familjeve në Kinë, autori analizon efektet e kërkesës për mikrokredi në zonat ku tri IMF-të më të mëdha në Kinë janë të shtrira. Sipas analizës, përfituesit më të mëdhenj nga produktet e mikrokredive janë familjet me të ardhura mesatare, duke gjetur se programi i modelit Grameen në Kinë dështon për të arritur të varfrit. Këtu kërkesa për mikrokredi lidhet pozitivisht me të ardhurat familjare, mundësitë për investime jashtë fermës dhe niveli arsimor i femrave huamarrëse. Prandaj, për të përmirësuar shtrirjen dhe për të rritur kërkesën për mikrokredi, duhet të shmang kufizimet dhe duke përshtatur produktet e mikrokredive për të varfrit, mund të shtojë numrin e kërkesës për kredi nga ata dhe përmirëson shtrirjen e mikrofinancës, Cheng (2007).

Sipas punimeve të Coleman (1999, 2006), duke përdorur të dhëna të jashtme, jo gjithmonë vlerësimi mbi mikrofinancën jep rezultate të pritura. Coleman (1999) përdor të dhënat nga një eksperiment i zhvilluar në verilindje të Tajlandës në vitet 1995-1996, ku nuk gjeti ndryshim pozitiv në pasurinë e ekonomive familjare pas analizës në qasjen e tyre në mikrokredi. Ai shfrytëzoi mostrën e cila përfshinte 445 ekonomi familjare në 14 fshatra të Tajlandës Verilindore. Në mostër përfshihen klientë që ishin anëtarë të “bankës së fshatit” nga tetë fshatra të ndryshme dhe që kishin marrë mbështetje nga kjo bankë e fshatit, pastaj klientë të “bankës së fshatit” nga gjashtë fshatra, të cilët ende nuk kishin marrë mbështetje nga banka dhe grupi i tretë ishin klientë që nuk i takonin asnjërit nga fshatrat (Coleman, 1999).

Coleman (2006) përdori të dhënat e hulumtimit të viteve 1995-1996, pasi ky kampion ishte kthyer në përfitues, në të cilin pjesëmarrësit e programit të mikrofinancës edhe para përdorimit të programit kishin tendencë për të qenë më mire ekonomikisht se ata që nuk ishin pjesëmarrës. Pra, fshatarët e pasur kanë më shumë mundësi të marrin pjesë në program sesa fshatarët e varfër. Ajo që është e rëndësishme për ta theksuar është se vetë anëtarët e komisionit të programit janë ata që shfrytëzojnë pozitën e tyre për të marrë hua të konsiderueshme, më shumë sesa anëtarët (klientët) e tjerë.

Argumenti se kërkesa për shërbime të besueshme financiare është e madhe bazohet në faktin se 40 deri 80 për qind e popullsisë në ekonomitë në zhvillim nuk kanë qasje në shërbime financiare në sektorin formal (Beck, Demirguc-Kunt dhe Martinez Peria 2007; Banka Botërore, 2007; Cull et al, 2008). Prandaj, kur flitet për nevojën për ndihmë të qindra ose miliarda njerëzve me të ardhura të ulëta, që janë të kufizuar në qasje në

shërbime bankare ose janë nën mëshirën e huadhënësit shfrytëzues apo abuzues, të gjithë pajtohen se qasja në shërbime financiare të besueshme mund t'i ndihmojë ata (Cull et al, 2008).

Në këtë kontekst, (Cull et al, 2008) theksojnë raportin mbi institucionet mikrofinanciare që kishin krijuar qasje për afër 100 milionë klientë, të cilët kishin arritur të shlyejnë kreditë dhe shumat e interesit. Kjo rritje, sipas Fushatës së Samitit të Mikrokredivë në vitin 2012, ishte rritur deri në 137.5 milionë familje të varfra me qasje në shërbime financiare ose 18-fish më shumë në krahasim me vitin 1997 (Banerjee et al, 2013:1).

2.3.4. Faktorët të përdorur për vlerësim të performancës të IMF-ve

Autor të ndryshëm, kanë identifikuar faktorë të cilët janë vlerësuar si përcaktues të performancën financiare të IMF-ve në vende të ndryshme. Ata janë përdorur në shumicën e rasteve për të vlerësuar ndikimin në vetëqëndrueshmërinë operative, vetëqëndrueshmërinë financiare, përfitueshmërinë, shtrirjen, efikasitetin ose produktivitetin e institucioneve mikrofinanciare etj. Për nevoja të këtij punimi do të trajtohen faktorët të cilët më së shumti janë përdorur për të matur ndikimin në vetëqëndrueshmërinë operative dhe kthimin nga aktivet.

Vetë qëndrueshmëria operative

Vetëqëndrueshmëria operative (OSS)⁵⁰ fokusohet të tregojë nëse IMF-ja ka arritur shkallën e duhur për të vazhduar operimin, duke mos u mbështetur nga subvencione të mëtejshme. Si theksohet nga Schreiner (2002:1), “qasja për vetëqëndrueshmëri specifikon se donacionet mbulojnë shpenzimet fillestare dhe mbështesin me fonde gjetjen e risive për të zvogëluar

⁵⁰ OSS – shkurtesa nga anglishtja “Operational Self Sufficiency” e cila shkurtese do të përdoret gjatë këtij punimi

shpenzimet e furnizimit, derisa të ardhurat nga klientët të mund të mbulojnë shpenzimet afatgjatë”. Për të vazhduar operimin pa mbështetjen nga subvencionet, IMF-të duhet të arrijnë vetë qëndrueshmëri operative 100 për qind ose më shumë, gjë që tregon se arrihet pika e fitueshmërisë. Në të kundërtën institucioni nuk do të mbulojë shpenzimet administrative dhe humbjet e kredive nga të ardhurat operative. Për shembull, K Schäfer dhe Y Fukasawa (2011), për të matur vetëqëndrueshmërinë operative (OSS), përdorin “ordinary least squares regression method”, duke përfshirë në mostër 1000 IMF, të cilat shërbejnë në vende të ndryshme të botës, të renditura ashtu siç janë marrë nga MIX market, për periudhën 2006 dhe 2008. Në model janë të përfshirë 12 faktorë (variabla të pavarura) nga grupi i faktorëve të efikasitetit, shtrirjes dhe performancës financiare. Numri i huamarrësve, raporti i shlyerjes së kredisë dhe raporti midis depozitorit/huamarrësit janë faktorë të rëndësishëm për të përcaktuar vetëqëndrueshmërinë e IMF. OSS është një matës i mirë i qëndrueshmërisë financiare të një IMF-ja, por si çdo masë tjetër e performancës financiare, kjo nuk do të vlerësojë dobinë për një klient të vetëm, një komunitet apo edhe ndonjë vend të ri në drejtim të rritjes së mirëqenës apo zvogëlimin e varfërisë (K Schäfer dhe Y Fukasawa, 2011).

Ngjashëm vepron Woldeyes (2012), i cili përdor “panel data regresion model” për të përcaktuar faktorët që ndikojnë në vetëqëndrueshmërinë operative (OSS) të IMF. Nga grupe të faktorëve të performancës identifikon se mesatarja e kredisë për huamarrës, kostoja për huamarrës, madhësia e IMF e matur me vlerën aktive, dhe norma e fitimit mbi portofolin bruto të kredisë, statistikisht janë variabla të rëndësishme në përcaktimin e vetëqëndrueshmërisë operative.

Kthimi nga aktive (ROA) dhe Kthimi mbi kapitalin (ROE)

Faktorët e fitueshmerisë që përdoren më shpesh janë: norma e kthimit mbi aktivet(pasurinë) dhe norma e kthimit mbi kapitalin. Këto raporte paraqesin nivelin e besueshmërisë mbi vendimet që institucioni i ka marrë për të investuar, te cilat shprehen përmes raportit të ardhurave neto mbi aktive ose kapitalin. Kthimi nga aktive (ROA) është matës i përgjithshëm i fitueshmerisë, i cili pasqyron marzhën e fitimit dhe efikasitetin të gjithë pasurisë apo aktiveve të institucionit. Sipas udhëzuesit teknik (2003), ky faktorë është “matës se si i përdor institucioni të gjitha aktivet(pasurinë) e saj”.⁵¹ Në bankat dhe institucionet e tjera financiare, masa më e zakonshme e Përfitueshmërisë është norma e kthimit nga aktivet (ROA), e cila pasqyron aftësinë e organizatës për të përfituar dhe për të rritur huadhënien e aktiveve dhe kthimin nga kapitali (ROE), i cili mat kthimet e prodhuara nga investimet e pronarëve. Kthimi nga aktivet (ROA) llogaritet si raport i të ardhurave neto mbi totalin e aktiveve(pasurinë), ndërsa kthimi nga kapitali (ROE) tregon raportin e të ardhurave neto mbi kapitalin e vetë pronarit. Sa më e lartë që do të jetë kthimin nga aktivet (ROA), kjo do të jetë e rëndësishme për IMF-të e komercializuara por edhe ato jo të komercializuara, pasi ky është një faktorë që tregon aftësitë e menaxhmentit për të shfrytëzuar aktivet në mënyrë sa më produktive, pavarësisht nga burimi i financimit. Kthimi nga kapitali (ROE) mat kthimet e gjeneruara nga investimet e pronarëve, që janë të rëndësishme për një institucion privat “fitimprurës”, pasi tregojnë kthimin e investimeve të tyre në institucion. Nga këndvështrimi i qëndrueshmërisë financiare, Kereta (2007) konstaton se IMF-të janë operacionalisht të qëndrueshme, të matura nga kthimi i aktivitet (ROA) dhe kthimi i kapitalit (ROE) dhe performanca e fitimit të industrisë përmirësohet

⁵¹ Performance Indicators for Microfinance Institutions; technical guide, 3rd Edition, 2003

me kalimin e kohës. Rritja e nivelit të shtrirjes ndikon që institucionet të përmirësojnë performancën financiare, por jo edhe me rritjen e kthimit të aktiveve, zgjerohet thellësia e shtrirjes. Prandaj, rritja e aktiveve kërkon vëmendje të veçantë (Gakhar, K. 2013).

Duke e matur performancën financiare të IMF-ve në Marok, nga perspektiva e kthimit ndaj aktiveve(ROA) dhe kthimit mbi kapitalin (ROE), gjetjet e punimit të El Kharti (2014) rezultojnë se portofoli në risk (PAR⁵²)30 ditë dhe mosha janë faktorët kryesorë të performancës financiare. Mengesha (2016), përdor të dhëna panel me modelin “fixed effect”, ka gjetur se vetë qëndrueshmëria financiare (FSS) dhe vetë qëndrueshmëria operative(OSS) kanë ndikim pozitiv me variablën kthimin ndaj aktiveve(ROA), përderisa portofoli në risk, norma e rezervës nga humbja e kredisë (provizionet), raporti i shpenzimeve operative, raporti i mbulimit të interesit, borxhi ndaj kapitalit dhe madhësia e mikrofinancës kanë ndikim negativ në aktivet e IMF-ve.

Faktorë të rëndësishëm përcaktues të performancës financiare

Ekziston numër i konsiderueshëm i faktorëve përmes së cilëve tentohet të matet performanca financiare e IMF-ve dhe ndikimi i tyre. Faktorët që janë marrë në konsideratë në këtë punim janë marrë edhe në punime të tjerë të më hershme siç janë; mosha e IMF-ve(përvoja e operimit), madhësia e institucionit e matur me vlerën e aktiveve, statusi ligjor i operimit të institucionit, portofoli e kredisë së leshur nga IMF-të, numri aktiv i huamarrësve, përqindja e huamarrësve femra, mesatare e kredisë së leshur nga IMF-ja, shpenzimet operative mbi aktivet, shpenzimet operative mbi portofolin e kredisë, shpenzimet e personelit mbi portofolin e kredisë, kosto për huamarrës. Ndikimi i faktorëve

⁵² PAR- Portfolio at risk – Portofoli në risk

në performancën financiare të IMF-ve është i ndryshme për IMF të ndryshme ashtu edhe vend dhe kohë kur ato janë përdorur.

IMF-të klasifikohen në tri kategori për nga periudha e operimit, si; fillestare, të reja dhe të pjekura/faturuara. Sipas Kipesha (2013), mosha e firmës, që tregon përvojën e saj, ka ndikim pozitiv në efikasitetin, qëndrueshmërinë dhe të ardhurat financiare, por ka ndikim negativ në fitueshmërinë. Edhe sipas (Cull et al, 2007; Gonzalez, 2007; Bogan et al, 2007), ekziston lidhje pozitive midis moshës së IMF dhe qëndrueshmërisë financiare. Kjo lidhje është e mbështetur edhe nga Cull et al (2005), sipas së cilit mosha e institucionit ka lidhje të rëndësishme dhe pozitive me performancën financiare tek të tre faktorët (FSS, OSS dhe AROA). Në raport me vetëqëndrueshmërinë operationale, sipas Nyamsogoro (2010), mosha nuk ka lidhje të rëndësishme. Në anën tjetër, e theksuar nga Nyamsogoro (2010), sipas gjetjeve të Robinson (2001) lë të kuptohet se mosha e operimit të institucioneve mikrofinanciare mund të ndikojë në nivelin e qëndrueshmërisë financiare. Robinson (2001) raporton se IMF-të në fazën e pjekurisë mund të arrijnë qëndrueshmëri dhe shtrirje tek të varfrit. Ndërsa institucionet mikrofinanciare maturohen, pritet që ato jenë më efikase në arritjen e objektivave për të cilat janë themeluar.

Nisur nga historiku i operimit të IMF-ve në Kosovë, shumica kanë filluar të operojnë që prej vitit 1999-2000, e cila mund të tregoj se ky sektor ka krijuar një përvojë që duhet marrë parasysh ndikimin pozitiv në performancën financiare.

Madhësia e organizatës kryesisht matet me madhësinë e shitjeve ose vlerën totale të aktiveve, numrin e punonjësve dhe qarkullimin e shitjes (Abondo 2013; Kettinger et al.,

2004; Aiken et al., 2006; Hoque and James, 2000; Merchant, 2011; Hoque et al., 2001). Madhësia është masë, nëse institucioni është mjaftueshëm i madh për të operuar dhe financiarisht i qëndrueshëm për të mbuluar ose jo shpenzimet operative. Totali i aktiveve është përdorur si faktorë për madhësinë e institucionit (Tihalu, 2013). Madhësia e IMF-së e matur me vlerën e aktiveve, ka ndikim pozitiv në performancën e institucionit mikrofinanciar (Kipesha, 2013). Madhësia e firmës nuk është gjithmonë përparësi, sepse në disa raste ato janë të ngadalta për futjen dhe adaptimin e teknologjive të reja, për shkak të burokracive dhe ngurtësimeve operacionale dhe kanë tendencë të mbesin vetëm në tregun ekzistues dhe jo të kërkojnë treg të ri dhe potencial, siç mund të kërkojnë firmat më të vogla (Kipesha 2013, Chandler 1962). Studimi i Nyamsogor 2010, ngjashëm me (Merlsland and strom 2009, Bogan et al 2007, cull et al 2007, dhe Robinson 2001), gjen që madhësia e IMF-ve ndikon në qëndrueshmërinë financiare, që ndryshon nga gjetjet e theksuara të Hartarska et al (2005). Bazuar në shqyrtim të literaturës, mundë të presim që ky faktorë të jetë i rëndësishëm për performancën financiare në dy drejtimet, vetëqëndrueshmërinë operative dhe kthimin mbi aktivet. Është vërejtur se gjatë viteve të operimit , aktivet e IMF-ve në Kosovë tregojnë tendenca të rritjes .

Sipas statusit, IMF-të mund të operojnë si banka, institucione financiare jobankare (IFJB), organizata joqeveritare (OJQ) ose kooperativa (unione kredie apo bashkë-operative), në varësi të ligjeve dhe sfondit të IMF-së (Hartarska, Shen dhe Mersland, 2013). Rregullimin e institucioneve mikrofinanciare si “paketë rregullative e qeverisë që përdorin për mikrofinancën” e nënvizon, CGAP (2003:1). Sipas Christen dhe Rosenberg (2000:22), Arun (2005), Nyamsogoro (2010), rregullimi i institucioneve mikrofinanciare mund të

ndikojë në qëndrueshmërinë e tyre, pozitivisht ose negativisht, në varësi të faktit nëse përfitimet tejkalojnë ose jo shpenzimet e rregullimit. Sipas fjalorit të MIX, IMF-ja me statusin OJQ është e regjistruar si jofitimprurëse, për qëllim tatimor ose ndonjë statusi tjetër legal. Shërbimet e saj financiare janë zakonisht më të kufizuara dhe nuk përfshijnë marrjen e depozitave. IMF - IFJB janë institucione që ofrojnë shërbime të ngjashme me ato të një banke, por janë të licencuara sipas kategorive të veçanta. Licenca e veçantë mund të jetë për shkak të kërkesave të ulëta të kapitalit ose të mbikëqyrjes. Sipas Robinson (2001), institucionet mikrofinanciare mund të ofrojnë shërbime fitimprurëse për klientët e varfër ekonomikisht aktiv,⁵³ atëherë kur mundësohet një mjedis makroekonomik, politik, legal i rregulluar. Ky faktorë do të merret parasysh për të bërë krahasimin midis faktorëve të IMF-ve me status të ndryshëm, kjo pasi që është vërejtur se në Kosovë, IMF-të operojnë si dy tipe, ato IMF- OJQ dhe IMF- IFJB.

Në shumë punime, portofoli i kredisë së lëshuar, është përdorur për të përcaktuar madhësinë e IMF-së, pasi është burimi kryesor i të ardhurave për IMF, i cili specifikon se sa më e lartë të jetë kredia, aq më të larta janë të hyrat nga interesi dhe fitimi (Tehulu, 2013). Portofoli i kredisë përfshin të gjitha kreditë e akordura nga IMF, pavarësisht nga produkti apo lloji i klientit (fjalori i MIX market⁵⁴). Në këtë punim ky faktorë përdoret për të gjetur nëse ndikon në vet qëndrueshmërinë e operative të institucioneve, në njërën anë dhe në anën tjetër, nëse ky faktorë bashkëvepron me faktorë të tjerë të performancës. Nga ajo që na është bërë e ditur, IMF-të në Kosovë fillimisht janë financuar përmes subvencioneve nga organizata të jashtme, megjithatë kohëve të fundit ato edhe marrin kredi

⁵³ Referuar Robinson (2001) termi ekonomikisht aktiv “është përdorur në një kuptim të përgjithshëm për t’iu referuar atyre në mesin e të varfërve që kanë ndonjë të punësuar dhe të cilët nuk janë me deficit të ashpër për ushqim ose të varfër.

⁵⁴ <https://www.themix.org/resource/glossary/glossary>

nga bankat vendore tregtare me qëllim të rritjes së vlerës së portofolis së tyre kreditore, të cilën pastaj e shpërndajnë për klientë të tyre sipas normave të caktuara të interesit.

Numri i huamarrësve aktiv, sipas fjalorit të MIX, paraqet numrin e personave apo subjekteve të cilat aktualisht kanë një bilanc të kredisë të paraqitur në IMF ose janë kryesisht përgjegjës për shlyerjen e një pjese të portofolit bruto të kredisë . Faktor i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e IMF-ve është numri i huamarrësve (Logotri 2006). Ky është një faktorë i qartë se, me rritjen e numrit të huamarrësve për një zyrtar kredie në terren, do të rriten faktorët e qëndrueshmërisë në FSS⁵⁵ dhe OSS (Ëoldeyes, 2012; Crombrugghe et al, 2007). Në anën tjetër, sipas Nyamsogoro (2010), numri i huamarrësve për staf është i lidhur me qëndrueshmërinë financiare të institucionit mikrofinanciar. Rritja e numrit të huamarrësve nëpër vite në IMF-të që operojnë në Kosovë, tregon popullaritetin që këto institucione kanë fituar. Duke parë se ky faktorë ka treguar rritje përgjatë operimit të IMF-ve në vend, kjo na shtyn të presim marrëdhënie pozitive dhe të rëndësishme midis numrit të huamarrësve dhe performancës financiare.

Mesatarja e madhësisë së kredisë. Ekziston një numër i punimeve që tregojnë rëndësinë e madhësisë së kredisë të akorduar nga IMF-të, e cila si shembull sipas Navajas et al (2000) i referohet vlerës që shoqëria përfiton nga përdorimi i mikrokredisë nga një huamarrës i caktuar. Sa më e vogël të jetë mesatarja e kredisë, shtrirja e IMF-ve do të jetë më e lartë, duke arritur kështu të depërtojë në nivel më të gjerë të shtrirjes. IMF-të me kredi mesatare të ulët kanë tendencë për performancë të ulët të fitimit dhe ndryshe është e kundërta, nënvizon Kereta (2007:24). Rritja e vlerës së portofolit të kredisë së lëshuar gjatë viteve të

⁵⁵ Në anglishte FSS- Financial Self Sufficiency (Vetëqëndrueshmëria Financiare)

operimit te IMF-ve në Kosovë, është shenjë e rritjes së mesatares së kredisë, e cila është faktorë se IMF-të bashkëpunojnë me klientë të përgjegjshëm për kthimin e kredive. Pritjet për këtë faktor në këtë punim janë pozitive dhe të rëndësishme për performancën financiare te IMF-ve.

Shuma e huave të akorduar për femrat huamarrëse në raport me portofolin e kredisë shpeshherë është përdorur si përfaqësues për thellësinë e shtrirjes, pasi që është konsideruar se kredia e marrë nga femrat do të ndikojë më shumë në shoqëri. Janda dhe Turbat(2013) gjejnë se femrat huamarrëse përmirësonin rezultatin financiar të institucioneve mikrofinanciare duke mbetur klientë te mira. Sipas Hermes dhe Lensink (2011), synimi për të arritur këtë grup të klientëve është për shkak se gratë shpesh kanë treguar se janë më të përgjegjshme financiarisht dhe me performancë më të mirë të shlyerjes së kredive sesa meshkujt. Ato përdorin pjesën e konsiderueshme të të ardhurave për shëndetin dhe edukimin e fëmijëve dhe luajnë një rol shumë të rëndësishëm në reduktimin e varfërisë brenda familjes së tyre (Hermes dhe Lensink, 2011). Pjesëmarrja e femrave në huamarrje të lëshuara nga IMF-të është në rritje dhe mund të jetë e krahasueshme me vende të cilat kanë pasur fatin e njëjtë të zhvillimit të pas luftës sic është rasti i Kosovës.

Fakti që institucionet mikrofinanciare priten te mos veprojnë sikurse bankat tradicionale, nuk do të thotë se nuk janë të interesuara në përfitueshmëri dhe çështje te efikasitetit(Nieto at al,2007). Në këtë drejtim për të vënë në pah nëse menaxhmenti i IMF-ve në Kosovë, ka arritur të jetë mjaft i aftësuar për menaxhim efikas të shpenzimeve operative, faktorët si; shpenzimet operative/aktivet, shpenzimet operative/portofolit të kredisë, shpenzimet e personelit/portofolit të kredisë dhe kosto për huamarrës do të analizohen. Këta faktorë konsiderohet si faktorë që nuk mund të manipulohen lehtë por janë më lehtë të

krahasueshëm midis institucioneve sesa faktorët e rentabilitetit, që i mundësojnë menaxhmentit të krahasojnë këto shpenzime me raportin e arritur të vetëqëndrueshmërisë operative. Raporti i shpenzimeve operative ndikon fuqishëm në qëndrueshmërinë financiare të IMF-ve (Nyamsogoro, 2010).

Portfoli në risk (PAR⁵⁶) 1-30 ditë dhe raporti mbi shlyerjen e kredisë (write off) janë të rëndësishëm për t'i analizuar. Risku i kredisë konsiderohet si masa më e pranueshme e cilësisë së portofolit (Nyamsogoro, 2010; CGAP, 2003). Shuma e interesave të marra është burimi më i rëndësishëm i të ardhurave për institucionet mikrofinanciare (Nyamsogoro 2010, Fernando 2006; Seymour 2002; CGAP, 1998). E theksuar nga Nyamsogoro (2010), sipas CGAP (2003:11), sa më gjatë periudha e mos shlyerjes në kohë të huasë, aq më i lartë është rreziku që ajo nuk do të paguhet e cila lidhet me riskun e kredisë. Risku më i madh lidhet me portofolin e kredisë, që është aktivi më i madh i institucionit dhe për këtë arsye rreziku i kthimit për institucionin mund të rritet. Portofoli në Risk (PAR), sipas Aemiro (2013), është faktorë i cili mund të ndikojë në qëndrueshmërinë financiare të IMF-së. Sa më e lartë të jetë portofoli në risk (PAR), më e ulët është norma e shlyerjes dhe prandaj qëndrueshmëria financiare është më e ulët. Sipas Nyamsogoro (2010), cituar (CGAP, 1995), PAR (Portofoli në risk) duhet të jetë nën 10 për qind. Raporti megjithatë fillimisht mund të jetë më i lartë, kur IMF-ja nuk operon me efikasitet dhe nuk ka stabilizuar menaxhimin e saj. Shlyerja e kredive dhe rikuperimi i kredive të vonuara është një faktorë i rëndësishëm i performancës financiare të IMF-ve, prandaj mbledhja e dobët dhe jo në kohë e tyre do ta përballë IMF-në me sisteme të dobëta menaxhimi.

⁵⁶ PAR- Portfolio at risk

2.3.5. Studime empirike mbi vlerësimin e performancës të IMF-ve

Bogan (2009) hulumton se ndryshimet në strukturën e kapitalit përmirësojnë efikasitetin dhe qëndrueshmërinë financiare të IMF-ve. Autori përdor modelin me të dhënat panel nga MIX, për të kuptuar më mirë lidhjen midis strukturës së kapitalit dhe performancës të IMF-ve. Në këtë punim janë shfrytëzuar faktorë nga grupi i shtrirjes, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë financiare të institucioneve mikrofinanciare të vendeve të Afrikës, Azisë, Evropës Lindore, Amerikës Latine, Lindjes së Mesme dhe Azisë Jugore, për periudhën 2003 dhe 2006. Sipas Bogan (2009), teoria e jetëgjatësisë është shpjegimi më i popullarizuar për lidhjen midis strukturës së kapitalit, qëndrueshmërisë, efikasitetit dhe shtrirjes. Megjithatë, vazhdon autori, kjo nuk shihet të jetë një faktorë në drejtim të financimit të IMF-ve. Faktorë të tjerë janë më të lidhur, siç është madhësia e IMF-ve (aktivet) dhe struktura e kapitalit të IMF-ve, janë të lidhura me performancën e IMF-ve.

Për matjen e performancës së institucioneve mikrofinanciare në Indi, Gupta et. al (2012) përdori të dhënat e mbledhura nga MIX market, të cilat u takojnë katër IMF-ve, nga të cilat dy me statusin bankar dhe dy me statusin jo bankar financiar (IFJB). Autorët përdorin pesë faktorë të qëndrueshmërisë financiare; PAR>30 ditë (Portofolin në Risk), raportin e kapitalit ndaj aktiveve, shpenzimet operative/portofolin e kredive, huamarrësit aktiv për numër të punonjësve dhe vetëqëndrueshmërinë operative (OSS). Duke llogaritur mesataren e ponderuar, institucionet mikrofinanciare kanë treguar shkallë të ndryshme të qëndrueshmërisë. Përmes modelit të propozuar për institucionet mikrofinanciare, mund të përcaktohet shkalla e nivelit të qëndrueshmërisë financiare dhe të kontrollohet nëse ato janë financiarisht të qëndrueshme ose jo.

Aemiro dhe Mekonnen (2012) përdorin analizën e statistikës përshkruese për të dhënat sasiore të nxjerra nga MIX market për periudhën gjashtëvjeçare 2004-2009, me fokus periudhën e krizës financiare, duke përzgjedhur dy IMF më të mëdha (Amhara Credit dhe Saving Institution's), të përkufizuara si ACSI. Studimi ka gjetur një përmirësim të performancës të herëpashershme, pasi ACSI arrin të mobilizojë shuma të kursimeve nga familjet e varfra, për të cilat kërkohet kujdes i shtuar. Megjithatë, performanca negative është prezente në periudhën e krizës, për të cilën preferojnë që studimi të zgjerohet në më shumë IMF, për të vërtetuar edhe faktorë të tjerë, përveç të krizës. Për të vlerësuar performancën financiare të IMF-ve në Etiopi në këtë studim bëjnë vlerësimin rentabilitetit dhe qëndrueshmërisë duke përdorur faktorët si, ROA (kthimi nga aktivet) ROE (kthimin nga kapitali), vlerësojnë kualitetin e portofolis me, riskun e PAR për 30ditë, PAR për 90 ditë, produktivitetin me numrin e huamarrësve për personel, gjithashtu vlerësojnë mobilizimin e depozitave duke përdorur depozitën në raport me kredinë, dhe depozitën në raport me total aktivet dhe në fund për të përcaktuar përfshirjen e IMF gjatë kohës së krizës përdorin numrin aktiv të huamarrësve.

Kinde (2012), duke ndjekur qasjen cilësore të vrojtimit, identifikon disa faktorë të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë financiare të IMF-ve në Etiopi, pasi përdor formatin panel të balancuar për të dhënat dytësore të nxjerra nga MIX market, dhe modelin e regresionit multivariabël, ku variabla e varur është gjithmonë faktorë e qëndrueshmërisë financiare Ky studim gjen që gjerësia e përfshirjes, thellësia e përfshirjes, shkalla e varshmërisë dhe shpenzimet për huamarrës janë të rëndësishme në përcaktimin e qëndrueshmërisë financiare të IMF-ve në Etiopi, përderisa nuk gjen lidhje midis strukturës së kapitalit dhe

qëndrueshmërisë financiare të institucioneve mikrofinanciare, e cila vlen edhe për produktivitetin e personelit. Megjithatë, në fund të këtij studimi kërkohet që IMF-të në Etiopi të sigurojnë rritjen e përfitueshmërisë për të qenë në përputhje me objektivat e tyre, nëse duan që misioni i tyre të jetë i mbështetur.

Lidhja midis performancës financiare dhe shtrirjes së institucioneve mikrofinanciare është analizuar nga Gakhar, K.(2013), duke shfrytëzuar të dhënat nga MIX market nga 40 institucionet mikrofinanciare të Indisë për periudhën 2004-2011. Përmes qasjes ekonometrike dhe përdorimit të modelit “panel data regresion⁵⁷” për disa faktorë të shtrirjes së institucioneve (mesatare e huamarrjes, numri aktiv i huamarrësve) pastaj faktorëve të performancës financiare (ROA, ROE, dhe OSS) dhe disa variabla kontrolluese (mosha dhe madhësia e aktiveve), ata gjejnë se rritja e nivelit të shtrirjes ndikon që institucionet të përmirësojnë performancën financiare. Në anën tjetër, nuk gjejnë rritje të kthimit ndaj aktiveve me rritje të thellësisë së përfshirjes. Autorët konkludojnë se IMF-të mund të arrijnë objektivin e tyre të dyfishtë, por duhet të kenë vëmendjen në kthim mbi aktivet.

Duke përdorur modelin “fixed effects” me të dhëna panel të marra nga MIX market, dhe Banka Qendrore e Tanzanisë dhe raporte financiare të 30 IMF-ve në Tanzani, Kipesha (2013) mat performancën përmes efikasitetit, vetëqëndrueshmërinë operacionale, fitueshmërinë dhe të ardhurat financiare, si variabla të varura. Vlerën totale të aktiveve, numrin e huamarrësve, numrin e punonjësve (me të cilën mat madhësinë e firmës) dhe numrin e viteve të operimit të firmës, i përdor si variabla të pavarura. Është e rëndësishme të theksohet se Kipesha (2013) gjen ndikim pozitiv të madhësisë së firmës të matur me

⁵⁷ Regresioni me të dhëna panel

vlerën e aktiveve si dhe numrit të huamarrësve në performancën e institucioneve mikrofinanciare në vend. Megjithatë, jo të gjitha variablat e pavarura të përdorura në punim tregojnë të njëjtin raport me performancën e IMF-ve në vend.

Janda dhe Turbata (2013), në hulumtimin mbi institucionet mikrofinanciare në Kazakistan, Kirgistan, Taxhikistan, Uzbekistan, Azerbajxhan, Mongoli, Afganistan dhe Kinë, për periudhën 1998-2011, ngritën hipotezën mbi faktorët që mund të ndikojnë në rritje të të ardhurave nga portofoli i kredisë, duke krahasuar nëngrupet e institucioneve mikrofinanciare. Ata përdorën tri metodologji të kreditimit. Duke hulumtuar mbi “kreditimin grupor”, “shënjestrimin e femrave huamarrëse” dhe “kreditimin e huamarrësve ruralë”, autorët gjejnë se femrat huamarrëse përmirësonin rezultatin financiar të institucioneve mikrofinanciare. Ata përdoren modelin “pooled OLS and fixed effects” për efektin e kreditimit grupor ose përparësitë e kreditimit rural, krahasuar me pritjet fillestare. Megjithatë, theksohet se kontributi i formave të ndryshme të qeverisjes së institucioneve mikrofinanciare dhe faktorët makroekonomikë potencialë mund të ndikojnë shume në performancën e IMF-ve.

Tihalu (2013), për të vlerësuar efektet në qëndrueshmërinë financiare, studioi gjerësinë e shtrirjes dhe mobilizimin e depozitave, joefikasitetin e menaxhimit, cilësinë e portofolis, intensitetin e kredive dhe madhësinë. Autori përdorur *probit model* dhe duke shfrytëzuar të dhëna të formatit panel të pabalancuara nga 23 IMF, të cilat përbënin 121 observime për periudhën gjashtëvjeçare (2004-2009). Si rezultat, intensiteti i kredisë dhe madhësia ndikojnë pozitivisht dhe dy variablat, menaxhimi joefikas dhe cilësia e portofolit, ndikojnë negativisht, ndërsa shtrirja dhe mobilizimi i depozitës nuk ndikojnë në qëndrueshmërinë e

IMF në Afrikën Lindore. Menaxhimi i efikas, cilësia e portofolit, intensiteti i kredisë dhe madhësia janë të faktorë të rëndësishëm, ndërsa gjerësia e shtrirjes dhe mobilizimi i depozitit nuk paraqiten faktorë të rëndësishëm të qëndrueshmërisë financiare për IMF në Afrikën Lindore, konkludon autori.

Për të matur vetëqëndrueshmërinë financiare, Rahman & Mazlan (2014) kanë shfrytëzuar të dhënat e shfrytëzuara nga MIX market për 12 IMF në Bangladesh. Rezultati nga teknika të shumfishta të regresionit ka gjetur se madhësia e IMF, kostoja për huamarrës, norma e produktiviteti për personel, të ardhurat nga portofoli i kredisë, kanë treguar lidhje pozitive me vetëqëndrueshmërinë financiare. Ndërsa variablat nga mesatarja e bilancit të kredisë për huamarrës, mosha e IMF, borxhi në raport me kapitalin, shpenzimet operative dhe numri i huamarrësve aktiv kanë lidhje negative me vetëqëndrueshmërinë financiare (FSS) në Bangladesh.

Gashayie dhe Sighn (2014) përdorin të dhënat dytësore për periudhën 2001, të nxjerra nga MIX market, për të hulumtuar dhe për të vlerësuar lidhjen midis qëndrueshmërisë financiare dhe shtrirjes së IMF në Etiopi. Autorët në model përfshijnë 5 IMF, me raporte më të plota nga 13 të cilat raportojnë në MIX market. Gjetjet e këtij punimi tregojnë se nuk ka lidhje të rëndësishme (signifikante) ndërmjet shtrirjes dhe qëndrueshmërisë financiare në Etiopi, për të cilën sugjerojnë në të ardhmen të zgjerohen, duke përfshirë më shumë IMF në model.

2.4. Përmbledhje e kapitullit

Shqyrtimi i literaturës nxori në pah qëllimin kryesor të mikrofinancës, duke nënvizuar themelimin e saj si mundësi për qasje në shërbime financiare të njerëzve të varfër dhe atyre me të ardhura të ulëta, pasi këto janë të kufizuar në shërbime të bankave tradicionale. U tregua se kufijtë e zhvillimit të mikrofinancës kapërcyen vendet e origjinës, duke u përhapur me shpejtësi në shumë vende të tjera të botës. Rritja e qasjes së të varfërve në shërbime financiare bëri që mikrofinanca të jetë e konsideruar si “instrument” i cili lufton varfërinë, fuqizon femrën huamarrës, mbështetë fermerët etj. Në këtë drejtim, mikrofinanca në Evropë u konsiderua mbështetje jo vetëm në ulje të varfërisë, por me theks mbështetës i mikrondërmarrjeve, që ato të zhvillohen dhe të zgjerohen në të ardhmen. Nga aspekti i teorive të zhvilluara mbi qëllimin e mikrofinancës, theksi vihet mbi “institucionalistët” dhe “mirëqenësit”, të cilët në thelb kanë të njëjtin qëllim “luftimin e varfërisë”. Të parët do të vendosin prioritetin mbi forcimin e qëndrueshmërisë financiare të institucionit, përderisa grupi i dytë ka prioritet rritjen e qasjes në shërbime financiare për të varfëritë. Gjithashtu, rëndësi jo të vogël në literaturë zë teoria e ashtuquajtur “trekëndëshi kritik i mikrofinancës”, i Zeller dhe Mayer (20002), e cila konsideron që lidhja e fortë e tre brinjëve “ndikimi, qëndrueshmëria, shtrirja tek të varfëritë” kërkon menaxhim të mirë, me qëllim që një institucion mikrofinanciar të jetë i suksesshëm. Në pjesën e fundit të kapitullit trajtohen punime empirike, të cilat identifikojnë grupe të ndryshme të faktorëve, të konsideruar të rëndësishëm për të vlerësuar performancën financiare të IMF-ve në vende të ndryshme të botës. Grupet si; karakteristika e institucionit, vetëqëndrueshmëria operative, shtrirja, produktiviteti, efikasiteti, cilësia e portofolit të kredisë, janë marrë si model për të identifikuar faktorët e performancës për institucionet mikrofinanciare që

operojnë në Kosovë. Është e rëndësishme të vihet në pah që shumë punime empirike nga literatura e shqyrtuar mbështeten në të dhënat dytësore të siguruara nga platforma e MIX, në të cilën raportojnë mbi 2000 IMF nga mbarë bota, e cila na shërben si burim dytësor për të dhënat mbi faktorët e përzgjedhur për analizë në këtë punim.

Shqyrtimi i punimeve më herët të punuara nga autorë të ndryshëm ndërkombëtarë është një orientim dhe lehtësim për të veçuar faktorët më të matshëm që e ndikojnë performancën financiare të IMF-ve që operojnë IMF-të në Kosovë. Fakti që në shumicën e punimeve janë përdorur tregues të profilit, shtrirjes, gjerësisë, efikasitetit, qëndrueshmërisë financiare, menaxhimit, etj, kjo nuk e pengon që punimi të jetë i zgjeruar ose të kufizohet në më pak tregues, pasi që kjo do të jetë e varur nga vitet dhe kualiteti i të dhënave në dispozicion.

KAPITULLI III: SITUATA EKONOMIKE DHE SOCIALE NË KOSOVË - NEVOJË PËR THEMELIMIN E MIKROFINANCËS.

Nën administrim të ish-Jugosllavisë, në njërën anë, dhe nga dobësimi i ekonomisë dhe sistemit financiar gjatë konfliktit të vitit 1998-1999, në anën tjetër, Kosova trashëgoi infrastrukturë të shkatërruar bankare. Megjithatë, pas përfundimit të luftës, në qershor të vitit 1999 dhe pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, në Kosovë filloi faza e rindërtimit dhe zhvillimit të sistemit bankar. Për më tepër, ky zhvillim, së fundi, karakterizohet me zhvillim të gjerë dhe deri-diku intensiv, duke u zgjeruar me numër të institucioneve financiare, me ofrimin e shërbimeve moderne bankare dhe shërbimeve financiare përmes institucioneve financiare jo bankare. Rritja e numrit të bankave dhe zgjerimi i institucioneve të tjera financiare nëpër vite, bëri që sistemi financiar i Kosovës të jetë i krahasueshëm me shumë vende në regjion.

Situata ekonomike dhe sociale e krijuar në Kosovën e pas vitit 1999 ishte e vështirë të rimëkëmbej pa mbështetjen dhe ndihmën e institucioneve ndërkombëtare dhe donatorëve të jashtëm, të cilët nuk munguan. Rindërtimi dhe zhvillimi i Kosovës së pasluftës u mbështet nga një numër i konsiderueshëm donatorësh(Tamoff,2001). Komisioni Evropian dhe Banka Botërore ishin udhëheqës në organizimin e përpjekjeve ndërkombëtare për ndihmë ekonomike, duke përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara, si donator kryesor. Përmes USAID-it, projektet zhvillimore ishin të orientuara në reforma politike, ekonomike, në fushën e çështjeve fiskale dhe tatimore, në të drejtën tregtare, si dhe në zhvillimin e sektorit privat. Ndër këto theksohen programet e mikrokreditimit për të nxitur rritjen e biznesit të vogël. Përmes fondeve të ofruara nga Banka Botërore, ajo do të mund të përmirësojë prodhimin

bujqësor, ta bëjë reformimin e sistemit të arsimit, të shëndetësisë dhe sistemin bankar, si dhe ta përmirësojë sektorin e energjisë(Tamoff,2001).

Kosova, si pjesë përbërëse e integritimeve ekonomike të Evropës Juglindore, të cilat ofrojnë mundësitë e zgjerimit të tregut në një hapësirë mjaft të gjerë, vlerësohet vend atraktiv me mundësi investimi për secilin investitor në sektorë të ndryshëm, duke pasur parasysh se:⁵⁸

- Taksat janë shumë të ulëta krahasuar me shtetet fqinje;
- Sistemi tatimor është jashtëzakonisht i thjeshtë;
- Popullata e re dhe e motivuar, 70 për qind nën moshën 35 vjeçare;
- Fuqi e re dhe e motivuar punëtore me shpirt dhe aftësi të forta ndërmarrëse dhe, gjithashtu, me njohuri të përgjithshme të shumicës së gjuhëve evropiane;
- Resurset e lakmueshme natyrore: linjiti, zinku, plumbi, ferro-nikeli dhe toka pjellore bujqësore;
- Qasja e lirë në tregun e Bashkimit Evropian dhe tregjet fqinje;
- Institucione moderne në përkrahjen e bizneseve;
- Procedura të thjeshta dhe të shpejta për regjistrim e bizneseve (brenda 3 ditëve);
- Sistemi i sigurt bankar;
- Struktura moderne ligjore dhe në pajtim me BE-në dhe
- Monedha zyrtare në Kosovë është euro, që eliminon rrezikun në eurozonë.

Në këtë kontekst, themelimi i sistemit financiar, në veçanti ndërmjetësve financiarë, gjithnjë duke u qasur në dokumente dhe raporte zyrtare të përditësuara, do të na shërbejnë për të trajtuar themelimin dhe zhvillimin e sektorit të mikrofinancës në Kosovë.


3.1. Zhvillimet kryesore të ekonomisë në Kosovë

Faktorët kryesorë makroekonomikë sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në Kosovë gjatë dhe pas vitit 2013 ka shënuar rritje. Rritja e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) në vitin 2013

⁵⁸ Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës: Ekonomia dhe investimet në Kosovë.

ishite 3.4 për qind apo 0.7 pikë përqindje më e lartë sesa në vitin 2012. Kontributi kryesor në rritje të PBB-së ishte nga konsumi dhe eksportet neto, ndërsa investimet në vitin 2012 kanë kontribut të lehtë negativ (BQK, 2014).⁵⁹ Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2015, vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se norma reale e rritjes së PBB-së në vitin 2015 ka qenë 3.0 për qind krahasuar me vitin 2014 (1.2 për qind gjatë vitit) e cila paraqitet në figurën në vijim.

Figura 4. Rritja reale e Produktit të Brendshëm Bruto nëpër vite




Burimi: Raporti i zhvillimeve makroekonomike; BQK, Prill 2016

Përmirësimet e vazhdueshme të ekonomisë botërore gjatë vitit 2013 theksohet të jenë zhvendosur në mes rajoneve, duke u zhvendosur nga ekonomitë në zhvillim tek ekonomitë e zhvilluara. Sipas raportit të BQK (2014), kjo rritje ekonomike në nivel botëror shënoi normën prej 3.0 për qind. Rimëkëmbja e aktiviteteve ekonomike gjatë vitit 2013 reflekton në të gjitha vendet e Evropës Juglindore (EJL) me rritje të PBB në 2.3 për qind, në krahasim me vitin paraprak kur vendet e EJL ishin përballur me recesion ekonomik. Mali i Zi dhe Kosova tregojnë normë të lartë të rritjes 3.4 për qind, Maqedonia 3.1 për qind, Serbia 2.5 për qind dhe Bosnja dhe Hercegovina 1.2 për qind, ndërsa Shqipëria shënon nivelin më të ulët të rritjes, 0.7 për qind.

⁵⁹ Raporti i zhvillimeve makroekonomike, shtator 2014

Figura 5. Norma e rritjes së PBB në vendet e Evropës Juglindore



Burimi: Raporti i zhvillimeve makroekonomike, BQK (2014)

Rritja ekonomike gjatë viteve të fundit ishte ndërmjet 4 për qind dhe 5 për qind, rritje e cila në periudhën 2005-2008 ishte e nxitur nga sektori privat, ndërsa që nga viti 2009 është sektori publik ai që ka marrë primatin në këtë rritje, duke reflektuar një sjellje kundër ciklike të shpenzimeve qeveritare. Siç tregohet, edhe sektori privat vazhdon të mbajë rol pozitiv në rritje, porse efekti i këtij sektori është reduktuar, duke reflektuar ambientin e përgjithshëm makroekonomik në rajon. Në anën tjetër, me ndikim negativ në rritjen ekonomike vazhdon të jetë deficitit tregtar, i cili karakterizohet me nivel të lartë të importeve të cilat kanë mbulueshmëri prej vetëm 10 për qind me eksporte.

Ekonomia e Kosovës tregoi rritje me 3 për qind në vitin 2009, kohë kjo kur shumica e shteteve të rajonit ishin në recesion dhe ka shënuar rritjen më të madhe ekonomike në rajonin e Evropës Juglindore (EJL)⁶⁰ çdo vit që atëherë.⁶¹ Rritja e ekonomisë gjatë vitit 2009, e cila vazhdon edhe gjatë vitit 2010, theksohet të jetë progres i arritur si rezultat i ndihmave nga donatorët dhe remitencat, por që nuk mund të jenë bazë për strategji të

⁶⁰ Vendet e Evropës Juglindore (Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kosova, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Rumani, Serbia), dy vite pas fillimit të krizës globale financiare, kanë filluar të shfaqin shenjat e para të rikuperimit të aktiviteteve ekonomike, edhe pse jo i balancuar në të gjitha vendet (Raporti Vjetor, BQK, 2010, fq. 23)

⁶¹ Strategjia e KOSOVËS: Dokument i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, 2013 (fq.7)

qëndrueshme ekonomike.⁶² Megjithatë, në njëhën anë kjo rritje tregon se Kosova është shumë më pak e integruar me vende të tjera, sidomos me ato që u prekën nga kriza, siç janë vendet e perëndimit⁶³ dhe se mbështetja në remitencat e emigrantëve⁶⁴ dhe në ndihmën e donatorëve nxjerr në pah mungesën e kapaciteteve të brendshme në ekonominë e Kosovës.⁶⁵

Përmirësimi i performancës së ekonomisë globale në vitin 2010 u reflektua edhe në ekonominë e Kosovës, duke ndikuar që sektori privat të jetë bartës kryesor i rritjes ekonomike dhe sistemi bankar i Kosovës kishte rol mjaft të rëndësishëm për financimin e konsumit dhe investimeve në vend (BQK, 2010). Ekonomia e Kosovës shënoi një normë reale të rritjes ekonomike për 4.6 për qind, e cila mbështetet në rritjen e konsumit dhe të investimeve të sektorit privat, FMN (2010).

Lidhjet e dobëta tregtare dhe financiare me ekonominë globale e mbrojnë Kosovën nga zhvillimet e jashtme negative,⁶⁶ shtet që, në krahasim me shumë vende të Evropës Juglindore (EJL), e përballoi më mirë krizën ekonomike të viteve 2008-2009.⁶⁷ Pavarësisht këtij fakti, Kosova vazhdon të përballlet me shkallë të lartë të varfërisë dhe papunësisë. Shkalla deri në 34 për qind e njerëzve që jetojnë në varfëri, me më pak se 1.41 euro në ditë, prej të cilëve 80 për qind jetojnë në varfëri të skajshme me më pak se 0.94 euro (94 eurocent) në ditë,⁶⁸ nuk është premtuese për të arritur në Qëllimet e Zhvillimit të

⁶² Strategjia e zhvillimit të NVM në Kosovë 2012-2016 (2011)

⁶³ Kosova në Kontekst Rajonal (KIPRED, 2013, fq. 5)

⁶⁴ Diaspora e Kosovës, në shumicën e rasteve, është e vendosur në Gjermani, Zvicër dhe në vendet nordike.

⁶⁵ Kosovo a strategy for economic development 2001

⁶⁶ Shih Dokumentin e Bankës Evropiane : <http://www.ebrd.com/downloads/country/strategy/kosovo-strategy-albanian.pdf>

⁶⁷ Nga raporti i Bankës Botërore dhe Zyrës së Statistikave të Kosovës, si pjesë e programit të punës së Bankës Botërore: Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2009 (2011)

⁶⁸ Strategjia e zhvillimit të NVM në Kosovë 2012-2016 (2011)

Mijëvjeçarit, respektivisht me një nivel prej 43 për qind të papunësisë, situatë që, sipas Bankës Evropiane,⁶⁹ vazhdon edhe në pesë vite pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, duke vazhduar të jetë një nga shtetet më të varfra në Evropë. Këto shifra rrisin problemet me të cilat mund të përballlet sektori bankar dhe në veçanti sektori mikrofinanciar që kemi për fokus të këtij punimi.

3.2. Ecuria e sistemit financiar në Kosovë

Sistemi financiar ka rol të pazëvendësueshëm si një nga komponentët më të rëndësishëm të një ekonomie (Salko dhe Dhuci, 2010). Roli i sistemit financiar, përmes sigurimit të shërbimeve kryesore, pa të cilat nuk mund të funksionojë një sistem ekonomik modern, shihet nga katër dimensione: ofrimi i kredive, ofrimi i mekanizmave për kryerjen e pagesave, krijon mundësi për krijimin e parasë dhe siguron një fitueshmëri për zotëruesit e kursimeve (Salko dhe Dhuci, 2010). Në një sistemin financiar veprojnë operatorët finalë dhe ndërmjetësuesit financiarë, të cilët njihen si ndërmjetës financiarë bankarë dhe ndërmjetës financiarë jo bankarë (Zaho dhe Cani, 2008).

Shtylla më e rëndësishme e stabilitetit të ekonomisë së Kosovës është sistemi financiar, bërthamë e të cilit është sektori bankar, për të cilin theksohet të ketë vazhduar të performojë shëndetshëm dhe stabil. Sistemi financiar i Kosovës është i përbërë nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), si autoritet mbikëqyrës i sistemit financiar, nga bankat tregtare dhe institucionet financiare jo bankare, pjesë e të cilit janë institucionet mikrofinanciare (IMF). Bankat tregtare në Kosovë kanë përshpejtuar ritmin e kredisë drejt ekonomisë, ndërsa besimi i rritur i publikut ndaj sistemit bankar ka rezultuar me rritje të vazhdueshme edhe të

⁶⁹ Strategjia e KOSOVËS: Dokument i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, 2013 (fq.7)

depozitave nëpër banka. Në vitin 2008, Kosova shpalli pavarësinë e vendit dhe në qershor 2009 u bë anëtarja e 186-të e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN),⁷⁰ parakusht për anëtarësim në çdo institucione tjetër financiar ndërkombëtar.

Konkretizimi i rregullave dhe procedurave të punës, standardeve dhe të gjitha politikave të tjera operative dhe zhvillimore, bënë që në Kosovë të krijohet Komiteti Këshillues i Pagesave Ndërkombëtare, që bëhet nën udhëheqjen e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). Më 27 korrik 2010, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 03/L-209 për “Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës”. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është subjekti juridik publik bazuar në nenet 11 dhe 140 të Kushtetutës dhe të dispozitave të këtij ligji, që ka autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese.⁷¹ Me ligjin e miratuar, Bankës Qendrore të Kosovës i janë shtuar detyrat dhe përgjegjësitë për sigurimin e stabilitetit financiar dhe atij makroekonomik në vend (BQK, 2010). *“Banka Qendrore (BQ) mbikëqyr sistemin bankar të një vendi ose të një bashkësie vendesh, është institucion që ushtron politikën monetare dhe përcakton e kontrollon rregullat e lojës në tregun ndërbankar”*⁷². Një nga funksionet kryesore të BQK-së është që të sigurojë mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare, me qëllim të krijimit të një sistemi financiar të shëndoshë, të arritshëm dhe konkurrues, i cili është i besueshëm dhe ofron një gamë të gjerë të shërbimeve financiare (BQK, 2009). Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka bërë përparim të rëndësishëm në promovimin dhe në rritjen e stabilitetit të sektorit bankar (FMN, 2013).

⁷⁰ IMF Country Report No. 11/210


⁷¹ <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,2>- Historiku i BQK-së

⁷² Zaho dhe Cani (2008), Teknikat bankare (fq 13)

“Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka për objektiv parësor ruajtjen dhe mbajtjen e një sistemi financiar stabil, d.m.th. stabilitet financiar, dhe objektiv dytësor ka që të kontribuojë në stabilitetin e çmimeve. Po ashtu, objektiv tjetër, pa cenuar dy objektivat e para, ka mbështetjen e politikave të përgjithshme qeveritare”.⁷³

Nën mbikëqyrjen e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) janë bankat tregtare, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, të cilat licencohen përmes BQK-së. “Sipas Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, asnjë person nuk mund të merret me veprimtari të një banke apo institucioni financiar pa licencë të vlefshme të lëshuar nga BQK-ja”.⁷⁴ Struktura e mbikëqyrjes së institucioneve mikrofinanciare është e përcjellë me strukturën e sistemit financiar në Kosovë si në figurën 6.

Figura 6. Struktura e sistemit financiar në Kosovë



Burimi: BQK (2016)

Gjatë vitit 2016 është bërë plotësimi i kornizës rregulluese për mbikëqyrjen e institucioneve financiare, ku bën pjesë amendamenti i rregulloreve për raportimin e bankave, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare. Këto rregullore

⁷³ <http://www.bqk-kos.org> (HISTORIKU)

⁷⁴ <http://www.bqk-kos.org>, Procedurat dhe Udhëzimet për Licencim

janë plotësuar me kërkesat e nevojshme të parapara me kornizën e re të raportimit, të plotësuar në kuadër të projektit të automatizimit të raportimit të bankave, IMF-ve dhe IFJB-ve për nevojat e analizave të pasqyrave financiare dhe nxjerrjes së raporteve periodike nga ana e BQK-së (BQK, 2016).

3.2.1. Dinamika e zhvillimit të sistemit financiar

Gjatë viteve të para të themelimit (deri në fund të vitit 2002) veprimtaria e sektorit bankar ishte zhvilluar me hapa shumë të shpejtë, duke u zgjeruar në shtatë banka komerciale dhe, deri në kohën kur shkruhet ky punim, tregut bankar në Kosovë i shtohen edhe dy banka të tjera, duke arritur në nëntë banka komerciale. Sektori bankar konsiderohet të jetë thelbi kryesor i sistemit financiar në Kosovë, i cili nuk mbetet mbrapa në krahasim me sistemet në regjion dhe më gjerë, përkundër përvojës më të gjatë që ato sisteme tanimë kanë krijuar.⁷⁵ Gjatë vitit 2009, përveç rritjes së prezencës së institucioneve financiare, vazhdon edhe me rritjen e vlerës së aktiveve në të njëjtën periudhë. Duke menaxhuar rreth 74.8 për qind të aktiveve, Kosova ka themeluar sistem të qëndrueshëm financiar duke krijuar bazën ligjore,⁷⁶ përmes së cilës rregullon edhe aktivitetet e Institucioneve Mikrofinanciare (IMF). Korniza ligjore në fushën e licencimit dhe rregullimit të mbikëqyrjes financiare është rishikuar dhe freskuar gjatë vitit 2012, për të siguruar një mbikëqyrje efektive financiare në përputhje të plotë me praktikat më të mira ndërkombëtare, standardet dhe direktivat e BE-së. Gjatë vitit 2012 është aprovuar Ligji Nr.04/ L- 093 për bankat, institucionet

⁷⁵ Tryeza: Tematike për ekonomi, financa dhe statistika, Kosova 2020, fq. 40

⁷⁶ Kriteret dhe kushtet për të marrë licencë për kryerjen e veprimtarive bankare dhe veprimtarive të tjera financiare në Republikën e Kosovës janë të përcaktuara me Ligjin për BQK-në (Ligji Nr. 03/ L-209) dhe në aktet e tjera nënligjore të nxjerra nga BQK-ja.

mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.⁷⁷ Pas këtyre ndryshimeve, sipas tabelës 2, në vijim në Kosovë numri i institucioneve financiare tregon një lëvizje të lehtë krahasuar me vitin 2007 (figura7).


Tabela 2. Trendi i numrit të institucioneve financiare në Kosovë

Lloji i institucionit	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Bankat komerciale	7	8	8	8	8	8	9	10	10	10
Kompanitë e sigurimit	10	10	11	11	13	13	13	14	15	15
Fondet Pensionale Ndhmesit financiar	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
&Institucionet mikrofinanciare	46	45	46	49	38+20	38+17	39+17	42+18	44+18	48+16

Burimi: Buletini i sistemit financiar, 2010; Raporti vjetor i BQK, 2013, 2016

Grafikisht e paraqitur me poshtë:

Figura 7. Trendi i numrit të institucioneve financiare në Kosovë



Burimi: Buletini i sistemit financiar, 2010; RVBK⁷⁸, 2013, 2016 (përpunuar nga autori)

Nga raporti i Raiffeisen Kosovë (2012), sistemi financiar në Kosovë dominohet nga sektori bankar, nga ku 90 për qind e sektorit është pjesë e bankave me kapital të huaj. Në vitin 2012, tregut bankar në Kosovë i shtohet një bankë (Raporti i BQK, 2012:43), duke mbetur e pandryshuar struktura e bankave sipas pronësisë, nga të cilat shtatë (7) banka operojnë me pronësi të huaj dhe dy nga to operojnë me pronësi vendore. Kompanitë e sigurimit, si dhe fondet pensionale, mbesin me numër të njëjtë gjatë vitit 2012, sikurse kishin operuar gjatë

⁷⁷ Raporti Vjetor 2012 (BQK fq. 91)


⁷⁸ RVBQK- Raporti Vjetor BQK

vitit 2011. Sipas raportit të BQK (2013), trendi i zgjerimit të institucioneve financiare tregon një rritje të lehtë të numrit të institucioneve financiare gjatë periudhës 2007-2013, e cila paraqet sistemin bankar stabil, duke krahasuar me sektorët e tjerë në Kosovë. Rritje e lehtë vërehet gjatë periudhës në vijim, pasi mbetet e njëjtë gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin 2015, me përjashtim të shtimit të numrit të ndihmësve financiarë (figura 7).

Aktivet e sistemit financiar⁷⁹ deri në vitin 2012 treguan një rritje më të ngadalshme, megjithëse sipas raporteve të paraqitura sistemi financiar në Kosovë tregon nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë. Nëse analizën e thellojmë më tutje, vlera e përgjithshme e aktiveve të sistemit financiar arrin në 4.8 miliardë euro, që tregon për një ngadalësim të rritjes nga 13.2 për qind në qershor 2011 në 4.8 për qind në qershor 2012. Sistemi financiar në Kosovë vazhdon të dominohet nga sektori bankar me një përqindje 77.5 për qind në gjithsej aktivet e sistemit financiar. Sipas raportit të BQK (2013), vlera e aktivet të sektorit financiar gjatë vitit 2013 arrin në 4.2 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 10.5 për qind (9.9 për qind në dhjetor 2012). Rritja i dedikohet kryesisht rritjes së aktiveve të fondeve pensionale dhe bankave komercial dhe pjesërisht rritjes së lehtë të kompanive të sigurimit (BQK, 2013). Fondi pensional është i vetmi sektor që rriti pjesëmarrjen në vitin 2013 në 21.7 për qind, nga 19.5 për qind sa ishte në vitin 2012. Pjesëmarrja e sektorit të mikrofinancës në strukturën e përgjithshme financiare tregoi ulje nga 3.0 për qind gjatë 2012, respektivisht 2.7 për qind gjatë vitit 2013. Sektori bankar vazhdoi të karakterizohet me performancë të mirë financiare, duke mbajtur nivelin e lartë të profitabilitetit (BQK, 2016).

⁷⁹ [http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2012/Raporti për qind20i për qind20Stabilitet për qind20Financiar.pdf](http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2012/Raporti%20për%20qind20i%20për%20qind20Stabilitet%20për%20qind20Financiar.pdf)

Figura 8. Struktura e aktiveve të sistemit financiar sipas sektorëve



Burimi: Raporti vjetor, BQK 2013, 2016

Siç pasqyrohet në figurën më lartë ecuria e zhvillimit të sistemit financiar do të reflektojë me vlerë rritjeje të gjithsej aktiveve, që sipas raportit të vitit 2016 (BQK, 2017) arriti në 5.39 miliardë euro në vitin 2016, duke paraqitur rritje vjetore 10.0 për qind nëpër vite, 2013-2016, si rezultat i sektorit bankar dhe sektorit pensional, duke pasuar me kompanitë e sigurimit, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiarë.

3.3. Roli i mikrofinancës në vendet e pas konfliktit

Konfliktet shkaktojnë degradimin të cilësisë së jetesës dhe të gjendjes ekonomik dhe pastaj shumë mjedise vuajnë nga mungesa e kapitalit financiar dhe social, infrastruktura dhe marrëdhënia funksionale (Welle-Strand, A., Sitter, N., & Kjøllesdal, K. 2010). Në këto rrethana, njerëzit e varfër nuk janë të shërbyer nga bankat, megjithatë kërkojnë shërbime me shpenzime të ulëta, të cilat janë projektuar për të zhvilluar jetën dhe mjedisin e pasluftës në të cilin ata duhet të jetojnë (Woller, 2002:7).

Me zhvillimin e sektorit mikrofinanciar rritet siguria dhe vetëbesimi tek individët e varfër si dhe të tjerët të kufizuar në qasje në shërbime bankare tradicionale, të cilët kanë nevojë për të filluar një përvojë të re për zhvillim dhe mirëqenie. Për të rritur njohuritë dhe besimin e mikrofinancës në vendet e pas konfliktit, Willson (2002) nxjerr në pah se mjedisi

ku do të zhvillohen aktivitetet ka një rëndësi të madhe. Gjithashtu, krijimi i besimit apo njohuria për punën e huamarrësve dhe funksionimi i tregjeve është po aq i rëndësishëm për mikrofinancën. Duke e specifikuar rëndësinë e mikrofinancës informale, e cila ”në vendet e pas konfliktit është e varur nga besimi reciprok në mes të huadhënësve dhe huamarrësve mbi aktivitetet që ata zhvillojnë”, Ëillson (2002) thekson që *”njerëzit e varfër më shumë preferojnë mikrofinancën informale, e cila ofron qasje më të lehtë, shërbime fleksibile si dhe kredi individuale”*.⁸⁰ Kontributi i mikrofinancës në ndërtim të paqes, në vendet e pasluftës, është parë se është mjet efektiv për lëvizjen e të varfërve në nivel të ekonomisë së qëndrueshme, pasi që:

“Institucionet mikrofinanciare (IMF) kanë krijuar procese për kreditimin në grupe, duke krijuar hapësirë të përbashkët ku ata që shërohen nga konflikti të mund të krijojnë barazi dhe zgjidhje të konfliktit, duke u fokusuar në një mision të përbashkët të zhvillimit ekonomik” Gauthier (2012:23).

Sipas Gauthier (2002), mikrofinanca inkurajon pajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit, duke përfshirë bashkëpunimin ndëretnik, sikurse që është kur prodhuesit dhe konsumatorët ndërveprojnë përtej kufijve etnikë. Për më shumë, në punimin⁸¹ *“A Critical Assesment of Micro Enterprise Development in the Post –Conflict Rehabilitation : A case Study of three MFIs in Kosovo”*, sipas e Addison et.al (2002 (b),⁸² të cituar nga Das (2003), ”rindërtimi shpesh shihet si proces i rindërtimit të infrastrukturës (bankave, shtëpive, rrugëve, aeroporteve etj.), të cilat përsërisin modelet e mëhershme të zhvillimit dhe shumë pak vëmendje i kanë dhënë ndryshimeve të shoqërisë dhe institucioneve“, edhe pse stabiliteti i

⁸⁰ Willson: 2002 :6-7,106).

⁸¹ Punimi i Nureen Das (2003)

⁸² Nga punimi “Finance in Conflict and Reconstration”

shoqërisë dhe i institucioneve është çelësi për zhvillim të qëndrueshëm në vendet e dala nga lufta (Das, 2003:68).

Prezenca e madhe e mikrofinancës është dëshmi se në vendet e zhvilluara, ato në zhvillim, si dhe në vendet e dala nga konfliktet, një numër i institucioneve mikrofinanciare ka arritur suksesin e duhur, duke rritur rëndësinë dhe përkrahjen e tyre. Implementimi i iniciativave paqësore në vendet e dala nga konfliktet i ofron njerëzve mundësi për t'u angazhuar në mikrondërmarrje/biznese të vogla, të cilat duken të jenë mundësi e mirë për gjenerim të të ardhurave dhe mundësi punësimi.⁸³ Në këto situata, janë OJQ-të e ndryshme të cilat kanë bërë të njohur nevojën për përkrahjen e bizneseve me qëllim që ato të rimëkëmben, të rriten dhe të zhvillohen.

Shumica i referohen IMF-ve me “OJQ financiare”. Në shumicën e rasteve, OJQ-të e mikrokredisë nuk lejohen të mbledhin depozita kursimi nga publiku i përgjithshëm. Ky grup i përbërë nga disa qindra OJQ ka udhëhequr zhvillimin e mikrokredisë dhe, si rrjedhim, edhe të mikrokredisë në mbarë botën. Shumica e tyre formojnë një grup që përgjithësisht i referohen si organizatat e “praktikave më të mira (best practises)”, ato që përdorin teknikat më të reja të kreditimit për të gjeneruar një numër efektiv klientësh që i lejon të shërbejnë nivelet më të ulëta të tregut në një mënyrë të qëndrueshme dhe fitimprurëse.

Das (2003: 69) thekson se për krijimin e IMF-ve në situatat pas konfliktit, OJQ-të dhe organizata të tjera zhvillimore dhe humanitare duhet të synojnë përdorimin dhe pranimin e

⁸³ Nuren Das (2003) A Critical Assessment of Micro Enterprises Development in Post- Conflict Rehabilitation; A Case study of Three MFI-se in Kosovo.

normave dhe praktikave vendore. Kjo duhet të ndodhë para se të vendoset për zhvillimin e importuar, i cili shpesh udhëhiqet nga donatorët. Në Bosnje dhe Hercegovinën e pasluftës, shumë organizata kanë futur mikrofinancën si pjesë të portofolios së tyre më të madhe, në aktivitetet programore me qëllim rindërtimin dhe rivitalizimin e komunikimit.⁸⁴ Në punimin⁸⁵ e tyre, Matul dhe Tsilikounas (2004) pohojnë se kreditë e mikrondërmarrjeve në Bosnje dhe Hercegovinë kanë nxitur rindërtimin e shtëpive, ngase këto shërbime ofrojnë efikasitet dhe qëndrueshmëri përballë ekonomive familjare të pasluftës. Sipas autorëve, shumicës së klientëve të mikrondërmarrjeve kreditë u kishin ndihmuar të paktën për të mbështetur aktivitetet e vetëpunësimit në ekonomitë e tyre shtëpiake. Autorët ndajnë mendimin se mikrofinanca dhe shërbimet e ngjashme mund të luajnë një rol të rëndësishëm në rindërtimin e zonave të pas konfliktit. IMF-të në Bosnje dhe Hercegovinën e pasluftës ishin shumë të kërkuara, në saje të garancive fleksibile të cilat kërkoreshin, ashtu që ato kanë plotësuar një treg të pashfrytëzuar, duke ju dhënë më shumë mundësi huamarrësve të fillojnë me biznese.

“Gjatë dhe pas konfliktit zgjerimi i bizneseve në sektorin informal është një burim i rëndësishëm i punësimit dhe i të ardhurave familjare. Këto biznese kërkojnë një gamë të gjerë shërbimesh të zhvillimit të biznesit, duke përfshirë edhe financat, të cilat normalisht duhet siguruar nga sektori informal. Kërkesa për mikrofinancat gjithashtu buron nga buxhetet familjare, kryesisht për zbutjen e konsumit (Eilson, 2002).”⁸⁶

Në hyrje më të thellë të studimit mbi zhvillimin e mikrofinancës, vërehen rezultate në zbutje të varfërisë në shumë vende të botës dhe promovim të mikrondërmarrjeve në vende të Unionit Evropian. Prandaj, sipas Shaw dhe Clarke (2004), mikrofinanca mund të

⁸⁴ Role of microfinance in the household reconstruction process in Bosnia and Hercegovina

⁸⁵ Qëllim i punimit ishte të kuptohej roli që kishin kreditë e mikrondërmarrjeve në rindërtimin e ekonomive familjare

⁸⁶ Microfinance during and after armed conflict : Lessons from AOJQla, Cambodia, Mozambique and Rwanda; TAMSIN WILSON, (March, 2002)

shfrytëzohet për të shërbyer si lehtësim dhe zhvillim i qëllimeve në mjediset e pas konfliktit.

3.4. Vështrim i përgjithshëm themelimi i mikrofinancës në Kosovë

Nga praktika të vendeve të ndryshme të botës vihet re se njerëzit e varfër dhe bizneset e vogla kërkojnë shërbime me shpenzime të ulëta. Megjithatë, ata nuk janë të shërbyer mirë nga bankat dhe kjo u pamundëson atyre të zhvillohen në mjedisin në të cilin jetojnë. Në këtë drejtim, rritja e shpejtë e mikrofinancës për të ofruar shërbime financiare për individë të kufizuar në shërbime financiare në shumë vende të botës nisur nga viti i origjinës, rrit shpresat që edhe në Kosovën e pas vitit 1999, bizneset e reja, të varfrit dhe të tjerët t'i qasen shërbimeve financiare të ofruara nga institucionet mikrofinanciare, në drejtim të zhvillimit të tyre individual dhe shoqëror.

Operimi i institucioneve mikrofinanciare në Kosovë është domosdoshmëri për plotësimin e kërkesave të një pjese të popullsisë, ekonomive familjare dhe bizneseve të vogla, të cilët nuk kanë qasje në shërbime financiare bankare. Megjithatë, ato duhet të mos ndryshojnë nga qëllimi i tyre për të cilin janë themeluar. Aktiviteti i institucioneve mikrofinanciare të regjistruara, është i rregulluar ligjin Nr.04/L-093 , *“qëllim kryesor është që të sigurojnë hua kryesisht për familjet dhe individët me të ardhura të ulëta dhe për mikrosubjektet dhe ato të vogla”* (fq:74)

Historia e themelimit të mikrofinancës në Kosovë ndërlidhet me vështirësi të cilat kanë treguar përvojat e bizneseve për t'u shërbyer me shërbime bankare menjëherë pas përfundimit të luftës në qershor të vitit 1999. Mundësitë për ofrim të shërbimeve financiare nga bankat ishin të kufizuara, si në aspektin ekonomik ashtu edhe atë gjeografik. Si

zgjidhje alternative për plotësimin e kësaj nevoje në Kosovë, më 22 tetor 1999, PSSP⁸⁷ nënshkroi një rregullore që autorizon institucionet financiare jobankare të jepnin kredi si mikrokredi deri në 2,000 DM⁸⁸ për individë dhe biznese të vogla. Si rezultat i kësaj, në vazhdim janë licencuar dhjetëra institucione kreditore jobankare, të cilat krijojnë kushte më të favorshme për zhvillimin e mikrofinancës.

Në vitin 2000, në mbështetje të Agjencisë për Zhvillim të Francës dhe BE, në Kosovë fillohet me fazën e parë të projektit pilot, përmes shoqatave të mikrofinancimit, për të ofruar shërbime për kredi dhe kursime, fillimisht në zonat rurale, si rasti i Klinës dhe i Vushtrrisë. Projekti kishte për qëllim të zgjerohej deri në 72 shoqata, për të përfshirë kështu një të tretën e fshatrave në Kosovë përgjatë katër viteve. Kapitali fillestar prej 4 milionë DM është dhënë në mënyrë të barabartë nga Agjencia e Francës për Zhvillim dhe Unionit Evropian (EU), duke financiar me 20.9 milionë DM në fazën e dytë, dhe 25 milionë DM do të financohet në fazën e tretë në vitin 2003. Më tutje, nga Banka Botërore ishin mbështetur programet e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) me një investim prej 20 milionë DM, duke përfshirë ndërmarrjet me veprimtari të industrisë së lehtë, ato me shërbime me vlerë të shtuar dhe ndërmarrjet e përpunimit të produkteve bujqësore.⁸⁹ Zhvillimi ishte i mirëseardhur si për fermerët komercialë ashtu edhe sipërmarrësit ruralë, të cilëve përmes kredive u mundësoheshin investime të reja dhe krijim i kapitalit punues. Me fillim të rimëkëmbjes së vendit, shumica e institucioneve mikrofinanciare kanë filluar të veprojnë si programe të zhvillimit ekonomik të organizatave humanitare ndërkombëtare.⁹⁰

⁸⁷ Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

⁸⁸ DM – Deutsche Mark, valuta e Republikës së Gjermanisë, e cila ishte adaptuar si valutë zyrtare në Kosovë pas luftës, deri në futjen në përdorim të Euros, nga vendet e Bashkimit Evropian.

⁸⁹ Kosovo and Strategy for a development 2001 (Strategjia zhvillimore e Kosovës , 2001)

⁹⁰ <http://www.themix.org/>

IMF në Kosovë janë rregulluar si OJQ nga Misioni i Kombeve të Bashkuara (UNMIK), të cilat do të regjistrohen në Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe fitimi i tyre ishte i liruar nga taksat.

Në Kosovë, institucioni mikrofinanciar është i regjistruar si person juridik i organizuar ose si OJQ sipas Ligjit për OJQ-të, ose si shoqëri aksionare sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Aktiviteti primar është dhënia e kredive dhe ofrimi i një numri të kufizuar të shërbimeve financiare për mikro dhe subjektet e vogla juridike, ekonomitë familjare me të hyra të ulëta dhe personat me të hyra të ulëta. Institucionet mikrofinanciare, të cilat ishin regjistruar si Organizata Joqeveritare (OJQ) të rregulluara nga Misioni i Kombeve të Bashkuara (UNMIK), filluan me dhënie të kredive mikrofinanciare si produkt të vetëm (AMIK, 2010). Në mars 2008, UNMIK aprovoi Rregulloren 2008/28 mbi Regjistrimin, Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Institucioneve Mikrofinanciare, duke iu mundësuar në këtë mënyrë IMF-ve të transformohen në entitete “të licencuara” depozitë marrëse. IMF-të depozitë marrëse duhet të regjistrohen në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë si Shoqëri Aksionarësh (SHA) ose Kompani me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK). Rregullorja, po ashtu, parasheh një nen për IMF-të që nuk kanë mundësi të plotësojnë kërkesat e kapitalit për institucione depozitë marrëse, që të bëhen institucione të “regjistruara”. IMF-të e regjistruara mund të vazhdojnë funksionimin si OJQ, duke dhënë kredi mikrofinanciare si produkt të vetëm, përderisa IMF-të e licencuara mund të veprojnë si entitete komerciale dhe janë të lejuara që të mobilizojnë depozita nga publiku. IMF mund të angazhohen edhe në aktivitete të tjera financiare, siç mund të përcaktohen nga BQK-ja me rregullore ose urdhëresë. BQK, po ashtu, mund ta ndalojë ose ta kufizojë çdo institucion të regjistruar mikrofinanciar.

Në fund të vitit 2012, në Kosovë operonin katërbëdhjetë (14) institucione mikrofinanciare dhe katër(4)institucione financiare jobankare, me aktivitete të kredidhënies. Në pajtueshmëri me kërkesat e kornizës ligjore, për arsye të mos fillimit të operimit të institucionet financiar, Bordi Ekzekutiv ka revokuar regjistrimin e dy institucioneve mikrofinanciare, “Agro Invest” (Krushë e Vogël, Prizren) dhe “Fundëay Mortgage” (Prishtinë).⁹¹

Institucionet e regjistruara mikrofinanciare mund të angazhohen edhe në aktivitetet vijuese⁹²

- Ofrimi i shërbimeve të pagesave lidhur me huat e dhëna klientëve;
- Përfitimi i fondeve me anë të grupeve apo me huazime, me qëllim të huadhënies apo për përdorim të tyre;
- Huazimi dhe vendosja e fondeve në tregje dhe institucione të miratuara nga BQK-ja, me qëllim të menaxhimit të likuiditetit të tyre;
- Përfitimi, posedimi, dhënia me qira, marrja me qira, mirëmbajtja, transferimi, shitja ose largimi i çdo pasurie të paluajtshme apo të luajtshme që është shfrytëzuar për realizimin e biznesit të tyre;
- Sigurimi i ndihmës financiare, teknike dhe profesionale; dhe trajnimi i klientëve të tyre apo ofrimi i ndihmës, që atyre t’u ofrohen shërbime në fushat e tilla.
- Institucionet mikrofinanciare, gjithashtu mundë te angazhohen në aktivitete të tjera financiare, siç mund të përcaktohen nga BQK-ja me rregullore ose urdhëresë; dhe
- BQK-ja po ashtu mundë të ndaloj ose kufizoj çdo institucion të regjistruar mikrofinanciar në angazhimin në ndonjë nga aktivitet e lejuara të përcaktuara në këtë nen të këtij ligji.

⁹¹ Raporti Vjetor 2012: BQK, fq. 91

⁹² Sipas nenit 93 – LIGJI Nr.04/L-093

Në ndërkohë, vendimi për masa të përkohshme ⁹³ i cili parasheh, pezullimin dhe zbatimin e neneve të cilat kishin mundësuar transformimin e OJQ-ve mikrofinanciare në shoqëri aksionare. Në të njëjtën kohë mundësin e shëndrrimit të kapitali të OJQ-ve në kapital privatë, e përcaktuar me ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucioneve financiare jobankare (ligji Nr 04/L-093). Kjo situatë kishte krijuar diskutime dhe debate të shumta midis shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të këtyre institucioneve, të cilat mbasin aktuale edhe gjatë kësaj periudhe.

3.5. Reflektimet e mikrofinancës për zhvillim ekonomik dhe social

Është e natyrshme që zhvillimi ekonomik i zonave rurale të jetë ndër prioritetet kryesore të një vendi nga situata e krijuar pas luftës. Kjo pasi që përballja me standarde të ulëta të jetesës, papunësi të madhe, nivel të ulët të prodhimit bujqësor dhe me mungesë të një politike të qëndrueshme për zhvillim rural, ishin problemet me të cilat preokupohej popullsia e zonave rurale. Në Kosovë, zonat rurale kishin përfituar nga programet mikrofinanciare të udhëhequra nga Njësitë e Përkohshme Kreditore (ICU), FINCA, ADIE-Internacional, Agjencia për Financim në Kosovë (AFK), Besëlidhja Mikrofinancë, etj.⁹⁴ Mbështetja e bizneseve të vogla, grupeve minoritare dhe grave, me kapacitet për të gjeneruar të ardhura, ishin pjesë e programeve mikrofinanciare, të cilat ishin themeluar nga OJQ-të ndërkombëtare dhe ato lokale.

⁹³ Rastin nr. K097/12

⁹⁴ Sipas hulumtimit të zhvilluar nga “Riinvest”, (Zhvillimi rural në Kosovë, 2014) përmes anketimit të 100 familjeve, të dhënat e dala mbi pronën e tyre të paluajtshme, aktivitet bujqësor dhe blegtorale, kushtet dhe standardin e jetës, pasqyrojnë qartë nevojën për zhvillim rural në Kosovë.

3.5.1. Kreditimi i mikrondërmarrjeve në Kosovë

Qëllimi i programeve të organizatave humanitare ndërkombëtare në Kosovë gjatë vitit 1999 ishte i orientuar kryesisht në zhvillimin ekonomik të vendeve rurale, përmes së cilave programe fillon së vepruari edhe sektori i mikrofinancës. Sipas Kodderich dhe Veillerette (1999), forcimi i institucioneve financiare që ofrojnë shërbime të kredive dhe të kursimeve është parakusht për zhvillim të sektorit rural, që paraqet nevojë urgjente për zhvillimin e institucioneve të fuqishme dhe të qëndrueshme financiare rurale. Kume et al. (2009) vijnë në përfundim se sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) është instrumenti më eficient për ekonominë në tranzicion, i cili gjeneron rritje ekonomike të qëndrueshme, punësim dhe reduktim të varfërisë. Në këtë drejtim, pjesëmarrja e mikrofinancës ka treguar ndikim pozitiv në ndërmarrjet që ishin tipike të vogla, me punë intensive dhe në rritje (Bolnick dhe Nelson, 1990).

Në dokumentin mbi Strategjinë e Kosovës (2013), NVM-të konsiderohet se përbëjnë shtyllën kurrizore të ekonomisë së Kosovës. Sipas Institutit për hulumtime zhvillimore “Riinvest” (2014),⁹⁵ 92 për qind e bizneseve të Kosovës janë mikrondërmarrje, me përbërje prej 1 deri 9 punëtorë, shumica janë në pronësi të familjes, gjë që krijon mundësi kufizimi për risi dhe për të arritur ekonominë e dobishme të shkallës. Nga ky volum, një e treta prej tyre janë të përqendruara rreth Prishtinës, duke lënë pjesët e tjera të Kosovës më pak të zhvilluara. Sipas “Vlerësimit të Sistemit Inovativ të Kosovës”, vështirësitë që ndërmarrjet e vogla të sigurojnë financimit të jashtëm për arsye të politikave konservatore të kredidhënies nga bankat dhe mangësitë në informacionin në dispozicion mbi kredimarrësit e besueshëm,

⁹⁵ Klima e Biznesit në Kosovë, Riinvest (2014)

Gjithashtu faktorë të tjerë janë edhe mungesa e kontabilitetit të duhur dhe pasqyrat e audituara financiare. Sipas, “Riinvest” (2014:34), kostoja e lartë e financimit është barrierë kryesore për zhvillim të NVM në Kosovë, e cila paraqet normën e lartë të interesit rreth 13 për qind, e cila aplikohet nga institucionet financiare. Gjithnjë sipas publikimi të Riinvest (2014), kjo normë e lartë e interesit ka kufizuar bizneset për të zgjeruar aktivitetin e tyre biznesore, të gjenerojnë vende pune dhe të zvogëlojnë përqindjen e lartë të papunësisë dhe nivelin e lartë të varfërisë. Ngjashëm edhe në publikimin e radhës së Riinvest (2015),⁹⁶ bizneset janë pyetur nëse kanë marrë kredi (hua) gjatë vitit 2013. Nga numri i të anketuarave, 28.1 për qind kanë marrë kredi, përderisa se nuk kanë marrë kredi janë përgjigjur 71.9 për qind e të anketuarve. Kësaj përgjigjeje i bashkëngjitet përgjigja se kredinë e kanë marrë nga bankat 94.9 për qind, përderisa vetëm 4.30 për qind nga institucionet e tjera dhe 0.80 për qind nga miqtë. Sipas këtij hulumtimi, vërehet se kushtet e huamarrjes janë arsye të cilat paraqesin pengesa në zhvillim të mikrondërmarrjeve, sipas së cilëve për kushte të pafavorshme deklarohen 39.1 për qind, duke u përcjellë me shumë të pafavorshme me 30.7 për qind, pastaj të favorshme 27.7 për qind, dhe shumë të favorshme vetëm 2.2 për qind. Pjesa më e madhe e hulumtimeve të analizuara nënvizojnë se ndër vështirësitë kryesore të paraqitura nga NVM janë financat, duke veçuar kushtet e huamarrjes, si normat e larta të interesit, afatin e kthimit të kredive dhe kolateralin.

Dhe, në fund, pavarësisht pranisë të institucioneve mikrofinanciare në Kosovë, qasja në financa mbetet sfidë e konsiderueshme për kompanitë private, veçanërisht për NVM-të, posaçërisht e kufizuar në zonat rurale (Strategjia e Kosovës, 2013:35). Në këtë drejtim, në

⁹⁶ Të gjeturat nga hulumtimi janë të shfrytëzuara në bashkëpunim me zyrtarë të Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim “Riinvest”, Prishtinë (2015)

Strategjinë për Zhvillimin e NVM-ve për periudhën 2012-2016, parashihet përmirësimi në mjedisin e biznesit, po ashtu përmirësimi i qasjes në financa, zhvillimi i kulturës së ndërmarrësisë dhe rritja e konkurrueshmërisë.⁹⁷

3.5.2. Raporti i të varfërve me mikrofinancën

Shkalla e lartë e varfërisë dhe papunësia e lartë janë faktorë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në jetën sociale të shoqërisë kosovare, për të cilën Kosova ka hartuar politika sociale për kategorinë sociale në nevojë.⁹⁸ Ndryshimet e filluara nga MPMS,⁹⁹ të nënvizuara, janë ai i skemës së ndihmave sociale dhe i shërbimeve sociale, që duhet të përshpejtohen dhe në këtë proces të përfshihen sa më shumë palë të interesit.

Studimet mbi varfërinë në Kosovën e pas vitit 1999-2000 tregojnë se 70 për qind e popullsisë ishin në nevojë, “persona të mbështetur”, duke krahasuar me vetëm 14 për qind të cilët ishin të mbështetur nga të ardhurat, dhe 4 për qind merrnin pensione ose ndihma sociale. Sipas Johson dhe Rogaly (1997), varfëria është kuptuar me nivelin e ulët të të ardhurave për ekonomitë familjare. Si rrjedhojë zvogëlimi i varfërisë lidhet direkt me ngritjen e nivelit mesatar të të ardhurave.¹⁰⁰

Në vitin 2011 raportohet se 29.7 për qind e popullsisë në Kosovë jetojnë nën kufirin e varfërisë, ndërsa 10.2 për qind e popullsisë jetojnë nën kufirin e varfërisë së skajshme¹⁰¹

⁹⁷ Strategjia e Kosovës, 2013.42

⁹⁸ <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/09743.pdf> (fq 49)


⁹⁹ Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale përbënë njërin nga dokumentet kryesore strategjike me të cilin adresohen çështjet sociale në Kosovë (shih po aty fq.18, pika 3.4)

¹⁰⁰ Microfinance and Poverty Reduction by Susan Johnson, Ben Rogaly: First published by Oxfam (UK and Ireland) and ACTIONAID in 1997. Reprinted by Oxfam GB 1997,1999

¹⁰¹ Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2011 (mars, 2013)

(figura 9), dhe numri i të papunëve mbetet i lartë, me rreth 43 për qind, që ishte në vitin 2009.¹⁰²

Figura 9. Shkalla e varfërisë në përqindje sipas zonave të banimit 2009-2011



Burimi: Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2011

Të dhënat e prezantuara për vitin 2009 - 2011 tregojnë se shkalla e varfërisë është zvogëluar për 5 pikë të përqindjes prej vitit 2009 në vitin 2010 dhe është rritur në masë të vogël nga viti 2010 në vitin 2011, për 0.5 pikë të përqindjes.

Burim kryesor i ekonomive familjare në Kosovë janë pagat. Prandaj, siç theksojnë Johson dhe Rogaly (1997), nëse niveli i caktuar i të ardhurave për frymë përdoret për përcaktim të nivelit të varfërisë, ulja e varfërisë mund të matet me numrin apo përqindjen e njerëzve që e kalojnë këtë nivel – të cilat janë të nxitur për të dalë nga varfëria (Johnson dhe Rogaly, 1997). Nga studimi i realizuar gjatë vitit 2005 nga Suman Bhaumik et al. (2005)¹⁰³,

¹⁰² <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/09743.pdf>

¹⁰³ Studimi shqyrton shtrirjen e varfërisë, duke përdorur të dhënat nga anketa (LSMS) e vitit 2001 për matjen e Standardeve të Jetesës për Kosovën për familjet serbe dhe shqiptare. Anketa i takon periudhës mes shtatorit dhe dhjetorit 2000, me të dhëna nga 2880 familje (studimi jep informacion për 2101 familje shqiptare dhe 416 familje serbe).

konkludohet se është edukimi më shumë se çdo tjetër që zvogëlon probabilitetin¹⁰⁴ për të qenë të varfër dhe krijon një distancë për ekonomitë familjare nga linja e varfërisë.¹⁰⁵

Gjatë vitit 1990, ofrimi i shërbimeve financiare duke ofruar depozita dhe kredi të vogla mikrofinanciare, me theks ofrim të mikrokredive, është vlerësuar si efektiv për të zbutur varfërinë.¹⁰⁶ Nga ky kontekst ekziston rritje e vazhdueshme në të kuptuarit se si shërbimet financiare mund të ofrohen për njerëzit e varfër. Dhe ajo që dihet është se shërbimet financiare i ndihmojnë të varfëritë ta zgjerojnë aktivitetet e tyre dhe të rrisin të ardhurat dhe aktivet e tyre, kështu që në të njëjtën kohë u rritet edhe vetëbesimi i tyre.

Në mesin e të varfërve, të cilët janë ekonomikisht aktivë në vende të zhvilluara të botës, ka kërkesa për shërbime të vogla komerciale financiare - si për kredi ashtu edhe kursime. Atje ku këto shërbime dhe shërbime të tjera financiare janë të disponueshme, ndihmojnë njerëzit me të ardhura të ulëta për ta përmirësuar; ekonominë familjare; menaxhimin e ndërmarrjes; rritjen e produktivitetit; rrjedhën e të ardhurave dhe koston e konsumit; zgjerimin dhe diversifikimin e biznesit të tyre mikro, dhe rrisin të ardhurat e tyre (Robinson, 2001:6). Sipas Johnson & Rogaly (1999), ofruesit e shërbimeve financiare, që kanë për qëllim mundësimin e njerëzve për të tejkaluar varfërinë, janë të përqendruara në kredi, me fokus tek kreditë për ndërmarrje të vogla, duke përfshirë prodhimin bujqësor.

Në ditët e sotme një numër i institucioneve theksojnë se të varfrit përfitojnë nga mikrofinanca në drejtim të rritjes së të ardhurave dhe zvogëlimit të varshmërisë. Dhe, në anë tjetër, ekzistojnë një numër i dëshmive që mikrofinanca ka ndikim pozitiv në qëllimin e

¹⁰⁴ Autorët, për të studiuar faktorët që kontribuojnë në incidencën e varfërisë, kanë përdorur “probit analizën” kur variabla e varur është faktorë binar që ka vlerë një kur ekonomia familjare është në varfëri dhe, në të kundërtën, zero. Analiza probit është mbështetur duke analizuar përcaktuesit e thellësisë së varfërisë, duke shfrytëzuar “modelin Tobit”.

¹⁰⁵ A Note on Poverty in Kosovo, 2005

¹⁰⁶ Microfinance and Poverty Reduction by Susan Johnson, Ben Rogaly: First published by Oxfam (UK and Ireland) and ACTIONAID in 1997. Reprinted by Oxfam GB 1997, 1999

parë të mijëvjeçarit, ngase numri i njerëzve që jetojnë në varfëri ekstreme, “ata që jetojnë me më pak se 1 dollarë në ditë”, do të reduktohet nga viti 1990 deri 2015.¹⁰⁷

Nisur nga fakti se sektori i mikrofinancës në Kosovë është bërë pjesë e sistemit financiarë kjo sjell në shprehje edhe tendencën e IMF-ve për të operuar të qëndrueshme në të ardhmen duke qenë të pritura për të ndikuar në drejtim të zhvillimit social dhe atij ekonomik të vendit.

3.5.3. Bujqësia dhe financimi i fermerëve

Bujqësia dhe zhvillimi rural janë sektorë kryesorë të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Bujqësia dhe agro përpunimi janë dy sektorë që Kosovës i ofrojnë mundësi reale për zbutjen e varfërisë, gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe për krijimin e të ardhurave për banorët e zonave rurale (Raporti i Gjellbër, 2014). OJQ-të kontribuojnë në sigurimin dhe në ofrimin e mikrokredive për të varfrit dhe të pambrojturit (Chowdhury, 2009),¹⁰⁸ ku shteti duhet të luajë rolin e madh në funksionimin e këtij sektori, duke u kujdesur për të siguruar mungesat në mes të sektorit informal dhe atij bujqësor, i cili do të sjellë rritje të punësimit dhe maksimizim të ndikimit në zbutje të varfërisë.

Në Kosovë, pas konfliktit të vitit 1999, financimet e donatoreve shiheshin si mbështetje kryesore për sektorin e bujqësisë. Bujqësia konsiderohet të ketë rol të rëndësishëm për zhvillim ekonomik dhe si instrument për luftimin e varfërisë.

¹⁰⁷ Po aty (Jonathan Morduch)

¹⁰⁸ Microfinance as a Poverty Reduction Tool- A Critical Assesment (pg.10)

Sipas Meyer (2013:1), shumë IMF kanë arritur suksese të konsiderueshme në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme mikrofinanciare që kontribuojnë në zgjidhjen e problemit të kreditimit bujqësor, duke shërbyer të varfrit në zona rurale. Nxitja e tregjeve financiare për të rritur furnizimin dhe për të reduktuar normat e interesit për kreditë bujqësore është edhe interes i qeverise. Kjo nxitje ndikon në IMF për të qenë financiarisht të qëndrueshme.

Në Kosovë, veprimtaria bujqësore është e përhapur dhe luan rol të rëndësishëm, si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social. Si kontribuues kryesor në PBB, duke u radhitur i dyti pas tregtisë me shumicë dhe pakicë, luhetet ndërmjet 11.5 për qind dhe 14.1 për qind, dhe nëse kësaj i shtohet edhe industria ushqimore, kontributi në PBB arrin në rreth 20 për qind. Sipas regjistrimit të vitit 2011, përmenden shifrat prej 4.4 për qind të të punësuarve në bujqësinë formale, por që vlerësohet se punësimi mund të arrijë në 35 për qind, nëse i shtohet bujqësia ekzistenciale.¹⁰⁹ Numri i përgjithshëm i njësive ekonomike bujqësore vlerësohet në 180,000. Ashtu si në Shqipëri dhe në shumicën e vendeve trashëgimtare të ish-Jugosllavisë, bujqësia ekzistenciale në Kosovë dominon pjesën më të madhe të sektorit bujqësor. Megjithatë, janë problemet ato të cilat mund të ndikojnë në ngadalësimin e zhvillimit të këtij sektori. Si shembull, ajo që theksohet është se shpeshherë prodhuesit bujqësorë, sidomos ata të vegjël, nuk kanë qasje në banka.

Financimi bujqësor në Kosovë dominohet nga një bankë e vetme, e cila përbën rreth gjysmën e totalit të portofolit të kredisë bujqësore. Kështu kreditë për bujqësi në IMF kanë një pjesëmarrje prej 27 për qind të tregut të kredisë për këtë sektor (BQK, 2014). Roli i lartë i IMF-ve është kryesisht për shkak të fokusit të tyre në zonat rurale, përvojës më të

¹⁰⁹ Financimi Bujqësor në Kosovë (fq.10)

madhe të kreditimit bujqësor dhe rural, si dhe njohjes më të mirë të nevojave të fermerëve të vegjël dhe reagimit të duhur ndaj tyre.¹¹⁰

Institucionet financiare janë të interesuara për kreditimin e sektorit bujqësor, por përballen me një numër sfidash në këtë drejtim. Në përgjithësi, sektori i bujqësisë shihet me risk të lartë në kendveshtrimin e kreditimit të tij, pasi institucionet financiare nuk janë në gjendje t'i menaxhojnë rreziqet specifike të prodhimit dhe të tregut të prodhuesve bujqësorë. Mungesa dhe pasaktësia e të dhënave në Kosovë kontribuojnë edhe më tej në këtë nivel risku të sektorit të bujqësisë, që çon jo vetëm në norma të larta të interesit dhe kërkesa për shumë kolateral (kufizimi i përballueshmërisë), por edhe në meny më pak të sofistikuara të produkteve të specializuara për bujqësinë (kufizimi i disponueshmërisë).

3.5.4. Remitencat dhe mikrofinanca

Numri i njerëzve të cilët jetojnë jashtë vendeve të tyre është rreth 215 milionë, numër që paraqet përafërsisht 3 për qind të popullsisë botërore, e rritur trefish që nga viti 1960 (Human Development Report, 2013:15). Rëndësia e remitencave ishte vënë re që me shfaqjen e urisë së madhe gjatë viteve 1846-1848 kur diaspora Irlandeze ishte e shpërndarë në Perandorinë Britanike. Remitencat ndihmuan komunitetin rural në Irlandë, duke u bërë burim i rëndësishëm i kapitalit. Remitencat përkufizohen si “shuma e parave që një punëtor emigrant dërgon në vendin e tij të origjinës”.¹¹¹ Në shumë vende të botës remitencat kontribuojnë me një pjesë të konsiderueshme të GDP-së së tyre.

¹¹⁰ Financimi Bujqësor në Kosovë (fq.7)

¹¹¹ (<http://www.microfinancegateWAY.org/sites/default/files/mfg-en-paper-remittances-the-neë-development-finance-2004.pdf>)

Njerëzit e varfër shpesh dështojnë për të siguruar kapitalin që ata kanë nevojë dhe kështu humbin mundësinë për zhvillim, dhe kjo ndodh sepse ata nuk kanë qasje në shërbime financiare ose vend për t'i ruajtur kursimet. Këtë mungesë të institucioneve ata do ta gjejnë duke u mbështetur në burime jozyrtare, si familjet, miqtë, furnizuesit ose huadhënësit për nevojat e tyre financiare.¹¹² Mungesa e shërbimeve sociale thelbësore bëri që remitencat nga diaspora të luajnë një rol vendimtar në sigurimin e një rrjeti informal social për familjet më të varfra.¹¹³ Roli i remitencave në Kosovë gjatë viteve është u rritur. Remitencat në Kosovë dërgohen kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra dhe janë burim i qëndrueshëm i flukseve hyrëse valutore, të cilat zakonisht tejkalojnë 10 për qind të PBB-se. Me qëllim për të përmbushur këto nevoja, duke krijuar sektorin formal, të tilla si joqeveritare, qeveritare dhe organizatë private, mikrofinanca paraqitet si term që ka ardhur për të referuar në përgjithësi për marrëveshje të tilla joformale dhe formale që ofrojnë shërbime financiare për të varfrit (Braou dhe Woller, 2004).


Sipas disa studimeve, remitencat në Kosovë, vazhdojnë të luajnë rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e mirëqenies së shumë qytetarëve të Kosovës, po ashtu edhe në financimin e ekonomisë përmes stimulimit të konsumit dhe investimeve private (hulumtimet e viteve 2011, 2012, 2013).¹¹⁴ Shuma totale e remitencave gjatë vitit 2012 me vlerë 457 milionë euro, llogaritet të ketë përbërë 9 për qind të Bruto Produktit Vendor, i cili ishte me vlerë 4,916 miliardë euro, që paraqitet në figurën 10.

¹¹² <http://web.undp.org/evaluation/documents/Essential-on-microfinance.pdf>

¹¹³ Country Strategy 2013- 2016 Kosovo

¹¹⁴ Hulumtime të realizuara nga UNDP-ja (për më shumë sqarim në: Kosovo Remittance Study, 2013)

Figura 10. Bruto Produkti Vendor (BPV) dhe remitencat në vitin 2012



Burimi nga : Studimi mbi remitencat në Kosovë (2013:14)

Transferimi i remitencave është i rëndësishëm edhe si burim i të ardhurave të përgjithshme për ekonomitë në zhvillim dhe, gjithashtu, për një numër të madh të ekonomive familjare, veçanërisht për gratë e varfra dhe fëmijët e tyre.¹¹⁵ Nga anketa mbi remitencat e ekonomive familjare (AREF), të realizuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, në mbështetje financiare dhe teknike të UNDP, ekonomitë familjare në Kosovë marrin remitenca të llojeve si:

1. Remitencat e dërguara nga emigrantët në formë të parave të gatshme;
2. Remitencat e dërguara në formën e mallrave dhe shërbimeve (si makina, rroba) si dhe një formë tjetër;
3. Shpenzimet që emigrantët i bëjnë personalisht gjatë vizitave në Kosovë.

Megjithatë, shumica e remitencave ende transferohet përmes burimeve informale, për arsye të kostove të larta, edhe pse IMF tanimë kanë një shtrirje të konsiderueshme në zonat rurale dhe lejimi i tyre do të mundësonte që dërgesat të jenë me kosto më të ulët dhe, gjithashtu, do të ndikonte në rritjen e qasjes në shërbime financiare dhe do të ndikonte në

¹¹⁵(<http://www.microfinancegateWAY.org/sites/default/files/mfg-en-paper-remittances-the-neë-development-finance-2004.pdf>)

përmirësimin e kulturës financiare të dërguesit dhe marrësit (Baleci, F., & Heeman, 2013:76). Është bërë e ditur se remitencat ndikojnë në zbutje të varfërisë, rritje të konsumit, në punësim, ofrojnë kapital punues dhe kanë ndikime të shumta përmes rritjes së shpenzimeve të ekonomive familjare. Institucionet mikrofinanciare (IMF) konsiderohen mënyrë unike për të shërbyer nevojat e marrësve të remitencave, duke investuar fonde të tepërta për të përmirësuar mundësitë për komunitetin lokal.¹¹⁶ Partneriteti ndërmjet bankave të regjistruara dhe institucioneve financiare jo bankare (unionet e kredisë, organizatat mikrofinanciare dhe rrjetet postare) që arrijnë popullsitë e pa shërbyera në zonat rurale, mund të jetë efektiv në zgjerimin e veprimtarisë së tyre. Për shembull, një bankë mund të marrë pagesat e remitencave nëpërmjet transfereve përmes llogarisë dhe të sigurojë qasje për klientët ruralë, përmes një marrëveshjeje me një zyrë postare që ka degë rurale.¹¹⁷

Remitenca ofron potencial të madh për bankat dhe institucionet e tjera financiare për të shtuar konsumin në komunitetin e varfër. Sektori privat duhet të bëhet i vetëdijshëm për mundësitë e tilla të tregut dhe përkrahja financiare do të zgjerojë operacionet në treg. Remitencat janë shumë më të dobishme për njerëzit e varfër, nëse ata kanë vend të sigurt për t'i ruajtur ato dhe prej ku mund t'i tërheqin sipas nevojës apo edhe ti përdorin për biznes. Institucionet mikrofinanciare (jo bankare) mund të jenë më të arritshme për të

¹¹⁶ <http://www.ifad.org/remittances/pub/networks.pdf>

¹¹⁷ (<http://www.microfinancegateway.org/sites/default/files/mfg-en-paper-remittances-the-needs-development-finance-2004.pdf>)

varfrit, por shpesh përballen me kufizime rregulluese në ofrimin e shërbimeve të depozitave.¹¹⁸

3.5.5. Roli i mikrofinancës në fuqizimin e femrave

Sa më shumë që trajtohet çështja lidhur me varfërinë, aq më shumë theksi bie mbi rolin e mikrofinancës. Ideja mbi mënyrën për të ndihmuar të varfrit përmes zhvillimit të mikrofinancës, që ishte përpjekje e Profesor Muhammed Yunus dhe e përcjellë përmes idesë së “Grameen“,¹¹⁹ e cila kishte qëllim për të mbështetur financiarisht sa më shumë familje dhe komunitete për çdo vit, mbetet e fuqishme. Theksohet se qasja në financa kontribuon në përmirësimin e gjendjes sociale dhe ekonomike të grave. Sipas Hermes dhe Lensink (2011), synimi për të mbështetur financiarisht këtë grup të klientëve është për shkak se gratë nga përvoja kanë treguar se janë më të përgjegjshme financiarisht dhe me performancë më të mirë të shlyerjes së kredive sesa meshkujt. Ato e përdorin pjesën e konsiderueshme të të ardhurave të siguruara për shëndetin dhe edukimin e fëmijëve dhe luajnë një rol shumë të rëndësishëm në reduktimin e varfërisë brenda familjes së tyre (Hermes dhe Lensink, 2011).

Në Kosovë, pas vitit 1999, janë zhvilluar shumë aktivitete dhe projekte, të cilat kishin për qëllim sensibilizimin e shoqërisë mbi barazinë gjinore, me theks integrimin dhe përfaqësimin e grave në procese të përgjithshme zhvillimore të vendit. Sipas ASK (2015), “barazia gjinore i referohet mundësive të barabarta të grave me burrat, të drejta dhe detyra

¹¹⁸ (<http://www.microfinancegateWAY.org/sites/default/files/mfg-en-paper-remittances-the-new-development-finance-2004.pdf>)

¹¹⁹ Yunus, M. (2007). *Creating a world without poverty: Social business and the future of capitalism*. PublicAffairs.

në mjediset e tyre sociale, profesionale dhe familjare”, për të cilën në dokumentin

“Programi i Kosovës për Barazi Gjinore – (PKBGJ, 2008)¹²⁰ theksohet që:

“Mungesa e barazisë gjinore shpesh ngadalëson produktivitetin e punës, në aspektin afatshkurtër dhe afatgjatë. Po ashtu, pabarazia gjinore krijon joefikasitet në ndarjen e punës si në familje ashtu edhe në shoqëri, e në këtë mënyrë ajo kontribuon në varfërimin e njerëzve” (fq:8).

Numërohen një numër faktorësh që ndikojnë në punësimin e grave, siç është përgjegjësia për rritjen e fëmijëve, obligimet ndaj punëve të shtëpisë, niveli arsimor, qasja e kufizuar në formimin profesional, pronësia dhe mundësia për të përfituar kredi. Në këtë kuptim, “krijimi i programeve për mikrokredi që synojnë të financojnë gratë sipërmarrëse” është një rekomandim i dhënë në hulumtimin mbi “udhëheqjen dhe pjesëmarrjen e grave në politikë”, në rastin e Kosovës. Projekti kishte për qëllim të vlerësonte pjesëmarrjen e grave në aktivitetet sociale dhe politike si dhe të analizonte faktorët që ndikojnë në nivelet e pjesëmarrjes së grave. Për shembull, sipas raporteve të institucioneve financiare (bankat), rezultoi se vetëm 3 për qind e kreditimeve ishin dhënë në emër të grave. Faktorë i ulët ishte edhe numri i menaxhimit të ndërmarrjeve të vogla në nga gratë. I njëjti dokument thekson se nga 500 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM), vetëm 2 për qind të tyre udhëhiqen nga gratë dhe pjesa tjetër, 98 për qind, udhëhiqen nga burrat, të dhëna këto të cilat paraqesin nivelin e ulët për shkaqe sociale.¹²¹

Një analize krahasuese, tregon përqindjen e huamarrësve femra pjesë e Institucionet mikrofinanciare të cilat operojnë në Kosovë, për periudhën 2010-2013, duke marrë në

¹²⁰ Ky dokument ishte i miratuar nga Këshilli Drejtues i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ), më 19 mars 2008.

¹²¹ <http://www.womensnetwork.org/documents/20130529105303566.pdf>

konsideratë katër IMF (FINCA, KEP, AFK, KGMAMF), të dhënat e të cilave ishin më të plota ¹²² na japin këtë panoramë të këtij fenomeni:


Tabela 3. Pjesëmarrja e femrave huamarrës në baza vjetore sipas IMF-ve

Viti	FINCA	KEP	AFK	KGMAMF	Gjithsejta klientë	Nr femrave huamarrese	Përqindja
2010	16,581	21,083	1015	4868	43,547	11,686	27%
2011	13,281	17,100	1215	4703	36,299	22,283	61%
2012	10,520	14,960	1456	4809	31,745	9,328	29%
2013	11,424	13,364	1777	4815	31,380	18,391	59%

Burimi: Të dhënat e mbledhura nga MIXmarkt , tabela punuar nga autori

Grafikisht e paraqesim si me poshtë:

Figura 11. Trendi i pjesëmarrjes së femrave në huamarrje (Kosovë)



Burimi: Të dhënat e mbledhura nga MIXmarkt , tabela punuar nga autori

Si rezultat i tabelës 3, ekziston rritje e numrit të femrave huamarrës nëse e krahasojmë vitin 2012 me vitin 2013, pasi në vitin 2012 kishte një ulje në krahasim me vitin 2011. Pjesëmarrja e femrave në huamarrje në MFI në Kosovë duke filluar nga 27% në vitin 2010 vazhdon duke u rritur në 59% në vitin 2013, ose rritja e huamarrësve femra është për 6000 huamarrësve më shumë në numri vitin 2013.

Pjesëmarrja e femrave në huamarrje të lëshuara nga IMF-të është në rritje dhe mund të jetë e krahasueshme me vende të cilat kanë pasur fatin e njëjtë të zhvillimit të pas luftës , ashtu si është rasti i Bosnjës dhe Hercegovinës. Ky krahasim është bërë pasi që të dy vendet kanë një histori të ngjashme në aspektin e gjendjes sociale dhe ekonomike si raste të pas luftës.

¹²² Te dhëna të njëjta janë përdorur në punimin e autorit “Social economic impact of microfinance for women empowerment”


Tabela 4. Pjesëmarrja e femrave në baza vjetore- Bosnje dhe Hercegovine (BH)

Year	EKI	MI BOSPO	LOK Micr	SUN RISE	Gjithsejte klientë	Nr femrave huamarrese	Përqindja
2010	41,605	16,195	29800	19103	106,703	52,836	50%
2011	35,342	13,912	23546	15262	88,062	41,543	47%
2012	33,987	14,172	24672	12424	85,255	38,621	45%
2013	36,237	15,643	19101	11635	82,616	38,231	46%

Burimi: Të dhënat e mbledhura nga MIXmarkt , tabela punuar nga autori

Grafikisht e paraqesim:

Figura 12. Trendi i pjesëmarrjes së femrave në huamarrje (BH)



Burimi: Të dhënat e mbledhura nga MIXmarkt , tabela punuar nga autori

Në rastin e BH pjesëmarrja e grave sipas tabelës më lartë arrin në 50% të huamarrësve në vitin 2010 duke paraqitur një ulje në vitin 2013 në 46%. Kjo tregon një diferencë jo të lartë në mes të dy vendeve, por duke pas parasysh se IMF në Bosnje dhe Hercegovine dhe sistemi bankar pra kultura e kreditimit është krijuar me herët ky faktor e tregon këtë ndryshim në numër të femrave huamarrëse. Kjo është një sinjal i mirë që gjatë viteve 2011- 2013 shihet një rritje e pjesëmarrjes së gruas në huamarrje e cila tregon se është rritur besimi i IMF në raport me ato si klientë të besueshme.

3.6. Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull u diskutua rreth historikut dhe zhvillimit të sistemit financiar, sektorit bankar, me theks themelimi dhe analiza e aktiviteteve më kryesore të institucioneve mikrofinanciare në Kosovë. Nga ajo që u diskutua del se sistemi financiar i Kosovë pas vitit 1999 ishte pothuaj i shkatërruar si pasojë e luftës së në vend. Lëvizjet pozitive të

menjëhershme do të vërehen në të gjitha fushat e jetës në Kosovën e pas 1999. Pas rimëkëmbjes dhe në vazhdim të zhvillimit, sektori bankar arrin të konsiderohet si komponenti kryesor i sistemit financiar në vend. Me mbështetje financiare nga institucione ndërkombëtare dhe donatorë të jashtëm, fillimisht si OJQ dhe më vonë për t'u licencuar si institucione mikrofinanciare (IMF), këto te fundit po bëhen pjesë e rëndësishme e sistemit financiar në Kosovë. Shumica e IMF-ve tregojnë rritje të ndjeshme nga viti 2000 deri sot, të cilat sipas Ligjit nr. 04/L-093 janë të mbikëqyrura nga Banka Qendrore e Kosovës si institucioni kryesor i sistemit financiar në vend. Një pjesë e rëndësishme në këtë kapitull, e cila ndërlidhet me qëllimin kryesor të këtij kapitulli, bazohet në analizën e themelimit dhe aktiviteteve të sektorit mikrofinanciar në vend. Ajo që del në pah është se institucionet mikrofinanciare po konsolidohen dhe janë kontribuues të rëndësishëm në financimin e bizneseve të vogla, mikronjesive dhe ekonomive fermerë në Kosovë. Analizat më të thella tregojnë se në vitet e para të themelimit, rritja dhe qëndrueshmëria e IMF-ve ishte inkurajuese, gjë që në vitet e fundit këta faktorë janë më të luhatshëm. Kjo është rrjedhojë e ndikimit që ka dhënë kriza financiare por edhe i problematikave që po ballafaqohet ekonomia e Kosovës.

Në pjesën e fundit të kapitullit tregohet se sa i rëndësishëm mundë të jetë zhvillimi i IMF-ve të lidhur me ndikimin e tyre në sektorin e mikrobiznesve, bujqësisë, zhvillimit të femrës në shoqëri, lidhja me remitencat, etj në zhvillim ekonomik dhe social të vendit.

KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E PUNIMIT

Në fillim të këtij kapitulli, rikujtojmë qëllimin, objektivat, pyetjet kërkimore dhe hipotezën e ngritur të punimit, të cilat janë përcaktuar në përputhje me parashtrimin e problemit të ngritur dhe literaturën e shqyrtuar. Do të prezantohet profili i shkurtër i sektorit të mikrofinancës. Nënvizojmë se, për realizim të këtij punimi janë përdorur të dhëna nga burime primare dhe dytësore. Për të argumentuar përdorimin e të dhënave dytësore të cilat janë kryesore, paraqitet rëndësia e platformës së MIX, si burim i besueshëm i informacioneve të performancës së IMF-ve nga e gjithë bota. Në vazhdim të këtij kapitulli, në mënyrë më të hollësishme, përshkruhet metodologjia e punimit, e bazuar në një shqyrtim literature të gjerë. Diskutohen raporte vendore mbi çështjen, pastaj prezantohen metodat e përdorura si dhe përshkruhet mbledhja e të dhënave primare dhe dytësore. Gjithashtu përshkruhet specifikimi i modelit ekonometrik i cili përdoret për të arritur deri te një punë e mirë empirike.

Matja e performancës financiare në të gjithë sektorët e ekonomisë është një fenomen në rritje në mbarë botën. Në këtë punim tentojmë të përcaktojmë faktorët që e ndikojnë performancën financiare të IMF-ve në Kosovë. Kjo do të bazohet në metodologji të përdorura në punime të ngjashme empirike të cilët kanë analizuar ndikimin dhe përcaktimin e faktorëve mbi performancën financiare.

Qëllimi

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të hulumtojë mbi ecurinë e operimit të institucioneve mikrofinanciare, të analizoj trendin e performancës dhe të përcaktojë faktorët që ndikojnë në performancën financiare të IMF-ve që operojnë në Kosovë.

Në funksion të këtij qëllimi ne kemi parashtruar edhe objektivat e punimit:

Objektivat

- Të hulumtojë faktorë që ndikojnë në performancën financiare të institucioneve mikrofinanciare bazuar në literaturën bashkëkohore.
- Të analizojë ecurinë në kohë të faktorëve kryesore të performancës financiare të IMF-ve në Kosovë.
- Të përcaktojë dhe analizojë faktorët që ndikojnë në performancën financiare të IMF-ve në Kosovë.
- Të evidentojë problemet lidhur me performancën e IMF-të gjatë operimit në Kosovë dhe të japë rekomandime për rritjen e saj.

Pyetjet kërkimore

1. Cili është ndikimi i moshës (përvojës), madhësisë (vlera e aktive), faktorët e shtrirjes (portofolit të kredisë, numri i huamarrësve aktiv, shumës mesatare të kredisë, huamarrëset femra) dhe faktorët e efikasitetit (shpenzimet operative mbi aktivet, shpenzimet operative mbi portofolin e kredisë, shpenzimet e personelit mbi portofolin e kredisë dhe kostoja për huamarrës) lidhur **me vetqëndrueshmërinë operative të IMF-ve në Kosovë?**
2. Cili është ndikimi i moshës (përvojës), madhësisë (vlera e aktive), faktorët e shtrirjes (portofolin e kredisë, numri i huamarrësve aktiv, shumës mesatare të kredisë, huamarrëset femra) dhe faktorët e efikasitetit (shpenzimet operative mbi aktivet, shpenzimet operative mbi portofolin e kredisë, shpenzimet e personelit mbi portofolin e kredisë dhe kostoja për huamarrës) lidhur **me kthimin nga aktivet të IMF-ve në Kosovë?**

Hipoteza1. *Mosha e institucionit, madhësia, faktorët e shtrirjes dhe të efikasitetit janë të rëndësishëm për performancën financiare e përfaqësuar përmes;*

1.1 vetëqëndrueshmërisë operative (OSS) dhe

1.2 kthimit ndaj aktiveve(ROA)

Vetëqëndrueshmëria operative (OSS¹²³) dhe kthimit nga aktivet (ROA¹²⁴), janë faktorë nga grupi i performancës së përgjithshme financiare (siç kategorizohen në MIX), pjesë e të cilit janë edhe vetëqëndrueshmëria financiare (FSS) dhe kthimi nga kapitali (ROE).

Një IMF për të arritur vetëqëndrueshmëri operative ajo duhet të arrijë raportin në nivelin 1 ose 100%. Ky raport sugjeron se IMF-të duhet të gjenerojnë të ardhura operative më të larta se shpenzimet e saj operative, duke krijuar një situatë që IMF-ja të operojë pa mbështetje të vazhdueshme të subvencioneve dhe donacioneve të tjerëve ose atyre qeveritare. Siç është bërë e ditur në literaturë, kjo nuk është se mund të arrihet lehtë, megjithëse jo e pamundur për të gjitha IMF-të.

Raporti i kthimit nga aktivet (ROA) është përdorur në shumë punime empirike për të matur aftësinë e përdorimit të aktiveve (pasurisë) nga institucioni, duke mbajtur këtë raport pozitiv. Sa më i lartë të jetë ky raport, tregon se menaxhmenti i institucionit shfrytëzon në mënyrë efikase aktivet e saj për të gjeneruar fitim. Për të arritur këtë raport, institucionet mikrofinanciare sugjerohen të shtojnë kujdesin ndaj portofolit të kredisë, gjenerimin e të ardhurave, uljen e kostos për huamarrje, raport më të ulët të kostove operative.

¹²³ OSS në këtë punim do të përdoret ngjashëm me punim të tjera e cila në anglishte është “ Operational self sufficiency”

¹²⁴ ROA- në këtë punim do të përdoret ngjashëm me punim të tjera e cila në anglishte është “ Return on asset”

4.1. Profil i shkurtër i sektorit të mikrofinancës në Kosovë

Institucionet mikrofinanciare në Kosovë njihen si organizata që ofrojnë kredi të vogla për klientë të nivelit me të ardhura të ulëta, ekonomi familjare, biznese të vogla, bujqësi, nevoja sezonale dhe të tjera. Aktiviteti i IMF-ve në Kosovë ka filluar menjëherë pas përfundimit të luftës së fundit të vitit 1999. Statusi i regjistrimit ndryshon varësisht në subjektin përkatës ku këto institucioneve janë regjistruar. Shumica e institucioneve mikrofinanciare në Kosovë, operojnë me kapital të huaj me statusin e OJQ-së, të cilat janë të licencuara përmes rregulloreve të Bankës Qendrore të Kosovës(BQK) për të ofruar kredi (huazime) për klientë shumë të vegjël dhe të vegjël. IMF-ve të regjistruara nuk u lejohej që të ofrojnë shërbime si, kursimet dhe depozitat apo edhe transfertat e parave dhe pagesat e shërbimeve komunale.

Është e theksuar se rregulloret e BQK-së bëjnë dallime midis IMF-ve me status të OJQ dhe IMF-ve me status IFJB(si IMF dhe IFJB janë të raportuara në MIXmarket). Pjesa më e madhe e institucioneve mikrofinanciare që veprojnë në Kosovë janë anëtare të Asociacionit të Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës(AMIK), e themeluar në vitin 2012, anëtare e të cilës janë, AFK, FINCA, KosInvest, KEP, KGMAMF, KRK, Qelim, Start, Meshtenka, Perspektiva. Pjesa e madhe e tyre raportojnë edhe platformën e MIX.

AFK- Agjencioni për financim në Kosovë

AFK e regjistruar si program i Mercy Corps Kosove, operon nga shtatori i vitit 1999, për t'u ri-regjistruar si OJQ në shkurt të vitit 2012. Krahas misioneve edhe të tjera IMF që operojnë në Kosovë, edhe AFK ka për mision përmirësimin e kushteve të jetesës në

Kosovë, përmes ofrimit të shërbimeve të qëndrueshme financiare për ndërmarrje të vogla dhe mikrondërmarrje. Aktivitete të tilla të shtrira në komuna si në Pejë, Gjakovë, Istog, Malishevë, Therandë dhe Prizren. Karakterizohet me klientët si ndërmarrjet/ndërmarrësit privat të cilat së paku kanë 6 muaj që janë në biznes. Për kërkesa për kredi më të vogël se €5,000 bizneseve nuk u kërkohet regjistrim¹²⁵. Duke pas për qëllim të jetë e barabartë për të gjithë të interesuarit pa dallim, etnike apo gjinie, AFK aktualisht ofron lloje të kredive si, kredi për biznes, kredi për bujqësi, kredi për nevoja familjare, kredi për renovim, kredi sezonale, kredi për kursim të energjisë, kredi për regjistrim të automjeteve, kredi për përgatitje për dimër¹²⁶.

KEP Trust

KEP Trust me misioni për të përmirësuar standardet jetësore dhe përkrahjen e zhvillimit ekonomik ofron shërbime financiare dhe jo financiare për individët dhe bizneset në nevojë. I njohur si “Programi Kosovar i Ndërmarrjeve”, KEP ka filluar veprimtarinë si një program ekonomik i Komisionit Ndërkombëtar Katolik për Migrim(ICMC)në shtator të vitit 1999. Qëllimi ishte të shërbej nevojave për kredi refugjatëve, të kthyerve, personave të zhvendosur brenda vendit dhe njerëzve migrues pas përfundimit të luftës në Kosovë¹²⁷. I regjistruar në Autoritetin Bankar të Pagesave në Kosovë (ABP)që nga viti 2000 dhe aktualisht në BQK, duke funksionuar si IMF e rregulluar vendore me status Institucione financiar jo bankar (IFJB) . KEP Trust, operon pa ndonjë aksionarë, të gjitha fitimet, të

¹²⁵ <http://www.amik.org>

¹²⁶ <http://www.afkonline.org/index.html>

¹²⁷ <http://www.keptrust.org/sq/Ballina>

hollat e donacioneve janë të kapitalizuara ¹²⁸. Është e shtrirë në shumë rajone të Kosovës, e përbërë nga 33 degë, duke ofruar produkte si, Express Kredi/Biznes, Express Kredi/shtëpi, Kredi për Biznes, Kredi për Agrikulturë. Kredi për banim dhe Express Kredi për banim¹²⁹.

FINCA – Fondacioni për asistencë të komunitetit ndërkombëtarë

Operimi i FINCA në Kosova ka nisur me misionin për zbutjen e varfërisë, duke bërë zgjidhje afatgjate të cilat ndihmojnë njerëzit të ndërtojnë asete, krijojnë vende të punës dhe për të ngritur standardin e tyre të jetesës. Zhvillimi i më hershëm i FINCA e bënë atë të jetë e shpërndarë në shumë vende të botës si në Afrikë, Euro-Azi, Lindje të Mesme, Azi Juglindore dhe Amerikën Jugore, duke shërbyer më shumë se 1.8 milion klientë. Selia e FINCA gjendet në Uashington DC. Në Kosovë, FINCA fillon të vepron që nga viti 1999, duke krijuar dhe modifikuar shumë produkte kreditore me qëllim për të bërë më të pranueshme dhe më tërheqëse për huamarrësit kosovar. Produkte të cilat ofron FINCA janë produkte kreditore, si grupore, biznesi, bujqësore, për renovim dhe kredi personale ¹³⁰.

KRK – Kreditimi Rural i Kosovës

Misioni i KRK Ltd është ofrimi i shërbimeve financiare për individë në mjedise rurale për sektorin e bujqësisë, në baza të qëndrueshme, kreditim për të institucion mikrofinanciare të përshtatshme e mundë të ndikojë në zhvillim të mjedisit rural në përgjithësi¹³¹. KRK shfrytëzon qasje të përzier për dhënien e kredive, përfshirë agjentë kreditor dhe këshilla kreditore e cila përqendrohet në çështje sociale përderisa agjentët kreditor bëjnë analizën

¹²⁸ <http://MIX.org/mfi/kep/compare#ixzz40Q0g5dhi>

¹²⁹ <http://www.amik.org/>

¹³⁰ <http://kosovo.finca.org/>

¹³¹ www.MIX.org

ekonomike lidhur me profitabilitetin e aktivitetit, qarkullimin e parasë dhe aftësinë e pagesës së klientit¹³².

Produktet e ofruara nga IMF-të në Kosovë, janë të dizajnuar për të plotësuar nevojat individuale dhe në raste ato ofrojnë edhe kredi në grup. Kreditë me vlera më të vogla janë më të shpeshtat të akorduara nga këto IMF. Niveli i kredive të akorduara ndahet në 4 intervale; kreditë me vlerë deri 5000 euro; kreditë 5001-10,000 euro; kreditë 10,001-25,000 euro dhe kreditë mbi 25,000 euro. Kërkesa për kolateral ndryshon midis IMF-ve, varësisht me kapitalin që IMF-të operojnë. Disa nga IMF akordojnë kredi deri në 5000 euro pa kolateral, përderisa të tjera kërkojnë kolateral për vlerën deri 1000 euro. Në këtë rast kolaterali duhet të mbuloj shumën e aplikuar nga klienti plus interesin. Marrja e kredive tek IMF-të në Kosovë karakterizohet nga procedura të shpejta dhe pagesa e kredive mund të bëhet edhe në afate të shkurtra, çka edhe i bën më me interes këto institucione. Norma e interesit për kreditë e akorduara nga IMF-të arrijnë deri në 21%-22%, të cilat konsiderohen të larta në krahasim me normat e kredive të akorduara nga bankat komerciale në Kosovë. Sektori i mikrofinancës vazhdon të tregojë rritje të theksuar në veprimtarinë e tij. Sipas raporteve vjetore të BQK-së vlera e aktiveve gjatë vitit 2016 tregon rritje për 23.5 për qind në krahasim me vitin 2015. Struktura e aktiveve e raportuar vazhdon të dominohet nga kreditë bruto, pasuar me lizingjet financiare, të përcaktuara sipas “ Ligji Nr. 03/L-103” dhe janë lejuar të ofrohen gjatë viteve të fundit nga disa IMF. Kreditë për ekonomi familjare përfaqësojnë rreth 67 për qind të gjithsej kredive të sektorit, të pasuara nga kreditë për ndërmarrje të cilat arrijnë deri në 33 për qind. Në këtë drejtim, raportohet edhe rritje e

¹³² <http://www.amik.org>

kredive të akorduara për sektorin e bujqësisë, pasuar nga sektori i ndërtimit dhe sektorë të tjerë, me ndryshim nga sektori i tregtisë, që shënon rënie. Rezultatet financiare pozitive të IMF-ve gjatë vitit 2016 vërehen duke i krahasuar me ato të vitit 2015 siç janë të paraqitura në tabelën 4 (të dhënat e siguruara gjatë bashkëbisedimit me përfaqësuesin e AMIK).

FINCA, KEP, KRK dhe viteve të fundit edhe AFK vazhdojnë të tregojnë epërsi duke dominuar sektorin e mikrofinanciës në Kosovë. Shuma e huave sipas tabelës në vijim paraqet rritje për periudhën e njëjtë të vitit 2016 në krahasim me atë të vitit 2015.

Tabela 5. Pasqyra e disa faktorëve të performancës sipas IMF-ve

	Shuma e huave deri në maj 2016	Shuma e huamarrësve deri në maj 2016	Shuma e huave deri në maj 2015	Aktivitet deri në maj 2016	Detyrimet deri në maj 2016	Kapitali në maj 2016	Numri I degëve në maj 2016	Numri I punonjësve deri në maj 2016
AFK	14,899,268	10,934	15,311,964	16,280,669	14,157,791	2,122,878	17	147
FINCA	20,424,324	13,305	17,324,900	21,044,046	16,954,488	4,089,558	19	173
KosInvest	2,229,575	1,738	1,965,052	2,311,062	2,096,699	214,363	3	37
KEPTrust	20,860,863	10,723	14,927,662	21,909,447	8,909,959	12,999,488	31	216
KGMAMF	5,182,946	3,801	5,089,730	7,915,942	1,462,085	6,453,857	4	24
KRK	17,627,315	9,097	16,333,013	18,821,805	13,906,542	4,915,263	20	142
QELIM	458,881	418	317,070	362,299	16,652	345,647	1	8
START	2,240,522	2,005	2,130,987	2,916,471	2,261,388	655,082	1	16
Meshtenka	229,456	205	102,030	274,910	100,641	174,269	1	5
Perspektiva	149,926	163	174,530	145,162	1,378	143,784	1	3
Gjithsejte	84,303,076	52,389	73,676,938	91,981,813	59,867,623	32,114,189	98	771

Burimi: AMIK (2016)

Shuma mesatare e kredisë të akorduar gjatë vitit 2015 arrit në 1900 euro. Sipas tabelës më lart (tabela5) aktivitetit të IMF-ve janë të shtrira përmes 98 degëve, të cilat mbulojnë tërë territorin e Kosovës. Gjithashtu sipas tabelës, këto degë ofrojnë shërbime për afër 53 mijë klientë aktiv ku janë të përfshirë 711 punonjës. Sipas këtij raportit të siguar nga

bashkëbisedimi me përfaqësuesin e AMIK, gjatë vitit 2016 janë hapur 8 nëndegë si dhe janë 12 zhvendosje të degëve dhe nëndegëve.

Shuma e huave deri në maj të vitit 2016 ishte 84 milionë euro, e cila paraqet rritje në krahasim me të njëjtë periudhë të vitit 2015 e cila ishte 73 milionë euro. Kjo rritje i referohet rritjes së huave të akorduara për bujqësi, e cila është një përparësi në krahasim me huatë të akorduara për të njëjtin sektor nga bankat tregtare (BQK, 2016).

Në anën tjetër, sipas tabelës më poshtë, e cila paraqet krahasimin e vëllimit të portofolit të kredisë të akorduar nga IMF-të në Kosovë me ato të vendeve fqinje, vërehet një pozicion i mirë i këtij sektori. Struktura e sektorëve të mikrofinancës në këtë tabelë, dominohet nga 15 IMF- IFJB , 7 IMF-ve me status OJQ , 2 janë Unione Kredit dhe 1 është me status sh.p.k e cila i takon Vision Fond Albania. Vlera e kredive të akorduara nga IFJB arrin në 79% të gjithsejte portofolit të kredisë për vitin 2013 sipas kësaj table. Përderisa 12% u takon IMF-OQJ, me 9% merrnin pjesë unionet e kreditit dhe 0.4% merr pjesë Visioni Fond Albania, trashëgimin e të cilit institucion e vazhdon Agro & Social fund, institucion financiar ky me tërësisht kapital shqiptarë.¹³³

Në vazhdim, nga detajet e marra për tabelën 5, është vërejtur se pjesëmarrja më e lartë në portofolin e kredisë i takon 9 IMF me status IFJB të cilat janë pjesë e sektorit mikrofinanciar në Bosnje dhe Hercegovinë, të cilat marrin pjesë me (56%) të totalit të portofolit të kredisë sipas tabelës në këtë punim. Pjesa tjetër i takon 2 IFJB të Shqipërisë(13%), e pasuar nga 2 IFJB të Kosovës(7%) dhe nga 1 IFJB Serbia(2%) dhe Mali

¹³³ Trashëgimin e këtij institucioni e vazhdon Agro & Social fund, institucion financiar tërësisht nën kapital shqiptar(mikrofinanca shqiptare:25 vite në shërbim të sipërmarrjes së lire)

i Zi (1%). Sipas raporteve të MIX për vitin 2013, nga tabela në vijim, mesatare e kredisë për huamarrës e akorduar nga IMF-të në Kosovë është po thuaj në një linjë të përafërt me ato të vendeve fqinje.

Tabela 6. Krahasimi i aktiviteteve midis IMF-ve në Kosovë dhe vendet fqinje

Vendet	Nr IMF-ve	Bruto portfolio e kredise (mln USD)	Bruto Portfolio e kredise sipas llojit te IMF-ve (mln USD)				Mesatare e kredise se leshuar	Numri aktiv I huamarresve
			IMF-OJQ	IMF-IFJB	Credit Union / Cooperative	Sh.p.k		
Shqiperia	4	96,201,123		73,984,956	19,841,683	2,374,484	2457	46161
Bosnja dhe Hercegovina	9	326,200,902		326,200,902			1627	181778
Kosova	6	81,362,035	39,470,645	41,891,390			1731	45965
Maqedonia	2	35,762,215	4,230,203		31,532,012		2986	9886
Mali I Zi	2	30,467,200	21,672,603	8,794,597			1737	16916
Serbia	2	16,360,190	3,195,287	13,164,903			1088	18353

Burimi : tabela e punuar sipas të dhënave për vitin 2013 - MIX ¹³⁴


Renditja e sektorit të mikrofinancës në Kosovë, është në një pozicion të mirë dhe inkurajues sidomos kur ajo krahasohet me sektorin e mikrofinancës në Shqipërisë i cili ka zanafillën e funksionimit që nga viti 1990. Gjithashtu një krahasim interesant është edhe shpërndarja e klientëve e cila tregon trend të ngjashëm midis IMF-ve në Kosovë dhe Shqipërisë. Sipas të njëjtit burim, pasqyra e vetëqëndrueshmërisë operative tregon se shumica e IMF-ve në tabelën e paraqitur kanë arritur në fazën e maturimit, të cilat tregojnë se është rritur aftësia për të krijuar kushte për të qenë të vetëqëndrueshme.

¹³⁴ këtu është e përfshirë mikrokredia e lëshuar nga bankat tregtare e vendeve në listën e paraqitur, të cilat raportojnë në MIX si psh Procredit Bank e Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë. Gjithashtu statusi i IMF-ve wshtw raportuar ashtu sic merret nga MIX.

4.1.1. Aktivitetet dhe performanca e faktorëve kryesore të IMF-ve në Kosovë

Me qëllim që bizneset e vogla dhe sektori i mikrobiznesit në Kosovë të ketë mbështetje financiare si dhe lehtësime nga industria e mikrofinancës, grupi i IMF-ve vendosi të themelojë shoqatën e quajtur Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës (AMIK), anëtarë të cilit u bënë: Kreditimi Rural i Kosovës (K RK), Besëlidhja Mikrofinancë, Agjencia për Financimin në Kosovë (AFK), FINCA – Kosovë dhe Programi i Ndërmarrjeve të Kosovës (KEP). Në këtë drejtim nga autoritetet vendore kërkohej të sigurohet qasja e mbikëqyrjes së institucioneve mikrofinanciare të jetë në përputhje me rreziqet që ato paraqesin (FMN, 2013). Aktiviteti i IMF-ve vazhduan të shtrihen kryesisht në tri regjionet më të mëdha në vend. Sipas, AMIK (2016) IMF-të në Kosovë, tregojnë tendencë të rritjes së aktiviteteve. Nga figura 13, shtrija e IMF-ve është në tri rajone të mëdha si Prishtina e cila përfshinë 54 % të degëve, Peja 32% dhe Prizreni 15% të degëve të sektorit të mikrofinancës.

Figura 13. Shpërndarje gjeografike e degëve të IMF-ve sipas regjioneve



Burimi : BQK (2016)

Në pjesën në vazhdim diskutohet mbi trendin historik të faktorëve të veçuar të performancës financiare të IMF-ve në Kosovë, të cilët janë marrë në konsideratë edhe në pjesën e metodologjisë së këtij punimi.

a) Madhësia e sektorit të mikrofinancës – Aktivet

Në Kosovë, sektori i mikrofinancës dominohet nga kapitali i huaj, aktivet e të cilave përbëjnë 91.6 për qind të gjithsej aktiveve të sektorit (BQK, 2013). Rritja e nivelit të aktiveve ndikon në rritjen e efikasitetit, qëndrueshmërisë dhe të ardhurave të institucionit mikrofinanciar (Kipesha, 2013). Sipas të dhënave nga viti 2004 deri 2011, të paraqitura në tabelën 6, pasqyrohet rritje e vlerës së aktiveve përgjatë viteve, e cila reflekton me ndryshime midis kësaj periudhe. Rritja e vlerës së aktiveve në vitin 2011 prej 390%(126.16 milionë dollarë në vitin 2011) në krahasim me vitin 2004(31.81milionë dollar). Gjatë vitit 2011 nga të dhënat e raportit të MIX, vlerën e aktiveve e përbëjnë 6IMF, ndërsa në vitin 2004 raportojnë 3IMF. Megjithatë, një dinamikë në ulje të vlerës së aktiveve vërehet gjatë viteve 2008-2011 në krahasim me vitet paraprake, e cila mundë të jetë si pasojë e zvogëlimit të rezultatit të aktiveve të tri IMF-ve më të mëdha, vlera e të cilave është zvogëluar në 49 për qind, nga 59 për qind sa ishte gjatë vitit 2010 sipas raportit vjetore (BQK 2011).


Tabela 7. Trendi i aktiveve gjatë periudhës 2004-2011

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Vlera e aktiveve (ne miliona USD)	31.81	45.51	69.83	106.12	128.823	145.38	149.10	126.16
Ndryshimi ne %		43.1%	53.4%	52.0%	21.4%	12.9%	2.6%	-15.4%

Burimi: Përpunuar nga autori (të dhënat MIX market, 2015)

Grafikisht e paraqesim:

Figura 14. Trendi i aktiveve gjatë periudhës 2004-2011



Burimi: Përpunuar nga autori (Të dhënat nga MIX market, 2015)

Nga analiza e mëtejme, vërehet se vlera e aktiveve të IMF-ve gjatë vitit 2012 kishte arritur në 115.8 milionë euro e cila tregon ulje krahasuar 121.9 milionë euro në vitin 2011, duke paraqitur një ndryshim në ulje të vlerës së aktiveve për rreth 5 për qind. Sipas raportit vjetor (BQK,2013) performanca e vlerës së aktiveve të IMF-ve në Kosovë tregon ulje edhe gjatë vitit 2013 në 2.7 për qind nga 3.0 për qind sa ishte pjesëmarrja në strukturën e aktiveve të sistemit financiar sipas sektorëve¹³⁵ në vitin 2012, (RV¹³⁶ BQK 2012). Kjo situatë mund të jetë rezultat i uljes së atraktivitetit të IMF-ve ose pse disa IMF, për arsye ligjore dhe probleme operative, ndërprejnë aktivitetin e tyre. Sipas raporteve, ndërprerja e tkurrjes së aktiviteteve ndodhi gjatë vitit 2014, pasi që vlera e aktiveve arrin në 112.9 milionë euro, një nivel i ngjashëm me vitin 2013 (tabela 8). Vlera e aktiveve gjatë vitit 2015 tregon rritje për 6.11 për qind krahasuar me vitin 2014, gjë që tregon se IMF-të në Kosovë janë duke vazhduar me zgjerimin e aktivitetit të kredidhënies (tabela 8). Rritja për 23.2 për qind sipas BQK (2016) i dedikohet rritjes së kredive në totale, aktivitet që kryesisht financohet nga huamarrjet në sektorin e jashtëm.

¹³⁵ Institucionet financiare si: bankat komerciale, institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimeve

¹³⁶ RV- Raporti Vjetor


Tabela 8. Trendi i aktiveve gjatë periudhës 2012-2016 (BQK)

	2012	2013	2014	2015	2016
Vlera e aktiveve (ne miliona euro)	115.78	112.93	112.92	119.81	147.75
Ndryshimi ne %		-2.46%	-0.01%	6.11%	23.32%

Burimi: BQK (2016), të dhënat e përpunuara nga autori

Grafikisht e paraqesim:

Figura 15. Trendi i aktiveve gjatë periudhës 2012-2016



Burimi: BQK (2016), të dhënat e përpunuara nga autori

Vlera e aktiveve tregon madhësinë e institucionit, e cila sipas analizës së performancës tregon rritje të sektorit mikrofinanciare ne vend. Sipas rezultateve në tabelën 7 (të dhënat nga MIX sipas viteve) dhe tabelës 8 (të dhënat nga BQK sipas viteve) konkludojmë se sektori mikrofinanciar është në rritje të popullaritetit në tregun e Kosovës e cila siç duket ka forcuar besimin tek klientela e saj, përderisa kjo do të shihet edhe me rritjen e numrit të këtyre klientëve.

b) Kredithënia e IMF-ve

Institucionet mikrofinanciare në Kosovë, siç u theksua deri këtu, ofrojnë shërbime të kredive, kryesisht për ekonomi familjare dhe biznese të vogla. Aktiviteti i kredive të akorduara nga IMF-të sipas raporteve të BQK është i ndarë në 4 intervale; kreditë me vlerë deri 5000 euro; kreditë 5001-10,000 euro; kreditë 10,001-25,000 euro dhe kreditë mbi 25,000 euro. Shumica e kredive të lëshuara nga IMF-të i takojnë kredive me vlera më të vogla, ato deri në 5000 euro, (BQK, 2012). Sipas BQK (2013), kategoria e kredive vazhdon

ta dominojnë strukturën e aktiveve të sektorit mikrofinanciar, duke treguar pjesëmarrje prej 64.1 për qind. Portofoli i kredisë përfshin të gjitha kreditë akorduara nga IMF, pavarësisht nga produkti apo lloji i klientit (fjalori i MIX market).

Rritja pozitive sipas të dhënave nga MIX, e portofolit të kredisë është nga 27.99 milionë dollarë në vitin 2004 në 106.84 milionë dollarë në vitin 2011, e cila paraqet rritje për rreth 382 për qind. Nga këndvështrimi i ndryshimeve gjatë vitit 2010 dhe 2011, vërehet rënie e kredidhënies krahasuar me vitin 2009, e cila vazhdoi edhe gjatë vitit 2012. Zvogëlimi i kredive të akorduara, sipas BQK (2011) është pasojë e vështirësimit të kushteve të financimit për këto institucione nga tregjet e jashtme. Kjo ndodh pasi IMF-të që operojnë në Kosovë për burim kryesor të financimit kanë linjat kreditore nga tregjet e jashtme dhe që ato nuk kanë të drejtën e pranimi të depozitave.


Tabela 9. Trendi i kredive gjatë periudhës 2004-2011

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Vlera e kredive (në miliona USD)	27.99	38.20	60.53	93.12	113.0469	144.14	136.70	106.84
Ndryshimi në %		36.47%	58.47%	53.84%	21.40%	27.50%	-5.16%	-21.84%

Burimi: Përpunuar nga autori (të dhënat nga MIX , 2015)

Grafikisht e paraqesim:

Figura 16. Trendi i kredive gjatë periudhës 2004-2011



Burimi: Përpunuar nga autori (të dhënat nga MIX market, 2015)

Zvogëlimi i trendit të kredive të akorduara gjatë vitit 2012 rezulton me 77.5 milionë euro (tabela9), që paraqet ulje në krahasim me vitin 2011 dhe po ashtu vazhdon edhe me zvogëlim të numrit të kredive duke arritur në 52,885 kredi. Trendi i njëjtë, sipas raporteve vazhdon edhe gjatë vitit 2013, duke shënuar zvogëlim të vlerës së kredive për 6.7 për qind, duke arritur në vlerë të kredive 72,3 milionë euro. Ky ngadalësim i aktiviteteve të kredidhënies mundë të jetë jo vetëm shkak të vështirësimit të kushteve të financimit nga tregjet e jashtme por mund të jete ndikuar gjithashtu nga ngadalësimi ekonomik në vend, e cila beri që kërkesa për kreditë e IMF-ve të bie. Rënia reflektoi zvogëlimin e pjesëmarrjes në strukturën e sistemit financiar sipas institucioneve nga 3.0 për qind që ishte në 2012, pjesëmarrja në strukturën e sistemit financiare në vitin 2013 ishte 2.7 për qind. Nga ana tjetër për vitin 2014 sipas raportit të BQK (2014), vlera e kredive totale shënoi një rritje vjetore prej 2.9 për qind dhe arriti 74.4 milionë euro. Vlera e kredive gjatë vitit 2015 u rrit në 82.39 milionë euro që, sipas tabelës 10, paraqet rritje 10.74 për qind në krahasim me vitin 2014. Rritje e konsiderueshme tregohet edhe në vitin 2016, duke e rritur vlerën e kredive të akorduara në 32.2 për qind në krahasim me vitin 2015. Kjo rritje është rezultat i rritjes së kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrje të vogla.


Tabela 10. Trendi i kredive gjatë periudhës 2012-2016 (BQK)

	2012	2013	2014	2015	2016
Gjithsejte kredite e leshuara (ne miliona euro)	77.50	72.34	74.40	82.39	108.95
Ndryshimi ne %		-6.67%	2.85%	10.74%	32.23%

Burimi: Tabela e përpunuar nga autori; bazuar në të dhënat e publikuara; Faqja zyrtare e BQK, 2016 (Seritë kohore)

Grafikisht e paraqesim:

Figura 17. Trendi i kredive gjatë periudhës 2012-2016 (BQK)



Burimi: Tabela e përpunuar nga autori; bazuar në të dhënat e publikuara; Faqja zyrtare e BQK, 2016 (Seritë kohore)

Sipas strukturës së kredive nga tabela 11, kreditë e ekonomive familjare në baza vjetore janë mbi 64 për qind të kredive të akorduara dhe pjesa tjetër janë kredi për ndërmarrje të vogla. Të dy janë kategori për të cilat bankat kufizohen në kreditim nga mungesë të kolateralit, qarkullimit të dobët të ardhurave ose mungesës së planit të biznesit etj. Numri i kënaqshëm i kredive për bujqësi në fshatra është rrjedhojë e kthimit në kohë të këtyre kredive, pasi kreditë për bujqësinë janë kthyer në kohë.


Tabela 11. Struktura e kredive në përqindje për ekonomi familjare dhe ndërmarrje

	Vlera e aktiveve (ne miliona euro)	Gjithsejte kredite e leshuara (ne miliona euro)	Ekonomi familjare (ne miliona euro)	Kredite ndaj ndërmarrjeve (ne miliona euro)	Ekonomi familjare %	Kredite ndaj ndërmarrjeve %
2012	115.78	77.50	49.62	27.89	64%	36%
2013	112.93	72.34	49.30	23.04	68%	32%
2014	112.92	74.40	49.08	25.32	66%	34%
2015	119.81	82.39	53.11	29.28	64%	36%
2016	147.75	108.95	73.01	35.94	67%	33%

Burimi: BQK (2016), përpunuar nga autori

Grafikisht e paraqesim:

Figura 18. Struktura e kredive të IMF-ve nëpër vite në mënyrë grafike



Burimi : Raporti Vjetor i BQK (2016)

c) Normat e interesit

Tregu i mikrofinancës, i bazuar në qasjen për luftim të varfërisë, është përqendruar në zhvillim e sipërmarrjes dhe zgjerimin e vetëpunësimit, duke shërbyer përafërsisht 155 milionë njerëz, i raportuar në “Microcredit Summit Campaign, 2009”.¹³⁷ Me gjithë rritjen e qasjes në shërbime financiare të ofruara nga IMF, mbetet e diskutueshme nëse mund të arrihet një qëndrueshmëri financiare, marrë parasysh numrin e madh të njerëzve të varfër për t’i shërbyer, të cilët nuk janë në gjendje për të paguar normë të lartë të interesit, kosto të lartë të transaksionit dhe të ofrojnë kolateral si garanci. Norma e lartë e interesit (Rahman dhe Mazlan 2014, Acclassato 2008)¹³⁸ nuk i mbron bizneset e vogla, por krijon dëme institucioneve mikrofinanciare. Në këtë drejtim institucionet janë ato të cilat duhet të ofrojnë çmime reale për të qenë të qëndrueshme, në njërin anë për të mbrojtur huamarrësin dhe, në anën tjetër, që të nxisin konkurrencë midis IMF-ve duke ofruar transparencë mbi normat e interesit.


Sipas raporteve vjetore të BQK-së mbi normat e interesit të lëshuara nga institucionet mikrofinanciare, këto norma karakterizohen me nivel relativisht të lartë krahasuar me normat mesatare në kreditë e lëshuara nga bankat tregtare. Faktorët që ndikojnë në këto

¹³⁷ E marrë nga: “Role of microcredit and microfinance in the eradication of poverty” Report of the Secretary –General (2010 ;3)

¹³⁸ Fq.109

norma të larta konsiderohen fakti se IMF-të nuk kanë të drejtën e pranimit të depozitave nga qytetarët dhe, në këtë drejtim, ato kërkojnë fonde të tjera financuese shpesh të huazuara. Këto burime janë institucione financiare ndërkombëtare, tregje të kapitalit apo edhe banka lokale, të cilat gjithashtu kanë norma të larta huazuese. Gjatë vitit 2013, norma mesatare e kredive të ofruara nga institucionet mikrofinanciare në Kosovë do të arrijte rreth 22 për qind, që është më e ulët se në vitin paraprak 2012, kur ishte 23.5 për qind. Nga shqyrtimi i raporteve të Bankës Qendrore të Kosovës, normat mesatare të kredive të lëshuara nga institucionet mikrofinanciare mbesin më të larta se ato që ofrohen nga sektori bankar, edhe pse me një trend rënës në 21 për qind gjatë vitit 2016 (BQK, 2016), ku përfshihen normat e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare dhe normat e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve, me rënie 0.9 pikë në përqindje (Figura më poshtë, nga BQK, 2016).

Figura 19. Norma e interesit nëpër vite sipas sektorëve kryesorë të shërbyer nga IMF-të



Burimi : Raporti Vjetor i BQK (2016)

Sipas theksit të vënë nga një përfaqësues të institucioneve dhe atij të shoqatave të sektorit të mikrofinancës duket se normat e interesit janë të krahasueshme me normat e interesit të IMF-ve tjera në vende fqinje , duke vënë në pah se janë më të larta se vende tjera në Evropë. Në analizë të mëtejshme vihet re, se norma të interesit duke filluar nga viti 2016 nuk do të jetë fikse ajo do të ndryshojnë në bazë të shumës së kredisë të kërkuar nga

klienti. Këto ndryshime reflektojnë me normë e interesit 25% për kredinë deri 1000 euro, me ndalesa administrative 2% (komision huaje), duke u përshkallzuar në vlera të ndryshme deri tek shuma maksimale e lejuar për IMF-të e cila arrin në vlerën 25 mijë euro, me normën e interesit 15.9 % dhe ndalesë administrative 1.5%. Është bërë e ditur se numri më i madh i kredive të akorduara nga IMF-të janë kredi të vogla. Gjithsej numri i kredive gjatë vitit 2016 sipas AMIK (2016) arrin 58,505, mesatare e së cilës arrin 1734 euro. Kjo tregon se në Kosovë, modeli i përcaktimit të normave të interesit është i ngjashëm me ato vende ku normat e interesit caktohen për të mbuluar si koston e financimit, si dhe kostot tjera operative të cilat janë më të larta kur është fjala për kredi të vogla. Kjo mund të jetë faktorë i asaj që numri i madh i kredive të vogla ndikon në normën e lartë të interesit.

d) Të ardhurat dhe shpenzimet e sektorit të mikrofinancës

Niveli i vetëqëndrueshmërisë operative¹³⁹ të institucionit mikrofinanciar mat nëse institucioni është në gjendje të mbulojë shpenzimet operative nga të ardhurat e krijuara. Sipas MIX, Vetë qëndrueshmëria operative llogarit raportin midis të ardhurave financiare mbi shpenzimet financiare plus humbjet neto nga zhvlerësimi i kredive plus shpenzimet operative. Në drejtim të vetëqëndrueshmërisë operative, ky faktorë duhet të arrijë nivelin 1 ose 100 për qind, gjë që tregon se institucioni mund të operojë pa mbështetje nga subvencionet ose burimet e tjera të financimit. Nëse një institucion i kursimeve ose kreditimit nuk e arrin këtë raport, kapitali i tij do të reduktohet nga humbja ose duhet të kompensohet me grante (Berne, 2005:7). Është e rëndësishme të analizohet se si është

¹³⁹ Vetëqëndrueshmëria operative (Operational self sustainability OSS); Në këtë punim OSS do të përdoret si variabël e varur, për të matur performancën financiare të IMF-ve që operojnë në Kosovë për periudhën 2000-2015.

zhvilluar ky faktorë për IMF-të në Kosovë, pasi historikisht këto institucione janë themeluar pas përkrahjes fillestare nga donatorët.

Nga e më poshtme (tabela 12), përqindja e vetëqëndrueshmërisë operative ka shënuar rritje marrë në përgjithësi sektori përgjatë periudhës 2004-2011. Mesatarja e përgjithshme për tetë vite arrin nivelin 116 për qind të vetëqëndrueshmërisë, me ndryshime sipas IMF-ve, (MIX market, të dhënat e shfrytëzuara gjatë vitit 2015).

Tabela 12. Përqindja në mesatare e vetëqëndrueshmërisë operative

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Mesatare %	124.4%	133.7%	129.3%	119.0%	117.0%	100.0%	103.2%	109.2%

Burimi: MIX market, 2015

Dy nga komponentët e vetëqëndrueshmërisë operative, të ardhurat operative dhe shpenzimet operative janë të analizuara bazuar në raportet e BQK (2012,2013,2014,2015,2016) . Sipas të dhënave të BQK-së, performanca e sektorit të mikrofinancës gjatë vitit 2012 dhe 2013 nuk është shumë inkurajuese. Përmbyllja e periudhës me bilanc negativ gjatë vitit 2012 ishte rezultat i rritjes më të shpejtë të shpenzimeve krahasuar me të ardhurat e gjenerura (Tabela 13).¹⁴⁰ Të ardhurat vjetore gjatë vitit 2013 paraqesin trend në rënie në krahasim me vitin 2012 për 7.5 për qind, duke shënuar vlerën 19.2 milionë euro(BQK,2013). Të ardhurat nga interesi dominuan me pjesëmarrje prej 80.9 përqindë. Raporti i njëjtë nënvizoi rënien prej 22.6 përqindë e shpenzimeve e cila reflektoni me vlerën 19.5 milion euro (BQK,2013). Rezultat ishte zvogëlimi i shpenzimeve të jo-interesit për 23.6 për qind dhe rënia e shpenzimeve për interesat prej 19.4 për qind gjatë vitit 2013 (BQK, 2013)(tabela 13).

¹⁴⁰ Llogaritjet në tabelën 13 janë bërë për nevoja të faktorët të vetëqëndrueshmërisë operative. Ky faktorë, sipas MIX, mat raportin midis të ardhurave dhe shpenzimeve operative.

Rezultati financiar i tri viteve të fundit reflekton se sektori mikrofinanciar në Kosovë mundë të mbetet i qëndrueshëm dhe me ndikim në përmirësimin e faktorëve të fitueshmerise. Në këtë drejtim, sektori i mikrofinancës do të duhet të mbes i orientuar në përshpejtim të kredidhënies për ekonomitë familjare dhe bizneset e vogla në përgjithësi.


Tabela 13. Trendi i të ardhurave dhe shpenzimeve të sektorit mikrofinanciar

	2012	2013	2014	2015	2016
Te ardhurat	20.78	19.22	19.32	21.06	24.83
Shpenzimet	25.26	19.54	18.59	18.68	20.72
Shpenzime/te ardhura	121.6%	101.7%	96.2%	88.7%	83.4%

Burimi: Përpunuar nga autori (të dhënat nga Seritë kohore: BQK, 2016)

Grafikisht e paraqesim:

Figura 20. Të ardhurat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar 2012-2016



Burimi: Përpunuar nga autori (të dhënat nga Seritë kohore: BQK, 2016)


Sikundër munde të vërehet gjatë viteve të fundit, me rritjen e të ardhurave , raporti paraqet edhe zvogëlim të shpenzimeve, e cila mundë të konsiderohet rritje e nivelit të efikasitetit të institucioneve mikrofinanciare ne drejtim të uljes së shpenzimeve. Për më shumë kjo tregon se IMF-të janë në gjendje për të marrë nën kontroll për të ulur shpenzimet brenda sektorit i cili mundë të forcoj rezultatet drejt qëndrueshmërisë së përgjithshme financiare.

e) Përfitueshmëria e IMF-ve

Gjatë viteve të fundit faktorët e fitueshmerisë tregun dinamikë të përmirësimit nëpër vite. Kjo tregon tendencën e institucioneve mikrofinanciare në Kosovë, për të rritje të aftësive për të krijuar fitim nga aktivitetet që ato zhvillojnë.

Duke ju referuar të dhënave të raporteve të BQK, figura 2, tregon se përmirësimi i normës së faktorëve të fitueshmerisë gjatë vitit 2013 në krahasim me vitin 2012 është rrjedhojë e përmirësimit të rezultatit financiar të institucioneve. Ndryshe, zvogëlimi i humbjes gjatë vitit 2013 sipas raporteve të BQK(2013) ndikoi në përmirësim të kthimit mesatar në aktive.

Figura 21. Faktorët e Përfitueshmërisë të sektorit mikrofinanciar



Burimi: Nga raporti vjetor i BQK për vitin 2016

Trendi në rritje i faktorëve të fitueshmerise rezultoi edhe gjatë vitit 2015, si rezultat i fitimit të realizuar gjatë kësaj periudhe. Kthimi mestar ndaj aktiveve u përmirësuar në 2.1 përqindë (0.6 përqind në vitin paraprak). Realizimi i fitimit në vlerë prej 4.1 milion euro deri në fund të dhjetorit 2016 e cila tregon rritje vjetore 73.3 përqind reflekton me rritje të normës së kthimit mesatare ndaj aktiveve (BQK 2016). Ecuria pozitive në drejtim të përmirësimit të faktorëve të fitueshmërisë vazhdoi edhe gjatë vitit 2017, i cili rezultoi me kthimi mesatar i aktiveve në 4.8 përqind nga 2.9 që ishte në vitin 2016(sipas Raporti i

Stabilitetit Financiar N12). Nëse i referohemi këtij raporti, rezultat ne rritje tregoi edhe faktorët i kthimit mesatar i kapitalit, e cila rezultoi nga 10.6 që ishte në 2016 duke arritur në 18.7 përqind deri në qershor të vitit 2017 (BQK,2017). Këto përmirësime të faktorëve të përfitueshmërisë mundë të preferojnë ndryshime në të ardhmen e IMF-ve, pasi që ato do të mundë të orientohen në rritje të fitimit për të mbetur të vetëqëndrueshme dhe për të rritur shtrirjen e qasjes së klinetëve në shërbimet mikrofinanciare.

4.2. Rëndësia e përdorimit të MIX

Nga shqyrtimi i shumë punimeve të ngjashme me theks ato ndërkombëtare, pasi ato vendore janë të pakta, është vënë re përdorimi i të dhënave nga platforma e MIX market.¹⁴¹ Prandaj të dhënat dytësore janë konsideruar shumë të rëndësishme, të cilat janë përdorur për të analizuar dhe për të përcaktuar faktorët që e ndikojnë performancën financiare të IMF-ve në vende të ndryshme. Vlefshmëria e të dhënave nga MIX konsiderohet e lartë, pasi që kjo është bazë e të dhënave e cila ofron informacione të kuptueshme dhe të hollësishme mbi performancën e institucioneve mikrofinanciare, dhe për këtë arsye është e përdorur nga shumë autorë që për qëllim kanë përcaktimin e faktorëve që e ndikojnë performancën financiare.

MIX ofron informacione të detajuara mbi faktorë të performancës financiare dhe sociale të IMF-ve që operojnë në shumë vende të botës, pasi që ato dërgohen në formë vullnetare nga vetë IMF-të. Të dhënat nga MIX paraqiten si bazë e të dhënave dhe e informacioneve mbi institucionet mikrofinanciare në atë formë, e cila mundëson që, përmes programit statistikor, të zgjidhen faktorët e nevojshëm për punim. Kjo bazë e të dhënave, për fat të

¹⁴¹ www.MIX.org

mirë, ishte me qasje të hapur (e lirë) për qëllime studimore ose analize dhe nuk mund të shfrytëzohet për çështje tregtare. Kjo qasje ndryshoi formën gjatë vitit 2016, për qëllime të strategjisë së institucionit.¹⁴² Në këtë bazë të dhënash, IMF-të janë të grupuara në baza të rajoneve kryesore gjeografike, Afrika, Azia, Evropa Lindore dhe Azia Qendrore (ECA), Amerika Latine, Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut (MENA¹⁴³). Kërkimi i informacioneve për IMF-të që operojnë në Kosovë bëhet nën rajonin “Evropa Lindore dhe Azia Qendrore”. Sipas “The microbanking bulletin no.17”,¹⁴⁴ baza e të dhënave ka dy qëllime, i pari është t’ju ndihmojë udhëheqësve dhe anëtarëve të bordit për të kuptuar performancën e IMF-së në krahasim me të tjera IMF. Qëllimi i dytë është të përcaktojnë standarde të performancës me rritjen e transparencës së raportimit financiar dhe me përmirësimin e performancës së institucioneve mikrofinanciare. Në anën tjetër pa u ndalur se si e kanë të regjistruar statusin në subjekte përkatëse IMF-të që operojnë në Kosovë, në këtë punim statusi është marrë ashtu siç raportohet në MIXmarket.

Në këtë drejtim, përmes shqyrtimit edhe të studimeve empirike të ngjashme, informohemi mbi “të dhënat që janë mbledhura, për t’iu përgjigjur pyetjeve hulumtuese ose për të testuar hipotezat”, Matthews dhe Ross (2010:22).

4.3. Metodologjia dhe të dhënat

Metodologjia, paraqet “studimin e metodave dhe ngrit të gjitha llojet e pyetjeve filozofike të mundshme, që hulumtuesit duhet të dinë dhe sa të vlefshme mundë të jenë pretendimet e tyre të dijes” (Fisher, 2010:50). Për të realizuar këtë punim është shqyrtuar literaturë e

¹⁴² www.MIX.org

¹⁴³ Shkurtesa MENA në anglishte - Middle East and North Africa

¹⁴⁴ Buletini MicroBanking është një nga drejtuesit e botimit të MIX (Information Microfinance Exchange, Inc), shkëmbyes i informacioneve të mikrofinancës.

gjerë, e cila përfshin libra, punime, artikuj, raporte të publikuara mbi çështjen e studimit. Për të siguruar të dhëna të sigurt për punimin, jam bazuar në metodologjinë e përdorur nga punime më të hershme, të ngjashme me këtë punim. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur metoda cilësore dhe sasiore. Gjithashtu, janë shfrytëzuar të dhëna primare dhe sekondare. Kjo metodologji na mundëson të analizojmë faktorët e performancës për institucionet mikrofinanciare, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë empirik, nëpërmjet analizës së pyetësorëve të shpërndarë dhe përdorimit të modeleve ekonometrike.

Metoda cilësore¹⁴⁵ dhe sasiore¹⁴⁶ janë metoda bazë të hulumtimit shkencor. Në këtë punim është përdorur metoda cilësore, për të marrë perceptim nga përfaqësues të IMF-ve në Kosovë mbi faktorët më të rëndësishëm të performancës financiare. Metoda sasiore hyn në funksion duke iu qasur bazës së të dhënave të MIX market,¹⁴⁷ ku midis opsioneve të tjerave, ofrohet qasje e lirë për shfrytëzimin e të dhënave për nevoja studimore mbi faktorët e performancës të IMF-ve.

Për të analizuar faktorët e IMF-ve është përdorur metoda e statistikave përshkruese, për të përshkruar tiparet e të dhënave në këtë studim. Ato na ofrojnë një përmbledhje të thjeshtë në lidhje me mostrën dhe masat. Metoda e grupimeve dhe metodat grafike janë përdorur gjerësisht për të treguar dhe për të analizuar tendencën e IMF-ve dhe ndryshimet nëpër vite. Modelimin ekonometrik e kemi përdorur për të identifikuar faktorët që e ndikojnë performancën financiare dhe për të vlerësuar në mënyrë empirike ndikimin e tyre. Për të

¹⁴⁵ Metoda cilësore mbledh të dhëna përshkruese, përvoja, opinione, mendime të individëve, etj., me qëllim të dhënies kuptim të informacionit.

¹⁴⁶ Metoda sasiore karakterizohet nga të shprehurit e rezultateve të kërkimit në sasi, në numra, të cilët përpunohen nga ana statistikore.

¹⁴⁷ Shkëmbyes informacionesh të mikrofinancës.

testuar modelin ekonometrik është përdorur programin SPSS, që paraqet: përmbledhjen e modelit; ANOVA modelin; koeficientet e variablave (metoda enter) dhe koeficientet e variablave në ekuacion të përzgjedhura (metoda stepwise)(metoda hap pas hapi)

Mostra e studimit e marrë nga popullacioni i tërësishëm studiohet për të arritur konstatime lidhur me popullacionin, (theksuar nga Yenesew,2014, Nyamsogoro,2010, të cilët bazohet tek Collins dhe Hussey,2003). Procesi i përzgjedhjes së mostrës nga popullacioni ka përparësitë dhe mangësitë e saj. Në një anë kjo kursen kohën dhe gjithashtu resurset financiare dhe njerëzore. Në anën tjetër sipas (Kuma, 2011)¹⁴⁸ nuk gjen informacione mbi karakteristikat e popullacionit në interes por vetëm ato të përlogaritura ose të parashikuara. Prandaj ekziston mundësia për gabime në përlogaritje. Përzgjedhja e mostrës është një proces për të zgjedhur disa (mostra) nga një grup i madh (grupim i popullacionit) për t'u bërë bazë për vlerësimin ose parashikimin e tyre (Kuma, 2011). Në këtë punim, njësia e analizës është institucioni mikrofinanciar, prej nga rezulton se popullacionin e përbëjnë të gjitha IMF-të që veprojnë në Kosovë. Për mostër të hulumtimit janë shfrytëzuar 11 IMF që raportojnë në MIX në periudhën 2000-2015 nga 14 që operojnë në Kosovë.

4.3.1. Mbledhja e të dhënave

a) Të dhënat primare

Të dhënat primare janë mbledhur nga intervista e realizuar përmes pyetësorëve të shpërndarë,¹⁴⁹ që paraqesin një grup pyetjesh të cilave pjesëmarrësit në hulumtim mund t'u përgjigjen në një varg mënyrash. Rezultati nga pyetësi na ofron perceptimin mbi faktorët

¹⁴⁸ Research Methodology (a step-by step guide for beginners)

¹⁴⁹ Pyetësi i ndërtuar për qëllim të punimit është pjesë e shtojcës në këtë punim, i cili është i ndërtuar bazuar ne punime te ngjashme ndërkombëtare dhe modifikuar sipas nevojave te këtij punimi.

që konsiderohen të rëndësishëm për performancën e IMF-ve dhe gjithashtu informacione më të përgjithshme mbi IMF-të.

Në këtë punim të dhënat primare janë mbledhur nga pyetësorët që u janë dërguar në formë elektronike përfaqësuesve të IMF-ve, të kontaktuar paraprakisht përmes telefonit, me qëllim të ofrimit të sqarimeve të nevojshme. Në rastin e parë, pyetësi i dërguar të pjesëmarrësit është refuzuar me arsyetimin e përmbajtjes së të dhënave financiare të kërkuara. Në tentativën e dytë, kur janë eliminuar pyetjet mbi të dhënat financiare dhe janë kërkuar vetëm perceptime mbi faktorët e paracaktuar që e ndikojnë performancën financiare, nivel i përgjigjeve është rritur por jo sipas pritjeve të autorit të këtij punimi.

Pjesa e parë e pyetësorit përmban informacione të përgjithshme mbi profilin e institucionit, së cilës i janë përgjigjur 3 IMF nga gjithsej 6IMF sa janë arritur të kontaktohen, duke u plotësuar gjatë intervistës së zhvilluar me përfaqësues të AMIK.¹⁵⁰ Pjesa e dytë e pyetësorit, që ka të bëjë me perceptimin mbi faktorë, dhe pjesa e tretë, mbi problemet dhe pengesat e IMF-ve. Pyetësi është dërguar tek 55 zyrtarë të IMF-ve, prej të cilëve janë përgjigjur 26 zyrtarë. Duhet theksuar se qasja e drejtpërdrejtë në 11 IMF, të dhënat e të cilave janë raportuara në MIX, ishte e vështirë për t'u arritur i cili është një nga kufizimet e këtij punimi. Punimi limitohet vetëm me përgjigje të 26 zyrtarëve të cilët janë pjesë e 3 IMF-ve. Për të përmbledhur pyetësorët e plotësuar është përdorur programi Excel, me të cilin janë treguar përqindjet e perceptimeve mbi secilin faktorë veç e veç.

¹⁵⁰ AMIK- AIMK (Agjencia e Institucioneve Mikrofinanciare në Kosovë), intervistë me zt.Buqaj

b) Të dhënat dytësore

Sipas Mattheës dhe Ross (2010: 285), përparësia e shfrytëzimit të teknologjisë informative “internetit” na mundëson në “qasjen në të dhëna dytësore”. Pasi që të dhënat primare nuk ofrojnë të dhëna cilësore të cilat kërkohen në këtë punim, por ato janë përdorur vetëm si mbështetje e përzgjedhjes së të disa nga faktorët e konsideruar të rëndësishëm për vlerësim të performancës. Përdorimi i të dhënave dytësore nga data baza e MIX, është konsideruar i sigurt dhe i përshtatshëm për këtë studim. Përzgjedhja e faktorëve të caktuar për t’i analizuar dhe për të testuar rezultatin e pritshëm është bazuar te studimet empirike, që sugjerojnë se janë përcaktues të rëndësishëm të performancës financiare të institucioneve mikrofinanciare. Për më tepër për të realizuar objektivat e përcaktuara në fillim të këtij punimi, diskutimi është i fokusuar në gjetjet e dala nga modeli ekonometrik dhe kjo në intervistat e realizuara përmes pyetësorit të cekura më lartë.

Variablat e pavarura të marra në konsideratë për të testuar hipotezat e ngritura në këtë punim janë klasifikuar sipas grupimit që bëhet në MIX market.

Profili i institucionit përfshinë: Moshën (përvoja sipas viteve të operimit) dhe madhësinë e institucionit (e matur me vlerën e aktiveve). Shtrirja e institucionit : Vlera e portofolios së kredisë e lëshuar nga IMF-ja, mesatarja e kredisë, numri i huamarrësve aktiv, raporti i huamarrësve femra. Efikasiteti i institucionit që përfshinë; raporti i shpenzimeve operative/aktivet, raporti i shpenzimeve operative/ portofoli bruto e kredisë, raporti i shpenzimeve të personelit/portofoli bruto i kredisë, kosto për huamarrës.

Variabël e varur është performanca financiare e matur përmes vetëqëndrueshmërisë operative (OSS)¹⁵¹ dhe kthimit nga aktivet (ROA),¹⁵² të përdorura si në punime të ngjashme me këtë punim.

Niveli i vetëqëndrueshmërisë operative (OSS) përcakton nëse IMF-ja përmes të hyrave të gjeneruara operative, është në gjendje për të mbuluar shpenzimet operative të institucionit dhe, gjithashtu, mundëson marrjen e një pamjeje subjektive dhe globale të institucioneve në aspektin e performancës së saj (Gakhar, K & Meetu 2013; Woldeyes, 2012; Schwfer dhe Fukasawa, 2011; Barres, 2006). Faktorë i rëndësishëm i performancës financiare është kthimi nga aktive (ROA), i cili reflekton marzhën e fitimit si dhe efektivitetet e institucioneve (Mengesha, 2016; Gashayie & Sighn, 2014; Gakhar, K & Meetu, 2013).

4.4. Specifikimi i modelit

Përderisa të dhënat kualitative (të dhënat primare) janë përdorur për të marrë një pasqyrë mbi institucionet mikrofinanciare dhe një perceptim mbi përzgjedhjen e faktorëve që konsiderohet të rëndësishëm për performancën financiare të IMF-ve në Kosovë.

Për të nxjerrë rezultat ekonometrik në këtë punim bazohemi në të dhëna dytësore, të rëndësishme për këtë punim. Të dhënat dytësore të mbledhura nga MIX përfshijnë të dhëna në vlera financiare dhe të dhëna jofinanciare (p.sh. mosha, madhësia, portfolio e kredisë, numri aktiv i huamarrësve etj. Për të analizuar të dhënat është përdorur programi **SPSS**, i vlerësuar për të menaxhuar të dhënat për të kryer analizë ekonometrike dhe statistikore, si dhe për të parashikuar modele të kualitetit të lartë përmes prodhimit të

¹⁵¹ Operational self-sufficiency (OSS)

¹⁵² Return on assets (ROA)

grafikëve cilësorë dhe tabelave që janë shfrytëzuar për t'i diskutuar në këtë punim. Përdorim modelin ekonometrik klasik, për të studiuar ndikimin e variablave të pavarura në variablën e varur. Modeli i regresionit linear u zhvillua me ekuacionin i cili përcakton lidhjen midis variablave të marra në studim.

$$Y_{it} = \alpha_i + \beta_1 X_{1it} + \beta_2 X_{2it} + \beta_3 X_{3it} \dots + \beta_k X_{kit} + \epsilon_{it} \quad (1)$$

Ky model përdoret kur kemi më pak të dhëna dhe tregon efektin e faktorëve X mbi Y si dhe dallimin ose jo të individëve midis tyre në lidhje me faktorë që nuk ndryshojnë me kohën. Në këtë punim; Y_{it} - është variabël e varur për periudhën, e cila kërkohet të shpjegohet; α_i - është termi konstant, β mat efektin e përgjithshëm të variablave të pavarura apo shpjeguese në periudhën t për njësinë i ; X_{1it} , X_{2it} , ... X_{kit} janë variabla të pavarura, të cilat përshkruhen në këtë punim dhe ϵ_{it} paraqet gabimet e rastësishme.

Metoda e krahasimit e cila është një metode baze e analizës dhe kërkimit përdoret për të evidentuar ndryshimet midis faktorëve në krahasojmë faktorët e IMF të ndryshme. Metoda e komponentëve kryesorë është përdorur si një alternativë e mesatareve shumëdimensionale për të eliminuar mbi vendosjet e mundshme ose ndërvarësinë (interdependencën) e variablave. Këto metoda përdoren për të ndërtuar një model ekonometrik klasik, por edhe modelin ANOVA. Metoda e komponentëve kryesorë synon reduktimin e numrit të variablave të pavarura, kur ato janë të korreluara në shkallë të lartë. Metoda ANOVA ose Analiza e Variancës synon testimin e efektit të variablave të pavarura në një variabël të varur, duke e ndarë variancën e përgjithshme në dy pjesë: varianca faktoriale dhe varianca e mbetur.

4.5. Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull u rikujtuan qëllimi, objektivat, pyetjet kërkimore dhe hipoteza e ngritur . Për t'u njohur më shumë mbi funksionimin e IMF-ve në Kosovë, në fillim të këtij kapitulli u përshkruar mënyra e themelimit, operimi dhe disa rezultatet të arritura deri më tani. U theksuan metodologjia e mbledhjes së të dhënave primare dhe kufizimet për zgjerimin e tyre. Rëndësi u dha edhe përdorimit të të dhënave nga MIX, e cila burim i rendshëm pjesë platformës tani e mirënjohur nga shumë vende të botës, në të cilën raportojnë një numër i konsideruar i institucioneve mikrofinanciare. Ajo që është me rëndësi për ta theksuar, është shfrytëzimi i kësaj platforme nga shumë autorë të cilët për çështje të studimit kanë marrë përcaktimin e faktorëve të performancës financiare të IMF-ve në vende të ndryshme , duke përdorur faktorë sipas qëllimit të caktuar. Në pjesën e tretë të këtij kapitulli u paraqit metodologjia e cila është zgjedhur për të analizuar IMF-të në Kosovë, dhe metodën për të përcaktuar faktorët që ndikojnë në performancën financiare të institucioneve të cilat operojnë në vendin tonë. Dhe në pjesën e fundit u pasqyruar modeli i cili përdoret për të identifikuar përcaktuesit e performancës financiare të IMF-ve në Kosovë. Pjesë e këtij punimi është analiza sipas të dhënave primare që si rezultat do të tregoj nivelin e perceptimit mbi faktorët e veçuar në këtë punim.

KAPITULLI V: TË DHËNAT, ANALIZAT EMPRIKE, REZULTATET DHE DISKUTIMI

Në pjesën e parë të këtij kapitull analizohen të dhënat e mbledhura përmes pyetësorit, të cilat vejnë në pah perceptimin e të anketuarve mbi rëndësinë e faktorëve të veçuar të performancës. Me gjithë qasjen e kufizuar nga përfaqësuesit e IMF-ve, realizimi i këtij pyetësoi ka shërbyer si mbështetje e përzgjedhjes së faktorëve për të analizuar ndikimin e tyre në performancën financiare të institucioneve mikrofinanciare që operojnë në Kosovë. Pas mbledhjes së të dhënave primare, ato janë futur në program të Excel, të cilat pastaj janë exportuar në pakon softuerike SPSS,¹⁵³ për të nxjerrë përqindjet e numrit të anketuarve, gjininë, pozitën dhe perceptimet mbi secilin faktorë veç e veç për të përmbledhur një mesatare të vlerësimit për gjithë faktorët që janë pjesë e pyetësorit.

Në pjesën e dytë të këtij kapitulli, diskutohet mbi rezultatet e të dhënave dytësore, përfshirë statistikat përshkruese, korrelacionin midis variablave dhe në pjesën e tretë analizohen modelet e regresionit të përcaktuara për këtë punim.¹⁵⁴ Për t'i analizuar të dhënat dytësore, fillimisht është krijuar databazë në programin Excel, të cilat janë përshtatur sipas grupimit dhe pastaj është bërë importimi i të dhënave në pakon softuerike SPSS, duke e përshtatur emërtimin dhe përpunimin e tyre. Variablat shpjeguese të përfshira në modelin e regresionit dhe ato të ato të përjashtuara gjatë procesit të analizës, do të përshkruhen dhe diskutohen. Si përfundim i analizës dhe rezultatit të modeleve ekonometrike gjetjet do të diskutohen.

¹⁵³ Paketa Statistikore për Shkenca Sociale (SPSS)

¹⁵⁴ Analiza e regresionit merret me studimin e marrëdhënies midis një variabli të quajtur, të shpjeguar, të pavarur, të ndryshueshëm dhe ose më shumë variabla të tjera të quajtura variabla të pavarura ose shpjeguese (Gujarati, 1999)

5.1. Përshkrimi dhe rezultatet e të dhënave të mbledhura përmes pyetësorit

Për të përforcuar përzgjedhjen e faktorëve të veçuar të performancës të përdorur në këtë punim janë bërë intervista me zyrtarë të IMF-ve që raportojnë në AMIK. Intervistat janë përmes bërë përmes pyetësorit i cili u është dërguar në formë elektronike 55 të zyrtarëve përfaqësues të 6 IMF-ve, ku prej tyre janë pyetësorit i janë përgjigjur 26 zyrtarë nga 3 IMF. Normalisht, me zyrtarët që kanë pranuar të përgjigjen autori i punimit ka qenë në korrespondencë të vazhdueshme për të sqaruar atyre sa më shumë që është e mundur pyetjet e pyetësorit. Të dhënat e mbledhura nga zyrtarët e IMF-ve plotësohen edhe nga të dhënat e mbledhura përmes intervistës së thellë me përfaqësuesin e AMIK.

Struktura e të anketuarve sipas pozitës në IMF, është paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 14. Numri i të anketuarve dhe pozita e punës në institucion

	Numri i të anketuarve	Përqindje	Përqindja kumulative
Drejtor	1	3.8	3.8
Menaxheri/e	7	26.9	26.9
Zyrtar	18	69.2	69.2
Total	26	100	100

Ndërsa në vijim paraqitet edhe përbërja e të anketuarve sipas gjinisë, një kriter që kur bëhet fjalë për kredimarrësit, është rezultat shumë i mirë pjesëmarrja e gruas në kredimarrje, andaj është konsideruar me rëndësi të paraqitet struktura gjinore që kanë pranuar t'u përgjigjen pyetjeve të parashtruara për ta.

Tabela 15: Gjinia e të anketuarve

	Numri i të anketuarve	Përqindje	Përqindja kumulative
Femer	9	34.6	34.6
Mashkull	17	65.4	65.4
Total	26	100	100

Pyetësori është ndërtuar nga tri pjesë;

- I. Pjesa e parë duhej të plotësohej vetëm nga një përfaqësues pasi që pyetjet kërkojnë informacione të përgjithshme mbi profilin e institucionit.
- II. Pjesa e dytë është perceptimi i të anketuarave mbi faktorët e veçuar të performancës, dhe
- III. Pjesa e tretë ka të bëjë me pyetje të hapura mbi çështje të përgjithshme të institucionit.

5.1.1. Përshkrim i rezultateve të nxjerra nga anketimi i zyrtarëve të IMF-ve

Çështjet kryesore që janë diskutuar me përfaqësuesit e IMF-ve lidhur me funksionimin e IMF-të janë si në vijim;

1. Qëllimi i themelimit;
2. Niveli i fazës së operimit të tyre;
3. Statusi i tyre ligjor;
4. Shtrirja territoriale e tyre përmes organizmit në degë;
5. Mënyra e financimit;
6. Numri i klientëve aktiv dhe struktura gjinore;
7. Shuma mesatare e kredisë së akorduar;
8. Produktet/shërbimet që ofrojnë IMF-të.

Sa i përket qëllimit të themelimit të IMF të anketuarit e ndajnë mendimin se qëllimi kryesor i themelimit të tyre është përkrahja sociale dhe zhvillimore duke ditur se klientët e IMF-ve në Kosovë i takojnë grupit të njerëzve me të ardhura të ulëta dhe ata të bizneseve të vogla. I mendimit të njëjtë është edhe përfaqësuesi i AMIK, përveç se pajtohet qëllimin e deklaruar nga vet IMFT-të, ai e plotëson edhe atë se këto institucionet janë themeluar me qëllim të plotësimit të boshllëkut nga sektori, për arsye se këto institucione vazhdojnë punën aty ku ndalen bankat, dmth të klientët që nuk janë shërbyer nga bankat.

Rezultatet e marra nga zyrtarët e IMF-ve, në përgjithësi tregojnë se IMF-të që operojnë në Kosovë kanë të kaluar të dy fazat e para të operimit dhe ato janë duke operuar në fazën e pjekurisë, e cila tregon se tendencat e tyre janë që ato të operojnë të vet-qëndrueshme dhe të arrijnë përfshirje më të gjerë edhe tek të varfëritë.

Për nga statusi i tyre ligjor, IMF-të në Kosovë operojnë në dy lloj formash: IMF- OJQ dhe IMF- SHPK. të dhënat e pranuar tregojnë se dominon statusi ligjor i IMF-OJQ me pronësi të huaj duke u veçuar një me pronësi vendore.

Sa i përket shtrirjes territoriale përmes organizimit të degëve, të dhënat tregojnë se IMF-të operojnë 98 degë të ndryshme gjithandej Kosovës, e të cilat janë të shtrira kryesisht në zonat urbane, përveç një IMF-je që i ka dhënë më shumë rëndësi zonës rurale. Kështu që numri aktiv sa më i madh i huamarrësve, i realizuar përmes shtrirjes sa më të gjerë territoriale është një faktor i rëndësishëm për ngritjen e nivelit të performancës financiare të IMF-ve. Kur bëhet fjalë për numrin aktiv të huamarrësve, struktura e tyre gjinore është domethënëse. Kështu, shumica e të dhënave nga hulumtimi e mbështesin argumentin, ashtu siç mbështet nga gjetjet e autorëve ndërkombëtarë të paraqitura në këtë punim, se përqindja e femrave huamarrëse ndikon në performancën më të mirë financiare të IMF-së, për shkak se ato i shfrytëzojnë më dobishëm kreditë dhe janë më të përgjegjshme në kthimin e tyre.

Në fillim të aktiviteteve të tyre, IMF-të ishin përkrahur nga donatorët, ndërsa viteve të fundit konsiderojnë se janë mjaft të qëndrueshme, megjithatë kohë pas kohe mund të huazojnë fonde për të rritur portofoliot e tyre kreditore. Portofoli që pastaj u ofrohet kredi personave me të ardhura të ulëta. Nga të anketuarit nënvizon marrja e kredive në banka të

tjera komerciale. Në këtë drejtim në bashkëbisedim me përfaqësuesin e AMIK, theksohet se IMF-të financohen përmes kredive komerciale nga institucione financiare ndërkombëtare me shkallë të interesit mes 6.5- 9%. Sipas intervistës me përfaqësuesin e AMIK thekson se huadhënësit e njohur për IMF- në Kosovë janë BERZH, FMO, EFSE, Blue Orchard, Symbiotics, OIKO Credit, Triple Jump dhe të tjerë. OJQ- IMF në Kosovë themelohen në përputhje me parimin kushtetues të lirisë për organizim dhe asocim.

Sa i përket numrit të klientëve huamarrës të IMF-e , nga të dhënat që ata kanë dhënë numri mesatar i klientëve për muaj sillet rreth 3,000, sipas përfaqësuesit të AMIK, deri në maj të vitit 2016 IMF-të në Kosovë ofrojnë shërbime për 52,389 huamarrës.

Mesatarja e kredive të lëshuara nga IMF-të ndryshon prej 500 Euro deri në 2000 €, gjersa për këtë çështje raportet në faqen zyrtare të AMIK, të dhënat për vitet 2012- 2016 tregojnë mesataren e kredisë rreth 1320 Euro.

Sipas rezultatit të gjitha IMF-të që operojnë në Kosovë, janë të orientuara në kreditim. Marrja e kredive te këto institucione, karakterizohet për procedurë të shpejta dhe pagesa e kredive mund të bëhet edhe në afate të shkurtra, çka edhe i bënë më me interes këto organizata. Kreditë e ofruara nga IMF-të fillojnë nga 100Euro dhe shkojnë deri në vlerën 25 mijë Euro. Kolaterali kërkohet për shuma mbi 1000 Euro(sic e thekson njeri përfaqësues i IMF-se). Kolaterali kërkohet vetëm për blerje të veturave, pajisje të biznesit, apo pajisje shtëpie. Sipas hulumtimit kolaterali duhet te mbuloj shumën e aplikuar nga klienti duke i shtuar interesin (kryegjëja+interesi)

5.1.2. Përmbledhje nga perceptimi mbi faktorët e veçuar të performancës financiare

Në pjesën në vazhdim paraqitet rezultatit i nxjerrë nga perceptimi i personelit të IMF-ve pjesë e hulumtimit, mbi rëndësinë e faktorëve të veçuar të performancës. Matja e perceptimit të anketuarve, është bërë me vlerësimin përmes shkallës së Likerit (1932)¹⁵⁵, për të kërkuar nga ata qëndrimin për secilin faktorë nga shkalla (5- pajtohem fuqishëm) deri tek shkalla (1- nuk pajtohem fuqishëm).

Vlera e aktiveve, kuptohet si masë nëse institucioni është mjaftueshëm i madh për të operuar dhe financiarisht i qëndrueshëm për të mbuluar ose jo shpenzimet operative. Merrtjen e vlerës së aktiveve, institucionet mikrofinanciare sigurojnë shërbime të kredive për klientët aktual dhe ata të rinj. Është bërë e ditur se aktivi kryesor i IMF-ve është kredia e lëshuar. Rezultatet tregojnë se 57.7% e të anketuarve pajtohen që faktorët i madhësisë (matur me vlerën e aktiveve) është faktorë i rëndësishëm për të matur performancën financiare të institucionit dhe 42.3% e ta anketuarve pajtohen fuqishëm mbi rëndësinë e faktorët.

Sipas rezultateve të marra, shumica e të anketuarve pajtohen, se mosha e institucionit është faktorë i rëndësishëm për performancën financiare, duke referuar 53.8% pajtohen fuqishëm dhe pjesa tjetër 46.2% pajtohen. Sipas literaturës së shqyrtuar, institucionet mikrofinanciare me kalimin e viteve të operimit janë më afër vetqëndrueshmërisë operative në krahasim nga ato të cilat janë në fazën fillestare të operimit.

Rezultatet e marra përmes pyetësorit tregojnë se shumica 65.4% e të anketuarve pajtohen me vlerësimin se statusi është një faktorë i rëndësishëm për performancën e institucionit,

¹⁵⁵A technique for the measurment of attitudes (Likert,1932); https://legacy.voteview.com/pdf/Likert_1932.pdf

gjithsesi janë pjesa tjetër 23.5% të cilët janë të pavendosur ose nuk pajtohen fuqishëm. Megjithatë, ajo që vihet re është theksi i vënë nga një i anketuari me pozitë Drejtor, sipas se cilit, IMF-të veprojnë ose gjenden në mes të një mentaliteti të OJQ-se dhe institucionit profesional që është një sfidë në vete për shkak të statusit të pa qartë të IMF-ve nga ana e BQK-së, si dhe ligji për IMF-të nuk është aprovuar ende nga kuvendi. Ky perceptim mund të jetë rezultat i pengesave që kishte ndodhë pas kërkesës së IMF-OJQ që të shndërrohen në shoqëri aksionare respektivisht entitete private, por që kjo ishte kundërshtuar¹⁵⁶ nga një pjesë e shoqërisë civile dhe një numër i deputetëve të kuvendit të Kosovës.

Portofoli i kredisë është vlerësuar si faktorë shumë i rëndësishëm sipas perceptimit të zyrtarëve të IMF-ve. Në mesin e IMF-ve, ekziston mendimi se pas përkrahjes fillestare nga donatorët, tani konsiderojnë se janë mjaft të qëndrueshëm financiarisht, edhe pse kohë pas kohe mund të huazojnë fonde për të rritur portofolit e tyre kreditore. Marrja e kredive, theksohet të realizohet në banka të tjera komerciale, ndërsa, përfaqësuesi i AMIK, thekson se IMF-të financohen përmes kredive komerciale nga institucioneve financiare ndërkombëtare.

Faktorë tjetër i rëndësishëm është numri aktiv i huamarrësve. Nga ajo që është bërë e ditur sa më e gjerë të jetë shtrirja e IMF-ve më shumë rritet mundësia e qasjes në shërbime financiare për klientët e varfër dhe ata që nuk kanë qasje në shërbime financiare bankare, pasi që shihen si rrezik për bankën vendore. Të anketuarit bëjnë vetëm përzgjedhje për tu pajtuar se ky faktorë është i rëndësishëm për vlerësim të performancës (69.2% pajtohen

¹⁵⁶ Më 12 prill 2013, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës vendosi të shpallë jo-kushtetuese nenet e Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jo-bankare (Nr.04/L-093) të cilat e mundësonin transformimin e OJQ-ve mikrofinanciare në shoqëri aksionare. Ky vendim u mor bazuar në rastin e ngritur nga Institucioni i Avokatit të Popullit me kërkesën e Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Lëvizjes Fol, Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dhe 55 OJQ-ve tjera mbështetëse

fuqishëm, dhe 30.8 pajtohen). Fokusi i IMF-ve duket të jetë rritja e numri të klientëve, marrë parasysh shtrirjen e degëve me të cilat operojnë IMF-të në Kosovë.

Ekziston një shpërndarje e perceptimit mbi rëndësinë e mesatares së kredisë, si faktorë i rëndësishëm i performancës së institucionit. Rezultatet e për mesataren e kredisë tregojnë se 46.2% janë të pavendosur dhe nuk pajtohen fuqishëm, përderisa 53.8% e të anketuarve, pajtohen dhe pajtohen fuqishëm se mesatare e kredisë është faktorë i rëndësishëm i performancës.

Shumica e të dhënave nga hulumtimi e mbështesin argumentin, ashtu siç mbështet nga gjetjet e autorëve ndërkombëtarë të paraqitura në këtë punim, se përqindja e femrave huamarëse ndikon në performancën më të mirë financiare të IMF-së, për shkak se ato i shfrytëzojnë më dobishëm kreditë dhe janë më të përgjegjshme në kthimin e tyre.

Të tre faktorët e qëndrueshmërisë së përgjithshme financiare siç kategorizohen në MIX, janë faktorë të rëndësishëm të cilët sipas teorisë janë përdorur në punime të ngjashme në vende të ndryshme të botës. Faktorët i vet qëndrueshmërisë (OSS) përdoret nga donatorët dhe menaxhmeti i IMF-ve për të vlerësuar nëse institucionit do të arrin të mbulojë shpenzimet operative me të ardhurat e gjeneruara. Ky faktorë duhet të arrijë normën 100% që një institucion të konsiderohet jetë i vet qëndrueshëm operativ.

Shpenzimet Operative, Shpenzimet e Personelit dhe Kosto për huamarrës janë faktorë të rëndësishëm për të matur efikasitetin dhe produktivitetin e institucionit. Këta faktorë tregojnë se sa mirë është duke funksionuar institucioni. Përderisa faktorët e produktivitetit pasqyrojnë sasinë e prodhimit për një njësi të inputeve, faktorët e efikasiteti gjithashtu

marrin parasysh koston për input . Kosto për huamarrës siguron një matës kuptimplotë të efikasitetit duke treguar koston mesatare të mbajtjes aktiv të një huamarrësi. Ky faktorë paraqet raporti midis të gjitha shpenzimeve operative që lidhen me funksionimin e institucionit, me numrin mesatar të huamarrësve aktivë për periudhën e dhënë.

Të dy faktorët e cilësisë së portfolios, Risku kreditor (PAR 30ditë) dhe faktorëi i shlyerjes, sipas teorisë janë treguar të rëndësishëm për performancën financiare të IMF-ve. Risku i portfolios kreditore (PAR) është faktorë i cili mund të ndikon në qëndrueshmërinë financiare të institucionit, kjo pasi që sa më e lartë të jetë PAR më e ulët është norma e shlyerjes, dhe prandaj qëndrueshmëria financiare është me e ulët. Ky faktorë duhet të jetë nën 10 përqind, përderisa portofoli i kredisë së IMF-së është duke vepruar në mënyrë efikase. Sipas literaturës, shlyerja e kredive dhe rikuperimi i kredive të vonuara është një faktorë i rëndësishëm i performancës financiare të IMF-ve , prandaj mbledhja e dobët dhe jo në kohë e tyre do të përballë IMF-në me sisteme të dobëta menaxhimi. Në këtë drejtim marrë nga perceptimi i të anketuarve shumica mendojnë se faktorëi i riskut (PAR 30dite) është faktorë i rëndësishëm (pajtohen fuqishëm 88.5 e të anketuarve) për performancën financiare të institucionit. Përderisa ngjashëm e kanë vlerësuar edhe faktorëin e shlyerjes së kredisë (76.9% e të anketuarve pajtohen plotësisht) të jetë faktorë i rëndësishëm i performancës financiare.

5.1.3. Mesataret nga perceptimi mbi faktorët e veçuar të performancës financiare

Përmbledhja në mesatare se si është dhënë perceptimi mbi rëndësinë e faktorëve të performancës duke është paraqitur në tabelën16.

Tabela 16. Mesatare nga perceptimi i të anketuarve

	N	Minimum	Maximum	Mean
Madhësia_Aktivet	26	4	5	4.42
Mosha_vitet e operimit	26	4	5	4.54
Vlera e Portfolios Kredi	26	4	5	4.58
Statusi	26	2	5	4
Numri Aktiv i Huamarrësve	26	4	5	4.69
Mesatare e kredisë	26	1	5	3.54
Femrat huamarrës	26	2	5	3.46
Kthimi mbi aktive_ ROA	26	4	5	4.35
Kthimi mbi kapitalin_ ROE	26	3	4	3.46
Vet_Qëndrueshmëria _OSS	26	4	5	4.54
ShpOperative_BPK	26	1	4	2.73
ShpPersonel_BPK	26	1	5	2.85
SHpHuamarrës	26	1	4	2.62
Shlyerja_Borxhi	26	2	5	4.42
Risku per 30 dite	26	4	5	4.88
Valid N (listwise)	26			3.94

Përpunuar në SPSS (autori,2016)

Nga rezultate e mbledhura sipas perceptimit të dhënë në pyetësin mbi vlerësimin e faktorëve si më të rëndësishëm për performancën financiare të IMF-ve në Kosovë, vihet re që mesatarja e arritur për të 3.94 e cila tregon se këta faktorë përmes së cilëve mund të matet ndikimi në performancë financiare, e që është qëllimi kryesor i këtij punimi. Me përmbledhjen e mesatareve sipas grupit të faktorëve(ashtu si kategorizohen në MIX) vihet re se rëndësia më e ulët bie mbi faktorët e efikasitetit dhe produktivitet 2.73, përderisa ajo më e larta e perceptuar nga të anketuarit është 4.65 për faktorët e cilësisë së portfolios kreditore. Në mesin e këtyre mesatareve mbasin të rëndësishëm faktorët e tjerë, të cilët janë pjesë e analizë në këtë punim.

Pjesa e tretë e pyetësit, paraqiti disa nga çështjet për të cilat të anketuarit ndan mendime të ndryshme. Në pah dolën sfida me konkurrencën, trajnimi dhe punësimi i personelit më profesional të cilat kërkojnë shpenzime shtesë. Kërkesat shtrënguese të Bankës Qendrore të

Kosovës, karshi IMF-ve paraqesin shpenzime shtesë, të cilat kërkojnë përmbushjen e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve, të cilat në shumicën e rasteve janë të krahasueshme me kërkesat që i bëhen bankave.

5.2. Statistikat përshkruese të variablave dhe analiza e korrelacionit

Statistika përshkruese të variablave të varura dhe të pavarura janë paraqitur në tabelën në shtojcë (tabela 40), përmes së cilës tregohet numri i vrojtimeve, mesatarja, minimumi i tyre. Përshkrimi i variablave fillon me grupin e faktorëve të qëndrueshmërisë së përgjithshme financiare; vetëqëndrueshmëria operative (OSS) dhe kthimin nga aktivet (ROA), profilin e institucionit (mosha, madhësia), shtrirjen¹⁵⁷ (portofolin e kredisë, numri aktiv i huamarrësve, mesatare e kredisë për huamarrës, përqindja e huamarrësve femra) efikasiteti (raporti i shpenzimeve operative mbi aktivet, raporti i shpenzimeve operative ndaj portofolit të kredisë, raporti i shpenzimeve të personelit ndaj portofolit të kredisë, koston për huamarrës).

Nieto et al (2007:18) thekson se shumë shpesh organizatat fillojnë si organizata jo qeveritare, dhe kur ato fillojnë të zhvillohen në botën e mikrofinancës, ato ndryshojnë në institucione financiare jo bankare. Në këtë punim nga rezultati i statistikave përshkruese përmes tabelave të kryqëzuara janë përfituar rezultate të cilat paraqesin ndryshimin midis IMF-ve në dy drejtime, sipas statusit ligjor dhe fazave të operimit.

Numri i vrojtimeve tek statistikave përshkruese ndryshon nga 73 dhe 101. Pas rregullimeve me metodën “listwise” të fshirjes statistikore e cila rregullon trajtimin e të dhënave që mungojnë duke i përjashtuar ato nga analiza, lista numëron 77 vrojtime. Strategjitë e

¹⁵⁷ Shtrirja (zgjerimi) nënkupton rritjen e qasjes në shërbimet financiare (“2007 MIX Global 100)

modelimit të regresionit marrin parasysh të paktën 10-20 vrojtme për variablën e pavarur (Haile, 2016 e theksuar Harrell's 2002). Përparësia e shfrytëzimit të këtyre të dhënave ishte se të njëjtat nuk ekzistojnë në ndonjë raport të ngjashëm, përderisa mangësi është se këto të dhëna nuk janë reprezentative për secilën IMF veç e veç. Megjithatë, së bashku mund të shfrytëzohen si një gjendje e institucioneve mikrofinanciare që operojnë në Kosovë.

Për të treguar nëse ekziston korrelacioni midis variablave është siguruar se të gjitha variablat që janë pjesë e modelit janë përcaktuar qartë në literaturën e hershme, e cila trajton çështjen e ngjashme me këtë punim.

5.2.1. Variablat e varura, përfaqësuese të performancës financiare

Vetëqëndrueshmëria operative (OSS)

Qasja për vetëqëndrueshmëri specifikon se donacionet mbulojnë shpenzimet fillestare dhe mbështesin me fonde gjetjen e risive për të zvogëluar shpenzimet operative, deri sa të ardhurat nga klientët mundë të mbulojnë shpenzimet afatgjatë (Schreiner,2002:1). Për të vazhduar operimin pa mbështetjen nga subvencioni IMF duhet të arrijë OSS mbi 100% e cila tregon se është arritur pika e rentabilitetit, në të kundërtën IMF-ja nuk arrin të mbulojë shpenzimet operative. Nëse një institucion i kursimeve ose krediti nuk arrijnë këtë raport, kapitali i saj do të reduktohet me humbje ose duhet të kompensohet me grante (Berne,2005:7).

Nga tabela e statistikave përshkruese (tabela në shtojce), vetëqëndrueshmëria operative (OSS) përfshirë 94 vrojtme në mesatare arrin në nivelin 106 përqind, përderisa minimumi mbetet 22.18 përqind dhe maksimale 251.39 përqind. Në analiza të mëtejshme përmes

tabelave të kryqëzuara tregon se IMF-OJQ përbëjnë 65 vrojtime dhe pjesën tjetër e përbëjnë IMF-IFJB (29vrojtime), tabela si më poshtë.

Tabela 17. Ndarja e IMF-ve sipas statusit OSS

STOSS * Statusi Crosstabulation				
		Statusi		Total
		IMF- OJQ	IMF-IFJB	
STOSS	OSS nen 100%	27	10	37
	OSS mbi 100%	38	19	57
Total		65	29	94

Burimi: autori (sipas te dhënave nga MIX- 2015)

Shumica e vrojtimeve (65) i referohen statusit të IMF-OJQ, prej te cilave 38 tregojnë vetëqëndrueshmëri operative mbi 100% dhe pjesa tjetër ende nuk arrijnë këtë nivel. Nga 29 vrojtime të referuara si IMF-IFJB shumica kanë arritur vetëqëndrueshmëri operative(mbi 100%), megjithatë mbesin 10 vrojtime të cilat nuk e kanë arritur këtë nivel. Nga analizat e mëtejshme (tabela 43 në shtojcë mbi ndryshimet e mesatareve midis IMF-ve sipas statusit), vetëqëndrueshmëri operative më të lartë arrijnë IMF-IFJB (111%) (përderisa IMF-OJQ në mesatare më arrijnë vetë qëndrueshmëri më të ulët (104%). Këto statistika kanë tendencë të tregojnë se një IMF me status institucion financiare jo bankare (IFJB) në Kosovë (sic i referohemi raportimit ne MIX) ka më shumë gjasat të jetë e vetëqëndrueshme ne drejtim operativ duke siguruar se mund të ofrojë edhe shërbime të tjera financiare (siç janë kursimet, depozitat apo edhe tranferet e parave dhe pagesat e shërbimeve komunale) të cilat shërbime nuk mund t'i ofron nje IMF me status ligjor OJQ. Historikisht, shumica OJQ janë të varura nga donatorë dhe kanë shpenzime të larta operative. Me kalimin e kohës, që ato të operojnë të vetëqëndrueshme, ato fillojnë të bëjnë ndarjen e aktiviteteve të mikrofinancës nga shërbime të tjera. Më vonë këto institucione do

të fillojnë të transformohen në institucioneve të rregulluara financiare. Duke analizuar këto ndryshime si dhe paraqitjen e përafërt të të vetëqëndrueshmërisë operative midis IMF-ve sipas statusit nga tabela 43, vihet në pah se ekziston dallim në operim të IMF-ve sipas statusit të raportuar. Një shqyrtim më gjithëpërfshirës të akterëve relevant do të sjellë në vëmendje nevojën për analizuar transformim e IMF-ve në status më efektiv për sektorin në përgjithësi. Këto ndryshime sipas AMIK (2016) janë të pranishme në vendet fqinjë, siç është Shqipëria, Maqedonia, Mali i zi, Serbia etj, të cilat mundë të shërbejnë për të marrë mësim për përvojat pozitive lidhur me zhvillimi e sektorit të mikrofinancës në vend.

Kthimi nga aktivet (ROA)

Kthimi nga aktivet(ROA) paraqet raportin midis të ardhurave neto ndaj aktiveve (pasurinë) në total. Sipas definicionit të MIX raporti i kthimit nga aktiveve llogarite si; (të ardhurat neto – taksat) / aktivet mesatare (pasurisë). Sa më lartë të jetë përqindja e këtij raporti aq më mirë konsiderohet se menaxhmenti i institucionit shfrytëzon në mënyrë efikase aktivet (pasurinë) e saj për të gjeneruar fitim. Kjo gjithashtu mat përfitimin e përgjithshëm e cila reflekton marzhën e fitimit dhe efikasitetin e institucionit. Nga pasqyrat më të fundit, trendi negativ i këtij faktorët të përfitueshmërisë është përmirësuar, duke vlerësuar se kjo mund të jetë rezultat i përshpejtimit të kredive të akorduara gjatë periudhë së fundit(sipas BQK,2016). Nga tabela 40, e statistikave përshkruese vërehet në mesatare performanca financiare e matur me kthimin nga aktivet (ROA) ishte me rezultat negative (-1.2858) duke marrë në konsideratë 83vrojtime. Ekziston dallim i madh midis vlerës minimale (-81.9) dhe asaj maksimale e ROA e cila tregon vlerën 16.03 përqind.

Tabela 18. Ndarja e IMF-ve sipas nivelit të ROA

STROA * Statusi Crosstabulation				
		Statusi		Total
		IMF- OJQ	IMF-IFJB	
STROA	Negative	23	8	31
	Pozitive	35	17	52
Total		58	25	83

Burimi: autori (sipas të dhënave nga MIX- 2015)

Nga tabela 18, shumica e vrojtimeve (58) tregojnë IMF-OJQ, prej të cilave 35 vrojtime tregojnë rezultat pozitiv të kthimit nga aktivet (ROA), pjesa tjetër e vrojtimeve (23) ende nuk janë në gjendje të tregojnë efikasitet drejt kthimit të aktiveve. Nga 25 vrojtime që i paraqet IMF-IFJB shumica kanë arritur të jenë efikase në drejtim të gjenerimit të fitimit, megjithatë, mbasin 8 vrojtime të cilat nuk e kanë arritur këtë nivel, të cilat kryesisht gjinden në fazë të pjekurisë. Nga analizat e mëtejshme (tabela 43 në shtojcë) rezultatet tregojnë se ROA për IMF-OJQ është negative (-2.4338), përderisa IMF-IFJB tregojnë vlerë pozitive(1.3776) e cila tregon se këto vrojtime për IMF kanë arritur të gjenerojnë të ardhura operative 1.3776 përqind në raport me mesatare të kthimit ndaj aktiveve(pasurinë).

5.2.2. Variablat e pavarura (shpjeguese)

Në vijim diskutohen variablat e pavarura sipas statistika përshkruese të përpunuara për këtë punim.

Faktori i cili pasqyron moshën e institucionit është i përfaqësuar nga 101 vrojtime të marra në konsideratë, e cila reflekton me përvojën e operimit të institucioneve mikrofinanciare në Kosovë që nga viti i themelimit. Suksesi i IMF-ve vlerësohet duke matur nivelin e vetëqëndrueshmërisë operative, e cila sipas përvojave ndërkombëtare ajo do të duhej arritur

brenda 3 deri 7 vite të operimit. Tendenca është që IMF-të më të reja nuk arrijnë lehtë vetëqëndrueshmërinë, kurse e kundërta ndodhë me IMF –të më të vjetra.

Në shumicën e punimeve të shqyrtuara mbi mikrofinancën, përvoja e IMF-ve karakterizohet përmes tri fazave të operimit, a) e para paraqet nga 1 deri në 4 vite të operimit ose faza e re b) e dyta nga 5 deri në 8 vite të operimit ose faza fillestare, dhe c) faza e pjekurisë mbi 8 vite të operimit. Nga të dhënat, sipas tabelës në shtojcë e bazuar në mesataren nga statistikat përshkruese, IMF-të në Kosovë kanë arritur në fazën e pjekurisë, pasi që mesatarja sillet rreth 8.10 vite përderisa maksimalja është 16 vite. Kjo periudhë e operimit, vë në dukje se IMF-të në duket të jenë mirë të pozicionuara në tregun e Kosovës, dhe kjo nga fakti se shumica ende vazhdojnë të operojnë, përkundër pengesave dhe sfidave me të cilat ato ballafaqohen sidomos me statusit ende të parregulluar deri më tani.

Nga vështrimi i tabelave në vijim, nuk ekziston dallim i madh midis IMF-ve me status të ndryshëm. Në mesatare, përvoja e operimit të IMF-OJQ është mbi 8 vite (8.4), përderisa IMF-IFJB janë mbi 7 (7.2). Në analiza më të thella nga tabela e kryqëzuar (tabela 19) nga gjithsej vrojtimit (94), shumica (50) i përkasin fazës së pjekurisë, prej tyre 29 paraqesin vetëqëndrueshmëri operative (mbi 100%) dhe 21 vrojtime ende nuk kanë arritur këtë nivel.

Tabela 19. Fazat e operimit dhe rezultati i OSS

STOSS * FazatOperim Crosstabulation					
		FazatOperim			Total
		Faza e pare	Faza e dyte	Faza e trete	
STOSS	OSS nen 100%	9	7	21	37
	OSS mbi 100%	5	23	29	57
Total		14	30	50	94

Burimi: autori (sipas të dhënave nga MIX- 2015)

Kur IMF-të operojnë në fazën e dytë (30 vrojtime), vetëqëndrueshmëri operative mbi 100% tregojnë 23 vrojtime, ndërsa 7 vrojtime të tjera nuk e kanë arritur këtë nivel. Gjatë fazës së parë shumica (9vrojtime) nuk kanë arritur vetëqëndrueshmëri operative, megjithatë 5 vrojtime paraqesin të kundërtën. Në këtë punim, faktorin e moshës e kemi marrë parasysh për të analizuar bazuar edhe në shumë punime të tjera të publikuara në revista ndërkombëtare. Është e pritur se me përvojën e kaluar (moshën më të madhe) menaxhmenti i institucionit do të jetë më i aftësuar në drejtim të menaxhimit më efikas të shpenzimeve të përgjithshme, përfshirë shpenzimet operative, shpenzimet e personelit dhe koston për huamarrës.

Në rastin kur faktori i fitueshmërisë (kthimi nga aktivet) është me vlerë pozitive tregon se kjo është arritur gjatë fazës së pjekurisë e cila tregohet përmes tabelës së kryqëzuar (tabela 20) e cila përfaqëson 52 vrojtime nga 83 të marra në konsideratë.

Tabela 20. Fazat e operimit dhe rezultati i ROA

STROA * FazatOperim Crosstabulation					
		FazatOperim			Total
		Faza e pare	Faza e dyte	Faza e trete	
STROA	Negative	4	7	20	31
	Pozitive	5	19	28	52
Total		9	26	48	83

Burimi: autori (sipas te dhënave nga MIX- 2015)

IMF-të treguan përmirësim të përfitueshmërisë të matur me kthimin mbi aktivet, pasi që nga 5 vrojtime të cilat tregonin rezultat pozitiv në fazën e parë, ajo rritet gjatë fazës së dytë (tabela 20). Këto pasqyra sugjerojnë se pritjet janë pozitive atëherë kur rritet mosha e IMF-

ve rezultatet janë në favor të operimit me vetëqëndrueshmëri operative dhe rritjes së kthimit mbi aktivet.

Madhësia e institucionit mikrofinanciare në këtë punim është matur me vlerën e aktiveve. Ky faktorë ka rol të rëndësishëm në pozicionimin e institucionit në treg, pasi që tregon nëse institucioni është mjaft i madh për të operuar dhe nëse është financiarisht i qëndrueshëm për të mbuluar shpenzimet operative. Nga tabela e statistikave përshkruese mesatarja është 15.6945 në vlerën e logaritmit natyror (Ln), ose në mil (7,893,841dollarë) për 97 vrojtme, përderisa vlera maksimale është 18.06 ose (69,938,936 dollarë) e cila shërben 19,336 kliente. Njësia me vlerën minimale është 12.94 ose (416,173.00 dollarë).

Rritja e sektorit të mikrofinances konsiderohet të jetë si rezultat i rritjes së portofolit të kredisë e cila është burimi kryesor i aktiveve. Statistikat sugjerojnë që IMF-IFJB në ofertën e tyre kanë mundësi të ofrojnë shërbime shtesë¹⁵⁸, përkundër IMF-OJQ nuk e kanë këtë mundësi. Me rritjen e aktiveve rritet portofoli i kredisë i cili do të sigurojë ofrim të shërbimeve për klientët e institucionit.

Faktorët e shtrirjes të institucionit mikrofinanciar në Kosovë, të paraqitur në tabelën e statistikave përshkruese do të diskutohet si në vijim. Portofoli e kredisë, përfshin të gjitha kreditë e akorduara nga IMF-të, pavarësisht nga produkti apo llojit të klientit (fjalori i MIX). Sipas tabelës së statistikave përshkruese, portofoli i kredisë në mesatar është 15.53 në vlerën e logaritmit natyror (Ln), maksimale 17.90 dhe minimale 12.05. Vlera e portofolit të kredisë në mesatare para logaritmit natyror (Ln) sipas statistikave përshkruese arrin në

¹⁵⁸ kursimet, depozitat apo edhe tranferet e parave dhe pagesat e shërbimeve komunale

10,149,722 dollarë dhe maksimalja 59,664,129 dollarë, e cila paraqet rritje të ndjeshme të kredidhënies së institucioneve.

Sipas buletinit të mikro banking (MBB), klasifikimi i IMF-ve në terma të madhësisë sipas portofolit të kredisë është më i vogël se 2 milionë dollar janë IMF-te vogla, ato që kanë portofolin e kredisë midis 2 deri 8 milion dollar janë të mesme dhe ato që kanë mbi 8 milion dollar janë ato të mëdha. Në analiza të mëtejshme sipas statistikave grupore, IMF-OJQ në mesatare tregojnë vlerën portofolis kreditore ln 15.1609 e cila përshkruhet nga 70 vrojtime, përderisa IMF-IFJB në mesatare arrijnë vlerën ln 16.3705 e përfaqësuar nga 30 vrojtime.

Numri i huamarrësve aktiv është matës i shtrirjes dhe thellësisë së institucionit, i cili mat numrin e të varfërve që janë të shërbyer nga institucioni mikrofinanciar (Woller dhe Schreiner, 2002). Në këtë punim, mesatarja e numrit të huamarrësve aktiv sipas 90 vrojtime është 5311 huamarrës, përderisa maksimalja arrin 21083 klientë. Konsiderohet se sa më i lartë të jetë numri i huamarrësve aq më e lartë është shtrirja e IMF-ve. Kjo tendencë e rritjes së numrit të huamarrësve aktiv mund të referohet rritjes së qasjes ndaj klientëve që nuk janë të shërbyer nga banka vendore dhe se procedurat e kredidhënies janë më të thjeshta dhe të shpejta tek institucionet mikrofinanciare. Mesatare e numrit të huamarrësve aktiv sipas statistikave grupore, IMF-IFJB (25vrojtime) arrin në 8406 përderisa për IMF-OJQ arrin 4121. Kredia mesatare për huamarrës tregon efikasitetin e një IMF për të ofruar kreditë tek klientët. Sipas literaturës madhësia e mesatares së kredisë në shumicën e rasteve është përdorur si përfaqësuese e shtrirjes së IMF-ve tek të varfëritë. Sa më e vogël është mesatarja e kredisë, ajo është faktorë i shtrirjes së IMF-ve tek të varfëritë. Në Kosovë sipas

AMIK(2016) të gjitha IMF-të ofrojnë kredi të vogla, si produkt kryesor të tyre, me orientim te kategoria e klientëve që janë të kufizuar nga shërbimet bankare tregtare. Sipas rezultateve nga statistikat përshkruese madhësia e kredisë mesatare është 2114.24 dollarë, që tregon se IMF-të në Kosovë ofrojnë një kredi, më shumë atyre që nuk janë shumë të varfër. Sipas tabelës së mesatareve midis IMF-ve me status te ndryshëm, IMF-IFJB arrijnë mesatare 2057.31 dhe për IMF-OJQ ishte 2262.28.

Përveç arritjes së të varfërve, synimi i grave si huamarrese është një nga objektivat themelore të mikrofinancës. Faktorë i cili është konsideruar me ndikim ne performancën financiare është pjesëmarrja e gjinisë femërore në huamarrje, e cila nga tabela e statistikave përshkruese tregoi se 32.57 për qind e klientëve janë të gjinisë femërore. Minimumi i pjesëmarrjes së femrave në huamarrje është 3.6 për qind dhe maksimalja është 100 për qind, atëherë kur një IMF shërben vetëm klientë të gjinisë femërore. Mund të pritet që ky faktorë të ndikojë pozitivisht në performancën financiare, nga fakti se nga strukturat e IMF-ve aplikohet procedura e cila motivon analistët e kredive, kur ata arrijnë të ofrojnë kredi te klientët femra, me theks kur një biznes i vogël është i udhëhequr nga një femër. Nga pjesëmarrja e përgjithshme e femrave ne huamarrje në mesatare 34.5% i takojnë IMF-OJQ dhe pjesa tjetër 27.7% i takon IMF-IFJB.

Nga grupi i shpenzimeve operative, që përfaqësojnë efikasitetin e institucionit më së shumti i përdorur është; raporti i shpenzimeve operative mbi aktivet, raporti i shpenzimeve operative mbi portofolin e kredisë, shpenzimet e personelit mbi portofolin e kredisë, kosto për huamarrës,etj. Matja e performancës së faktorëve të efikasitetit dhe krahasimi i tyre me konkurrencën, mund të përcaktoj nivelin e shfrytëzimit më të mirë të resurseve në

dispozicion dhe të qes në pah se cilat ndryshime duhet bërë për të operuar të vetëqëndrueshme në vazhdimësi. Sipas Muriu (2011:69), evidencat empirike tregojnë faktin se ofrimi i shërbimeve të mikrofinancës është një biznes i kushtueshëm, kjo ndoshta për shkak të transaksioneve të larta dhe kostos së informacionit (Hermes dhe Lensink, 2017; Gonzalez, 2007). Qasja për vetëqëndrueshmëri specifikon se donacionet mbulojnë shpenzimet fillestare dhe mbështesin me fonde gjetjen e risive për të zvogëluar shpenzimet e furnizimit, derisa të ardhurat nga klientët mund të mbulojnë shpenzimet afatgjatë (Schreiner, 2002:1).

Shpenzimet operative ndaj aktiveve janë njëri nga raportet të cilat paraqesin nivelin e kostos së nevojshme që një IMF-të mund të përdorë për të operuar me një njësi të aktiveve të saj. Ky faktorë është i krahasueshëm me raportin e efikasitetit i cili sipas statistikave përshkruese në mesatare është 15.4 përqind. Nga analiza krahasuese midis IMF-ve sipas statusit, ky raport për IMF-OJQ në mesatare është 16.7 përqind, dhe është më i lartë se IMF-IFJB që kanë mesatare 12.5 përqind. Kjo tregon se IMF-IFJB janë më eficiente në drejtim të menaxhimit të shpenzimeve operative ndaj aktiveve. Gjithashtu ky faktorë tregon lidhje të fortë korrelative me të dy faktorët përfaqësues të performancës, e cila forcon bindjen e rëndësisë së këtij faktori. Në tabelën e statistikave përshkruese, faktorët e efikasitetit si mesatarja e shpenzimeve operative ndaj portofolis e kredisë është 17.6 përqind dhe ajo maksimale arrin 53 përqind, gjë që tregon se shpenzimet operative mund të jenë problem për performancën financiare të IMF-ve në Kosovë. Shpenzimet e personelit janë pjesë e “shpenzimeve operative” i cili termi sipas MIX përdoret për të përshkruar shpenzimet e personelit dhe administrative siç janë pagat, amortizimi, mirëmbajtja etj.

Shpenzimet e personelit/portofolit së kredisë, sipas statistikave përshkruese, në këtë studim janë në mesatare 9.3 për qind, maksimumi ishte 20.21 për qind. Sa më e ulët të jetë kjo kategori e shpenzimit aq më i lartë do të jetë produktiviteti i IMF-së. Kostoja për huamarrës (kredi) reflekton se sa një institucion aktualisht shpenzon në personel dhe në shpenzime administrative për të shërbyer një huamarrës të vetëm. Sa më e ulët të jetë vlera e këtij faktori, kjo tregon se sa është efikas një IMF në shërbimet e ofruara. Sipas CGAP (2009), ky faktorë nuk e penalizon IMF-në që të ofrojë kredi të vogla, kostoja për klient është një raport më i mirë i efikasitetit për të bërë krahasimin e institucioneve. Sipas tabelës së statistikave përshkruese, mesatarja e kostos për huamarrës që një IMF krijon, nga 78 observime, është 338.93 dollarë. Ky faktorë nuk paraqet një dallim të madh nëse është IMF-OJQ e cila paraqet kosto në mesatare 351.66 dollarë dhe IMF- IFJB tregojnë 300 dollarë, pas rregullimit në numër të variablave.

5.3. Analiza e korrelacionit

Analiza e koeficienteve të korrelacionit përfshin matjen dhe interpretimin e koeficienteve të korrelacionit të dyanshëm midis të gjitha variablave. Në mënyrë që të shihet shkalla e lidhjes midis variablës së varur (përfaqësuese e performancës financiare) dhe variablave shpjeguese, analiza e korrelacionit është bërë dhe përshkruar në vijim të kësaj pjese. Kjo lidhje (korrelacion) duhet të jetë pozitive ose negative në drejtim që variabla e varur të jetë mirë e përfaqësuar.

Nga rezultati i analizës së korrelacionit, ekziston lidhje e fortë midis dy përfaqësuese të faktorëve të performancës financiare vetëqëndrueshmërisë operative (OSS) dhe kthimit mbi aktivet (ROA) por që në këtë punim të dyja analizohen në modele të veçanta ekonometrike.

Analiza më e thellë e korrelacionit tregon, se përveç me faktorët e efikasitetit (raporti i shpenzimeve operative nga aktivet, shpenzimet operative nga portofoli e kredisë, shpenzimet e personelit nga portofoli e kredisë dhe kostoja për huamarrës) që janë në korrelacion të fortë në drejtim negativ(rëndësi statistikore 1 përqindë) me vetëqëndrueshmërin, të tjerë faktorë nuk kanë lidhje korrelative me përfaqësuesin e performancës OSS në këtë punim. Kjo analizë sugjeron se institucioni duhet të shtojnë kujdesin në drejtim të uljes së shpenzimeve operative nëse vetëqëndrueshmëria operative është qëllim për t'u arritur.

Tabela e korrelacionit tregon lidhje negative (rëndësia statistikore në nivelin 5 përqind) midis kthimit nga aktivet me moshën dhe koston për huamarrës. Lidhje të fortë negative në nivelin 1 përqindë, sipas tabelës së korrelacionit tregon kthimi nga aktivet me raportin e shpenzimeve operative/aktive, shpenzimet operative/portofolin e kredisë, shpenzimet e personelit/portofolin e kredisë me shpenzimet operative/portofolin e kredisë dhe shpenzimet e personelit/portofolin e kredisë, e cila tregon se me ndryshimin në drejtim negativ të shpenzimeve do të ndryshoj në të njëjtin drejtim edhe kthimi nga aktivet. Përderisa lidhje pozitive në nivel 5 përqind tregon midis kthimit nga aktive me madhësinë e matur me vlerën e aktiveve dhe portofolin e kredisë, e cila nënkupton kontributi është pozitiv në drejtim të kthimit ndaj aktiveve për IMF-të që janë pjesë e këtij punimi.

Edhe në këtë rast sikurse të lidhja e vetëqëndrueshmëris operative me faktorët e shtrirjes u tregua lidhje e dobët, e cila tregon se orientimi i IMF-ve më shumë mundë të jetë në krijimin e fitimit se në rritjen e qasjes së klientëve të nivelit që nuk janë të shërbyer nga bankat vendore.

Për të studiuar ndikimin e këtyre statistikave përmbledhëse të cilat janë fituar nga rezultati i korrelacionit, do të bëhet analiza ekonometrike e cila do të jetë e paraqitur në pjesën në vazhdim të këtij kapitulli.

5.4. Rezultati ekonometrik

Për të përcaktuar faktorët që e ndikojnë performancën financiare të IMF-ve në Kosovë, në këtë punim është përdorur **modeli i regresionit linear** dhe **regresioni logjistik binar**.

Modeli i regresionit linear supozon që variablat e pavarura (shpjeguese) kanë efekt në variablen e varur dhe modeli i regresionit logjistik binar përdoret për të thelluar analizën më tej, për të matur ndikimin e variablave të përzgjedhura në variablat e varura. Përmes koeficienteve të regresionit të shumëfishtë linear do të tregohet saktësisht se si performanca financiare e IMF-ve në Kosovë, është e ndikuar nga faktorë të veçuar e përfaqësuar përmes dy faktorëve të qëndrueshmërisë së përgjithshme financiare, atë të vetëqëndrueshmërisë operative dhe kthimit nga aktivet.

Regresioni linear përfshinë ato variabla, të dhënat e të cilave ishin më të plota të raportuara e të cilat janë të mbledhura në data bazën e MIX për IMF të që operojnë në Kosovë. Mbledhja e të dhënave dytësore ka për qëllim të studioj faktorët që ndikojnë në performancën financiare, bazuar në, moshën, madhësinë, shtrirjen dhe efikasitetin e një njësie.

Kujtojmë që dy variablat e varura, përfaqësuese të performancës financiare në këtë punim, bëjnë pjesë në grupin e faktorëve të “performanca e përgjithshme financiare”¹⁵⁹ të kategorizuara sipas MIX. Vetëqëndrueshmërinë operative (OSS) dhe Kthimi nga aktive

¹⁵⁹ Overall financial performance

(ROA) janë përdorur si përfaqësuese të performancës financiare, të cilat janë bazuar në konceptin dhe matjen e me punime të ngjashme si (Rahman & Mazlan,2014; El Kharti ,2014; Gakhar dhe Mettu,2013; Gupta et. al ,2012; Woldeyes ,2012; K Schäfer dhe Y Fukasawa ,2011 etj) duke veçuar ata faktorë që janë me interes për këtë punim.

Tabela 21. Përshkrimi i variablave të varura të përdorura në model

Përshkrimi I variablave	Matja (Formula)	Emërtimi i Variablit në model	Burimi i te dhenave
Vet qëndrueshmëria operacionale	Të ardhurat Operative / (Shpenzimet operative + Kostot Financiare + Humbjet nga zhvlerësimi i kredive)	OSS	MIX Market
Kthimi nga aktivet	(Të ardhurat operative neto-tatimet)/mesatare e totalit te aktiveve	ROA	

Burimi: Faktorët në përqindje, ashtu siç raportohen në MIX market

Siç është vënë re gjatë shqyrtimit të literaturës, ekzistojnë edhe faktorë të tjerët të cilët mundë të përdoren për të matur performacën financiare të IMF-ve, megjithatë në këtë punim janë marrë në konsideratë këta faktorë pasi që të dy për nga natyra tregojnë aftësinë financiare dhe efikasitetin e institucionit për të operuar të pavarura nga subvencione ose mbështetje të tjera financiare.

Me vetëqëndrueshmërinë operative është matur aftësia e institucionit që me të ardhurat e gjeneruar të mbuloj shpenzimet e operimit. Kthim ndaj aktiveve është përdorur për të matur aftësinë e institucionit për të përdorur në mënyrë sa më efikase aktivet e saj.

Modeli origjinal i regresionit, për matjen e ndikimit të faktorëve të performancës financiare përfshinë të gjitha variablat e shpjeguara tek statistikat përshkruese (tabela ne shtojce) dhe pjesën e teorisë në kapitullin e parë , dukej ;

$$Y_{it} = \alpha_i + \beta_1 * Moshait + \beta_2 * LnMADHit + \beta_3 * LnBPK_{it} + \beta_4 * MesKredi_{it} + \beta_5 * NakHuam_{it} + \beta_6 * FemHuam_{it} + \beta_7 * SHO_AK_{it} + \beta_8 * SHO_PK_{it} + \beta_9 * SHP_PK_{it} + \beta_{10} * KosHuam_{it} + e_{it} \dots\dots\dots(2)$$

Për të testuar normalitetin e shpërndarjes së të dhënave është përdorur testi i normalitetit sipas **Kolmogorov-Smirnova dhe Shapiro-Wilk** dhe është kryer përmes pakos softwerike SPSS. Bazuar në këtë metodë, kur rezultati i testit del të jetë statistikisht jo i rëndësishëm ($p > 0.05$) tregon se shpërndarja e mostrës nuk është shumë e ndryshme nga një shpërndarje normale. Me fillim të testit të normalitetit, disa nga variablat dukeshin qartë se nuk kanë një shpërndarje normale, për shkak të vlerave numerike të mëdha dhe dispersive, si madhësia e matur me vlerën e aktiveve dhe bruto portofoli e kredisë, këto variabla u transformuan përmes logaritimit natyror në variabla të reja para se të zhvillohej testi i normalitetit. Kufizimi më i madh gjatë punës me të dhëna dytësore, konsiderohet atëherë kur të dhënat nuk janë raportuar të plota ose ekziston pasaktësi në raportim, e kjo krijon probleme në përzgjedhjen e tyre. Ato ose duhet larguar ose duhet provuar të shndërrohen në të dhëna të matshme. Për femrat huamarrse dhe numrin aktiv të huamarrësve si faktorë të rëndësishëm të shtrirjes u provuar të shndërrohen në numër logaritmit, por edhe këtë herë nuk e kaluan testin e normalitetit. Nga testi i normalitetit tani largohen (numri i huamarrësve aktiv, madhësia e kredisë mesatare, huamarrëset femra, shpenzimet e personelit/portofolin e kredisë dhe portofoli në risk PAR30dite si dhe shlyerja e kredisë, cila u provua të përfshihej në model. Testi i normalitetit përfundon duke numëruar 77 vërtetime të cilat duket se janë mjaftë reprezentative për modelin e regresionit të përdorur në këtë punim.

Pas kryerjes së testit të normalitetit është zhvilluar procedura e aplikimit të modelit ekonometrik përmes dy llojeve të regresionit;

- regresionit linear ;
- regresionit logjistik binar.

Në regresion u përfshinë variablat të cilat kaluan testin e normalitetit e ato janë, mosha(përvoja e institucionit), lnMadhesia(vlera e aktiveve), lnBPK(portofoli i kredisë), shpenzimet operative/aktivet, shpenzimet operative/portofolin e kredisë, kostoja për huamarrës(KosHuam).

Për të vërtetuar hipotezën e ngritur në të dy drejtimet është përdorur qasje ngjashme e përdorur nga autorë në punime të ndryshme, shumica e të cilët përdorin të dhëna nga MIX, nënvizuar Rahman & Mazlan,(2014), El Kharti (2015), Gakhar dhe Mettu (2013), Gupta et. al (2012), K Schäfer dhe Y Fukasawa (2011); etj.

Për të testuar modelin ekonometrik është përdorur programi SPSS, versioni 21, që paraqet: përmbledhjen e modelit; ANOVAmodeLIN; koeficientet e variablave dhe koeficientet e variablave në ekuacion të përzgjedhura përmes procedurës Stepwise. Procedura “Stepwise” ose “Hap pas Hapi” përdoret për të parë nëse variablat e përzgjedhura që kanë ndikim janë të rëndësishme apo jo për modelin. Kjo metodë lejon lëvizjen në drejtim të zvogëlimit ose shtimit të numrit të variablave, të cilat fillimisht mund të duken të jenë të rëndësishme Kjo është procedurë automatike e përzgjedhjes së variablave shpjeguese , e cila zgjedh ato më të rëndësishme(Brooks,2008).

5.4.1. Formimi i modeleve ekonometrike

Nga diskutimi i mësipërm, janë formuar dy modele ekonometrike për të matur ndikimin e variablave shpjeguese në performancën financiare në dy drejtimet;

$$\text{OSS}_{it} = \alpha_i + \beta_1 \text{Moshait} + \beta_2 \text{LnMadhësia}_{it} + \beta_3 \text{LnBPK}_{it} + \beta_4 \text{ShO_AK}_{it} + \beta_5 \text{SHO_PK}_{it} + \beta_6 \text{KosHuam}_{it} + \varepsilon \quad \dots\dots\dots(3)$$

$$\text{ROA}_{it} = \alpha_i + \beta_1 \text{Moshait} + \beta_2 \text{LnMadhësia}_{it} + \beta_3 \text{LnBPK}_{it} + \beta_4 \text{ShO_AK}_{it} + \beta_5 \text{SHO_PK}_{it} + \beta_6 \text{KosHuam}_{it} + \varepsilon \quad \dots\dots\dots(4)$$

Siç është shpjeguar në këtë punim, faktorët më së shpeshti të përdorur për të matur performancën financiare të IMF-ve janë, vetëqëndrueshmëria financiare (FSS¹⁶⁰), vetë qëndrueshmëria operative(OSS), kthimi nga aktive (ROA), kthimi mbi kapitalin (ROE). Në, këtë punim metoda e regresionit linear është përdorur për të matur ndikimin e përcaktuesve në vetëqëndrueshmërinë operative(OSS)dhe kthimin mbi aktivet(ROA), përderisa për ROE rezultati nuk e kaloi testin e multikularitetit dhe për FSS kishte mungesë të dhënave.

Vetëqëndrueshmëria operative matë aftësinë e IMF-së për të mbuluar shpenzimet operative nga të ardhurat operative të gjeneruara. Kthimi mbi aktivet, është matës i përgjithshëm i fitueshmerisë i cili reflekton marzhin e fitimit dhe efikasitetin e institucionit.

Në modelin e regresionit linear kemi mbajtur gjashtë (6) variabla shpjeguese nga nëntë(10) të pritura, në mesin e numrit të madh që raportohen në MIX. Marrja në konsideratë e numrit të vogël të faktorëve është pasojë e numrit të vogël të IMF-ve që raportojnë me të dhëna të plota në MIX. Përfshirja e numrit më të madh të variablave(me

¹⁶⁰ FSS- Financial self sufficient

vlera të mangëta) vetëm se do të ta humbiste kuptimin e këtij studimi. Nga variablat e mbajtura, dy i takojnë grupit të profilit të institucionit (mosha dhe madhësia), grupi i shtrirjes (portofoli i kredisë), grupi efikasitetit (shpenzimet operative/aktive, shpenzimet operative/portofolin e kredisë dhe kostoja për huamarrës).

5.4.2. Metoda dhe rezultati i regresionit linear për vetëqëndrueshmërinë operative

Fillimisht u testua përshtatshmëria e modelit para se të procedohej ndikimi i variablave të caktuara në vet-qëndrueshmërinë operative.

Tabela 22. Përmbledhje e modelit

Model Summary				
Model	R	R katror	Rkatrori i rregulluar	Gabimi standard dhe vlerësimi
1	.623 ^a	0.388	0.334	27.83795
a. Predictors: (Constant), SHO_PK, Mosha, KosHuam, LnMADH, ShO_AK, LnBPK				

Burimi: Autori (llogaritur SPSS)

Rezultati nga tabela (22) tregon se R^2 është 0.388 që domethënë se variablat e pavarura mjaftueshëm i shpjegojnë rezultatet e performancës financiare. Si zakonisht, vlera e R^2 nën 0.2 konsiderohet e dobët, midis 0.2 dhe 0.4 është e moderuar, dhe mbi 0.4 është e fortë.

Po ashtu, përshtatshmëria e testimit të modelit u bë edhe përmes tabelës ANOVA, rezultatet e së cilës paraqiten në tabelën vijuese.

Tabela 23. ANOVA modeli

Model	Shuma e katërorve	df	Mesatarja e kateroreve	F	Sig.
1 Regression	32964.2	6	5494.029	7.09	.000 ^a
Residual	51921.8	67	774.952		
Total	84885.9	73			

a. Predictors: (Constant), SHO_PK, Mosha, KosHuam, LnMADH, ShO_AK, LnBPK

b. Dependent Variable: OSS

Burimi: autori (llogaritur SPSS)

Nga tabelë 23 e statistikave ANOVA modeli, sipas të dhënave të përpunuara, të cilat janë parametrat e popullacionit, kanë nivel të signifkancës prej 0.000. Kjo tregon se të dhënat janë të përshtatshme për të shpjeguar hipotezën e ngritur pasi që pasi që vlera e signifkances është (pvalue) me e vogël se 5 përqind.

Në vijim janë paraqitur rezultatet e modelit ekonometrik, të testuar përmes regresionit linear të shumëfishtë. Rezultatet nga regresione linear tregojnë 4 nga 6 variablat e pavarura, siç shihet në tabelën 24, kanë prezencë të prezencë të multikolinearitetit për shkak të lidhshmërisë së lartë në mes tyre, ndërsa vetëm mosha dhe kostoja huamarrëse nuk kanë prezencë të multikoinearitetit.

Tabela 24. Koeficientet e variablave

Model	Koeficientët e pastandardizuar		Koeficientet e standardizuar	t	Rëndësia statistikore	Statistika ekolinearitetit	
	B	Gabimi standard	Beta			Tolerance	VIF
(Constant)	153.544	63.788		2.407	0.019		
Mosha	-4.002	1.117	-0.416	-3.583	0.001	0.677	1.477
KosHuam	-0.034	0.027	-0.136	-1.239	0.22	0.759	1.317
LnMADH	23.483	46.66	0.715	0.503	0.616	0.005	221.22
LnBPK	-21.461	46.331	-0.663	-0.463	0.645	0.004	224.081
ShO_AK	3.887	3.912	0.629	0.994	0.324	0.023	43.946
SHO_PK	-5.185	3.203	-0.997	-1.619	0.11	0.024	41.578

a. Dependent Variable: OSS

Burimi: Autori (llogaritur SPSS)

Pas procedurës së largimit të variablave një nga një, me qëllim të evitimit të prezencës së multikolienaritetit, u vërtetua se variablat në vijim nuk kanë prezencë të multikolinearitetit në mes veti; Mosha, LnMadhsia, Kostoja për huamarrës (KosHuam) dhe ShOp_AK(Shpenzimet Operative/Aktivitet), dhe te cilat u përfshinë në modelin (tabela25)

Tabela 25. Përmbledhje e modelit

Model	R	R katror	Rkatrori I rregulluar	Gabimi standard dhe vlerësimi
1	.599 ^a	0.359	0.321	28.09232
a. Predictors: (Constant), ShO_AK, Mosha, KosHuam, LnMADH				

Burimi: autori (llogaritur SPSS)

Rezultati nga tabela 25, tregon se R^2 është 0.359 që domethënë se variablat e pavarura mjaftueshëm i shpjegojnë rezultatet e performancës financiare. Gjithashtu, përshtatmëria e testimit të modelit u bë edhe përmes tabelës ANOVA, rezultatet e së cilës paraqiten në tabelën vijuese.

Tabela 26. ANOVA modeli

Model	Shuma e katërorve	df	Mesatarja e kateroreve	F	Sig.
1 Regression	30432.6	4	7608.155	9.641	.000 ^a
Residual	54453.3	69	789.178		
Total	84885.9	73			

a. Predictors: (Constant), ShO_AK, Mosha, KosHuam, LnMADH
b. Dependent Variable: OSS

Burimi: autori (llogaritur SPSS)

Rezultatet nga modeli ekonometrik, i paraqitur në vijim sipas tabelës 26, tregojnë se variablat në radhë: Mosha (e cila përfaqëson përvojën e institucionit), dhe Shpenzimet operative mbi aktivet, rezultuan të jenë statistikisht të rëndësishme, megjithatë ndikimi i të dy variablave në performancën financiare të matur me vetëqëndrueshmërinë operative (OSS) është negativ, për shkak të shenjës së koeficientit B(negativ). Përderisa, LnMadh (e matur me vlerën e aktiveve) dhe KosHuam (kostoja për huamarrës) rezultuan të mos jenë statistikisht të rëndësishme pasi që vlera e pvalue>0.05.

Tabela 27. Koeficientet e variablave

Model	Koeficientët e pastandardizuar		Koeficientet e standardizuar	t	Rëndësia statistikore	Statistika ekolinearitetit	
	B	Gabimi standard	Beta			Tolerance	VIF
(Constant)	138.13	62.565		2.208	0.031		
1 Mosha	-3.565	1.097	-0.371	-3.25	0.002	0.715	1.399
LnMADH	2.882	3.889	0.088	0.741	0.461	0.663	1.509
KosHuam	-0.023	0.027	-0.092	-0.854	0.396	0.801	1.249
ShO_AK	-2.283	0.714	-0.37	-3.198	0.002	0.696	1.437

a. Dependent Variable: OSS

Burimi: autori (llogaritur SPSS)

Për të mbajtur në model vetëm variablat që janë statistikisht të rëndësishme me metodën Stepëise të regresionit linear metoda(Hap pas Hapi) në programin SPSS, e cila i nxjerri të tri këto variabla statisikisht të rëndësishme tabela 27 nga e fitojmë koeficientët e variablave për ekuacionin.

Nga rezultati i metodës Stepwise të regresionit linear , paraqesim ekuacionin e fituar, (hapi i dytë) nga tabela 28.

Tabela 28. Koeficientet e variablave për ekuacion

Model	Koeficientët e pastandardizuar		Koeficientet e standardizuar	t	Rëndësia statistikore	Statistika ekolinearitit	
	B	Gabimi standard	Beta			Tolerance	VIF
1 (Constant)	156.468	10.246		15.271	0.000		
ShO_AK	-3.018	0.635	-0.489	-4.752	0.000	1.00	1.000
2 (Constant)	179.738	11.752		15.294	0.000		
ShO_AK	-2.732	0.599	-0.442	-4.563	0.000	0.98	1.020
Mosha	-3.177	0.932	-0.33	-3.408	0.001	0.98	1.020

a. Dependent Variable: OSS

Rezultati tregon se modeli është statistikishtë i rëndësishëm sepse niveli është i rëndësisë statistikore, tabela 28 me pvalue<0.05,në të cilin model na ruhen faktorët: raporti i shpenzimeve operative/aktivet (ShO_AK, 0.000), Mosha (0.001),

$$\text{OSSit} = 179.738 - 2.732 * \text{ShO_AK} - 3.177 * \text{Mosha} + \varepsilon \dots\dots\dots(5)$$

Gjetjet nga modeli i përdorur i regresionit linear tregon se koeficienti i shpenzimeve operative mbi aktivet ishte negativ dhe statistikishtë i rëndësishëm. Edhe nëse të gjitha gjërat mbasin konstante me rritjen e shpenzimeve operative që lidhen me aktivet, vetëqëndrueshmëria operative do të zvogëlohet.

Rezultatet ekonometrike tregojnë se ekziston lidhje negative midis moshës (përvoja e kaluar) dhe vetëqëndrueshmërisë operative, përkundër që është pritur të ketë ndikim pozitiv

në vetëqëndrueshmërinë operative. IMF-të më të vjetra krijojnë shpenzime operative më të larta. Kjo lidhje negative në rastin tonë, mundë të na mbështesi mendimin se me rritjen e shpenzimeve operative, përkundër gjenerimit të ardhurave operative të cilat gjatë viteve të fundit tregojnë trend në rritjen, IMF-te nuk arrijnë të për të mbuluar mjaftueshëm shpenzimet operative. Në këtë rast, përderisa të ardhurat e gjeneruara nuk mbulojnë kushtin për të mbuluar mjaftueshëm shpenzimet operative, menaxhmenti i institucionit sugjerohet të aplikoj metodologji për të kontrolluar në mënyrë më efikase shpenzimet operative të ndodhura brenda vet institucionit.

5.4.3. Metoda dhe rezultati i regresionit linear për kthimin nga aktivet

Fillimisht u testua përshtatshmëria e modelit para se të procedohej ndikimi i variablave të caktuara në kthimin mbi aktivet.

Tabela 29. Përmbledhje e modelit

Model	R	R katror	Rkatorri i rregulluar	Gabimi standard dhe vlerësimi
1	.560 ^a	0.313	0.252	6.565
a. Predictors: (Constant), KosHuam, Mosha, SHO_PK, LnMADH, ShO_AK, LnBPK				

Burimi: Autori (llogaritur SPSS)

Rezultati nga tabela 29, tregon se R^2 është 0.313 që domethënë se variablat e pavarura mjaftueshëm i shpjegojnë rezultatet e performancës financiare. Si zakonisht, vlera e R^2 nën 0.2 konsiderohet e dobët, midis 0.2 dhe 0.4 është e moderuar, dhe mbi 0.4 është e fortë.

Po ashtu, përshtatshmëria e testimit të modelit u bë edhe përmes tabelës ANOVA, rezultatet e së cilës paraqiten në tabelën e ANOVA.

Tabela 30. ANOVA modeli

Model	Shuma e katërorve	df	Mesatarja e kateroreve	F	Sig.
1 Regression	1318.366	6	219.728	5.098	.000 ^a
Residual	2887.648	67	43.099		
Total	4206.014	73			
a. Predictors: (Constant), KosHuam, Mosha, SHO_PK, LnMADH, ShO_AK, LnBPK					
b. Dependent Variable: ROA					

Burimi: autori (llogaritur SPSS)

Nga tabelë30, ANOVA modeli, sipas të dhënave të përpunuara, të cilat janë parametrat e popullacionit, kanë nivel të signifkancës prej 0.000. Kjo tregon se të dhënat janë të përshtatshme për të shpjeguar hipotezën e ngritur pasi që pasi që vlera e signifkances është (pvalue) me e vogël se 5përqind.

Në vijim janë paraqitur rezultatet e modelit ekonometrik, të testuar përmes regresionit linear të shumëfishtë. Rezultatet nga regresione linear tregojnë 4 nga 6 variablat e pavarura, siç shihet kanë prezencë të prezencë të multikolinearitetit për shkak të lidhshmërisë së lartë në mes tyre, ndërsa vetëm mosha dhe kostoja huamarrëse nuk kanë prezencë të multikolinearitetit(tabela 31)

Tabela 31. Koeficientet e variablave

Model	Koeficientët e pastandardizuar		Koeficientet e standardizuar	t	Rëndësia statistikore	Statistika ekolinearitetit	
	B	Gabimi standard	Beta			Tolerance	VIF
1 (Constant)	-14.863	15.043		-0.988	0.327		
Mosha	-0.895	0.263	-0.418	-3.398	0.001	0.677	1.477
LnMADH	4.813	11.004	0.659	0.437	0.663	0.005	221.22
LnBPK	-3.008	10.926	-0.417	-0.275	0.784	0.004	224.081
ShO_AK	-0.228	0.923	-0.166	-0.248	0.805	0.023	43.946
SHO_PK	-0.135	0.755	-0.117	-0.179	0.859	0.024	41.578
KosHuam	-0.002	0.006	-0.032	-0.272	0.787	0.759	1.317
a. Variabla e varur: ROA							

Burimi: Autori (llogaritur SPSS)

Pas procedurës së largimit të variablove një nga një, me qëllim të evitimit të prezencës së multikolienaritetit, u vërtetua se variablat në vijim nuk kanë prezencë të multikolienaritetit në mes veti; Mosha, LnMadhsia, Kostoja për huamarrës dhe ShOp_AK.

Tabela 32. Përmbledhje e modelit

Model	R	R katror	Rkatrori i rregulluar	Gabimi standard dhe vlerësimi
1	.559 ^a	0.313	0.273	6.47281
a. Predictors: (Constant), ShO_AK, Mosha, KosHuam, LnMADH				

Burimi: autori (llogaritur SPSS)

Rezultati nga tabela32, tregon se R^2 është 0.313 që domethënë se variablat e pavarura mjaftueshëm i shpjegojnë rezultatet e performancës financiare. Gjithashtu, përshtatmëria e testimit të modelit u bë edhe përmes tabelës ANOVA, rezultatet e së cilës paraqiten në tabelën vijuese.

Tabela 33. ANOVA modeli

Model	Shuma e katërorve	df	Mesatarja e kateroreve	F	Sig.
1 Regression	1315.1	4	328.775	7.847	.000 ^a
Residual	2890.92	69	41.897		
Total	4206.01	73			
a. Predictors: (Constant), ShO_AK, Mosha, KosHuam, LnMADH					
b. Dependent Variable: ROA					

Burimi: autori (llogaritur SPSS)

Rezultatet nga modeli ekonometrik, i paraqitur në vijim si në tabelën 33, tregojnë se variablat në radhë: Mosha (e cila përfaqëson përvojën e institucionit), Ln Madhësia (e matur me vlerën e aktiveve) dhe Shpenzimet operative mbi aktivet, rezultuan të jenë statistikisht të rëndësishme, pasi vlerat e tyre bien në intervalin p-value <0.5. Mirëpo ndikimi i moshës dhe shpenzimeve operative mbi aktivet është negativ në performancën financiare e matur me kthimin ndaj aktiveve, për shkak të shenjë negative të koeficientit

B, ndërsa madhësia e matur me vlerën e aktiveve ka ndikim pozitiv në kthimin ndaj aktiveve(ROA).

Mbetet kostoja për huamarrës e cila rezulton jostatistikisht e rëndësishëm (0.778) për performancën financiare të matur me vlerën e aktiveve, pasi vlera e pvalue >0.05.

Tabela 34. Koeficientet e variablave

Model		Koeficientët e pastandardizuar		Koeficientet e standardizuar	t	Rëndësia statistikore	Statistika ekolinearitetit	
		B	Gabimi standard	Beta			Tolerance	VIF
1	(Constant)	-14.22	14.416		-0.986	0.327		
	Mosha	-0.886	0.253	-0.414	-3.504	0.001	0.715	1.399
	LnMADH	1.794	0.896	0.246	2.003	0.049	0.663	1.509
	KosHuam	-0.002	0.006	-0.032	-0.283	0.778	0.801	1.249
	ShO_AK	-0.394	0.164	-0.286	-2.395	0.019	0.696	1.437
a. Dependent Variable: ROA								

Për të mbajtur në model vetëm variablat që janë statistikisht të rëndësishme me metodën Stepwise të regresionit linear metoda(Hap pas Hapi) ,në programin SPSS, e cila i nxjerri të tri këto variabla statisikisht të rëndësishme(tabela 35) prej nga dalin koeficientët e variablave për ekuacionin.

Tabela 35. Koeficientet e variablave për ekuacion

Model		Koeficientët e pastandardizuar		Koeficientet e standardizuar	t	Rëndësia statistikore	Statistika ekolinearitetit	
		B	Gabimi standard	Beta			Tolerance	VIF
1	(Constant)	9.072	2.357		3.849	0		
	ShO_AK	-0.595	0.146	-0.433	-4.07	0	1	1
2	(Constant)	13.66	2.761		4.947	0		
	ShO_AK	-0.538	0.141	-0.391	-3.825	0	0.98	1.02
	Mosha	-0.626	0.219	-0.293	-2.859	0.006	0.98	1.02
3	(Constant)	-14.756	14.197		-1.039	0.302		
	ShO_AK	-0.412	0.151	-0.299	-2.725	0.008	0.815	1.228
	Mosha	-0.891	0.25	-0.416	-3.556	0.001	0.718	1.393
	LnMADH	1.811	0.888	0.248	2.039	0.045	0.666	1.502

a. Dependent Variable: ROA

Nga rezultati i metodës Stepwise “ Hap pas Hapi” të regresionit linear, paraqesim ekuacionin e fituar, (hapi i tretë) nga tabela 35. Rezultati tregon se modeli është statistikisht i rëndësishëm sepse niveli është i rëndësishëm statistikore, tabela17 me $pvalue < 0.05$, në të cilin model na ruhen faktorët: raporti i shpenzimeve operative/aktivet (ShO_AK, 0.008), Mosha(0.001), dhe madhësia e matur me vlerën e aktiveve (LnMadh,0.045). Nga tabela vërehet se konstanja nuk është signifikante, pasi rezulton me $pvalue = 0.302$, dhe për këtë rast modelin e përshkruajmë duke e përjashtuar konstante. Këtu përdorim vlerat e koeficienteve të standardizuar (Z) e cila tregon e standardizuar, pasi është përjashtuar konstanta, ndryshe quhet si metoda OLS –ordinary least squares metoda.

$$ROA_{it} = -0.299*(ZShO/AK) - 0.416*(ZMosha) + 0.248*(ZLnMadh) + \varepsilon \quad (6)$$

Gjetjet nga regresioni linear treguan, një lidhje negative midis raportit të shpenzimeve operative mbi aktivet (ShO_AK) me kthimit nga aktivet(ROA). Lidhje negative ekziston edhe midis moshës (përvoja e operimit) me faktorin e performancës të matur me kthimin mbi aktivet(ROA), e cila nuk ishte e pritur, megjithatë mundë të shpjegohet se me kalimin e viteve rezulton rritje më e shpejtë e shpenzimeve në krahasim me të hyrat e gjeneruara e cila mundë të ndikoj ulje e performancës me vitet e ardhshme. Ashtu siç ishte pritur rezultati tregon lidhje pozitive midis madhësisë (LnMadhësia) e matur me vlerën e aktive, e cila tregon se IMF-të duhet të sigurojnë rritje të vlerës së aktiveve me qëllim që të rezultojnë fitimprurës.

Nga dy modelet e regresionit të përdorur në këtë punim, rezultatet sugjerojnë se institucionet mikrofinanciare ne Kosovë janë duke u ballafaquar probleme për të arritur performancë financiare ne dy drejtime, të vetëqëndrueshmëris operative dhe kthimi mbi

aktivet. Si është bërë e ditur vetëqëndrueshmëria operative(OSS) fokusohet të kuptojë nëse IMF-ja ka arritur shkallën e duhur për të vazhduar operimin, duke mos u mbështetur nga subvencione të mëtejshme. Kthimi nga aktive (ROA) është matës i përgjithshëm i përfitueshmërisë i cili pasqyron margjinën e fitimit dhe efikasitetit të institucionit, ose është siç theksohet është matës se si institucioni përdor të gjitha aktivet(pasurinë) e saj.

Për të dalë me përfundime më të rëndësishme në vazhdim do të zhvillojmë regresionin logjistik binar për të matur ndikimin e variablave të përzgjedhura në variablën e vetëqëndrueshmëris operative (OSS) dhe kthimin nga aktivet (ROA).

5.4.4. Metoda dhe rezultatet e regresionit logjistik binar

Në këtë punim është përdorur edhe metoda e regresionit logjistik binar me qëllim që të matet ndikimi i variablave të pavarura për mundësinë e ndodhjes së rezultatit të variablës së varur. Te regresioni logjistik binar janë marrë për trajtim vetëm variablat që dolën të kenë ndikim statistikisht të rëndësishme në vetëqëndrueshmërinë operative (OSS) dhe kjo për arsye që të matet ndikimi apo mundësitë.

Te metoda e regresionit logjistik, variablat e përdorura janë variabla diskrete. Kështu, nëse Vetë qëndrueshmëria operative (OSS) është “nën nivelin e arritur te 100%” e përfaqësuar nga 37 vrojtime ajo është koduar me “0” dhe kur vetë qëndrueshmëria (OSS) ka arritur “nivelin 100% dhe mbi 100% ” është koduar me 1 e cila në rastin tonë është e përfaqësuar nga 57 vrojtime.

Testi e kalon vlerfshmërinë për futjen e këtyre variablave në model, pasi që ka një Chi-square të lartë 12.113 dhe nivel të rëndësisë statistikore të rëndësishëm që është p-value =

0.002 e që është $p \text{ value} < 0.05$. Variablat në ekuacion e shpjegojnë me një variancë prej 14.2 deri 19.5 përqind nivelin e OSS .

Tabela 36. Koeficientet e variablave për ekuacion

Variablat ne ekuacion							
		B	S.E.	Wald	df	Sig.	Exp(B)
Step 1 ^a	Mosha	-0.081	0.071	1.303	1	0.254	0.923
	ShO_AK	-0.137	0.051	7.212	1	0.007	0.872
	Constant	3.479	1.056	10.848	1	0.001	32.424

a. Variable(s) entered on step 1: Mosha, ShO_AK.

Pas procedimit të regresionit logjistik, vërehet se vetëm raporti shpenzimeve operative ndaj aktiveve kanë ndikim statistikisht të rëndësishme, i cili është negativ, ndërsa mosha nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në vetëqëndrueshmërinë operative (OSS). Nëse shikohet B e pritur - Exp (B), e cila tregon pritjet e ndryshimit të variablas së varur nga variabla e pavarur, atëherë mund të thuhet se rritja e raportit ShO_Ak për 1 njësi do të ndikoj në rritjen e nivelit të vetëqëndrueshmërinë operative (OSS) për 0.872, që tregon performanceën negative të OSS pasi që nga ky ndryshim koeficienti është më i vogël se 1.

Sikurse në rastin e matjes se vetëqëndrueshmërisë operative (OSS), edhe në procedimi i regresionit logjistik binar të kthimit nga aktivet (ROA), u zgjodhën të përfshihen në model vetëm variablat që ishin statikisht të rëndësishme, mosha dhe ShO_Ak, dhe kjo për arsytet që të matet ndikimi apo mundësitë.

Edhe në këtë rast, variabla (ROA) është variabël diskret dhe tregon nëse një njësi e analizës ka pasur rezultat të kthimit nga aktivet (ROA-së) negativ ose pozitiv për një. Nëse ROA është “jo-fitimprurëse-negative” ajo është koduar me “0”e përfaqësuar me 31 vrojtime

dhe e kundërta kur ROA është “fitimprurëse –pozitive” është koduar me “1” e përfaqësuar me 52 vrojtime.

Tabela 37. Testet e vlefshmërisë të koeficienteve të modelit

		Chi-square	df	Sig.
Step 1	Step	13.247	3	0.004
	Block	13.247	3	0.004
	Model	13.247	3	0.004

Nga rezultati i gjeneruar, sipas tabelave, sado që modeli i regresionit logjistik e kaloi testin e vlefshmërisë së procedimit faktori Chi Square është mjaft i lartë 13.247 (tabela 37) dhe rëndësia statistikore $p < 0.05$, dhe po ashtu përqindja e përgjithshme korrekte e vrojtimeve prej 72.2 %, (tabela 38)

Tabela 38: Përqindja e përgjithshme e vrojtimeve

Observed			Predicted		
			STROA		Percentage Correct
			Negative	Pozitive	
Step 1	STROA	Negative	13	16	44.8
		Pozitive	6	44	88
	Overall Percentage				72.2
a. The cut value is .500					

megjithatë asnjëra nga variablat e pavarura të ekuacionit nuk rezultuan të kenë ndikim statistikisht të rëndësishëm në variabëlin e varur-ROA (tabela 39).

Tabela 39. Variablat ne ekuacion

Variables in the Equation							
		B	S.E.	Wald	df	Sig.	Exp(B)
Step 1 ^a	Mosha	-0.148	0.086	2.955	1	0.086	0.863
	LnMADH	0.588	0.314	3.512	1	0.061	1.8
	ShO_AK	-0.074	0.053	1.959	1	0.162	0.929
	Constant	-6.291	4.933	1.626	1	0.202	0.002
a. Variable(s) entered on step 1: Mosha, LnMADH, ShO_AK.							

5.5. Përmbledhje e rezultatit të regresionit

Analiza e regresionit linear dhe regresionit logjistik binar, tregoi faktorët që e ndikojnë performancën financiare sipas hipotezës së ngritur në këtë punim, të cilën e rikujtojmë në vijim.

Hipoteza1. *Mosha e institucionit, madhësia, faktorët e shtrirjes dhe të efikasitetit janë të rëndësishëm për performancën financiare e përfaqësuar përmes;*

1.1. vetëqëndrueshmërisë operative (OSS) dhe

1.2. kthimit mbi aktivitet (ROA)

Fillimisht në këtë punim u tentua që hipoteza e ngritur të testohet në tri drejtime; vetëqëndrueshmëria operative (OSS), kthimi nga aktivet (ROA) dhe kthimi nga kapitali (ROE). Megjithatë kur disa nga variablat e pavarura (shpjeguese) dolën me multikolinearitet zakonisht diku nga katër (4) dhe kur u larguan “numri i huamarrësve aktiv” dhe “madhësia mesatare e kredisë” u largua multikolineariteti në dy variabla të tjera (Ln portofoli bruto i e kredisë dhe kostoja për kredi), kështu te kthimi nga aktivet (ROA) dhe vetëqëndrueshmëria operative (OSS) modeli vazhdoi të mbetet signifikant ndërsa tek kthimi nga kapitali (ROE), variabël me multikolinearitet atëherë modeli nuk kalonte testin e signifikances. Përmes testit të normalitetit sipas Kolmogorov-Smirnova dhe Shapiro-Wilk u mbajtën vetë ato variabla shpjeguese që rezultuar të kalojnë testin e normalitetit.

Përmes regresionit linear dhe regresionit logjistik binare, përfituam faktorët që ndikuan në performancën financiare të përfaqësuar me vetëqëndrueshmërinë operative dhe kthimi nga aktivevet. Duke përmbledhur rezultatet e dy modeleve të regresionit logjistik, mund të konkludohet se vetëm raporti i shpenzimeve operative mbi aktivet (ShO_Ak) ishte

statistikishtë i rëndësishëm në raport me vetëqëndrueshmërinë operative (OSS) të IMF –ve që operojnë në Kosovë, dhe ndikim i të cilës ishte negativ. Raporti i shpenzimeve operative ndaj aktiveve, tregojnë koston e nevojshme për IMF për të operuar me një njësi të aktiveve të saj. Konsiderohet se këtu është burimi i performancës së dobët financiare të IMF, ose menaxhimi jo i mirë i shpenzimeve operative. Ky ndikim negativ i shpenzimeve operative duket se reflekton që edhe mosha të ketë ndikim negativ e cila doli të jetë statistikisht e rëndësishme përmes regresionit linear të OSS dhe ROA. Po të analizohen mosha në kushte normale si variabël e pavarur e izoluar, do të pritej të kishte ndikim pozitiv për shkak se me bërjen e përvojës, IMF do të funksionin më mirë. Duke qenë se ekziston ndikimi negativ i shpenzimeve operative ndaj aktiveve, si në raport me vetëqëndrueshmërinë operative (OSS) dhe kthimin nga aktivet (ROA), me kalimin e viteve veç se i thellon problemet financiare të IMF-ve. Në raste të tjera siç thekson Robinson(2001) IMF në fazën e pjekurisë mundë të arrijnë qëndrueshmëri dhe shtrirje tek të varfëritë. Rezultate me ndikimi pozitiv të moshës në performancën i gjejmë nga Kipasha (2013), Cull et al (2005) sipas së cilit mosha e institucionit ka lidhje signifikante dhe pozitive me performancën financiare edhe tek të tri faktorët (FSS, OSS dhe AROA). Përderisa në raport me vetëqëndrueshmërinë operacionale sipas Nyamsogoro(2010) mosha nuk ka lidhje signifikante, ngjashëm gjejmë edhe Rahman & Mazlan (2014) kur masin lidhjen me vetëqëndrueshmërinë financiare (FSS).

Rritja e nivelit të aktiveve (Kipasha,2013:111) e ndikon rritjen e efikasitetit, qëndrueshmërisë dhe të ardhurave të institucionit mikrofinanciar. Dhe pasi që variabla shpjeguese $\ln \text{Madhësia}$ e matur nga aktivet doli të jetë statistikisht e rëndësishme, atëherë

për të zbutur problemin e shpenzimeve operative nga aktive, sugjerohet të rriten aktivet e IMF-ve përmes huazimeve financiare, por në anën tjetër duhet të shtohet kujdes që këto huazime të përdoren me efikasitet, të mos shkojnë në shpenzime të panevojshme operative, por të përdoren në aktive fitimprurëse siç janë kredithënia, të cilat do të ktheheshin me rritje të aktiveve për shumën e interesit që arkëtohet nga kreditë e lejuara.

Sipas, Nyamsongoro(2010; Mersland and Strom,2009; Bogan 2008) madhësia e IMF është e rëndësishme dhe pozitivisht e lidhur me qëndrueshmërinë financiare. Të kundërtën e thekson Hartarska(2005) e nënvizuar nga Nyamsongoro(2010). Për më shumë, thekson Nyamsongoro(2010) madhësia e IMF lë të kuptohet që IMF e mëdha kanë kapital të madh dhe prandaj mund të arrijnë numër më të madh të klientëve se ato IMF më të vogla, i cili theks është mbështetur nga Kyereboah-Coleman and Osei (2008).

5.6. Përmbledhje e kapitullit

Realizimi i intervistave përmes pyetësorit të ndërtuar për këtë punim tregoi mbështetje mbi shumicën e faktorëve që fillimisht ishin përzgjedhur për të vlerësuar performancën financiare të IMF-ve në Kosovë, të cilat shërbyen për të vazhduar me studim të këtij punimi. Rezultati tregoi karakteristikat e përgjithshme të institucioneve duke theksuar sfidat dhe problemet me të cilat IMF-të në Kosovë ballafaqohen. Sfidë mbetet mungesa e ligjit e cila do të përcaktonte qartë funksionimin e IMF-të ishte një ndër çështjet e theksuar nga disa të intervistuarve që ishin pjesë e pyetësorit. Statistikat përshkruese treguan mesataren dhe rëndësinë e secilit faktorë veç e veç të cilat u realizuan në program të SPSS. Tabelat e kryqëzuara treguan dallimet midis karakteristikave të IMF-ve sipas statusi që ato operojnë, të cilat favorizuar IMF- IFJB në krahasim me IMF-OJQ, sipas të

dhënave të raportuara në MIX. Rezultatet e korrelacionit treguan lidhje te forta midis variablave të varura me variablat shpjeguese si dhe marrëdhënien midis variablave shpjeguese veç e veç. Rezultate treguan se të variablat e varura, midis tyre si përfaqësues të performancës financiare, treguar lidhje te fortë të korrelacion. Lidhje te fortë korrelative treguan përfaqësuesit e performancës financiare me faktorët e efikasitetit dhe jo me faktorët e shtrirje, përderisa pjesërisht ishte në korrelacion me faktorë të profilit të institucionit siç ishte mosha dhe madhësia (e matur me vlerën e aktiveve)

Rezultatet e regresionit linear dhe regresionit logjistik binar paraqitën se problemi kryesor për të arritur vetëqëndrueshmëri operative dhe kthim nga aktivet janë shpenzimet operative mbi aktivet. Pra, gjetjet tona në këtë punim, në masën më të madhe tregojnë se IMF-të duhet të jenë të fokusuara më shumë në shpenzimet operative me theks mbi ato që ndikojnë zvogëlimin e aktiveve. Rritja e efikasitetit ndaj shpenzimeve do të ndikojë në shtrirjen më të gjerë dhe njëkohësisht në arritjen e misionit të synuar nga IMF-të.

Dhe përderisa, faktorët e shtrirjes (portofoli i kredisë, numri aktiv i huamarrësve, femrat huamarrëse) faktorët e efikasitetit (shpenzimet operative/portfolin e kredisë, shpenzimet e personelit/portfolin e kredisë, koston për huamarrës) nuk u paraqitën faktorë të rëndësishëm për performancën financiare të përfaqësuar nga vetëqëndrueshmëria operative dhe kthimi nga aktivet.

Si përfundim duke u referuar gjetjeve në këtë punim, sugjerohet që në punimet në të ardhmen analiza të zgjerohet si në vite gjithashtu edhe në faktorë të tjerë të cilët nuk patën mundësinë të jenë pjesë e këtij studimi.

KAPITULLI VI. PËRMBLEDHJE, KONKLUZIONE, REKOMANDIME DHE KUFIZIMET E PUNIMIT

Për të paraqitur konkluzionet nga analizat e zhvilluara në këtë punim, është e rëndësishme që fillimisht të paraqesim një përmbledhje nga literatura e gjerë e shqyrtuar mbi këtë temë.

Mikrofinanca me misionin për luftimin e varfërisë, historikisht tregoi se ka gjetur mbështetje nga subvencione, donatorë, investitorë dhe gjithashtu donacione qeveritare ku ajo është zhvilluar. Institucionet mikrofinanciare fillimisht janë themeluar me idenë për të financuar kategori të njerëzve më të varfër, që ata të mbijetojnë dhe të zhvillohen, që më vonë këto institucione të bëhen pjesë e rëndësishme dhe kontribuese e sistemit financiar në ato vende ku ato operojnë. Donatorët, investitorët, qeveritë dhe menaxhmenti i institucioneve interesohen që përmes ofrimit të shërbimeve mikrofinanciare, të arrijnë performancë të suksesshme dhe qëndrueshmëri më afatgjate, me tendencë për të operuar të pavarura në të ardhmen, gjë që e rritë interesimin për përcaktimin e faktorëve përcaktues të performancës financiare të IMF-ve. Interesimi dhe zgjerimi i mikrofinancës rezulton me ballafaqim të teorive e paraqitur midis dy shkollave të mendimit ekonomik mbi matjen e qëndrueshmërisë financiare të IMF-ve. E para “Ekonomistëve Institucionalistë” dhe e dyta “Ekonomistëve të Mirëqenies”, për nga prioriteti i caktuar që ato diskutojnë duken të jenë kontradiktore, megjithatë qëllim të përbashkët kanë luftimin e varfërisë përmes zgjerimit sa më të madh të qasjes në shërbime financiare.

Studimi i performancës financiare të IMF-ve do të lindë si nevojë e domosdoshme për të nxjerrë në pah nëse këto institucione do të duhet vazhdimisht të jenë të mbështetura në

subvencione ose edhe këto një ditë do të operojnë të pavarura nga këto subvencione pasi që të kenë kaluar në fazën e tretë të operimit.

Punime të shumta mbi përcaktimin e faktorëve përcaktues të performancës financiare të IMF-ve janë publikuar me rezultatet të ndryshme, varësisht nga grupi i faktorëve të performancës që janë marrë për studim. Rezultatet mbi ndikimi i faktorëve përcaktues në performancën financiare ndryshon nga vendi dhe koha kur IMF-të operojnë, përderisa në Kosovë nuk ekziston një punim i ngjashëm.

Identifikimi i faktorëve përcaktues të performancës financiare i cili është qëllimi kryesor i këtij punim, është bazuar në shqyrtim të literaturës, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Te dhënat primare shërbyen si udhëzim për të vazhduar me punimin përderisa përdorimi i të dhënave dytësore nga platforma e mirënjohur e MIX për IMF-të që operojnë në Kosovë, shërbyen për të nxjerrë konkluzione dhe për dhënë rekomandime për punime dhe palë të interesuar në të ardhmen.

6.1. KONKLUSIONE

Rezultatet e nxjerra nga analiza e regresionit linear dhe regresionit logjistik binar, mund të mos jenë ato të priturat, pasi që ndikimi i faktorëve në performancë financiare e IMF-ve është pritur të jetë e sqaruar nga më shumë faktorë të rëndësishëm. Gjithsesi ky punim është zgjeruar edhe në analiza të tjera për të krijuar një pasqyrë më të qartë të operimit të IMF-ve që operojnë në Kosovë, për të cilat konkluzionet në vijim janë paraqitur:

- Nga intervistat e realizuara përmes pyetësorit të ndërtuar në këtë punim, mesatarja e arritur 3.94 tregoi se faktorët e përzgjedhur janë të rëndësishëm, përmes së cilëve

mund të matet ndikimi në performancë financiare, e që ishte qëllimi kryesor i këtij punimi. Megjithatë jo të gjithë faktorët e marrë për studim arrijnë të na mbështesin hipotezën e ngritur në këtë punim, shumica e të cilëve u përfshinë në model dhe u diskutua rëndësia e tyre. Kjo sipas autorit mbetet një mundësi për studim në të ardhmen, nëse do të mund të sigurohen të dhëna më të plota për periudhë më të gjatë kohore, e cila u paraqit kufizim në këtë punim.

- Të gjitha IMF-të që operojnë në Kosovë, janë të orientuara në kreditim. Marrja e kredive të këto institucione, karakterizohet për procedurë të shpejta dhe pagesa e kredive mund të bëhet edhe në frekuenca afatshkurtra, çka edhe i bënë më me interes këto institucione. Kreditë e ofruara nga IMF-të fillojnë nga 100 Euro dhe shkojnë deri në vlerën 25 mijë Euro. Si rrjedhojë IMF-të në Kosovë janë duke e zgjeruar aktivitetin e tyre drejt rritjes qasjes për klientët që nuk janë të shërbyer nga bankat tregtare vendore, pavarësisht që këto institucione kanë normën e interesit të lartë në krahasim me bankat. Norma e interesit sipas të dhënave sillet rreth 22% e cila theksohet të jetë e krahasueshme me vendet fqinje që zhvillojnë sektorin e mikrofinancës. Kjo mbetet një temë e rëndësishme për të cilën ndaj mendimin se duhet studiuar në të ardhmen duke e trajtuar normën e interesit si një faktorë i rëndësishëm për operim të IMF-ve në Kosovë. Kjo normë e lartë e interesit argumentohet nga ndikimi i dy faktorëve:

- a. risku i lartë me të cilin ballafaqohet aktiviteti huadhënës i IMF-ve që operojnë me mikrobiznesin dhe kreditë për ekonomitë fermere dhe
- b. kostoja e lartë e huamarrjes që IMF-të sigurojnë nga donatorët.

- Sfiduese sipas të anketuarve në këtë punim, mungesa e një kornize më të mirë ligjore (Status jo i qartë I IMF-ve), konkurrenca në treg, zhvillimet e shpejta në teknologji dhe adaptimi me këto zhvillime, komercializimi, nevoja për trajnim dhe punësim të stafit profesional në segmente të caktuar, kërkesat shtrënguese të BQK-se të cilat konsiderohen se janë elemente shtesë që implikojnë shpenzime shtesë në përmbushjen e të gjitha ligjeve dhe rregulloreve të cilat janë shpenzime të mëdha dhe të vështira për IMF-të të sigurohen.
- Analiza e trendit të faktorëve tregoi se prezenca e IMF-ve në Kosovë, është e rëndësishme për sistemin financiar duke kontribuar në vlerën e përgjithshme të kredithënies, dhe në anën tjetër si rezultat i rritjes së vlerës së aktiveve IMF-të kanë vazhduar të jetë i përqendruara në financimin e bizneseve të vogla dhe ekonomive familjare, të cilat kategori nuk konsiderohet potencial për bankat vendore, pasi që këto shihen si rrezik për portofolin e tyre kreditore. Analizat e mëtejshme treguan se vlera e aktiveve gjatë vitit 2016 paraqet rritje për 23.32 për qind në krahasim me vitin 2015, në të cilin viti vlera e aktiveve kishte arritur në 118.91 milion euro (6.11 përqind më shumë se në vitin 2014). Struktura e aktiveve e raportuar vazhdon të dominohet nga kreditë bruto, pasuar me lizingjet financiare (produkte këto së fundi të ofruara nga disa IMF). Kreditë për ekonomi familjare përfaqësojnë rreth 67 për qind të gjithsej kredive të sektorit, të pasuara nga kreditë për ndërmarrje, 33 për qind.
- Rezultatet nga statistikat përshkruese tregojnë se institucionet mikrofinanciare kanë arritur në mesatare 8.10 vitet te operimit dhe në maksimale arrijnë në 16 vite. IMF-të në Kosovë janë duke operuar në fazën e pjekurisë e cila mund të konsiderohet përvojë

e konsiderueshme për të arritur aftësinë për të vetëqëndrueshmëri operative dhe rritje te performancës së përfitueshmërisë.

- Në mesatare IMF-të treguan se kanë arritur vetëqëndrueshmëri operative në nivel 106 përqind. Vetëqëndrueshmëri operative më të lartë treguan IMF-IFJB (111%) përderisa IMF-OJQ treguan 104%, përkundër që ishin të përfaqësuar me numër më të madh të vrojtimeve në këtë punim. Megjithatë ekzistojnë IMF të cilat nuk arrijnë vetëqëndrueshmëri operative ose ekzistojnë IMF- me probleme financiare për të cilën arsye do të mbyllin aktivitetin e tyre në Kosovë.
- Statistikat përshkruese, tregojnë se IMF-të që operojnë në Kosovë, në mesatare nuk janë fitimprurëse duke u bazuar në mesataren negative të ROA (-1.2858). Në anën tjetër nga krahasimi midis statusit të IMF-ve, vërehet se IMF- IFJB të cilat në mesatare rezultati i ROA ishte pozitiv (1.3776), e cila tregon se këto institucione kanë rritur fokusin në rritje të fitimit përderisa ato IMF-OJQ të cilat mbasin me mesatare negative të ROA (-2.4338), mund të thuhet se ende mbasin në fokus të shërbimet të klientëve të varfër. Ky dallim kërkon një studim më të thellë cili do të fokusohet më shumë në krahasimin e metodologjisë së operimit midis dy tipave të IMF-ve.
- Sipas rezultateve nga statistikat përshkruese mesatarja e kredisë është 2114.24 dollarë, që tregon se IMF-të në Kosovë ofrojnë kredi më shumë klientëve që nuk janë shumë të varfër. Sipas tabelës së mesatareve midis IMF-ve me status të ndryshëm, IMF-IFJB arrijnë mesatare 2057.31 dhe për IMF-OJQ ishte 2262.28.
- Analiza e korrelacionit tregon, se përveç faktorët e efikasitetit (raporti i shpenzimeve operative/aktivet, shpenzimet operative/portofolin e kredisë, shpenzimet e personelit /

porofolin e kredisë dhe kostoja për huamarrës) që janë në korrelacion të fortë në drejtim negativ(rëndësi statistikore 1 përqind) me vetëqëndrueshmërinë operative, të tjerë faktorë nuk kanë lidhje korrelative me vetë qëndrueshmëri operative.

- Në të njëjtin drejtim ekziston lidhja midis kthimit mbi aktivet me faktorët e efikasitetit, duke shtuar lidhjen me rëndësi statistikore që ekziston midis kthimit nga aktivet (ROA) dhe moshës (rëndësi statistikore 5 përqind) në drejtim negativ dhe portofolin e kredisë në drejtim pozitiv.

Për të përmbyllur konkluzionet për këtë punim që për qëllim kishte identifikimin e faktorëve më të rëndësishëm që e ndikojnë performancën financiare të IMF-ve në Kosovë, rezultatet nga testimi i hipotezës kryesore janë paraqitur si me poshtë:

Hipoteza1. *Mosha e institucionit, madhësia, faktorët e shtrirjes dhe të efikasitetit janë të rëndësishëm për performancën financiare e përfaqësuar përmes;*

1.1 vetëqëndrueshmërisë operative (OSS);

- Variablat e pavaruara të përfshira në model të regresionit linear e shpjegojnë performancën financiare me R^2 është 0.388 (38%) të përfaqësuar me vetëqëndrueshmërinë operative (OSS).
- Mosha (e cila përfaqëson përvojën e institucionit), rezultoi të jetë statistikisht e rëndësishme, megjithatë ndikimi ishte negativ në drejtim të arritjes së vetëqëndrueshmërisë operative.
- Shpenzimet operative mbi aktivet, rezultoi të jetë statistikisht e rëndësishme edhe ky faktorë ishte me shenjën e koeficientit B (negativ).

- Përderisa, LnMadh (madhësia e matur me vlerën e aktiveve) dhe KosHuam (kostoja për huamarrës) rezultuan të mos jenë statistikisht të rëndësishme pasi që vlera e $pvalue > 0.05$ në raport me vetëqëndrueshmërinë operative (OSS).
- Ne anën tjetër, modeli regresioni logjistik linear nxjerrë me rëndësi statistikore vetëm shpenzimet operative ndaj aktiveve, përderisa mosha nuk ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në vetëqëndrueshmërinë operative (OSS).

1.2 Kthimit ndaj aktiveve (ROA)

- Variablat e pavaruar të përfshira në model të regresionit linear e shpjegojnë performancën financiare me R^2 është 0.313 (31%) të përfaqësuar me kthimin nga aktivet (ROA).
- Si rezultat i regresionit linear, ekziston lidhje negative midis raportit të shpenzimeve operative mbi aktivet (ShO_AK) me kthimit nga aktivet.
- Lidhje negative ekziston edhe midis moshës (përvoja e kaluar) me kthimin nga aktivet, e cila nuk ishte e pritur, megjithatë mund të shpjegohet se me kalimin e viteve rezulton rritje më e shpejtë e shpenzimeve në krahasim me të hyrat e gjeneruara e cila mund të ndikojë ulje e performancës me vitet e kaluara.
- Ashtu siç ishte pritur rezultati tregon lidhje pozitive midis madhësisë (LnMadh) e matur me vlerën e aktive, e cila tregon se IMF-të duhet të sigurojnë rritje të vlerës së aktiveve me qëllim që të rezultojnë me perfitueshmëri.
- Nga rezultati i gjeneruar, sado që modeli i regresionit logjistik e kaloi testin e vlefshmërisë së procedimit pasi që faktori Chi Square është mjaft i lartë 13.247 dhe rëndësia statistikore $p < 0.05$, dhe po ashtu përqindja e përgjithshme korrekte e

vrojtimeve prej 72.2 %, megjithatë asnjëra nga variablat e pavarura të ekuacionit nuk rezultuan të kenë ndikim statistikisht të rëndësishëm në variablën e varur kthimin nga aktivet (ROA).

Nga këto rezultate konkludojmë se ndikimi negativ i shpenzimeve operative mbi aktiveve, në performancën financiare të IMF-ve të përfaqësuar me vetëqëndrueshmërinë operative (OSS) dhe kthimin nga aktivet (ROA), me kalimin e viteve veç se i thellon problemet financiare dhe meqenëse madhësia e matur me vlerën e aktiveve nga doli të jetë statistikisht e rëndësishme, atëherë për të zbutur problemin e shpenzimeve operative, duhet të rriten aktivet e IMF-ve përmes huazimeve financiare.

Nga ana tjetër duhet të shtohet kujdes që këto huazime të përdoren me efikasitet, të mos shkojnë në shpenzime të panevojshme operative (të rishikohen shpenzimet operative, administrative, pagat e personelit, mirëmbajtje, blerje e automjeteve ,etj) por të përdoren në aktive fitimprurëse siç janë kredithënia, me të cilin do të plotësonin nevojat e tregut e të ktheheshin me rritje të aktiveve nëpërmjet interesave të arkëtuara nga kreditë e akorduara.

Edhe pse faktorët e tjerë të cilët u morën fillimisht në analizë dhe nuk arritën të kalojnë testin e normalitetit ose treguan multikolionaritet të lartë, nuk duhet neglizhuar pasi që në shumë punime të tjera këtë faktorë si (portofoli i kredisë, kredia mesatare, numri i huamarrësve femra, numri i huamarrësve aktiv, shpenzimet operative/portofolin e kredisë, shpenzimet e personelit/portofolin e kredisë, kosto për huamarrës, cilësia e portofolit) janë treguar të rëndësishëm dhe me ndikim në performancën financiare të IMF-ve në vende të ndryshme.

6.2. REKOMANDIME

Si rezultat i shqyrtimit të literaturës së gjerë, analizës së situatës aktuale të sektorit të mikrofinancës në vend dhe gjetjeve nga modelet ekonometrike në këtë punim, rekomandimet në vijim mund të jenë të dobishme për institucionet mikrofinanciare, mbikëqyrësit dhe gjithashtu për studime në të ardhmen.

Për institucionet mikrofinanciare

- Duhet të rritet transparenca e raportimeve të faktorëve të performancës, pasi kjo do ndihmonte një studim më cilësor dhe të paanshëm dhe me rezultate më domethënëse si për institucionin ashtu edhe donatorët, mbikëqyrësit e sektorit të mikrofinancës në vend.
- Duhet të rritet kontrolli dhe efikasiteti ndaj shpenzimeve operative, pasi që këta janë faktorët më të ndjeshëm dhe me përmirësimin e tyre, do ishte një stimulim më shumë për fituar mbështetje me fonde afatgjatë, duke siguruar vetë qëndrueshmëri operative dhe përmirësim të fitueshmërisë. Rekomandimi vjen si pasojë e rezultateve të modelit ekonometrik ku shpenzimet operative mbi aktivet në çdo formë dolën të jetë burim i problemit për vetëqëndrueshmëri operative dhe kthimi nga aktivet.
- Duhet të shikohet mundësia për zgjerim të rrjetit të IMF-ve edhe në zonat më rural, duke ditur se qasja në shërbime financiare nga bankat vendore atje është e kufizuar.
- Duhet të rritet niveli i kualifikimit të stafit në IMF nëpërmjet punësimit të specialistëve dhe menaxherëve të aftë dhe me eksperiencë në sektorin financiar e bankar.

Për institucionet mbikëqyrëse

- Qeveria duhet të interesohet të krijojë një Fond Garantues i cili do të stimulonte IMF-të për krijuar qëndrueshmëri më të gjatë të IMF-ve në Kosovë, pasi që institucionet mikrofinanciare shihet se janë të interesuar për ta rritur gamën e produkteve që ato ofrojnë. Krijimi i këtij fondi do të ulte riskun e kredidhënies dhe si rrjedhojë edhe koston e saj të reflektuar me norma interesi më të ulëta se deri tani.
- Duhet rishikuar kufiri aktual i normës së interesit mbi kreditë e lëshuara, të jetë i përcaktuar me ligj, ose në bashkëpunim me BQK të vendoset një kufi i sipërm i pranueshëm për tregun, i cili do të mbrojtë klientin dhe do të rrisë konkurrencen midis institucioneve.
- Të krijohen kushte për të rishqyrtuar statusin e IMF-ve me qëllim të zgjerimit krahas kreditimit të klientëve dhe ofrimit të shërbimeve tjera financiare si ai i pagesave, kursimet, depozitet apo transferet e parave dhe pagesa e shërbimeve komunale, të ngjashme siç janë të pranishme në vendet fqinje. Kjo të jetë në përputhje me kornizën ligjore të aplikueshme në Kosovë.

6.3. KUFIZIMET

Në Kosovë gjatë realizimit të këtij punimi sigurohemi se operojnë 13 IMF, megjithatë vetëm 11 raportojnë në MIX, por jo nga të gjitha kemi arritur të mbledhim të dhënat të mjaftueshme cilësore dhe sasiore. Ky punim është përcjellur me disa kufizime të cilat janë të rëndësishme për ti paraqitur.

- Kufizimi i parë. Pyetësi i ndërtuar për nevoja të punimit është shpërndarë në formë elektronike tek 6 IMF-të nga 11 që raportojnë në MIX. Në qoftë se të paktën 6IMF do të na ofronin të dhëna financiare për 12 faktorë të përzgjedhur, për ti analizuar në raport me ndikimin në performancë financiare, do të kishin kontribuar në arritjen e rezultateve më të mira të pritura statistikore.
- Kufizimi i dytë. Pyetësorët janë pranuar vetëm nga të 3IMF nga 6IMF-të të cilat kemi arritur t'i kontaktojnë në formë elektronike (email). Nëse pyetësi të ishte plotësuar nga të gjitha IMF-të të paktën nga 10 të anketuar për secilën IMF, kjo do të na ndihmonte që të marrim perceptim më bindës mbi përzgjedhjen e faktorëve që kemi supozuar se e ndikojnë performancën financiare të IMF-ve në Kosovë.
- Kufizimi i tretë. Në shikim të parë vërehet se në MIX raportojnë 11 IMF që operojnë në Kosovë. Por jo të gjitha raportojnë nga viti i themelimit, dhe jo të gjitha raportojnë për të gjithë faktorët sic është kriter në MIX . Kjo ndodh pasi që IMF-të raportojnë në forma vullnetare në MIX. Kjo ndikon që punimi të mos arrijë të përdor më shumë faktorë që mund të kishin më shumë vlerë për punimin dhe për lexuesin në të ardhmen.

Marrë parasysh kontributin dhe rëndësinë që ofron një punim i pari me i plotësuar mbi përcaktimin e faktorëve të rëndësishëm të performancës financiare të IMF-ve në Kosovë, kjo nuk na ndalon të vazhdojmë me procedurat për rregullimin e të dhënave që kishim për qëllim për studim.

Të dhënat në interes ishin ato për periudhën 2000-2016, megjithatë autorja arrin të siguroj të dhënat më të plota për periudhën nga 2000-2015 ashtu si janë raportuar nga IMF-të në MIX. Pritjet ishin të siguronim të paktën 134 vrojtime nëse merrej parasysh sasia dhe koha

e raportimi nga viti i themelimit për secilën IMF. Megjithatë, jo të gjitha IMF-të raportojnë rregullisht që nga viti i themelimit. Disa IMF raportojnë nga viti i katërt i themelimit, disa raportojnë me ndërprerje gjatë viteve, disa nuk i raportojnë një numër të caktuar të faktorëve, të cilat ndikojnë në përfitim të numrit të madh të vrojtimeve. Pasi që përdorëm procedurat e programit statistikor SPSS, sigurojmë të dhëna midis 77 dhe 101 vrojtimeve, dhe pas rregullimit në modelin ekonometrik përfundojmë me 77 vrojtime, të cilat janë konsideruar reprezentative për këtë punim. Ky proces na detyron të përjashtojmë disa faktorë nga modeli pasi që mungesa e tyre sasore dhe kohore krijonte vështërsi në matjen e rezultateve.

6.3.1. E rëndësishme për studime në të ardhmen

Punimet në të ardhmen të jenë më shumë të zgjeruar, pasi që në punim për të analizuar gjendjen aktuale të sektorit mikrofinanciare janë përdorur të dhënat e raportuara në baza vjetore nga Banka Qendrore e Kosovës, me theks , të dhënat për vitin 2012-2016 .

Të dhënat dytësore të cilat janë marrë për analizë në modelin ekonometrik i takojnë periudhës së vitit 2000-2015 , të cilat janë nxjerrë nga platforma e mirënjohur MIX, në të cilën kanë raportuar 11 IMF-të të cilat operojnë në Kosovë, gjatë kohës që ky hulumtim është realizuar.

Si rezultat nga 12 faktorë që ishte tentuar të jenë më ndikim në performancën financiare të IMF-ve në Kosovë, vetëm tre faktorë dalin të jenë me rëndësi statistikore. Mosha, Madhësia dhe Shpenzimet operative mbi aktivet, të cilat u trajtuan gjatë këtij punimi. Rritja e numrit të faktorëve do të jetë përparësi për punime në të ardhmen.

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

- Alimukhamedova, N. (2013). Contribution of microfinance to economic growth: Transmission channel and the ways to test it. *Business and Economic Horizons (BEH)*, 9(4), 27-43.
- Adeyemi, K. S. (2008). INSTITUTIONAL REFORMS FOR EFFICIENT MICRO FINANCE OPERATIONS IN NIGERIA. PUBLICATION OF THE CENTRAL BANK OF NIGERIA, 26.
- Altay, A. (2007). The challenge for global women poverty: Microfinance (or microcredit) as a solution for women poverty in Turkey. In Papers of the Annual IUE-SUNY Cortland Conference in Economics (pp. 4-21). Izmir University of Economics.fq 6
- Armendáriz de Aghion, B., & Morduch, J. (2000). Microfinance beyond group lending. *Economics of transition*, 8(2), 401-420. (fq 17)
- Arun, Thankom. "Regulating for development: the case of microfinance." *The Quarterly Review of Economics and Finance* 45.2 (2005): 346-357.
- Cheston, S., & Kuhn, L.(2002).Empowering women through microfinance. Draft, Opportunity International.
- Weber, A., & Thomas, I. R. (2005). Key performance indicators. *Measuring and Managing the Maintenance Function*, Ivara.(fq3)
- O'Neill, M. J. (2006). *Measuring workplace performance*. CRC Press.
- Matthews, B., & Ross, L. (2014). *Research methods*. Pearson Higher Ed.
- Armendariz, Beatriz de Aghion, and Jonathan Morduch. "The economics of microfinance." (2005).
- Microfinance and Poverty Reduction by Susan Johnson , Ben Rogaly : First published by Oxfam (UK and Ireland) and ACTIONAID in 1997 . Reprinted by Oxfam GB 1997,1999
- Aemiro, T., & Mekonnen, D. (2012). The financial performance and sustainability of microfinance institutions during the current financial crisis: The case of Amhara Credit and Saving Institution (ACSI) in Ethiopia.*International Journal of Business and Public Management*, 2(2), 81-87.
- Arun, T. G., & Hulme, D. (2008). *Microfinance-A way forward*. Available at SSRN 1297187.

- Barr, M. S. (2005). Microfinance and financial development. *Michigan Journal of International Law*, 26, 271: 282
- Bateman, M. (2011). Microfinance as a development and poverty reduction policy: is it everything it's cracked up to be?
- Bateman, M., & Chang, H. J.(2009).The microfinance illusion. Available at SSRN 2385174.
- Baldi, G., Sadovskis, V., & Šipilova, V. (2014). Economic and Employment Effects of Microloans in a Transition Country.
- Baleci, F., & Heeman, H. (2013). Making Kosovo Work Again: Challenges and Opportunities for Young People. *European Perspectives*, 65-80.
- Banerjee, Abhijit V., Esther Duflo, Rachel Glennerster, and Cynthia Kinnan. "The miracle of microfinance? Evidence from a randomized evaluation." (2013).(fq1)
- Bouman, F. J. (1995). Rotating and accumulating savings and credit associations: A development perspective. *World development*, 23(3), 371-384.
- Bolnick, B. R., & Nelson, E. R. (1990). Evaluating the economic impact of a special credit programme: KIK/KMKP in Indonesia. *The Journal of Development Studies*, 26(2), 299-312.
- Brau, J. C., & Woller, G. M. (2004). Microfinance: A comprehensive review of the existing literature. *Journal of Entrepreneurial Finance*, JEF, 9(1), 1-27.
- Chowdhury, A.(2009). Microfinance as a poverty reduction tool-a critical assessment. United Nations, Department of Economic and Social Affairs (DESA) working paper,(89).
- History matters in microfinance; By Hans Dieter Seibel (2003)
- Claessens, S. (2005). Access to financial services: a review of the issues and public policy objectives. *World Bank Policy Research Working Paper*, (3589).
- Cull, R., Demirgüç-Kunt, A., & Morduch, J. (2008). Microfinance meets the market. *World Bank Policy Research Working Paper Series*, Vol.(fq.2)
- Cheng, E. (2007). The demand for microcredit as a determinant for microfinance outreach-evidence from china. *Savings and Development*, 307-334.

Coleman, B. E. (1999). The impact of group lending in Northeast Thailand. *Journal of development economics*, 60(1), 105-141.

Christen, Robert Peck, and Richard Rosenberg. The rush to regulate: Legal frameworks for microfinance. Consultative group to assist the poorest (CGAP), 2000.

De Aghion, B. A., & Morduch, J. (2004). Microfinance: Where do we stand. *Financial development and economic growth: explaining the links*. (pg 135)

Development Practice in International Settings George Warren Brown School of Social Work April 29, 2008.

Dieckmann, R., Speyer, B., Ebling, M., & Walter, N. (2007). Microfinance: An emerging investment opportunity. Deutsche Bank Research. Current Issues. Frankfurt.

Dowla, A. (2006). In credit we trust: Building social capital by Grameen Bank in Bangladesh. *The Journal of Socio-Economics*, 35(1), 102-122.

Duvendack, M., Palmer-Jones, R., Copestake, J. G., Hooper, L., Loke, Y., & Rao, N. (2011). What is the evidence of the impact of microfinance on the well-being of poor people?

Eriksson, P. E., Kraemer-Eis, H., & Conforti, A. (2011). Microfinance in Europe. *tool of ethical financing for sustainable development*, 49.

Farhodova, L. (2008). Community Driven Development and Microfinance Lutfiya Farhodova, Elizabeth Kimani, Rainier Masa, Mingguo Deng, Kevin Mungai

Fisher, C. M., & Buglear, J. (2010). *Researching and writing a dissertation: an essential guide for business students*. Pearson Education. (pg.106)

Gutierrez-Nieto, B., Serrano-Cinca, C., & Molinero, C. M. (2007). Microfinance institutions and efficiency. *Omega*, 35(2), 131-142.

Gakhar, K. (2013). FINANCIAL PERFORMANCE AND OUTREACH OF MICROFINANCE INSTITUTIONS: IS THERE A TRADE-OFF?-AN EMPIRICAL STUDY OF INDIAN ECONOMY. *Global Management Review*, 7(4). (EBSCO)

Gauthier, M. S. (2012). Microfinance for Post-Conflict Peacebuilding. GEORGE MASON UNIV ARLINGTON VA SCHOOL FOR CONFLICT ANALYSIS AND RESOLUTION.

- Gupta, S. V., Chawla, P. M., & Harkawat, S. (2012). MEASURING PERFORMANCE OF MICROFINANCE INSTITUTIONS IN INDIA. *Annamalai International Journal of Business Studies & Research*, 4(1). (EBSCO)
- Gujarati, D. N., & Porter, D. C. (1999). *Essentials of econometrics*.
- Hartarska, Valentina, Xuan Shen, and Roy Mersland. "Scale economies and input price elasticities in microfinance institutions." *Journal of Banking & Finance* 37.1 (2013): 118-131.
- Hermes, N., & Lensink, R. (2007). The empirics of microfinance: what do we know?. *The Economic Journal*, 117(517), F1-F10.) (F1)
- Hermes, N., & Lensink, R. (2011). Microfinance: its impact, outreach, and sustainability. *World development*, 39(6), 875-881. (fq5,14)
- Hollis, A., & Sweetman, A. (1998). Microcredit: What can we learn from the past?. *World Development*, 26(10), 1875-1891.
- Hubka, A., & Zaidi, R. (2005). Impact of government regulation on microfinance (fq1)
- Hulme, D. (2000). Impact assessment methodologies for microfinance: Theory, experience and better practice. *World development*, 28(1), 79-98.
- Hulme, D., & Arun, T. (Eds.). (2009). *Microfinance: A reader*. Routledge. (LIBER)
- Javid, A. Y., & Abrar, A. *Microfinance Institutions and Poverty Reduction: A Cross Region Analysis*.
- Jegede, C. A., Kehinde, J., & Akinlabi, B. H. (2011). Impact of microfinance on poverty alleviation in Nigeria: An empirical investigation. *European journal of humanities and social sciences*, 2(1), 97-111.
- Joanna, L. (1999). *Microfinance handbook: an institutional and financial perspective*. World Bank, Washington DC.
- Johnson, S., & Rogaly, B. (1997). *Microfinance and poverty reduction*. Oxfam.
- Janda, K., & Turbat, B. (2013). Determinants of the financial performance of microfinance institutions in Central Asia. *Post-Communist Economies*, 25(4), 557-568. (EBSCO)
- Karlan, D. S., & Goldberg, N. (2007). Impact evaluation for microfinance: Review of methodological issues. *World Bank, Poverty Reduction and Economic Management, Thematic Group on Poverty Analysis, Monitoring and Impact Evaluation*. fq 3

- Karnani, A. (2007). Microfinance misses its mark. Retrieved February, 18, 2009.
- Kinde, B. A. (2012). Financial sustainability of microfinance institutions (MFIs) in Ethiopia. *European Journal of Business and Management*, 4(15), 1-10.
- Kothari, C. R. (2004). Research methodology: Methods and techniques. Neë Age International.
- Kodderitzsch, S., & Veillerette, B. (1999). Kosovo: Re-launching the Rural Economy. A Medium Term reconstruction and Recovery Program, ECSSD Environmentally and Socially Sustainable Development Working Paper, (19).
- Kume, V., Koxhaj, A., & Kume, A. (2009). SMEs—A key Factor for Economic Growth and Employment. *Journal of Entrepreneurships and Innovation*, 1.
- Kraemer-Eis, H., & Conforti, A. (2009). Microfinance in Europe. A market overview. EIF Research & Market Analysis. Working Paper 2009, 1.
- Kraemer-Eis, H., & Conforti, A. (2009). Microfinance in Europe. A market overview. EIF Research & Market Analysis. Working Paper 2009, 1.
- Lafourcade, A. L., Isern, J., Mëangi, P., & Brown, M. (2005). Overview of the outreach and financial performance of microfinance institutions in Africa. Microfinance Information eXchange, Washington, DC. http://www.MIX.org/medialibrary/MIX/Africa_Data_Study.pdf.
- Ledgerwood, J. (1998). Microfinance handbook: An institutional and financial perspective. World Bank Publications.
- Ledgerwood, J. (1999). Sustainable banking with the poor microfinance handbook.
- Ledgerwood, J., Earne, J., & Nelson, C. (Eds.). (2013). The new microfinance handbook: A financial market system perspective. World Bank Publications.
- Leikem, K. (2012). Microfinance: A Tool for Poverty Reduction?.
- Lützenkirchen, C., Weistroffer, C., Speyer, B., & AG, D. B. (2012). Microfinance in evolution. An industry between crisis and advancement,,Deutsche Bank Research “, September, 13(fq.3)
- MacIsaac, N., & Branch, A. (1997). The role of microcredit in poverty reduction and promoting gender equity: A discussion paper. report to CIDA, macisaac@mos.com.np.

- McIntosh, C., Villaran, G., & Wydick, B. (2011). Microfinance and home improvement: using retrospective panel data to measure program effects on fundamental events. *World Development*, 39(6), 922-937.
- Meyer, R. L. (2013). Microcredit and agriculture: challenges, successes, and prospects. *Microfinance in Developing Countries: Issues, Policies and Performance evaluation*, Gueyie, JP., Manos, R et Yaron, J. éd.(New York: Palgrave Macmillan), 199-222.
- Mishkin, F. S. (2009). Is monetary policy effective during financial crises?(No. w14678). National Bureau of Economic Research.fq5(a)
- Molenaar, K. (2009). Microfinance, its concepts and development, lessons to draw for Europe. *European Microfinance Network*.(f 3,10)
- Morduch, Jonathan. "The microfinance promise." *Journal of economic literature* 37, no. 4 (1999): 1569-1614.(fq18)
- Morduch, J. (2000). The microfinance schism. *World development*, 28(4), 617-629.(fq.617)
- Nagarajan, G. (2004). *Microfinance Research in Conflict Environments: State of the Art and the Road Forward*. Micronotes Issues, 2.
- Navajas, S., Schreiner, M., Meyer, R. L., Gonzalez-Vega, C., & Rodriguez-Meza, J. (2000). Microcredit and the Poorest of the Poor: Theory and Evidence from Bolivia. *World development*, 28(2), 333-346.
- Nyamsogoro, G. D. (2010). *Financial sustainability of rural microfinance institutions (MFIs) in Tanzania* (Doctoral dissertation, University of Greenwich).
- Otero, Maria. "Bringing development back, into microfinance." *Journal of Microfinance/ESR Review* 1.1 (1999): 8-19. (fq.8)
- Quadrat-I Elahi, K., & Lutfur Rahman, M. (2006). Micro-credit and micro-finance: functional and conceptual differences. *Development in Practice*, 16(5), 476-483.
- Rahman, M. A., & Mazlan, A. R. (2014). Determinants of Financial Sustainability of Microfinance Institutions in Bangladesh. *International Journal of Economics and Finance*, 6(9), 107.(109)
- Rhyne, E. (1998). The yin and yang of microfinance: Reaching the poor and sustainability. *MicroBanking Bulletin*, 2(1), 6-8.

- Rhyne, E. (1998). The yin and yang of microfinance: Reaching the poor and sustainability. *MicroBanking Bulletin*, 2(1), 6-8.
- Robinson, M. S. (2001). *The microfinance revolution: sustainable finance for the poor*. World Bank Publications. (pg9,22)
- Rodrik, D., & Rosenzweig, M. (2009). Access to Finance Chapter 2, *Handbook of Development Economics*, Volume 5.(70)
- Roy, M. A. (2003). *Microfinance as a Tool for Development*. Schulich School of Business.
- Shaw, J., & Clarke, M. (2004). *Risky business in Bougainville: implementing microfinance in post-conflict environments*. Unpublished.
- Schreiner, M. (2000) "Ways Donors Can Help the Evolution of Sustainable Microfinance Organizations", *Savings and Development*, Vol. 24, No. 4, pp. 423–437.
- Schreiner, M. (2001). Informal finance and the design of microfinance. *Development in Practice*, 637-640.
- Schreiner, M. (2002). Aspects of outreach: A framework for discussion of the social benefits of microfinance. *Journal of international development*, 14(5), 591-603.
- Schreiner, M. (2004). *Support for Microenterprise as Asset-Building: Concepts, Good Practices, and Measurement*. Center for Social Development, Washington University, Saint Louis.
- Seibel, H. D. (2003). History matters in microfinance (No. 2003, 5). Working paper/University of Cologne, Development Research Center.
- Seibel, H. D. (2005). Does history matter? The old and the new world of microfinance in Europe and Asia (No. 2005, 10). Working paper/University of Cologne, Development Research Center.
- Sengupta, R., & Aubuchon, C. P. (2008). The microfinance revolution: An overview. *Federal Reserve Bank of St. Louis Review*, 90(January/February 2008).,
- Simmons, P. J. (1998). Learning to live with OJQs. *Foreign policy*, 82-96.
- Sinha, A. K., & Shankar, N. (2014). *Building Sustainable & Profitable Micro-Finance Institution in India in Changing Regulatory Environment*. Available at SSRN 2403381.
- Srnc, K., & Svobodová, E. (2009). Microfinance in less developed countries: history, progress, present—charity or business?. *Agricultural Economics—czech*, 55, 467-474.

- Stigler, G. J. (1961). The economics of information. *The journal of political economy*, 213-225.
- Taylor, D., & Procter, M. (2008). The literature review: a few tips on conducting it. Writing Support, University of Toronto. Retrieved, 19.
- Tarnoff, C. (2001, June). Kosovo: Reconstruction and Development Assistance. Congressional Research Service, Library of Congress.
- Vathi, Z., & Black, R. (2007). Migration and poverty reduction in Kosovo. Development Research Centre on Migration, Globalisation, and Poverty, Falmer, Brighton, UK.
- Vetrivel, S. C., & Kumarmangalam, S. C. (2010). Role of microfinance institutions in rural development. *International Journal of Information Technology and Knowledge Management*, 2(2), 435-441.(435)
- Webster, J., & Watson, R. T. (2002). Analyzing the past to prepare for the future: Writing a literature review. *Management Information Systems Quarterly*, 26(2), 3.
- Wilson, T. (2002). Microfinance during and after armed conflict: Lessons from AOJQla, Cambodia, Mozambique and Rwanda. Durham: Mountjoy Research Centre.
- Woller, G. M., Dunford, C., & Woodworth, W. (1999). Where to microfinance. *International Journal of Economic Development*, 1(1), 29-64.
- Wrenn, E. (2005). Microfinance-Literature Review. Trocaire
http://www.dochais.ie/documents/microfinance_literature_review.pdf.
- Yunus, M. (2003, January). Expanding microcredit outreach to reach: The Millennium Development Goal—Some Issues for Attention. In International seminar on attacking poverty with microcredit, Dhaka (pp. 8-9).
- Yunus, Muhammad. "The Grameen Bank." *Scientific American* 281.5 (1999): 114-119.
- Zeller, M., & Meyer, R. L. (Eds.). (2002). The triangle of microfinance: Financial sustainability, outreach, and impact. Intl Food Policy Res Inst.
- EXCLUSION, P. O. F. (2008). Financial Services Provision and Prevention of Financial Exclusion.
- Overview of the Microcredit Sector in the European Union, 2008-2009: (Jayo et al 2010)
<http://www.microfinancegateway.org/sites/default/files/mfg-en-paper-overview-of-the-microcredit-sector-in-the-european-union-jun-2010.pdf>

From exclusion to inclusion through microfinance: fq(6)

http://www.emnconference.org/archives/data/file/14_euro_report.pdf

Overview of the Microcredit Sector in the European Union 2010-2011 (Bendig et al ,2012)

<http://www.european-microfinance.org/index.php?rub=publications&pg=microfinance-overview-surveys&speg=overview-2010-2011>

Performance indicators for microfinance institutions: Technical guide. Inter-American Development Bank, 2003.

Udhëheqja dhe pjesëmarrja e grave ne politikë (UNDP,2014)
<http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/PublicPulse/PPOnWomen/SHQIP%2001-1.pdf>

Programi i Kosovws per Barazi Gjinore – (PKBGJ)

<http://www.womensnetwork.org/documents/20130529105303566.pdf>

Qendra rajonele per mikrofinancen (MFC)

<http://www.mfc.org.pl/en/about>

REPORT Microcredit for small businesses and business creation: bridging a market gap

<http://www.microfinancegateway.org/sites/default/files/mfg-en-paper-microcredit-for-small-businesses-and-business-creation-bridging-a-market-gap-2003.pdf>

Kosova ne shifra 2013

https://ask.rks-gov.net/publikimet/doc_download/1116-kosova-ne-shifra-2013

Administrimi dhe Qeverisja ne Kosove,2005

http://www.kipred.org/repository/docs/Rehabilitimi_i_Shoq%C3%ABrive_t%C3%AB_shk_at%C3%ABrruara nga_lufta_607584.pdf

Vlerësimi i Sistemit Inovativ të Kosovës

http://www.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/Klima_e_Biznesit_ne_Kosove_-_20141415956437.pdf

Raporti Vjetor , BQK 2005, 2006,2009,2010 ,211

MF Country Report No. 11/210

<http://MIX.org/>

Amik.org/shqip/?page_id=6982

Udhëheqja dhe pjesëmarrja e grave në politikë (UNDP,2014)

<http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/PublicPulse/PPOnËomen/SHQIP%2001-1.pdf>

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore –

(PKBGJ)w<http://www.womensnetwork.org/documents/20130529105303566.pdf>

Raporti Statistikor mbi Institucionet Mikrofinanciare,xxxx

LIGJI Nr. 04/L-093 PËR BANKAT INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKAR (fq 2,3)

Financimi Bujqësor në Kosove-Raport Studimi

http://bujqesia.org/ëp-content/uploads/2015/11/2014-10-study-paper_agrifinance-kosovo_for-publication_albanian.pdf

The Economic Sustainability of Post- Conflict Kosovo: JAMES P.KOROVILAS: Post–Communist Economies,Vol.14.No.1.2002: Cerfax Publishing

Kosovo: Reconstrucion and Development Assistance (Tarnoff, 2001)

SHTOJCA

Tabela 40. Tabela e statistikave

	N	Minimum	Maximum	Mean	Deviation
Variablat e varura					
OSS	94	22.18	251.39	106.4576	39.22994
ROA	83	-81.98	16.03	-1.2858	12.23202
Variablate e pavarura					
Mosha	101	1	16	8.1	4.063
LnMADH	96	12.94	18.06	15.6945	1.16967
LnBPK	100	12.05	17.9	15.5238	1.22379
MesKredi	90	514	10186	2114.24	1400.683
NakHuam	90	60	21083	5311.6	4857.917
FemHuam	82	3.6	100	32.5702	24.65765
ShO_AK	79	5.24	46.4	15.4392	6.54303
SHO_PK	81	5.62	53.53	17.6651	7.69702
SHP_PK	73	2.69	20.21	9.3347	3.52225
KosHuam	76	77	829	338.93	144.193
Valid N (listwise)	63				

Tabela 41: Përshkrimi i variablave

<i>Emërtimi</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Emërtimi i Variablat ne model</i>
Mosha e IMF-se	Vitet e IMF sipas fazave te operimit	<i>Mosha</i>
Madhësia e IMF-së	Madhësia e IMF-së e matur me vlerën e gjithsejte aktiveve te saj	<i>LnMadh</i>
Bruto portfolio e kredive	Gjithsejtë portfolio I kredive (Aktive)	<i>LnBPK</i>
Mesatare e kredise	Bruto portofoli I kredise / numri aktiv I huamarresve	<i>MesKredi</i>
Numri aktiv I huamarresve	Numrit aktiv te huamarresve	<i>NakHuam</i>
Klientët Femra	Përqindja e klientëve femrave te shërbyer nga IMF-te	<i>FemHuam</i>
Shpenzimet Operative mbi aktivet	Raporti i shpenzimeve operative mbi aktivet	<i>SHO_AK</i>
Shpenzimet operative	Raporti i shpenzimeve operative në portofolit bruto të kredisë	<i>SHO_PK</i>
Shpenzimet e personelit	Raporti i shpenzimeve të personelit e në portofolit bruto të kredisë	<i>SHP_PK</i>
Kostoja për huamarrës	Shpenzimet operative për numrin aktive te huamarrësve	<i>KostHuam</i>

Tabela 42. Tabelat e kryqëzuara per statusin e IMF-ve (2tabelat)

STROA * Statusi Crosstabulation					
			Statusi		Total
			IMF- OJQ	IMF-IFJB	
STROA	Negative	Count	23	8	31
		% within Statusi	39.70%	32.00%	37.30%
		% of Total	27.70%	9.60%	37.30%
	Pozitive	Count	35	17	52
		% within Statusi	60.30%	68.00%	62.70%
		% of Total	42.20%	20.50%	62.70%
Total		Count	58	25	83
		% within Statusi	100.00%	100.00%	100.00%
		% of Total	69.90%	30.10%	100.00%
STOSS * Statusi Crosstabulation					
			Statusi		Total
			IMF- OJQ	IMF-IFJB	
STOSS	OSS nen 100%	Count	27	10	37
		% within Statusi	41.50%	34.50%	39.40%
		% of Total	28.70%	10.60%	39.40%
	OSS mbi 100%	Count	38	19	57
		% within Statusi	58.50%	65.50%	60.60%
		% of Total	40.40%	20.20%	60.60%
Total		Count	65	29	94
		% within Statusi	100.00%	100.00%	100.00%
		% of Total	69.10%	30.90%	100.00%

Tabela 43. Tabela e kryqëzuar sipas fazave te operimit

STOSS * FazatOperim Crosstabulation						
			FazatOperim			Total
			Faza e pare	Faza e dyte	Faza e trete	
STOSS	OSS nen 100%	Count	9	7	21	37
		% within FazatOperim	64.30%	23.30%	42.00%	39.40%
		% of Total	9.60%	7.40%	22.30%	39.40%
	OSS mbi 100%	Count	5	23	29	57
		% within FazatOperim				
		% of Total	35.70%	76.70%	58.00%	60.60%
Total		% of Total	5.30%	24.50%	30.90%	60.60%
		Count	14	30	50	94
		% within FazatOperim	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%
		% of Total	14.90%	31.90%	53.20%	100.00%

STROA * FazatOperim Crosstabulation						
			FazatOperim			
			Faza e pare	Faza e dyte	Faza e trete	Total
STROA	Negative	Count	4	7	20	31
		% within FazatOperim	44.40%	26.90%	41.70%	37.30%
		% of Total	4.80%	8.40%	24.10%	37.30%
	Pozitive	Count	5	19	28	52
		% within FazatOperim	55.60%	73.10%	58.30%	62.70%
		% of Total	6.00%	22.90%	33.70%	62.70%
Total		Count	9	26	48	83
		% within FazatOperim	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%
		% of Total	10.80%	31.30%	57.80%	100.00%

Tabela 44. Testi i normalitetit – faktorët e përfshirë në modelin e regresionit

Tests of Normality						
	Kolmogorov-Smirnov ^a			Shapiro-Wilk		
	Statistic	df	Sig.	Statistic	df	Sig.
Mosha	0.077	74	.200 [*]	0.976	74	0.171
LnMADH	0.052	74	.200 [*]	0.99	74	0.813
LnBPK	0.053	74	.200 [*]	0.989	74	0.745
ShO_AK	0.056	74	.200 [*]	0.975	74	0.141
SHO_PK	0.069	74	.200 [*]	0.973	74	0.112
KosHuam	0.072	74	.200 [*]	0.973	74	0.108
a. Lilliefors Significance Correction						
*. This is a lower bound of the true significance.						

Tabela 45. Statistikat përshkruese- krahasimi i mesatareve IMF-ve sipas statusit

MESATARE MIDIS IMF- Sipas Statusit													
Statusi		ROA	OSS	Mosha	LnMADH	LnBPK	MesKredi	NakHuam	FemHuam	ShO_AK	SHO_PK	SHP_PK	KosHuam
IMF-OJQ	Mean	-2.4338	104.3662	8.46	15.327	15.1609	2057.31	4121.28	34.564	16.7142	19.3013	10.1702	354.79
	N	58	65	70	67	70	65	65	58	55	56	50	53
	Std. Deviation	13.93683	40.25824	3.981	1.1136	1.17387	1402.463	3952.2	27.37329	6.80778	7.79747	3.52606	140.824
IMF-IFJB	Mean	1.3776	111.1452	7.29	16.5435	16.3705	2262.28	8406.44	27.7521	12.5175	14	7.5183	302.39
	N	25	29	31	29	30	25	25	24	24	25	23	23
	Std. Deviation	6.27113	37.07035	4.197	0.80554	0.88018	1413.772	5660.988	15.81187	4.85581	6.15686	2.80613	148.339
Total	Mean	-1.2858	106.4576	8.1	15.6945	15.5238	2114.24	5311.6	32.5702	15.4392	17.6651	9.3347	338.93
	N	83	94	101	96	100	90	90	82	79	81	73	76
	Std. Deviation	12.23202	39.22994	4.063	1.16967	1.22379	1400.683	4857.917	24.65765	6.54303	7.69702	3.52225	144.193

Tabela 46. Tabela e korrelacionit midis variablave të varura me ato të pavarura

Korrelacioni												
	OSS	ROA	Mosha	LnMADH	LnBPK	MesKredi	NakHuam	FemHuam	ShO_AK	SHO_PK	SHP_PK	KosHuam
OSS	1	.706**	-0.141	0.123	0.145	0.002	0.047	0.109	-.519**	-.499**	-.431**	-.343**
ROA	.706**	1	-.261*	.246*	.249*	-0.145	0.091	0.014	-.640**	-.621**	-.343**	-.238*
Mosha	-0.141	-.261*	1	.446**	.477**	-0.131	.417**	.237*	0.198	0.165	.302**	0.05
LnMADH	0.123	.246*	.446**	1	.995**	-0.033	.864**	0.115	-.378**	-.403**	-.378**	-0.175
LnBPK	0.145	.249*	.477**	.995**	1	0.005	.841**	0.091	-.365**	-.398**	-.368**	-0.171
MesKredi	0.002	-0.145	-0.131	-0.033	0.005	1	-0.1	-0.215	-0.224	-.288*	-0.191	.486**
NakHuam	0.047	0.091	.417**	.864**	.841**	-0.1	1	0.119	-0.141	-0.181	-0.146	-0.121
FemHuam	0.109	0.014	.237*	0.115	0.091	-0.215	0.119	1	0.032	0.049	-0.048	-0.163
ShO_AK	-.519**	-.640**	0.198	-.378**	-.365**	-0.224	-0.141	0.032	1	.983**	.814**	.441**
SHO_PK	-.499**	-.621**	0.165	-.403**	-.398**	-.288*	-0.181	0.049	.983**	1	.836**	.385**
SHP_PK	-.431**	-.343**	.302**	-.378**	-.368**	-0.191	-0.146	-0.048	.814**	.836**	1	.579**
KosHuam	-.343**	-.238*	0.05	-0.175	-0.171	.486**	-0.121	-0.163	.441**	.385**	.579**	1
** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).												
* . Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).												

PYETESORI

Jam Qefsere Kupina, doktorante pranë Universitetit Evropian të Tiranës, dhe ky pyetësor është pjesë e punimit, “Performanca financiare e IMF-ve në Kosovë” që për qëllim ka identifikimin dhe vlerësimin e faktorëve të performancës të IMF-ve që operojnë në Kosovë.

Duke e plotësuar këtë pyetësor ju do të kontribuoni në realizmin e këtij punimi.

Përgjigjet do të përpunohen dhe do të përdoren vetëm për qëllim të realizimit të këtij punimi dhe në asnjë rast nuk do të publikohen si material i ndarë për qëllime tjera.

Duke e shënuar me shenjën √ në hapësirat e zbrazëta (√) ju lutem ofroni informacionin që është më i saktë sipas mendimit tuaj.

PJESA E PARË : INFORMACIONE TË PERGJITHSHME

Emri i Institucionit _____

Pozita që ju ushtroni ne institucion _____

1. Kur keni filluar të operoni ne Kosovë si IMF?

- Më pak se 5 vite ()
- 5-10 vite()
- Mbi 10 vite.....()

2. Shëno statusin me te cilin aktualisht operoni ne Kosovë.

- OJQ (Organizate Joqeveritare)..... ()
- IFJB(Institucion Financiar Jo Bankar) ()
- Tjetër (specifikojeni).....()

3. Pronësia e Institucionit tuaj është?

- I huaj (specifiko) _____
- Vendor (specifiko)_____
- I huaj dhe vendor (specifiko)_____

4. Cili është lloji i investimit për te zhvilluar aktivitet ne Kosovë?

- Grante.....,()
- Donacion()
- Qeveri.....()
- Kredi Bankare,()
- Tjetër (specifiko)_____

5. Cili është qëllimi kryesor i themelimit të institucionit ?

- Ulja e varfërisë (Social).....()

- Fitimprurese.....()
- Te dyja.....()

6. Sa punonjës numëron institucioni juaj?

- 20 deri 50..... ()
- 50 deri 100... ()
- Mbi 100.....()

7. Ndarja e punonjësve sipas gjinisë në institucionin (ne përqindje) ?

- Femra _____
- Meshkuj _____

8. Shëno numri e zyrave /degëve me të cilat operoni në Kosovë ?

- 0 deri 5()
- 6 deri 10.....()
- 11 deri 20.....()
- Mbi 20.....()

9. Si e keni të organizuar shtrirjen e zyrave/degëve sipas vendeve? (paraqit numrin)

- Urbane _____
- Rurale _____

10. Numri i klientëve aktiv?

- 0 deri 1000
- 1001 deri 3000
- 3001 deri 5000
- Mbi 5000

11. Mesatare e kredisë për klientë (Euro) ?

- Deri ne 100
- 100 deri 500
- 500 deri 2000
- 2000 deri 5000
- Mbi 5000

12. Cilat lloje të produkteve/shërbimeve ofroni?

PJESA E DYTË- PËRCAKTUESIT E PERFORMANCES FINANCIARE TË IMF-VE

Në tabelën1. më poshtë janë faktorët kryesor që konsiderohen të kenë ndikim në **PERFORMANCEN FINANCIARE** të institucionit mikrofinanciar.

Sipas përvojës tuaj në institucion, ju lutem **që me shenjë (√) të paraqitni vlerësimin tuaj.**

5 =pajtohem fuqishëm 4= pajtohem 3= pavendosur 2 = nuk pajtohem 1 = fuqishëm nuk pajtohem

FAKTORËT		VLERESIMI					SHËNIM SHITESI MBI FAKTORIN
		1	2	3	4	5	
1	Madhësia e IMF-se (e matur me vlerën e aktiveve)						
2	Mosha e IMF-se (e matur me vitet e operimit)						
3	Statusi I IMF-se						
4	Portofoli i kredisë						
5	Numri aktiv i huamarrësve						
6	Kthimi nga aktive						
7	Kthimi mbi kapitalin						
8	Vetëqëndrueshmëria operative						
9	Mesatare e kredisë						
10	Përqindja huamarrësve femra						
11	Shpenzimet Operative/portfolion e kredisë						
12	Shpenzimet e personelit/Portfolio e kredisë						
13	Shpenzimet për huamarrës						
14	Vlera e kredive të shlyera (Ërite off)						
15	Portofoli ne Risk (PAR 30dite)						

PJESA E TRETE : PYETJE GJENERALE

Sipas mendimit tuaj, cilat janë sfidat të cilat ndikojnë në performance financiare të institucionit mikrofinanciar ne Kosove?

.....

.....

Çfarë mendoni se duhet te ndryshoj menaxhmenti i institucionit në drejtim që institucioni juaj të vazhdoj të operoj me sukses dhe i vetëqëndrueshëm?

.....

.....

.....

Cilat janë problemet (nëse ka) lidhur me politikat qeveritare(ligje, rregullore,etj) që duhet adresuar me qëllim që të promovoni aktivitet e institucionit tuaj.

.....

.....

Nëse mendoni se keni ndonje çështje të rëndësishme që ndërlidhet me performancën financiare te institucionit mikrofinanciare ju lutem e shenoni.

.....

.....

Ju faleminderit për kohen,